




REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe



**Doracak mbi kthimin efektiv
të aseteve në përputhje**
me standardet evropiane dhe ndërkombëtare

Doracak mbi kthimin efektiv të aseteve
në përputhje me standardet evropiane
dhe ndërkombëtare

Titulli:	Doracak mbi kthimin efektiv të aseteve në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare
Projekti:	Forcimi i antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes përmirësimit të masave për sekuestrimin e aseteve
Botuesit:	Këshilla për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE) Nisma Rajonale Antikorrupsion (RAI)
Për botuesit:	Biljana Braithwaite Vladan Joksimović
Redaktorët:	Eldan Mujanović Darko Datzer
Autorët:	Krešimir Kamber, Will Ferris, Catharina Harby (Standardet ndërkombëtare dhe evropiane) Eriona Haxhia, Artur Selmani (Shqipëri) Eldan Mujanović, Darko Datzer (Bosnje dhe Hercegovinë) Ganimete Ismajli (Kosovë*) Aleksa Ivanović (Mali i Zi) Mirjana Lazarova Trajkovska (Maqedonia e Veriut) Radmila Dragičević Dičić (Serbi)
Përkthimi dhe korrektimi:	Lumnije Ahmeti, Kimete Cimili, Adelina Albrahimi (në gjuhën shqipe) Maja Andrić, Duška Tomanović (në gjuhën BKMS) Duška Tomanović (në gjuhën angleze) Zoran Gavriloski (në gjuhën maqedonase)
Ekipi i RAI-t dhe AIRE-s:	Desislava Gotskova, Aida Trožić
Referencat dhe DTP-ja:	Adnan Fazlić
Faqosja:	Marko Milićević, Klikker Design

* Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GjND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Përmbajtja

PARATHËNIE.....	9
Lista e Shkurtimeve	10
I. HYRJE	11
II KONFISKIMI I TË ARDHURAVE NGA KORRUPSIONI: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I UDHËZIMEVE DHE I STANDARDEVE TË KOMBEVE TË BASHKUARA, KËSHILLIT TË EVROPËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN	16
2.1. HYRJE	16
2.1.1 Çfarë është konfiskimi?	16
2.1.2 Pse ka rëndësi konfiskimi?	17
2.2 STANDARDET NDËRKOMBËTARE	17
2.2.1 Konventat e Kombeve të Bashkuara	17
2.2.2 Instrumentet e Këshillit të Evropës	18
2.2.3 Instrumentet e Bashkimit Evropian	19
2.2.4 Instrumentet e tjera ndërkombëtare	20
2.3. QASJA E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE LIDHUR ME ASPEKTET KRYESORE TË KONFISKIMIT	20
2.3.1 Urdhrat për ngrirje dhe kompetencat për hetim	20
2.3.2 Konfiskimi i zakonshëm (i bazuar në dënim)	21
2.3.3 Konfiskimi i vlerës dhe pëzierja	21
2.3.4 Konfiskimi i mjeteve	22
2.3.5 Konfiskimi i të ardhurave dhe përfitimeve të tjera që rrjedhin nga produktet e krimit dhe korrupsionit	22
2.3.6 Tjetërsimi i barrës së provës	23
2.3.7 Konfiskimi nga pala e tretë	23
2.3.8 Konfiskimi i bazuar në mosdënim	24
2.3.9 Bashkëpunimi ndërkombëtar	25
2.3.10 Masat mbrojtëse	25
2.4 ORGANET MONITORUESE TË KËSHILLIT TË EVROPËS	25
2.4.1 GRECO	25
2.4.2 MONEYVAL-i	26
2.5 KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	26
2.5.1 Neni 1 i Protokollit 1	27
2.5.2 Neni 6.....	39
2.5.3 Neni 7.....	44
2.5.4 Neni 8.....	47
III. ANALIZË KRAHASUESE E PROCESVEVE TË KTHIMIT TË PASURISË	51
3.1. SHQIPËRIA	51
3.1.1. Hetimet financiare	51
3.1.2. Masat e përkohshme (ngrirja dhe sekuestrimi i produkteve të krimit)	55
3.1.3. Procedurat e konfiskimit	60

3.1.4. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatës lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprave penale	65
3.2. BOSNJA DHE HERCEGOVINA	70
3.2.1. Hetimet financiare	70
3.2.2. Masat e përkohshme të sigurimit të dobisë pronësore (bllokimi/ngriri/sekuestrimi /konfiskim i përkohshëm)	75
3.2.3. Veprimet për sekuestrim të përhershëm të dobisë pronësore, të përfituar me vepër penale	79
3.2.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë	83
3.3. MALI I ZI (MZ)	88
3.3.1. Hetimet Financiare	88
3.3.2. Masat e përkohshme të sigurimit të pasurisë (bllokimi/ngriri dhe konfiskimi/ sekuestrimi i përkohshëm)	91
3.3.3. Veprimet për sekuestrim të përhershëm të produkteve të veprave penale	94
3.3.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë	97
3.4. KOSOVA*	100
3.4.1. Hetimi financiar	100
3.4.2. Masat e përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore (bllokimi/ngriri dhe sekuestrimi /konfiskimi i përkohshëm)	104
3.4.3. Procedura për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale.....	107
3.4.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për konfiskimin e përkohshëm dhe të përhershëm të dobisë pasurore	109
3.5. MAQEDONIA E VERIUT	112
3.5.1. Hetimi financiar	112
3.5.2. Masat e përkohshme të sigurimit të dobisë pasurore (bllokimi /ngriri dhe sekuestrimi).....	116
3.5.3. Procedurat për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale	118
3.5.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për konfiskim dhe sekuestrim të dobisë pasurore	121
3.6. SERBIA	123
3.6.1. Hetimi financiar	123
3.6.2. Masat e përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore (bllokimi/ngriri dhe sekuestrimi/konfiskimi i përkohshëm)	127
3.6.3. Veprimet për konfiskimin e dobisë pasurore, të fituara me vepër penale	130
3.6.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për konfiskimin dhe sekuestrimin e dobisë pasurore	134

IV. KONFISKIMI I ZGJERUAR NË ASPEKTIN KRAHASUES137

4.1. SHQIPËRIA	137
4.1.1 Korniza ligjore e konfiskimit të zgjeruar	137
4.1.2. Fushëveprimi i ligjit	137
4.1.3. Standardet dëshmuese (prezumimet ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës, dhe të tjerat)	137
4.2. BOSNJA DHE HERCEGOVINA	139
4.2.1. Korniza ligjore për konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore	139
4.2.2. Fushëveprimi.....	139
4.2.3. Kriteret e dëshmisë (baza ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës, etj.)...	140
4.3. MALI I ZI	142
4.3.1. Korniza ligjore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore	142
4.3.2. Fushëveprimi	142

4.3.3. Kriteret e dëshmisë (baza ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës, etj.)...	143
4.4. KOSOVA*	144
4.4.1. Korniza ligjore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore	144
4.4.2. Fushëveprimi.....	144
4.4.3. Kriteret e dëshmisë (baza ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës etj.)....	145
4.5. MAQEDONIA E VERIUT	147
4.5.1. Korniza ligjore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore	147
4.5.2. Fushëveprimi	147
4.5.3. Kriteri i dëshimit (baza ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës, etj.).....	148
4.6. SERBIA	149
4.6.1. Korniza ligjore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pronësore	149
4.6.2. Fushëveprimi.....	149
4.6.3. Kriteret e dëshmisë (baza ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës, etj.)...	150

V. PËRFUNDIME151

5.1. PASQYRË E OBJEKTIVAVE DHE STANDARDEVE TË KOMBEVE TË BASHKUARA, KËSHILIT TË EVROPËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN	151
5.2. ANALIZA KRAHASUESE E LEGJISLACIONIT	151
5.2.1. Hetimi financiar	151
PASQYRA E ELEMENTEVE PËR HETIMIN FINANCIAR, NË BAZË TË LEGJISLACIONEVE TË ANALIZUARA	154
5.2.2. Masat e përkohshme të sigurimit	155
PASQYRA E ELEMENTEVE TË KONFISKIMIT TË ZGJERUAR TË DOBISË PASURORE, NË BAZË TË LEGJISLACIONEVE TË ANALIZUARA.....	157
5.2.3. Konfiskimi i zgjeruar	158
PASQYRA E ELEMENTEVE TË KONFISKIMIT TË ZGJËRUAR TË DOBISË PASURORE, NË BAZË TË ANALIZËS SË LEGJISLACIONEVE	161
5.3. ANALIZA KRAHASUESE E PËRVOJAVE PRAKTIKE NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONEVE.....	162
5.3.1. Hetimi financiar	162
5.3.2. Masat e përkohshme të sigurimit	164
5.3.3. Konfiskimi i zgjeruar	165

VI. LITERATURA.....167

PARATHËNIE

Kthimi i aseteve është ide e thjeshtë, është kthimi ligjor i përfitimeve të paligjshme. Megjithatë, në praktikë, kthimi i aseteve është fushë komplekse dhe shumëdimensionale e ligjit, e cila shpesh kërkon procedura të ndërlikuara praktike dhe përfshin shumë palë dhe juridiksione. Komplexiteti praktik kërkon që gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët punojnë në këtë fushë, të posedojnë njohuri të mira lidhur me legjislacionin e tyre të brendshëm që ka të bëjë me ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin, si edhe të kenë njohuri solide mbi standardet dhe instrumentet ndërkombëtare që përipiqen ta forcojnë dhe ta harmonizojnë praktikën ndërkombëtare.

Në vitin 2017, Qendra AIRE (Këshilla për të Drejta Individuale në Evropë) dhe RAI (Nisma Rajonale Antikorrupsion) filluan të punojnë së bashku për të mbështetur juridiksionet e vendeve të Evropës Juglindore (EJ) për të përmirësuar aftësitë e tyre për kthimin e aseteve. Në vitin 2018, të dyja organizatat bouan një studim të quajtur *Kthimi i aseteve në Ballkanin Perëndimor: analizë krahasuese e legjislacionit dhe e praktikës*, i cili u krye pas këshillimeve të gjera me ekspertë rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Ky botim arriti në përfundimin që përkundër faktit që legjislacioni i brendshëm në juridiksionin e vendeve të Evropës Juglindore, në parim, ishte në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane, kompetencat për kthimin dhe konfiskimin e aseteve që ofrohen nga legjislacionet përkatëse nuk shfrytëzoheshin mjaftueshëm apo në mënyrë efektive. Për pasojë, njëri prej rekomandimeve kryesore të botimit ishte rritja e kapaciteteve të agjencive rajonale për zbatimin e ligjit, i shërbimeve të prokurorisë dhe i organeve gjyqësore, në mënyrë që të sigurohet sekuestrimi dhe konfiskimi efikas i aseteve në juridiksionet e tyre.

Si përgjigje ndaj këtij rekomandimi, Qendra AIRE dhe RAI kanë përpiluar këtë doracak si pjesë të një projekti rajonal dy vjeçar të quajtur *Forcimi i antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes përmirësimit të masave për kthimin e aseteve*. Projektin e zbatojnë Qendra AIRE dhe RAI dhe financohet nga Qeveria Britanike. Përpilimi i këtij doracaku shërben si plotësues i aktiviteteve të tjera për rritjen e kapaciteteve, të cilat janë në vazhdim e sipër, në rajonin e Evropës Juglindore dhe do të përdoret në disa trajnime të cilat janë planifikuar specifikisht për të mbështetur autoritetet e angazhuara në kthimin e aseteve.

Doracaku plotësohet nga një doracak tjetër: *Mjetet dhe praktikat më të mira për bashkëpunimin ndërkombëtar për kthimin e aseteve*. Të dyja botimet janë realizuar njëkohësisht, duke pasur parasysh objektivin e njëjtë të përgjithshëm.

Qendra AIRE dhe Nisma Rajonale Antikorrupsion dëshirojnë ta falënderojnë Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar për përkushtimin, mbështetjen e madhe financiare dhe këshillat e dhëna, Fondacionin Konrad Adenauer që na është bashkëngjitur në këtë rrugëtim dhe ka mbështetur pjesëmarrjen e përfituesve të tjerë, dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për mbështetjen e aktiviteteve fillestare që kanë çuar tek masat thelbësore në rajonin e Evropës Juglindore.

Lista e Shkurtimeve

- AMP - Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë
- ATK - Administrata Tatimore e Kosovës*
- BH – Bosnja dhe Hercegovina
- BE – Bashkimi Europian
- DB – Distrikti i Bërçkos (BH)
- FBH – Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës
- GRECO – Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit
- GJED – Gjykata Evropiane e Drejtësisë
- GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- GJKKKO – Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
- KB – Kombet e Bashkuara
- KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- KP – Kodi Penal
- KPR – Kodi i Procedurës Penale
- LM – Ligji Antimafia
- MONEYVAL – Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- MPB – Ministria e Punëve të Brendshme
- NJIF – Njësia e Inteligjencës Financiare
- NJPK – Njësia Speciale për Parandalimin e Korrupsionit
- PKR - Prokuroria e Krimeve të Rënda
- RK – Republika e Kosovës*
- RS – Republika Serbe (pjesë e BH-së)
- SMR - Sistemi për Menaxhimin e Rasteve
- TFVF – Task Force për Veprim Financiar lidhur me Pastrimin e Parave
- UNCAC – Konventa Kundër Korrupsionit e Kombeve të Bashkuara
- UNTOC – Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar

* “Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GjND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.”

I. HYRJE

Ekziston një aksiomë e vjetër penalo-juridike, që faktikisht është parim civilizues, sipas së cilës askush nuk mund të përvetsojë produktet e përfituara nga një vepër penale. Duke marrë parasysh se veprat penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe format të tjera të rënda të krimit ekonomik, janë të orientuar drejt mbledhjes së produkteve të veprave penale, konfiskimi efikas i produkteve të veprave penale në lëndët penale për veprat e përmendura, theksohet shprehimisht dhe shërben si paradigmë e tezës *nullum commodum capere potest de sua propria iniuria* (**askush nuk mund të nxjerrë përfitim nga veprimi i tij kriminal**). Konfiskimi i produkteve të veprave penale është i njohur që në historinë më të hershme të së drejtës dhe shtetit, por që pas Luftës së Dytë Botërore atij i është kushtuar kujdes më i madh. **Madje, edhe në shtetet si Franca**, ku konfiskimi është i pranishëm në legjislacion që prej shekujsh më parë, norma e konfiskimit të produkteve të veprave penale shpeshherë është anashkaluar nga praktika gjyqësore. Për shumë kohë, gjyqtarët janë përqendruar kryesisht te sanksionimi i drejtë dhe adekut, duke i konsideruar produktet e realizuara nga veprat penale thjesht si rrethanë rënduese për caktimin e llojit dhe masës së sanksionit. Megjithatë, dekadat e fundit është shënjuar një kthesë në politikat kundër krimit, e cila cila përqendrohet te lufta me të gjitha mjetet. Kjo ka qenë veçanërisht e dukshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në paradigmen e “luftës kundër drogës”, duke ndikuar në qasjen e re lidhur me trajtimin e produkteve të veprave penale. Hulumtimet e shumta shkencore, midis të cilave veçanërisht është i njohur hulumtimi i Robert Martinson (1974), flasin për problemet në trajtimin penal dhe rehabilitimin e autorëve të krimit, ku i jepet rëndësi dimensionit personal (fokusi te anëtarët e organizatave kriminale) dhe veçanërisht përfitimeve nga kryerja e veprave penale. Qëllimi kryesor i përfshirjes së individit dhe grupit kriminal është krijimi i produkteve nga veprat penale, të cilat jo vetëm që krijojnë përfitime nga sjellja e paligjshme, por krijojnë edhe një bazë për kryerje e veprave të tjera penale dhe, veçanërisht, për korrupsionin e zyrtarëve publik (Vettori, 2006). Në qoftë se autorët e formave të ndërlikuara të kriminalitetit (krimit të organizuar, krimit ekonomik, korrupsionit etj.) sillen në mënyrë racionale dhe „peshojnë“ avantazhet dhe disavantazhet e kryerjes së një krimi, atëherë funksioni i përgjithshëm preventiv i konfiskimit të produkteve të veprave penale është veçanërisht i rëndësishëm dhe konsiderohet si masa më e rëndësishme në këtë fushë (Kilchling, 2014). Për shkak se me konfiskimin efikas të produkteve nga veprat penale ne bëjmë përpjekje për ta kthyer situatën në gjendjen në të cilën ajo ishte para se të kryhej vepra në fjalë (Bavcon i Shelih, 1996; Pavishiq, Grozdaniq & Veiq, 2007), në fakt përmes tij kthehet barazia në shpërndarjen e të mirave në shoqëri, ndërsa organizatat kriminale privohen nga mjetet për kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Pa dyshim që konfiskimi i produkteve të veprave penale ka rëndësi të madhe për të luftuar kriminalitetin. Vlerësimet e Kombeve të Bashkuara dhe Fondit Ndërkombëtar Monetar flasin për shumta të mëdha të realizuara nga krimet, që arrijnë deri në disa përqindje të prodhimit bruto në botë (të përkthyer në shifra absolute, gati dy miliardë euro). Nga kjo shumë kaq e madhe, vetëm një pjesë e vogël, më pak se një për qind, identifikohet dhe konfiskohet përmes procedurave penale dhe procedurave të tjera. Në Evropë vlerësimet lidhur me nivelin e produkteve nga veprat penale variojnë nga disa qindra miliardë euro deri në gati një trilion euro, nga e cila vetëm një pjesë e vogël arrin të konfiskohet në mënyrë të përhershme. Sipas vlerësimeve, vetëm pak më shumë se një miliardë arrin që të konfiskohet në mënyrë të përhershme, duke theksuar një hendek të madh ndërmjet përfitimit të realizuar nga kriminelët dhe të sasisë së sekuestruar dhe konfiskuar të produkteve të veprave penale (Europol, 2016). Shumë shtete e kanë të rregulluar sistemin e konfiskimit dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të shumta për perfeksionimin e tij, por ka dallime nga njëri vend tek tjetri lidhur me natyrën juridike të institutit, vëllimin e rregullimit ligjor, modalitetet e dëshimit të ekzistencës së produkteve të veprave penale (rregullat e procedurës penale ose kombinimi me institutet provuese nga procedurat e kontestimit), dhe lidhur me disa elemente të tjera të rëndësishme (Mujanović & Sarajlija, 2014).

Krahas faktit se me kriminalitet realizohen përfitime të mëdha materiale, gjë të cilën një shtet serioz nuk mund ta tolerojë, Boucht (2017) shprehet se ekzistojnë disa arsye (teorike) shtesë, të cilat e arsyejnë ekzistencën dhe aplikimin e institutit të konfiskimit të produkteve të veprës penale. Arsyja e parë është **restorative** dhe ka të bëjë me faktin se askush nuk mund të realizojë dhe të mbajë produktet e përfituara në një formë “jo të drejtës”, përkatësisht përmes shkeljes së ligjit. Kthimi i situatës në gjendjen ekzistuese para kryerjes së veprës, është në pajtim me botëkuptimet morale të shumicës së shoqërive të civilizuar dhe është një nga parimet e të drejtës bashkëkohore. Arsyja e dytë ka të bëjë me **parandalimin e kriminalitetit**. Një kriminel potencial do të tërhiqet nga vepra në fjalë në raste se përfitimet e krijuara nga sjellja kriminale janë më të vogla se rreziqet dhe mungesa e rehatisë që do të vinte si rezultat i një sjelljeje të tillë. Duke i “sulmuar” kriminelët në pikën më të dobët (domethënë të fitimi), përkatësisht duke krijuar përshtypjen se përfitimet e krijuara në mënyrë të paligjshme do të konfiskohet, humbet motivimi për autorët potencialë të veprave dhe ata sprapsen nga sjellja e mundshme kriminale në të ardhshmen. Krahas kësaj, kjo qasje ka efekt **ndëshkues** deri në një farë mase, për shkak se fokusi i reagimi të së drejtës penale është konfiskimi i produkteve të veprave penale dhe ai është më efikas se sa sanksione. Arsyja e tretë, ka të bëjë gjithashtu me parandalimin, por në këtë perspektivë është e **orientuar ndaj pronës**.

Pas konfiskimit, pronat e konfiskuara nuk mund të përdoren për aktivitete të ardhshme kriminale, gjë që është veçanërisht e rëndësishme për grupet e organizuara kriminale. Në fakt, në tërësi grupet e organizuara kriminale janë të orientuara drejt krijimit të pasurisë përmes kryerjes së veprave penale, kështu që konfiskimi efikas godet „aortën“ e grupeve të organizuara kriminale, si duke eliminuar potencialin për ndikim në rrjedhat ligjore, edhe duke zvogëluar tërheqjen e anëtarëve të rinj për të marrë pjesë në aktivitete kriminale. Arsyja e katërt është **kompensuese**. Në shumë shtete konfiskimi i produkteve të veprave penale korrespondon me kërkesë për dëme materiale nga të dëmtuarit dhe, shpeshherë, këto dy institute plotësojnë njëri-tjetrin. Janë të shpeshta vendimet penalo-juridike ku mjetet e konfiskuara përdoren për kompensimin e padive për dëme materiale nga të dëmtuarit, veçanërisht nëse konfiskimi është i rregulluar me institut të veçantë penalo-juridik dhe i paraprinë realizimit të kërkesës për dëme materiale. Gjithashtu, është e mundur që të ardhurat e fituara përmes konfiskimit të produkteve nga veprat penale të mblidhen në fonde për viktimat dhe të dëmtuarit nga veprat penale, duke bërë kështu të mundur kompensimin e tyre (në mënyrë të tërthortë). Po ashtu, ka edhe shtete që të ardhurat e siguruar si rezultat i aplikimit efikas të konfiskimit të produkteve të veprave penale ia vënë në dispozicion organeve policore dhe gjyqësore, me qëllim luftimin më të suksesshëm të kriminalitetit, ose organeve të ndihmës sociale, ose i vënë në dispozicion në një mënyrë tjetër që është e qasshme nga komuniteti dhe, në këtë mënyrë kompensojnë dëmet që pa dyshim shkaktohen nga kriminaliteti.

Produktet e veprës penale mund të përkufizohen si një ndër elementët e veprës penale, por ato duhet të konstatohen si të tilla. Për shembull, ky është rasti te veprat penale të korrupsionit, ku produktet e veprave penale janë element përbërës i pjesës më të madha të këtyre krimeve. **Produktet** e krimit, në parim, konsiderohen edhe përfitimet që nuk përbëjnë element të një krimi, por janë shpërblyer për veprën e kryer, ose për pasojën e veprës (Baçiq, 1998). Konstatimi është i rëndësishëm për vendimin për konfiskim, në pajtim me parimin e përgjithshëm të të drejtës penale se askush nuk mund ta mbajë produktet e me veprës penale, por shpeshherë edhe për shkak se ai shërben për të përcaktuar edhe vetë ekzistencën e veprës.

Sa i përket natyrës juridike të institutit për konfiskimin e produkteve të veprës penale, ekzistojnë zgjidhje të ndryshme. Pavarësisht nga qasja, e përbashkëta është se ky institut përqipet të realizojë parimin e të qenit i drejtë, përmes të drejtës penale, që është e rëndësishme për legjitimitimin e rendit të përgjithshëm juridik dhe politik. Baçiq (1998) këtë e përmbledh duke pohuar se është “juridiksht e palejueshme, e padrejtë dhe jomorale, që dikush të mbaj atë që ka fituar për shkak të kryerjes së veprës penale, duke përfshirë atë që ka fituar për kryerjen e veprës”.

Qasja e parë e konsideron institutin e konfiskimit të produkteve të veprave penale si një sanksion të së drejtës penale *per se*. Një situatë e tillë, për shembull, ishte e pranishme në ish Jugosllavi nga viti 1959 deri në vitet '70 të shekullit të kaluar, ku konfiskimi konsiderohej si masë e veçantë sigurie. Konfiskimi konsiderohet ende si sanksion i veçantë në Francë, ku trajtohet veçmas nga dënimi me burgim ose dënimin me gjobë dhe ku mund të jepet ose krahas sanksioneve të sipërpërmendura, ose në mënyrë të pavarur. Në Francë konfiskimi mund të paraqitet në disa forma: i përgjithshëm, kur zbatohet vetëm në rastet e kriminalitetit të rëndë (për shembull, në lidhje me përdorimin e drogës, terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe të ngjashme) dhe kur konfiskohet e gjithë pasuria e të pandehurit (pavarësisht nëse ka të bëjë me veprën penale konkrete që është lëndë e procedurës penale); dhe i veçantë, i cili zbatohet në të gjitha rastet kur produktet kanë rrjedhur nga një vepër penale tjetër, e ndryshme nga vepra e përshkruar te konfiskimi i përgjithshëm. Në rastet kur produktet e veprës penale nuk janë të disponueshme, Gjykata mund të vendosë që autori i veprës të paguajë në të holla shumën që i përgjigjet vlerës së produkteve të përfituara prej tij për shkak të veprës penale të kryer. **Qasja e dytë** e trajton konfiskimin e produkteve të veprës penale si pasojë juridike të dënimin, që do të thotë se zbatimi i tij është i lidhur me vendimin përfundimtar të gjykatës dhe hyn në fuqi *ex lege*.

Qasja e tretë e konsideron konfiskimin e produkteve të veprave penale si lloj të veçantë të angazhimit shtetëror, i cili nuk është domosdo me natyrë penale, por administrative. Për shkak të problemeve të mëdha me krimin e organizuar, në Itali, që prej viteve '50 të shekullit të kaluar, ekzistojnë të ashtuquajturat masat e veçanta preventive, ndërsa nga vitet '70 ekzistojnë edhe masat preventive të konfiskimit. Kusht për zbatimin e masave preventive të konfiskimit është ekzistenca e dyshimit shtesë se përfitimi është krijuar me aktivitete kriminale dhe është në disproporcion me të ardhurat e ligjshme, aktivitetet ekonomike dhe pasurisë së konstatuar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka konfirmuar në disa vendime të saj natyrën administrative të masave italiane preventive të konfiskimit. **Qasja e katërt** e konsideron konfiskimin e produktit të vepër penale si masë të veçante të veprës penale, përkatësisht si reagim të detyrueshëm të shtetit ndaj veprës penale, të veçuar nga sistemi i sanksioneve penale. Qëllimi i konfiskimit të produkteve të veprës penale në bazë të kësaj perspektive ka natyrë sidomos restauruese në kuptimin se përmes konfiskimit bëhen përpjekje për vendosjen e pronës që ka çuar në produktet e veprës penale në gjendjen ligjore siç ka qenë para kryerjes së veprës penale. Qëllimi i kësaj mase është që të bëhet dallimi midis saj dhe sanksioneve penale. Përveç kësaj, për t'u zbatuar sanksionet, është i nevojshëm dënimi, i cili nuk është i domosdoshëm te instituti i konfiskimit të produkteve të veprave penale (në rastin e fundit konfiskimi mund të aplikohet edhe te personat e papërgjegjshëm, personat ndaj të cilëve nuk mund të zhvillohet ndjekja penale, etj.). Sanksionet kanë të bëjnë me vetë autorin dhe pasurinë e tij të përgjithshme, ndërsa konfiskimi i produkteve të veprave penale kanë të bëjnë vetëm me asetet dhe të drejtat që mund të lidhen me veprat penale të autorit të veprës (Datzler, 2017). Rrjedhimisht, bazuar në qasjen e përshkruar, konfiskimi i produkteve të veprave penale është institut *sui generis*, i cili përdoret në rast të kryerjes së veprës penale, por i cili me një pjesë të tij lidhet me rregullat e drejtës civile (sekuestrimi/ngrirja e pronës, procedura e përmbarrimit/ekzekutimit, etj.). Nuk është befasi që Derencinovic (1999) e konsideron konfiskimin si institut të përzier penalo-civil, qëllimi i të cilit është kthimi i situatës në gjendjen përpara kryerjes së veprës penale dhe ndalimi i pasurimit të paligjshëm me veprimtari kriminale.

Procedura e konstatimit të produkteve të veprës penale përfshin konstatimin e objektit dhe përmbajtjes së produkteve të veprave penale, ose ekuivalentit të tyre monetar. Në pjesën më të madhe të legjislacioneve kjo procedurë parashikohet *in rem*, që do të thotë se zbatohet në kuadër të procedurës penale, kështu që duhet të respektohen parimet që zbatohen në procedurën penale. Meqenëse kjo procedurë i bashkohet asaj penale, vet konfiskimi më së shpeshti është i kushtëzuar me vendimin dënues të gjykatës. Por, në rrethana të caktuara konfiskimi është i mundur edhe për personin që nuk është shpallur fajtor në procesin penal. Një procedurë e tillë konfiskimi quhet konfiskim **objektiv ose i pavarur** për shkak se zhvillohet jashtë procesit penal, (qëllimi i të cilit është pikërisht konstatimi i ekzistencës së veprës penale dhe i fajësisë së autorit). Një mundësi e tillë ekziston, për shembull, në

Republikën Federale të Gjermanisë. Në të drejtën gjermane, procedura e konfiskimit objektiv mund të realizohet në qoftë se ekzistojnë arsye të natyrës reale, të tilla si pamundësia e qasjes për shkak të arratisjes dhe pamundësia e identifikimit të autorit, ose në rast të shpalljes së pafajësisë, si rezultat i së cilës personi lirohet nga dënimi, apo të shtyrjes së ndjekjes penale. Procedurën e nis prokurori privat apo shtetëror në rast se, në bazë të rezultateve të hetimit, ekziston mundësia për nxjerrjen e urdhërit të konfiskimit. Kërkesa duhet të arsyetohet dhe duhet të përshkruhen veçanërisht objektet do të duhej të konfiskohen. Lidhur me kërkesën vendos gjykata që ka juridiksion për zhvillimin e procedurës penale, po të mos ishin pengesat e përshkruara, pra gjykata me juridiksion mbi objektet që propozohen për konfiskim. Procedurë e veçantë konsiderohet edhe ajo në të cilën përfshihet prona e autorit ose personave të tjerë, në qoftë se ekziston dyshimi i përfitimeve nga aktivitetet kriminale. Kjo procedurë zakonisht quhet procedura e **konfiskimit të zgjeruar** të produkteve të veprës penale, ku përfshihen jo vetëm asetet nga vepra penale për të cilën po zhvillohet çështja penale konkrete, por çdo produkt tjetër që supozohet se është nxjerrë nga e njëjta veprë penale, ose nga vepra të tjera që e kanë paraprirë veprën e parë, ose që përkojnë me të, dhe të cilat nuk duhet të përcaktohen në detaje. Zakonisht kushti themelor për konfiskimin e zgjeruar është: 1) dënimi për veprë të rëndë penale (krimi i organizuar, etj.); 2) **rrethanat që** dëshmojnë mundësinë e prejardhjes së pronës tjetër të autorit nga veprat penale (të papërcaktuara); dhe 3) dështimi i të akuzuarit, përkatësisht i poseduesit të së drejtës ose pronës për të justifikuar prejardhjen e ligjshme të pronës. Konfiskimi i zgjeruar i përkufizuar në mënyrë të tillë zakonisht konsiderohet si detyësor ndaj konfiskimit të zakonshëm të dhënë. Kur prokurori dyshon për një ose më shumë vepra konkrete penale të kryera nga autori, ai përpiqet të dëshmojë se produktet kanë ardhur pikërisht nga këto vepra, ndërkohë që një nga karakteristikat e konfiskimeve të zgjeruara është se organet shtetërore i përqendojnë hetimet te produktet e veprat penale të papërcaktuara. Vetëm pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore dhe provat e lejuara për zbatimin e konfiskimit të rregullt, merret parasysh konfiskimi i zgjeruar, i cili në legjislativione të shumta konsiderohet formë sporadike dhe ndihmëse e konfiskimit të rregullt. (Datzer, 2017).

Modelet e përmendura të procedurës së konfiskimit të aseteve të përfituara me vepra penale rregullohen kryesisht me legjislacionin penal. Gjithashtu, ekziston edhe **qasja e të drejtës civile** për konfiskimin. Sipas kësaj qasjeje, “i akuzuari” është prona në bazë të faktit se ka rrjedhur nga aktiviteti kriminal (aktit të paligjshëm) (Mujanoviq & Sarajlija, 2014), ndërsa poseduesi ose pronari i saj duhet të arsyetojnë nëse është **prona është** krijuar në mënyrë të ligjshme. KY model i konfiskimit nuk bazohet te faji i autorit të veprës, por te prejardhja e pronës. Shembull tipik i një veprimi të tillë është i pranishëm në Mbretërinë e Bashkuar. Atje, konfiskimi mbi bazën e të drejtës civile është i ndërvarur nga procesi penal, dhe është e nevojshme që policia të paraqesë prova të mëtjeshme në rastet kur nuk ka prova të mjaftueshme për të filluar dhe vazhduar me procesin penale, nuk ka interes publik për të vazhduar me procesin penal, por ekzistojnë vështirësitë procedurale që pamundësojnë veprimet e tjera penale (autori nuk është i aksesueshëm, ka vdekur, etj.). Megjithatë, duhet të bëhet fjalë për përfitim të konsiderueshëm, (të paktën 10.000 GBP) dhe për dyshim të arsyeshëm se përfitimi ka ardhur si rezultat i kryerjes së veprës penale ose si shpërblim për veprën në periudhë prej dymbëdhjetë vitesh nga fillimi i procesit. Kërkesat civile për dëmshpërblim depozitohen në Gjykatën e Lartë, ndërsa aplikohen standardet e dëshmive sipas të drejtës civile (Datzer, 2016).

Zakonisht dallohen katër fazat kyçe, të dhëna më poshtë, të procedurës së konfiskimit të produkteve të veprës penale. Ato janë: faza hetimore (financiare), gjyqësore, faza e ekzekutimit, dhe faza e administrimit të pronës së konfiskuar (Mujanoviq, 2017). **Hetimet financiare** nënkuptojnë disa veprime që zhvillohen njëkohësisht me veprimet kriminale-operative, me qëllim zbulimin dhe identifikimin e produkteve të veprës penale, të pronave të të dyshuarve dhe personave të tretë, nga të cilët është i mundshëm konfiskimi i përfitimeve të kundërligjshme dhe sigurimi i konfiskimit përfundimtar (Këshilli i Evropës, 2007). Hetimi financiar ka për qëllim grumbullimin e të dhënave lidhur me të ardhurat e përfituara në mënyrë të kundërligjshme, përcaktimin ose vlerësimin e tyre, si edhe konfiskimin e tyre. Fazat tipike të hetimit financiar me të cilat realizohen këto objektiva përfshijnë: konstatimin e të ard-

hurave të veprave penale, caktimin e pronës që mund të konfiskohet dhe parashtrimin e kërkesës për caktimin e masave të përkohshme të sigurimit. Konfiskimi i përkohshëm i pronës, që mund të realizohet në procesin penal është rezultati themelor i hetimit financiar; me të pengohet shfrytëzimi, bartja ose fshehja e të ardhurave apo pronës së autorit të veprës penale, kështu që krijohen parakushtet për konfiskim të përhershëm. Ekzistojnë dy forma themelore, në bazë të të cilave mund të realizohet konfiskimi i përkohshëm i pronës: ngrirja dhe sekuestrimi.¹ Ngrirja apo bllokada ka të bëjë me ndalesën e bartjes, konvertimit, shfrytëzimit dhe zhvendosjes së pronës. Sekuestrimi nënkupton konfiskimin e përkohshëm dhe ruajtjen apo mbikëqyrjen e pronës (do të thotë, disponim fizik të pronës), në bazë të urdhrit të gjykatës, ose një organ tjetër kompetent. Sekuestrimi konsiderohet masë tipike e zbatueshme, ndërsa ngrrirja aplikohet vetëm nëse sekuestrimi është i pamundur, ose nuk është praktik, megjithëse kohët e fundit situata po ndryshon në favor të ngrrirjes (Mujanović, Datzler, & Kadribašić, 2018). Ndonëse, në parim konsiderohen si procedurë brenda procesit penal, veprimet dhe masat që ndërmerren në kuadër të **procesit gjyqësor**, me të cilin merret vendim për konfiskimin e produkteve të veprës penale janë të zakonshme për procedurën me të cilën zgjidhet lënda penale (p.sh. marrja në pyetje e dëshmitareve, dorëzimi i dokumenteve si prova, etj.), kështu që ato merren bashkërisht me veprime të tjera dhe shpeshherë nuk përcaktohet shprehimisht se bëhet fjalë për veprime të proceseve dytësore, por si veprime brenda procesit penal kryesor (i cili përcakton ekzistencën e veprës dhe fajësinë e autorit). Ato zakonisht nënkuptojnë rolin aktiv të autorit dhe të personave të lidhur me të (p.sh. pjesëmarrësit në vepër, palëve të cilave u janë transferuar produktet), të cilëve duhet t'u ofrohet mundësia që të parashtrijnë çdo provë të mundshme për të mohuar lidhjen e pronës në pronësi, posedim apo kontroll të tyre me autorin e veprës penale dhe të sqarojnë në përgjithësi prejardhjen e pronës që ka lidhje me aktivitetet kriminale. Pjesa përkatëse e vendimit penal të gjykatës lidhur me konfiskimin e produkteve të veprave penale duhet t'i përshtatet procedurës me të cilën duhet **të realizohet me forcë, pra do të ekzekutohet** urdhri për konfiskim. Pra, në qoftë se prona objekt konfiskimi nuk është sekuestruar/ngrrirë, pjesa operative e vendimit ku urdhërohet konfiskimi duhet të përmbajë afatin për përmbushje vullnetare, urdhërimin e autorit të veprës penale apo të një personi të tretë për dorëzimin e objekteve të tundshme, ose dorëzimin e një sasive të caktuar të objekteve për zëvendësimin e dëmit, ose pagimin e një shume të caktuar mjetesh monetare, e cila është e barasvlershme me përfitimin e nxjerrë. Vendimi për konfiskim konsiderohet dokument ekzekutiv në shumicën e legjislacioneve, ndërkohë që për borxhet e papaguara zbatohen rregullat e legjislacionit përmbarimor. **Faza e administrimit** e pronës së konfiskuar nënkupton çfarëdo lloj forme administrimi nga organet shtetërore të produkteve të veprës penale, të tilla si ndalimi i transferimit dhe konvertimit të pronës së tillë, ruajtja, deponimi, shfrytëzimi, dhënia me qira, shitja, dhurimi, shkatërrimi, kthimi dhe çdo formë tjetër heqjeje të produktit në fjalë. Administrimi i pronës së konfiskuar kohët e fundit i besohet kryesisht organeve të strukturuar, ndonëse nuk mund të flitet për universalitetin e kësaj qasjeje.

1 Këto nuk janë të vetmet forma. Krahas formave të përmendura më sipër, teoria dhe praktika botërore njohin edhe të ashtuquajturën shitje të përkohshme ose të anticipuar, shfrytëzimin e pronës, shkatërrimin e pronës, etj.

II KONFISKIMI I TË ARDHURAVE NGA KORRUPSIONI: VËSHTRIM I PËRGGJITHSHËM I UDHËZIMEVE DHE I STANDARDEVE TË KOMBEVE TË BASHKUARA, KËSHILLIT TË EVROPËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN

2.1. HYRJE

Ky doracak ofron një pasqyrë të standardeve ndërkombëtare lidhur me konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe korrupsioni. Së pari, ai trajton pyetjet se çfarë është konfiskimi dhe pse është i rëndësishëm ai. Së dyti, ai identifikon konventat kryesore ndërkombëtare dhe ofron udhëzime lidhur me qëllimin e secilës prej tyre. Së treti, ai sqaron qasjen e këtyre standardeve lidhur me aspektet kryesore të konfiskimit. Ai përqendrohet kryesisht në fazën gjyqësore të procedurës së konfiskimit gjatë së cilës merret vendimi përfundimtar për konfiskim, edhe trajton po ashti edhe çështje të tilla si ngrirja e pasurisë me qëllim konfiskimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për çështjet e konfiskimit. Më tej, doracaku vijon shkurtimisht me punën e organeve monitoruese të Këshillit të Evropës lidhur me këto standarde dhe shqyrton masat mbrojtëse të krijuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

2.1.1 Çfarë është konfiskimi?

Konfiskimi është humbja përfundimtare ose e përhershme e pasurisë me anë të një urdhri të gjykatës². Konfiskimi mund të përfshijë po ashti edhe humbjen e pasurisë me anë të një urdhri të një autoriteti kompetent tjetër përveç gjykatës³. Konfiskimi nuk është domosdoshmërisht ndëshkues për nga natyra⁴ dhe nuk është domosdoshmërisht i kufizuar të humbja e pasurisë që rrjedh nga produktet e kriminalitetit⁵.

Përkufizimi i gjerë i konfiskimit tregon që ai është koncept fleksibël. Gjatë përcaktimit të masave për konfiskim, organi ligjvënës duhet të marrë parasysh disa faktorë. Këta faktorë përfshijnë: shtrirjen e pasurisë që potencialisht mund të konfiskohet; llojet e sjelljes kriminale (ose të sjelljes tjetër të paligjshme) që duhet potencialisht të çojnë tek konfiskimi; dhe standardet dhe barrën e dëshmisë që duhet të zbatohet në përcaktimin nëse duhet apo nuk duhet të konfiskohen pasuri të caktuara. Këto dhe çështjet e tjera shqyrtohen në vijim në frymën e standardeve ndërkombëtare.

2 Neni 1 i Konventës së Strasburgut e vitit 1990, Konventa e Varshavës dhe Direktiva e vitit 2014 e përcaktojnë “Konfiskimin si një ndëshkim ose masë, të urdhëruar nga gjykata pas procesit gjyqësor lidhur me veprën penale që ka për pasojë humbjen e pasurisë.” Neni 2 i UNTOC-ut dh UNCAC-ut e përcakton “konfiskimin”, i cili përfshin sekuestrimin në rastet kur është i zbatueshëm, si humbjen e përheshme të pasurisë me urdhër të gjykatës ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent”.

3 Përkufizimi i “konfiskimit” i përdorur në UNTOC-u ose UNCAC-u është i zgjeruar, jo ai që përdoret në Konventën e Strasburgut të vitit 1990, në Konventën e Varshavës, ose në Direktivën e vitit 2014.

4 Përkufizimi i “konfiskimit” në Konventën e Strasburgut të vitit 1990 dhe në atë të Varshavës thotë që konfiskimi mund t'i referohet një “ndëshkimi” ose një “masë”.

5 Përkufizimi në Konventën e Strasburgut të vitit 1990, në Konventën e Varshavës dhe në FD 2005 është shumë i kufizuar, por jo në UNTOC, UNCAC ose në Konventën e Vjenës.

2.1.2 Pse ka rëndësi konfiskimi?

Edhe pse ka këndvështrime të ndryshme lidhur me mënyrën si duhet saktësisht të duket regjimi i konfiskimit, pavarësisht kësaj konfiskimi njihet dhe promovohet gjerësisht si armë e fuqishme për luftimin e krimit të rëndë dhe korrupsionit⁶. Në këtë aspekt, ai u shërben disa qëllimeve. Kur zbatohet në mënyrë të suksesshme, ai ka mundësi:

- Të mbrojë ekonominë e ligjshme nga korrupsioni dhe infiltrimi i pasurive të paligjshme.
- Të përkrahë të ardhurat nga taksat në ekonominë e ligjshme.
- Të gjenerojë pasuri që mund të përdoret për të mirën e publikut.
- Të ndihmojë për mbështetjen e sundimit të ligjit.
- Të minojë nismat kriminale dhe, në këtë mënyrë, të veprojë si frenues i aktiviteteve të paligjshme.

2.2 STANDARDET NDËRKOMBËTARE

2.2.1 Konventat e Kombeve të Bashkuara

1. Konventa Kundër Korrupsionit e Kombeve të Bashkuara (2005)

Konventa Kundër Korrupsionit e Kombeve të Bashkuara (UNCAC) ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2005 dhe trajton parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, si në sektorin privat po ashtu edhe në atë publik⁷.

Neni 31 i UNCAC-ut kërkon nga shtetet që të miratojnë “në shkallën më të madhe të mundshme në sistemet ligjore të vendeve të tyre” masat e nevojshme për të mundësuar konfiskimin e të ardhurave nga veprat penale të parashikura në Konventë, si edhe të pasurisë që përdoret në ato vepra penale ose që ka për qëllim të përdoret në to. Në këtë nen përcaktohen po ashtu procedurat e nevojshme për sekuestrimin dhe ngrirjen e pasurisë lidhur me veprat penale të përcaktuara në Konventë.

Neni 53, 54 dhe 55 parashikojnë kushtet për pranimin e urdhrave për konfiskim ndërmjet shteteve dhe mekanizmat përmes të cilëve zbatohen urdhrat për konfiskim.

Neni 57 parashikon kthimin dhe tjetërsimin e pasurisë së konfiskuar.

2. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar e dhjetorit 2000

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC) që ka hyrë në fuqi në shtator 2003, është instrumenti kryesor i Kombeve të Bashkuara për luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar. Veprat penale të përfshira në të kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në grupe të krimit të organizuar, pastrimin e parave, korrupsionin dhe pengimin e drejtësisë si edhe me

6 Shih, p.sh., përfshirja e konfiskimit në Rekomandimin 4 të Task Forcës për Veprim Financiar të vitit 2012.

7 Më shumë material sqarues mund të gjendet në Udhëzuesin Legjislativ të UNCAC-ut dhe në Udhëzuesin Teknik në adresën: https://www.unodc.org/pdf/corruption/CoC_LegislativeGuide.pdf dhe https://www.unodc.org/documents/corruption/Technical_Guide_UNCAC.pdf

“krimet e tjera të rënda”⁸.

Neni 12 i UNTOC-ut u kërkon shteteve të miratojnë “në shkallën më të madhe të mundshme në sistemet e tyre ligjore të brendshme”, masat për të mundësuar konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe pasurinë e përfshirë me vepra penale.

Neni 13 përcakton procedurat dhe detyrimet për bashkëpunim ndërkombëtar në procedurat e konfiskimit.

Neni 14 parashikon mënyrën e tjetërsimit të pasurisë së konfiskuar.

2.2.2 Instrumentet e Këshillit të Evropës

1. Konventa për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe për financimin e terrorizmit (ETS nr. 198) (“Konventa e Varshavës”) e vitit 2005

Konventa e Varshavës merret në veçanti me konfiskimin e financimit të terrorizmit, madje edhe kur fondet që shërbejnë për financimin e terrorizmit kanë prejardhje të ligjshme. Ajo zbatohet po ashtu mbi masat e konfiskimit në mënyrë më të përgjithshme, edhe pse shtetet kontraktuese mund ta kufizojnë zbatimin e saj me anë të deklaratës⁹.

Neni 3 përcakton detyrimet e përgjithshme të palëve kontraktuese për zbatimin e masave të konfiskimit, ndërsa neni 5 përcakton domosdoshmërinë e të siguruarit që pasuria që rrjedh nga pastrimi i parave të mund t’i nënshtrohet ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit.

Neni 9 përcakton veprat që përbëjnë veprat penale të pastrimit sipas Konventës dhe nevojën e palëve që t’i kategorizuar ato si vepra penale.

Neni 15 përcakton parimet e përgjithshme të bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatim efektiv të urdhrave për konfiskim, si edhe masat e nevojshme për arritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Neni 16 përcakton detyrimet e palëve për të ndihmuar lidhur me hetimet ndërkombëtare dhe neni 28 përcakton bazën sipas së cilës palët mund ta refuzojnë bashkëpunimin lidhur me urdhrin për konfiskim.

2. Konventa e të Drejtës Penale mbi Korrupsionin e vitit 1999 (ETS 173) (“Konventa e Strasburgut e vitit 1999”)

Kjo konventë është miratuar në zbatim të *Programit për Veprim kundër Korrupsionit* të Komitetit të Ministrave të vitit 1996. Ajo ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2002 dhe merret me korrupsionin si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Ajo përfshin si personin që ofron ryshfet (“mitmarrje aktive”) edhe personin që merr ryshfet (“mitmarrje pasive”)¹⁰.

Neni 2 përkufizon mitmarrjen aktive dhe i detyron palët nënshkruese të konventës ta parashikojnë një akt të tillë si vepër penale. Neni 3 bën të njëjtën gjë lidhur me mitmarrjen pasive. Nenet 4 deri në

8 Më shumë material sqarues mund të gjendet në Udhëzuesin Legjislativ të UNTOC-ut në adresën: https://www.unodc.org/pdf/crime/legislative_guides/Legislative%20guides_Full%20version.pdf

9 Më shumë material sqarues mund të gjendet në raportin sqarues të Konventës në adresën: <https://rm.coe.int/16800d3813>

10 Më shumë material sqarues mund të gjendet në raportin sqarues të Konventës në adresën: <https://rm.coe.int/16800cce441999>

15 vazhdojnë të përcaktojnë aktet e tjera të cilat palët, sipas Konventës, duhet t'i parashikojnë si vepra penale.

Neni 23 përcakton masat që duhet të ndërmerren nga shtetet palë në Konventë me qëllim mbledhjen e dëshmive për shkelje të ligjit dhe konfiskimin e të ardhurave nga cilado prej veprave penale të përcaktuara në Konventë.

Neni 25 përcakton parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar sipas Konventës, si edhe masat që duhet të merren për këtë lloj bashkëpunimi. Ai plotësohet me nenin 26, i cili përcakton detyrimet e palëve për t'i ofruar njëra-tjetrës ndihmë reciproke gjatë hetimeve dhe ndjekjeve penale.

3. Konventa për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi e vitit 1990 (ETS 141) (“Konventa e Strasburgut 1990”).

Konventa e Strasburgut e vitit 1990 ka fushëveprim më të gjerë se sa tri Konventat e Kombeve të Bashkuara të paraqitura më sipër, në kuptimin që nuk e kufizon konfiskimin në ndonjë kategori të posaçme të veprave penale. Megjithatë, përmes deklaratës, palët mund të kufizojnë zbatimin e dispozitave të Konventës për konfiskim në vepra të saktësuara penale, ose në kategori të caktuara të veprave penale.¹¹

- Neni 2 parashikon hapat që duhet të ndërmerren nga palët për të mundësuar konfiskimin e pasurisë së përfshirë në vepra penale dhe të të ardhurave nga veprat penale, si edhe thekson që secili shtet palë në Konventë mund t'i kufizojë kategoritë e veprave penale për të cilat vlejnë detyrimet e Konventës.
- Neni 13 i detyron shtetet palë në Konventë që të zbatojnë urdhrat për konfiskim të dhëna nga palët e tjera. Neni 14 parashikon procedurat sipas të cilave do të ekzekutohen urdhrat për konfiskim.
- Neni 18 përcakton shkaqet mbështetur në të cilat palët mund të refuzojnë bashkëpunimin me palët e tjera, ndërsa neni 23 përcakton që palët duhet t'i njohin vendimet e huaja gjyqësore. Neni 27 përcakton kushtet për kërkesa për bashkëpunim ndërmjet palëve shtetërore lidhur me kryerjen e hetimeve ose të procedurave gjyqësore.

2.2.3 Instrumentet e Bashkimit Evropian

Korrupsioni parashikohet si krim me nenin 83 (1) të *Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian*, duke i dhënë kështu BE-së kompetenca legjislativë për rregullimin e kësaj fushe. Ekzistojnë disa Vendime Kornizë të Këshillit (“FD”) të cilat e përfshijnë konfiskimin, krimin dhe korrupsionin. Shtetet anëtare (“MS”) janë të detyruara t'i përdorin masat e konfiskimit lidhur me veprat penale përkatëse. Për pasojë, këto instrumente të BE-së e promovojnë harmonizimin ndërmjet shteteve anëtare në një shkallë shumë më të madhe se sa standardet ndërkombëtare të përshkruara më sipër.

- Neni 3 i Vendimit Kornizë 2005/212/JHA e parashikon “konfiskimin e zgjeruar” (të njohur po ashtu edhe si ‘konfiskim i posaçëm’). Ai mundëson konfiskimin e pasurisë që nuk është drejtpërdrejt e lidhur me veprën penale që shqyrtohet në gjykatën kombëtare. Në mënyrë specifike, kjo dispozitë zbatohet kur të ardhurat e personit janë në shpërpjestim me vlerën e pasurisë së tij dhe gjykata është e bindur që pasuria në fjalë ka rrjedhur nga aktiviteti kriminal i personit.
- Direktiva e vitit 2014 2014/42/EU (“Direktiva 2014”) është prezantuar për t'i përafuar edhe më tej regjimet e ngrirjes dhe të konfiskimit të shteteve anëtare, duke patur parasysh dallimet e

11 Më shumë material sqarues mund të gjendet në Raportin Sqarues të Konventës në adresën: <https://rm.coe.int/CoER-MPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016800cb5de>

vazhdueshme ndërmjet ligjeve të shteteve anëtare. Ajo përfshin dispozita më të plota për harmonizimin e ligjeve të konfiskimit brenda BE-së në lidhje me vepra specifike të rënda penale.

- Rregullorja 2018/1805/BE (“Rregullorja 2018”) është prezantuar më pas. Ajo prezanton sistemin e njohjes reciproke për urdhrat për ngrirje dhe konfiskim të nxjerra në kuadër të kornizave të procedurave penale në çështjet penale, duke përcaktuar kur duhet të njihet dhe të ekzekutohet një urdhër për konfiskim, si edhe situatat kur shtetet anëtare mund ta refuzojnë njohjen. Rregullorja mbulon po ashtu edhe administrimin dhe tjetërsimin e pasurisë së ngrirë dhe të konfiskuar, detyrimet e shteteve anëtare ndaj personave të prekur dhe mjetet efektive ligjore të disponueshme për këta persona.

2.2.4 Instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Rekomandimet e *Task Forcës për Veprim Financiar lidhur me Pastrimin e Parave e vitit 2012* (“Rekomandimet TFVF”)

Task Forca për Veprim Financiar (TFVF) është një organ ndërqeveritar politikbërës që ka për qëllim caktimin e standardeve dhe promovimin e zbatimit efektiv të masave ligjore, rregulluese dhe operationale për luftimin e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit dhe të krimeve financiare lidhur me to. Rekomandimet e TFVF-së njihen si standarde ndërkombëtare për luftimin e këtyre aktiviteteve kriminale, pasi ofrojnë mjete të përshtatshme për luftimin e pastrimit të të ardhurave nga korrupsioni. Ndonëse shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk janë shtete anëtare të TFVF-së, MONEYVAL-i është anëtar partner dhe e realizon vlerësimin e shteteve në bazë të standardeve të TFVF-së (shih në vijim).¹²

Rekomandimi B (zakonisht i njohur si rekomandimi 4) ka të bëjë me pastrimin e parave dhe konfiskimin, me nenin 4 që përcakton qasjen e rekomandimeve ndaj masave të konfiskimit.

Rekomandimi G (zakonisht i njohur si rekomandimi 38) cakton standardet e rekomandimeve të TFVF-së lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar.

2.3. QASJA E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE LIDHUR ME ASPEKTET KRYESORE TË KONFISKIMIT

2.3.1 Urdhrat për ngrirje dhe kompetencat për hetim

Konfiskimit shpesh paraprihet nga ngrirja e pasurisë gjatë hetimit, duke parandaluar përkohësisht transaksionet me atë pasuri. Ngrirja e pasurisë është hap me rëndësi vendimtare për parandalimin e fshehjes ose të shpërndarjes së pasurisë, e cila në fund mund t’i nënshtrohet konfiskimit. Të gjitha konventat kryesore ndërkombëtare¹³ të trajtuara në këtë botim i detyrojnë palët të miratojnë masa për ngrirjen e pasurisë dhe i japin kompetenca të tjera hetuese. Ato zhvillohen edhe më tej në Direktivë, përfshirë masat mbrojtëse për të siguruar që urdhri për ngrirje nuk duhet të mbetet në fuqi më gjatë sesa është e nevojshme dhe pasuria e ngrirë e cila nuk konfiskohet duhet t’i kthehet pronarit të ligjshëm¹⁴.

12 Më shumë material sqarues mund të gjendet në dokumentin e TFVF për praktikën më të mira ‘Përdorimi i rekomandimeve të TFVF për luftimin e korrupsionit’ në adresën: <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/BPP-Use-of-FATF-Recs-Corruption.pdf>

13 UNTOC, UNCAC, Konventa e Strasburgut e vitit 1990, Konventa e Strasburgut 1999 dhe Konventa e Varshavës.

14 Urdhrat për ngrirje i nënshtrohen të njëjtit test proporcionaliteti si edhe urdhrat për konfiskim, por ka mundësi që natyra e tyre e përkohshme dhe parandaluese mund të ndihmojë për përcaktimin e tyre si proporcionale (p.sh. *Raimondo kundër Italisë* 12954/87, datë 22 shkurt 1994, dhe *Arcuri kundër Italisë* 52024/99, datë 5 korrik 2001).

2.3.2 Konfiskimi i zakonshëm (i bazuar në dënim)

Konfiskimi i zakonshëm, i bazuar në dënim, është njëri prej mjeteve më themelore të konfiskimit, së bashku me konfiskimin në bazë të vlerës dhe konfiskimin e mjeteve. Konfiskimi i zakonshëm është konfiskimi i produkteve ose i përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga vepra penale për një person, i cili është dënuar me vendim të formës së prerë. Kjo i bën të mundur gjykatës që, përmes një urdhri, ta privojë personin nga të ardhurat nga krimi (krimet) për të cilin/cilët ai është dënuar.

Të gjitha standardet ndërkombëtare të shënuara më sipër përfshijnë detyrimin e palëve për të miratuar masat e nevojshme për të mundur konfiskimin e zakonshëm të "produkteve" (ose të ardhurave) të krimit në kuadër të fushës së tyre përkatëse të veprimit¹⁵. Prandaj, në këtë aspekt është me rëndësi përkufizimi i «produkteve» të krimit:

Si në UNTOC ashtu edhe në UNCAC "produktet" e krimit nënkuptojnë çdo lloj pasurie (përfshirë dokumentet ligjore ose instrumentet ku dëshmohet e drejta mbi pasurinë përkatëse apo interesimi për të) që ka rrjedhur drejtpërdrejt apo është fituar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, përmes kryerjes së një veprë penale.

"Produktet" nga krimi përkufizohen në Konventën e Strasburgut 1990 si çfarëdo lloj avantazhi ekonomik nga veprat penale, i cili mund të përbëhet nga pasuria me çfarëdo lloj përkrimi, dhe po ashtu mund të përfshijë çfarëdo lloj dokumenti apo instrumenti ligjor që dëshmon të drejtën mbi këtë pasuri apo interesin mbi të. Edhe Konventa e Strasburgut e vitit 1999 ka të njëjtën qasje¹⁶.

Ato përkufizohen më gjerësisht në Konventën e Varshavës si çdo lloj avantazhi ekonomik, *i cili rrjedh ose fitohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga veprat penale, i cili mund të përbëhet nga pasuria e çfarëdo lloj trajte, si edhe nga çdo lloj dokumentesh dhe instrumentesh ligjore që dëshmojnë të drejtën mbi këtë pasuri apo interesin mbi të.* [Është shtuar theksimi]

Edhe Konventa e Varshavës e parashikon konfiskimin e pasurisë së passtruar.

"Produktet" përkufizohet gjerësisht në Direktivën e vitit 2014: ato përkufizohen si "çdo lloj avantazhi ekonomik që rrjedh nga veprat penale, i cili mund të përbëhet nga pasuria e çfarëdo lloj trajte, [përfshirë dokumentet dhe instrumentet ligjore që dëshmojnë të drejtën mbi këtë pasuri apo interesin mbi të] dhe përfshin investimet apo transformimet pasuese të produkteve të drejtpërdrejta nga një person i dyshuar apo i akuzuar si dhe çfarëdo lloj përfitimi të vlefshëm". [Është shtuar theksimi]

2.3.3 Konfiskimi i vlerës dhe pëzierja

Në disa situata mund të jetë e pamundur që të sekuestrohen produktet e drejtpërdrejta nga krimi, gjë e cila e bën të vështirë ose të pamundur konfiskimin e zakonshëm. Kjo mund të ndodhë në rastet kur të ardhurat nga krimi janë transformuar ose janë konvertuar në një tjetër trajtë pasurie. Në raste të tilla, armë efektive mund të jetë masa e cila mundëson konfiskimin e një sasi të parave të barasvlershme me vlerën e produkteve të krimit. Kjo formë konfiskimi njihet si konfiskimi i vlerës.

15 Kur ta nënshkruajnë ose ta ratifikojnë Konventën e Strasburgut të vitit 1990, palët mund ta kufizojnë zbatimin e kësaj dispozite të nenin 2(1) për miratimin e masave të konfiskimit lidhur me veprat e specifikuar penale ose kategoritë e veprave penale. Zbatimi i dispozitës së barasvlershme në Konventën e Varshavës mund të kufizohet po ashtu ose në veprat e dënueshme me maksimumi më shumë se një vit burgim, ose duke iu referuar një liste të veprave specifike, me kusht që të aplikohet konfiskimi i zakonshëm për pastrimin e parave dhe kategoritë e veprave penale të shënuara në shtojcën e Konventës.

16 Shih Raportin Sqarues lidhur me Konventën Penale për Korrupsion, paragrafi 94.

Situatë tjetër kur nuk është e mundur të bëhet sekuestrimi i produkteve të drejtpërdrejta nga krimi mund të paraqitet kur produktet e veprave penale janë përzier me pasurinë e fituar nga burimet e ligjshme. Kjo njihet si përzierje. Çështja e përzierjes mund të trajtohet me prezantimin e masave specifike që do ta mundësonin konfiskimin e një pjese të pasurisë së përzier duke e rrumbullaksuar vlerën e vlerësuar të produkteve fillestare nga krimi.

Të gjitha këto instrumente ndërkombëtare, UNTOC-u, UNCAC-u dhe Konventa e Varshavës, i detyrojnë palët të miratojnë masa për konfiskimin e vlerës. Përveç kësaj, ato i detyrojnë palët të mundësojnë konfiskimin e pasurisë kur janë transformuar ose konvertuar të ardhurat nga krimi dhe të mundësojnë konfiskimin e pasurisë së përzier deri në vlerën e vlerësuar të të ardhurave të përziera nga krimi.

Konventa e Strasburgut e vitit 1990 dhe ajo e vitit 1999 parashikojnë në mënyrë të hollësishme detyrimin për miratimin e masave të konfiskimit të vlerës dhe nuk i trajtojnë drejtpërdrejt çështjet që kanë të bëjnë me transformimin, shndërrimin apo përzierjen e pasurisë. Ndoshta qëllimi është që këto çështje të trajtohen përmes përkufizimit të gjerë të “produkteve”, i cili përfshinë çfarëdo lloj avantazhi ekonomik nga veprat penale. Mund të konsiderohet që pasuria e transformuar, e shndërruar ose e përzier, e cila ka rrjedhur nga një vepër penale, mund të konfiskohet pa ndonjë dispozitë të hollësishme shtesë, në bazë të interpretimit të saj si avantazh ekonomik, pavarësisht nëse ka ndryshuar forma e saj apo jo.

2.3.4 Konfiskimi i mjeteve

Mjetet janë çdo lloj pasuri e cila shfrytëzohet ose ka për qëllim të shfrytëzohet, në çfarëdo lloj mënyre, tërësisht apo pjesërisht, për të kryer një vepër penale ose disa vepra penale. Ato mund të përfshijnë, për shembull, automjetet që shfrytëzohen për fshehjen e mallrave në situatat e trafikimit, ose paisjet që përdoren për kryerjen e një krimi. Si UNTOC-u ashtu edhe UNCAC-u i detyrojnë palët të miratojnë masa për të mundësuar konfiskimin e pasurisë, të paisjeve ose të mjeteve të tjera¹⁷, të cilat shfrytëzohen apo janë të destinuara për t’u përdorur për realizimin e veprave të përfshira në këto konventa. Konventa e Strasburgut e vitit 1990 dhe ajo e vitit 1999, Konventa e Varshavës dhe Direktiva e vitit 2014 parashikojnë në mënyrë të ngjashme që çdo shtet palë duhet të prezantojë masa për të mundësuar konfiskimin e mjeteve (ashtu siç përkufizohet në fjalinë e parë të këtij paragrafi).

2.3.5 Konfiskimi i të ardhurave dhe përfitimeve të tjera që rrjedhin nga produktet e krimit dhe korrupsionit

Produktet e krimit dhe korrupsionit, ose pasuria në të cilën transformohen ose shndërrohen këto produkte, mund të gjenerojnë të ardhura ose përfitime të tjera të vlefshme. Është qartazi e rëndësishme që të gjitha këto lloj përfitimesh duhet t’i nënshtrohen konfiskimit në rastet e përshtatshme, nëse duam të sigurojmë ndëshkimin e aktivitetit kriminal dhe korrupsionit. Të gjitha standardet kryesore ndërkombëtare e trajtojnë këtë çështje, edhe pse e bëjnë këtë në mënyra të ndryshme.

Të gjitha instrumentet ndërkombëtare, UNTOC-u, UNCAC-u dhe Konventa e Varshavës, e parashikojnë qartë konfiskimin e të ardhurave dhe të përfitimeve të tilla, në mënyrë të njëjtë dhe në shkallë të njëjtë si produktet e krimit. Konventa e Strasburgut e vitit 1990 e trajton çështjen ndryshe përmes përkufizimit të “produkteve” nga krimi ku përfshihet çfarëdo lloj avantazhi ekonomik nga vepra penale. Pretendohet, të paktën, se këtu përfshihen avantazhet në trajtën e të ardhurave që rrjedhin nga produktet e krimit, edhe pse ndoshta ka pasur shqetësim që kjo nuk është del krejt e qartë. Direktiva e vitit 2014 e zgjeron përkufizimin e “produkteve” duke përcaktuar se ato përfshijë “çfarëdo lloj përfitimi të vlefshëm”.

17 “Mjetet” nuk përkufizohen në UNTOC ose në UNCAC.

2.3.6 Tjetërsimi i barrës së provës

Një element i rëndësishëm i regjimit të konfiskimit, si në lidhje me konfiskimin e zgjeruar po ashtu edhe më gjerësisht, është mënyra si përcaktohet se cilat pasuri duhet t'i nënshtrohen konfiskimit. Pa ndihmën e pronarit mund të jetë e vështirë të vërtetohet që pasuria ka prejardhje të paligjshme, kështu që mund të konsiderohet si e përshtatshme që lidhur me masat e konfiskimit barra e provës për të vërtetuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë t'i ngarkohet të akuzuarit. Disa standarde ndërkombëtare¹⁸ e sugjerojnë këtë qasje në mënyrë hezituese duke u shprehur se çdo shtet palë mund ta marrë parasysh mundësinë për t'i kërkuar të akuzuarit të dëshmojë prejardhjen e ligjshme të të ardhurave të pretenduara si produkte të krimit/korrupsionit, ose të pasurisë tjetër që rrezikohet të konfiskohet, deri në masën që kjo kërkesë është në pajtueshmëri me parimet¹⁹ e të drejtës së brendshme, me natyrën e procedurave gjyqësore dhe të procedurave të tjera. Konventa e Varshavës është pak më pak hezituese. Ajo i detyron palët të miratojnë masa lidhur me veprat penale (sipas përkufizimit të ligjeve kombëtare) duke kërkuar nga autori të dëshmojë prejardhjen e pasurisë që rrezikohet nga konfiskimi, edhe pse ky detyrim mund të mos zbatohet përmes deklaratës.²⁰ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka gjetur sisteme specifike që përfshijnë tjetërsimin e barrës së provës brenda kufijve që janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ")²¹. Megjithatë, KEDNJ-ja u "[kërkon] shteteve t'i kufizojnë ato brenda kufijve të arsyeshëm, të cilët e marrin parasysh rëndësinë e asaj që është në rrezik dhe sigurojnë të drejtën për t'u mbrojtur²²".

2.3.7 Konfiskimi nga pala e tretë

Një kriminel/zyrtar i korruptuar mund të bëjë përpjekje t'ju shmanget masave të konfiskimit duke i transferuar produktet e krimit tek palët e treta, siç janë të afërmit dhe personat të cilët kriminelin mund t'i kontrollojë. Konfiskimi nga palët e treta i referohet konfiskimit të pasurisë që gjendet tek palët e tilla të treta. Kombet e Bashkuara (UN) dhe Konventat e Këshillit të Evropës nuk përmbajnë rregulla të posaçme lidhur me konfiskimin nga pala e tretë, edhe pse potencialisht kjo mbulohet nga dispozitat e tyre të përgjithshme për konfiskimin.

Megjithatë, Direktiva e vitit 2014 përmban dispozita lidhur me konfiskimin nga pala e tretë. Ajo kërkon në mënyrë të qartë prezantimin e masave që mundësojnë konfiskimin nga pala e tretë, në rastet kur pala e tretë i ka siguruar të ardhurat, ose pasurinë tjetër, vlera e të cilës korrespondon me të ardhurat e transferuara nga një person i dyshuar ose i akuzuar, të paktën nëse, në bazë të fakteve dhe të rrethanave, pala e tretë ka qenë në dijeni ose është dashur të ketë qenë në dijeni të faktit që qëllimi i transferimit ose i pëvetësimit ishte shmangia e konfiskimit. Fakti që pasuria është transferuar pa pagesë ose në këmbim të një shume shumë më të vogël se vlera e tregut përmenden si tregues të mundshëm të të qenit në dijeni, duke i ngarkuar fajin palës së tretë.

Sa i përket mbrojtjes për "palët e treta të pafajshme", jurisprudenca e KEDNJ-së parashikon mbrojtje shumë të kufizuar në këtë aspekt.²³ Megjithatë, dispozitat e konfiskimit në rekomandimet e UNTOC-ut, UNCAC-ut, TFVF-së dhe Direktiva 2014 nuk duhet të interpretohen shprehimisht që i paragjykojnë të drejtat e palëve të treta *bona fide*. Konventa e Strasburgut e vitit 1990 parashikon që secila palë miraton masa që mund të jenë të nevojshme për të siguruar që palët e interesuara të

18 Rekomandimet e UNTOC-ut, UNCAC-ut, TFVF-së.

19 Në UNCAC flitet për "parimet themelore"; në UNTOC flitet vetëm për "parimet".

20 Shih nenin 53(4).

21 P.sh. *Grayson dhe Barnham kundër MB-së*, Vendim, datë 23 dhjetor 2008.

22 Paragrafi 28, *Salabiaku kundër Francës*, Vendim, datë 7 tetor 1988.

23 Në vendimin *AGOSI kundër MB*, datë 24 tetor 1986, është mbështetur urdhri për sekuestrim kundër një 'pronari të pafajshëm'.

prekura nga masat e konfiskimit, sipas Konventës, kanë mjete efektive ndihmëse ligjore në mënyrë që t'i ruajnë të drejtat e tyre. Konventa e Strasburgut e vitit 1999 nuk thotë asgjë lidhur me këtë çështje.

2.3.8 Konfiskimi i bazuar në mosdënim

Ekzistojnë situata të caktuara kur nuk mund të bëhet konfiskimi i bazuar në dënim penal. Për shembull, mund të mos ketë dëshmi të mjaftueshme për ta mbështetur ndjekjen penale, ose i dyshuari mund të ketë vdekur, ose mund të jetë arratisur, ose pas gjykimit është shfajësuar. Në situata të tilla, nuk ka dënim penal, por prapë mund të konsiderohet e dëshirueshme të mundësuarit e procedurës për konfiskim, në varësi të mbrojtjes së duhur. Disa shtete parashikojnë procedurë për konfiskim, në kushte të caktuara, në mungesë të dënimit penal. Ky quhet konfiskim i bazuar në mosdënim.

Standardet ndërkombëtare nuk e kanë rregulluar shumë qasjen ndaj konfiskimit civil. Ka mundësi që arsyeja për këtë është se operacioni i konfiskimit në mungesë të dënimit është një fushë posaçërisht e ndjeshme për shkak të pasojave potencialisht të rënda të masave të konfiskimit që mund të shqiptohen në bazë të standardeve civile të dëshmisë dhe për shkak të faktit që, nga aspekti procedural, konfiskimi shumë shpesh lidhet me gjykimin penal. UNTOC-u, UNCAC-u, Konventa e Strasburgut e vitit 1990, Konventa e Strasburgut e vitit 1999 dhe Konventa e Varshavës nuk e bëjnë dënimin penal parakusht për konfiskim në mënyrë të qartë, por përkufizimet e tyre të "produkteve të krimit" dhe dispozitat për konfiskim të mjeteve nënkuptojnë që ato përqendrohen shumë te konfiskimin e bazuar në dënim.

Megjithatë, në këtë fushë po zë fill një zhvillim i standardeve ndërkombëtare. UNCAC-u parashikon që, për qëllim të ndihmës reciproke, palët "marrin parasysh" marrjen e masave për lejjimin e konfiskimit të pasurisë me prejardhje të huaj sipas një urdhri të lëshuar nga gjykata e një pale tjetër pa dënim penal, në rastet kur shkelësi nuk mund të ndiqet penalisht për shkak të vdekjes, arratisjes apo mungesës, ose në raste të tjera të përshtatshme.²⁴ Në rekomandimet e TFVF-së thuhet që vendet nuk "duhet ta marrin parasysh miratimin" e masave të tilla.²⁵ Për më tepër, në Konventën e Varshavës, në kontekst të bashkëpunimit me shtetet kërkuese, thuhet që mund të kërkohej ekzekutimi i masave "në shkallën më të gjerë të mundshme sipas ligjit të brendshëm" në rastet kur kjo kërkohej "në lidhje me një vepër penale" [thexsim i shtuar] dhe jo domosdoshmërisht si sanksion penal pas dënimit²⁶.

Në kuadër të Bashkimit Evropian po krijohen standarde të cilat e pranojnë konfiskimin civil. Në lidhje me veprat e lidhura me tatimin, FD-ja e vitit 2005 parashikon që shtetet anëtare mund të shfrytëzojnë procedura të tjera përveç atyre penale për ta privuar autorin nga të produktet e veprës penale. Në vitin 2008, Komisioni Evropian propozoi që shtetet anëtare të marrin parasysh futjen në përdorim të masave të konfiskimit civil²⁷. Kjo është çuar edhe më tej në Direktivën 2014, e cila kërkon prezantimin e konfiskimit që nuk bazohet në dënim, ndonëse në rrethana shumë të kufizuara, kur sëmundja ose ikja e personit të dyshuar apo të akuzuar shkakton probleme në ndjekjen e dënimit penal dhe me kushtin që personi, prona e të cilit preket, duhet të përfaqësohet nga një avokat. Sipas memorandumit sqarues të Komisionit, kjo u mundëson shteteve anëtare të zgjedhin nëse konfiskimi duhet të jepet nga gjykata penale dhe/ose civile/administrative²⁸.

24 Shih nenin 54(1)(C) të UNCAC.

25 Rekomandimi 4.

26 Neni 23(5) i Konventës së Varshavës.

27 Paragrafi 3.3.1, Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin: 20.11.2008, COM (2008) 766 final, "Të ardhurat nga krimi i organizuar, të siguruarit që 'krimi nuk shpaguhet'".

28 COM(2012) 85 final, f.11.

2.3.9 Bashkëpunimi ndërkombëtar

UNTOC-u, UNCAC-u, Konventa e Strasburgut e vitit 1990, Konventa e Strasburgut e vitit 1999 dhe Konventa e Varshavës e njohin rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me konfiskimin dhe përfshijnë dispozita të hollësishme lidhur me të²⁹.

2.3.10 Masat mbrojtëse

Si UNCAC-u ashtu edhe UNTOC-u i detyrojnë palët shtetërore të ndërmarrin masat e duhura për mbrojtjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të viktimave, të cilët japin dëshmi lidhur me veprat e përcaktuara në pajtueshmëri me ato konventa, pa i paragjykuar të drejtat e të pandehurit, përfshirë të drejtën për proces të rregullt. Më tej, ato theksojnë që të drejtat *bona fide* të palëve të treta nuk duhet të cenohen. Ndonëse Konventa e Strasburgut e vitit 1990 dhe ajo e vitit 1999 nuk japin garanci specifike, Raporti Sqarues i Konventës së Strasburgut 1999 e pranon ndërhyrjen e mundshme të teknikave të posaçme hetuese. Prandaj, e vërteton që palët shtetërore janë të lira të vendosin që disa prej këtyre teknikave të mos pranohen në sistemin e tyre të brendshëm ligjor, ose e rrethojnë përdorimin e tyre “me aq masa mbrojtëse dhe garanci që kërkohen nga domosdoshmëria e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe e lirive themelore”³⁰.

2.4 ORGANET MONITORUESE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

2.4.1 GRECO

Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) është krijuar në vitin 1999 nga Këshilli i Evropës për të monitoruar pajtueshmërinë e shteteve me standardet antikorrupsion të organizatës. Përveç monitorimit të zbatimit të Konventës të Strasburgut të vitit 1999, GRECO monitoron respektimin e parimeve udhëheqëse për luftën kundër korrupsionit të miratuara në vitin 1997 nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës (“Parimet udhëheqëse”).

Prej tyre, parimet në vijim janë shqyrtuar në veçanti gjatë raundit të dytë të vlerësimit (2003-2006) dhe janë përqendruar te identifikimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga korrupsioni, parandalimi dhe zbulimi i korrupsionit në administratën publike dhe te parandalimi i përdorimit të personave juridikë si mburoja për korrupsion:

- **Produktet/të ardhurat nga korrupsioni:**
 - » Parimi udhëheqës 4: të ofrojë masat e duhura për sekuestrimin dhe privimin nga të ardhurat nga veprat e korrupsionit;
 - » Parimi udhëheqës 19: të sigurojë marrjen parasysh të lidhjeve të mundshme me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave në çdo aspekt të luftës kundër korrupsionit;
- **Administrata publike dhe korrupsioni:**
 - » Parimi udhëheqës 9: të sigurojë që proceset organizative, funksionale dhe vendimmarrëse të administratës publike marrin parasysh nevojën për luftimin e korrupsionit, në veçanti duke siguruar transparencë të mjaftueshme që është në përputhje me nevojën për arritjen e efikasitetit;

29 Shih Doracakun e UNODC-së për bashkëpunimin ndërkombëtar për qëllime të konfiskimit të të ardhurave nga krimi: http://www.unodc.org/documents/organized-crime/Publications/Confiscation_Manual_Ebook_E.pdf

30 Raporti sqarues për Konventën Penale për Korrupsion, paragrafi 114.

- » Parimi udhëheqës 10: të sigurojë që rregullat lidhur me të drejtat dhe detyrat e zyrtarëve publikë marrin parasysh kërkesat e luftës kundër korrupsionit dhe parashikojnë masa të përshtatshme dhe efektive disiplinore; promovojnë saktësim të mëtejshëm të sjelljes që pritet nga zyrtarët publik përmes mjeteve të përshtatshme, siç janë kodet e sjelljes;
- **Personat juridikë dhe korrupsioni:**
 - » Parimi udhëheqës 5: të ofrojë masa të përshtatshme për parandalimin e shfrytëzimit të personave juridikë si mburojë për veprat e korrupsionit;
 - » Parimi udhëheqës 8: të sigurojë që legjislacioni fiskal dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij kontribuojnë për luftimin e korrupsionit në mënyrë efektive dhe të bashkërenduar, në veçanti duke refuzuar zbritjen e taksave, sipas ligjit ose në praktikë, për mitmarrje/mitdhënie ose për shpenzimet e tjera lidhur me veprat e korrupsionit;

GRECO ndihmon në identifikimin e politikave kombëtare kundër korrupsionit, duke i nxitur reformat legjislative, institucionale dhe praktike. GRECO po ashtu ofron një platformë për ndarjen e praktikave më të mira në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit.

2.4.2 MONEYVAL-i

MONEYVAL-i (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit) është një organ tjetër i përhershëm monitorues i Këshillit të Evropës. Atij i është besuar detyra e vlerësimit të pajtueshmërisë me standardet kryesore ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe efikasiteti i zbatimit të tyre, si edhe detyra e nxjerrjes së rekomandimeve për autoritetet kombëtare lidhur me përmirësimet e nevojshme në sistemet e tyre. Ai e bën këtë përmes një procesi dinamik të vlerësimeve reciproke, rishikimit të kolegëve dhe vazhdimësisë së rregullt të raporteve të veta. MONEYVAL-i i vlerëson të 34 anëtarët e vetë në bazë të standardeve të sipërpërmendura të TFVF-së.

2.5 KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Ndërsa komuniteti ndërkombëtar është fort i motivuar për ta luftuar korrupsionin dhe për t'i kthyer produktet e krimit,³¹ është shumë e rëndësishme që masat për këtë qëllim të jenë në pajtueshmëri me mekanizmat për të drejtat e njeriut, në mënyrë që të pengohet sekuestrimi arbitrar i pasurisë dhe të mbrohen të drejtat thelbësore të individëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ” ose “Gjykata”) pranon që kompetencat për konfiskim, të cilat i kanë shtetet, janë të arsyeshme dhe të domosdoshme për ta luftuar krimin e organizuar në mënyrë të suksesshme. Përmes zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ” ose “Konventa”), ajo, megjithatë, siguron që pronarëve të pasurive të tilla të konfiskuara t’ju ofrohet niveli themelor minimal i mbrojtjes³².

Në procesin e konfiskimit të të ardhurave nga krimi mund të përfshihen disa të drejta nga Konventa. Në radhë të parë, është e drejta për zotërim të qetë të pasurisë (neni 1 i Protokolit nr.1), e drejta për proces të rregullt ligjor (neni 6) dhe në rrethana të caktuara, neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) kur pronat që konsiderohen “shtëpi” konfiskohen apo kontrollohen. Së fundi, çështjet, të cilat kanë të bëjnë me ligjshmërinë e veprave apo të dënimeve, mund ta përfshijnë parimin e mosdënimit pa ligj (neni 7).

31 Këshilli Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe TI, *Integrimi i të Drejtave të Njeriut në Agjendën Anti-Korrupsion: Sfidat, Mundësitë dhe Rastet*, 2010, f. 63.

32 Frankie McCarthy, *Mbrojtja e Pronës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, 6 Brigham-Kanner Prop. Rts. Conf. J. 306 – 307 (2017).

Qëllimi i kësaj pjese është të sqarojë, në lidhje me praktikën përkatëse gjyqësore, mënyrën e funksionimit të këtyre neneve lidhur me konfiskimin, sekuestrimin dhe humbjen e të ardhurave nga krimi. Më poshtë do të shqyrtohet përmbajtja e neneve dhe parimet kryesore të parashikuara nga Gjykata, të pasuara nga përmbledhja e praktikës kryesore gjyqësore përkatëse për konfiskimin e pasurisë. Qëllimi gjithëpërfshirës është t'i ndihmojë lexuesit t'i kuptojnë më mirë kontekstet e ndryshme në të cilat mund të përfshihen këto të drejta të Konventës dhe kur mund të shkelen ato.

2.5.1 Neni 1 i Protokollit 1

2.5.1.1 Neni 1 i Protokollit 1 – pjesa e përgjithshme

Parimi i të drejtës për posedim të qetë të pasurisë është parashikuar në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Neni 1 i Protokollit nr.1 thotë:

- 1) *Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë të posedojë i qetë pasurinë e tij. Askush nuk privohet nga pasuria përveç nëse kjo është në interes publik ose nëse i nënshtrohet kushteve të parashikuara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
- 2) *Dispozitat paraprirëse, megjithatë, nuk e dobësojnë në asnjë mënyrë të drejtën e shtetit për zbatimin e ligjeve të tilla që konsiderohen të domosdoshme për kontrollimin e pasurisë në pajtueshmëri me interesin e përgjithshëm ose për ta siguruar pagesën e taksave ose të kontributeve të tjera ose të ndëshkimeve.*

Neni 1 i Protokollit nr. 1 garanton të drejtat e pronës dhe i mbron individët apo personat juridik nga ndërhyrja arbitrare e shtetit në pasurinë e tyre.³³ Neni 1 i Protokollit nr. 1 imponon shtetit si detyrim negativ ashtu edhe atë pozitiv për ta mbrojtur posedimin e pasurisë³⁴. Megjithatë, gjykata e njeh të drejtën e shtetit për ta konfiskuar pasurinë e individëve apo të personave juridikë brenda kushteve të caktuara të parashikuara në nenin 1 të Protokollit nr. 1. Në mënyrë specifike, çdo ndërhyrje duhet të jetë në pajtueshmëri me interesin publik, të zhvillohet në mënyrë të tillë që është në pajtueshmëri me sundimin e ligjit dhe në proporcion me qëllimin e tij.

Gjykata ka krijuar një proces të përbërë prej tri niveleve për të vendosur nëse ka ndodhur shkelja e kësaj dispozite apo jo.

(i) Përfshirja e nenit 1 të Protokollit nr. 1: 'Posedimi' i 'pronës'

Për të hyrë në fushën e veprimit të Konventës, individit duhet ta 'posedojë' pronën në kuptimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1. Shprehja 'posedim' ka kuptim autonom në sistemin e Konventës³⁵ dhe sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 ajo ka të bëjë me pretendimin/të drejtën e individit mbi pronën. Është me rëndësi vendimtare që ky pretendim/e drejtë duhet të bazohet në të drejtën e brendëshme dhe është detyrim i parashtruesit të ankesës ta vërtetojë natyrën e saktë të së drejtës së tij në të drejtën e brendshme. Për shembull, në çështjen *Novikov kundër Rusisë*³⁶, gjykata ka vënë në pah që kërkuesi kishte pretendime mbi karburantin e sekeuestruar nga policia ruse si objekt i krimit sepse ai ishte përfitues i një marrëveshjeje transferimi lidhur me karburantin, e cila ishte e zbatueshme sipas ligjit rus.

33 *Marckx kundër Belgjikës*, vendim, datë 13 qershor 1979.

34 *Öneryıldız kundër Turqisë*, vendim, datë 30 nëntor 2004.

35 *Gasus Dossier und Föedertechnik GmbH kundër Holandës*, vendim, datë 23 shkurt 1995.

36 *Novikov kundër Rusisë*, vendim, datë 11 korrik 2013.

Për t'u pranuar si 'posedim', çdo e drejtë/pretendim mbi pronë në të ardhmen duhet jetë pjesë e fushës së veprimit të pretendimit të ligjshëm ose të pritsshmërisë legjitime. Pritshmëria legjitime është e zbatueshme sipas së drejtës së brendshme dhe konsiderohet si pasuri për qëllime të nenit 1 të Protokollit nr. 1. *Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë*³⁷ përfshinte një burrë i cili ishte dënuar për tradhti dhe autoritetet e kishin konfiskuar pasurinë. Më pas, bashkëshortja dhe e bija pretenduan që ato posedonin pjesërisht pasurinë e konfiskuar. Gjatë vlerësimit të pretendimit të gruas, gjykata konstatoi që e drejta e bendshme parashikonte pronësi të përbashkët mbi pasurinë e fituar nga bashkëshortët në martesë, prandaj bashkëshortja kishte pritsshmëri legjitime ndaj një pjese të pasurisë familjare që ishte e barabartë me atë të bashkëshortit të vet.

Shprehja "pasuri" interpretohet gjerësisht dhe nuk është e kufizuar vetëm në mallra fizike. Ajo përfshinë si në vijim:

- pasurinë e prekshme, të tundshme dhe të patundshme (mallrat, ndërtesat, tokën);
- pasurinë e paprekshme (fondet monetare, aksionet, pronën intelektuale, pensionet, të drejtat e sigurimit social);
- pretendimet ligjore (vendimet detyruese të gjykatave dhe të tribunaleve, detyrimet e borxhit).

Në kontekstin e sekuestrimit, të konfiskimit ose të humbjes së pasurisë, posedimet kanë përfshirë avionë të konfiskuar,³⁸ pasurinë e sekuestruar në proceset penale,³⁹ si edhe pasurinë e sekuestruar në një vend të huaj.⁴⁰

(ii) Ndërhyrja në nenin 1 të Protokollit nr. 1 – Tri rregullat

Pas hapit të parë, gjykata përcakton nëse ka (ka pasur apo do të ketë) ndërhyrje në posedimin e një prone. Kjo përfshin shqyrtimin e akteve apo të fushave përkatëse për të parë nëse ato ndikojnë në posedimin e pasurisë në fjalë. Vendimi i gjykatës do të përcaktohet përmes një shqyrtimi se cila prej tri rregullave vlen në situatën në fjalë⁴¹.

Rregulli i parë

Rregulli i parë vendos parimin e përgjithshëm që individët kanë të drejtë për posedimin e qetë të pasurisë së tyre (formula që i përfshinë të gjitha). Rregulli i dytë dhe i tretë duhet të interpretohen në frymën e këtij parimi të përgjithshëm.

Rregulli i dytë

Rregulli i dytë ka të bëjë me privimin nga posedimi, që do të thotë shuarja e të drejtave pronësore të individit. Për ta përcaktuar nëse ka patur apo do të ketë «privim», gjyqtari shqyrton nëse individ është (apo do të jetë) në gjendje ta shfrytëzojë, ta shesë, ta dhurojë pasurinë në fjalë, apo përndryshe do të mund t'i ushtrojë të drejtat e veta mbi këtë pasuri.

Privimi mund të jetë *de facto* ose *de jure*. Në përgjithësi, privimi *de facto* ndodh kur autoritetet përkatëse (p.sh. një organ shtetëror) ndërhyjnë në posedimin e pronës pa e larguar zyrtarisht titullin e pronarin. Duhet theksuar që gjykata është e kujdesshme lidhur me njohjen e privimit *de facto* të

37 *Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë*, vendim, datë 1 prill 2010.

38 *Bosphorus Airways kundër Irlandës*, vendim, datë 30 qershor 2005.

39 *Tandem kundër Spanjës*, vendim, datë 13 korrik 2010.

40 *Saccoccia kundër Austrisë*, vendim, datë 18 dhjetor 2008.

41 *Gogitidze kundër Gjeorgjisë*, vendim i Dhomës së Madhe, datë 12 maj 2015.

pasurisë për qëllime të nenit 1(2) të Protokolit nr. 1, përveç nëse kur të drejtat e pronarit janë shuar zyrtarisht. Në rastin *Hentrich kundër Francës*⁴², gjykata është shprehur se parablerja e pasurisë së kërkuesit nga ana e autoritetit tatimor, pasi ajo i ishte shitur kërkuesit me një çmim tepër të ulët, përbën shpronësim *de facto* të pasurisë meqenëse parablerja përbënte privim të posedimit të kërkuesit, ashtu siç përkufizohet në nenin 1 të Protokolit nr. 1.

Sipas rregullit të dytë, jo të gjitha aktet e kufizimit të të drejtave pronësore të pronarit konsiderohen si privime; disa prej tyre bëjnë pjesë në rregullin e tretë.

Rregulli i tretë

Rregulli i tretë ka të bëjë me kontrollin e shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesat e përgjithshme. Kontrolli i shfrytëzimit të pronës del në pah kur një organ përkatës ka vendosur rregulla në interesin e përgjithshëm, të cilat e kufizojnë posedimin e pronës nga ana e pronarit por nuk përbëjnë privim nga posedimi. Si pjesë e kompetencave të tij, shteti ka liri të gjerë, por jo të pakufizuar, të vlerësimit, për të kontrolluar pronën. Kontrolli i pronës duhet të zbatohet në harmoni me rregullat e përgjithshme dhe nuk mund të jetë arbitrar⁴³. Gjykata shpesh i citon si shembull të kontrollit të pronës, sipas rregullit të tretë, dispozitat e konfiskimit sipas ligjeve të vendin në fuqi.

Kontrolli i shtetit lidhur me shfrytëzimin e pronës mund të ketë fushëveprim më të gjerë se sa privimi nga prona. Shteti mund të ndikojë në "kontroll" duke zbatuar rregullat që kërkojnë veprim pozitiv nga një individ⁴⁴, ose përmes rregullave që imponojnë kufizime në aktivitetet e tyre – për shembull:

- Kontrolli i planifikimit
- Urdhrat mjedisore
- Urdhrat për konfiskim
- Urdhrat për sekuestrim

Gjykata thekson që të tria rregullat nuk janë të ndryshme dhe të shkëputura nga njëra-tjetra. Dy të fundit janë të dy instanca të një ndërhyrjeje në posedimin e qetë të pronës dhe, si të tilla, ato duhet të interpretohen në frymën e parimit të përgjithshëm të parashikuar në rregullin e parë.⁴⁵ Nëse ndërhyrja në të drejtat pronësore nuk mund të klasifikohet sipas rregullit të dytë apo të tretë, atëherë zbatohet rregulli i parë.

(iii) Arsyetimi për ndërhyrje

Hapi i fundit që duhet ta ndërmarrë gjykata për të vlerësuar nëse ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokolit 1 është të përcaktojë nëse ndërhyrja në të drejtat pronësore të parashtruesit të ankesës është e arsyeshme. Për të qenë e arsyeshme, veprimet e shtetit duhet t'i kalojnë tri teste të qarta: ato duhet të jenë të ligjshme, t'i shërbyjnë qëllimit legjitim dhe të ruajnë një ekuilibër të drejtë, proporcional ndërmjet të drejtave të individit dhe qëllimit legjitim të ndjekur.

Ligjshmëria

Së pari, ndërhyrja e shtetit në pronën e parashtruesit të ankesës duhet të ketë qenë e ligjshme, çfarë do të thotë se ndërhyrja duhet të ketë pasur bazë të qartë në legjislacionin e brendshëm dhe t'i

42 *Hentrich kundër Francës*, vendim, datë 22 shtator 1994.

43 *Pine Valley Developments Ltd kundër Irlandës*, vendim, datë 9 shkurt 1993.

44 *Denev kundër Suedisë*, vendim, datë 18 janar 1989.

45 *James kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 21 shkurt 1986.

ketë respektuar parimet e sundimit të ligjit. Ligjshmëria nuk kërkon vetëm që shteti të veprojë në pajtueshmëri me legjislacionin e saktë të brendshëm, por edhe që të respektojë një procedurë të drejtë dhe të duhur – masa në fjalë duhet të nxirret nga një autoritet i përshtatshëm dhe të ekzekutohet nga ai dhe nuk duhet të jetë arbitrare⁴⁶. Shkurt, në mënyrë që ndërhyrja të jetë e ligjshme, ajo duhet të bazohet në të drejtën kombëtare⁴⁷ dhe të jetë e qartë, e parashikueshme dhe e saktë për personat në fjalë⁴⁸. Megjithatë, shtetet nuk pengohen që t'i ndryshojnë ligjet e tyre në mënyrë që t'i rregullojnë situatat e vazhdueshme faktike ose marrëdhëniet ligjore në mënyrë prapavepruese.⁴⁹

Baklanov kundër Ruisë kishte të bënte me konfiskimin e 250,000 dollarëve të parashtruesit të ankesës për shkak të kontrabandës, pasi ai ishte kontrolluar në një aeroport dhe nuk kishte deklaruar që kishte me vete një shumë të tillë dollarësh. Pas dënimit me dy vjet burgim me kusht, paratë i ishin konfiskuar si objekt kontrabande. Parashtruesi i ankesës u ankua në gjykatë duke parashtruar se paratë i ishin konfiskuar pa kurrfarë baze në ligj sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Gjykata konstatoi që ligji i brendshëm përkatës nuk ishte mjaftueshëm i qartë për t'i "mundësuar parashtruesit të ankesës të parashikonte pasojat e veprimeve të tij, deri në masën që është e arsyeshme në ato rrethana". Kjo shkaktohej nga fakti që Kodi i ri Penal nuk i përfshinte më dispozitat e Kodit Penal të mëparshëm që mundësonin konfiskimin në rrethana të tilla dhe praktika gjyqësore jo-konsekuente e vendit nuk e sqaronte çështjen. Prandaj, gjykata u shpreh se kishte shkelje të nenit 1 i Protokollit nr. 1.

Qëllimi legjitim

Së dyti, ndërhyrja e shtetit në të drejtën e posedimit të qetë të pronës duhet t'i shërbejë qëllimit legjitim në interes të publikut ose në interesin e përgjithshëm⁵⁰. Për shkak të morisë së madhe të politikave të krijuara nga shtetet, të cilat mund të ndikojnë mbi pronën në një mënyrë, formë apo trajtë, gjykata e pranon që shtetet posedojnë liri të madhe vlerësimi gjatë përcaktimit se çfarë mund të jetë në interes publik apo të përgjithshëm, e çfarë nuk është⁵¹. Në rastet kur përfshirja shtetërore përfshin politikën sociale dhe ekonomike të zbatuar përmes legjislacionit, gjykata "e respekton vendimin e ligjvënësit lidhur me atë se çfarë është "në interes të publikut, përveç nëse vendimi në fjalë është dukshëm i pabazuar"⁵².

46 *Winterwerp kundër Holandës*, vendim, datë 24 tetor 1979.

47 *Bosphorus Airways kundër Irlandës*, vendim, datë 30 qershor 2005.

48 *Carbonara and Ventura kundër Italisë*, vendim, datë 30 maj 2000 dhe *Beyeler kundër Italisë*, vendim, datë 5 janar 2000.

49 *Gogitidze kundër Gjeorgjisë*, vendim i Dhomës së Madhe, datë 12 maj 2015.

50 *James kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 21 shkurt 1986.

51 *James kundër Mbretërisë së Bashkuar* si më sipër.

52 Po aty.

Në çështjen *Riela dhe të tjerët kundër Italisë* prona e parashtruesit të ankesës ishte konfiskuar nga autoritetet italiane me arsyen që ajo ishte fituar përmes të ardhurave nga krimi. Ekzistoni dëshmi të rëndësishme që dy parashtruesit e parë të ankesës ishin anëtarë të një organizate kriminale të llojit mafia dhe që prona e konfiskuar ishte fituar përmes aktiviteteve të tyre në këtë organizatë. Parashtruesit e ankesës u ankuan sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 që masa e konfiskimit e shkelte të drejtën e tyre në lidhje me pronën. Gjykata u shpreh në çështjen *Riela* se përderisa masa e konfiskimit i kishte shkelur pa dyshim të drejtat e parashtruesve të ankesës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, qëllimi legjitim i luftimit të organizatave kriminale të llojit mafia në Itali ishte aq i rëndësishëm sa që ndërhyrja në Konventë nuk ishte në shpërpjestim me qëllimin. Prandaj, nuk kishte shkelje të Konventës dhe kërkesa ishte qartë e pabazë.

Ndërhyrja proporcionale

Së fundi, ndërhyrja e shtetit në pronë duhet të jetë proporcionale. Duhet të arrihet një ekuilibër i drejtë ndërmjet të drejtave të parashtruesit të ankesës për posedim të qetë të pronës dhe të kërkesës për interes publik.

Në çështjen *AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar* parashtruesi i ankesës u kishte shitur 1,500 monedha ari Kruegerrand dy meshkujve, të cilët ishin arrestuar duke u përpjekur t'i kontrabandonin monedhat në Mbretërinë e Bashkuar. Monedhat ishin konfiskuar si objekte kontrabande. Në kontratën për shitjen e monedhave thuhej që e drejta mbi monedha nuk bartej deri sa t'i bëhej pagesa kompanisë dhe meqë çeku që i ishte dhënë AGOSI-t për pagesë nuk ishte respektuar, kompania pretendoi në procedurën gjyqësore në MB që ajo kishte ende të drejtë mbi monedha, prandaj ato duhet t'i ktheheshin kompanisë. Parashtruesi i ankesës u ankua në gjykatë duke pretenduar se konfiskimi i monedhave kishte shkelur nenin 1 të Protokollit nr. 1 sepse ata nuk ishin fajtorë për asnjë vepër. Në vlerësimin e proporcionalitetit, Gjykata u shpreh në çështjen AGOSI:

“Shteti gëzon liri të gjerë vlerësimi në lidhje me zgjedhjen e mjeteve për zbatimin dhe për vërtetimin nëse pasojat e zbatimit janë të arsyeshme për interesin e përgjithshëm për qëllim të arritjes së objektit të ligjit në fjalë”.

Gjykata e ka pranuar që arritja e një ekuilibri të drejtë varet nga shumë faktorë të ndryshëm:

Sjellja e pronarit (lidhur me veprën që ka shkaktuar ndërmarjen e veprimit nga shteti p.sh. një vepër penale).⁵³

Niveli i fajit ose i kujdesit të treguar nga pronari në sjelljen e vet dhe nëse procedurat e zbatueshme e kanë lejuar shtetin të marrë parasysh nivelin e fajit apo të kujdesit të parashtruesit të ankesës⁵⁴.

Qëllimet dhe objektivat e politikave/legjislacionit në fjalë. Në veçanti ligjvënësi duhet të ketë mundësi të marrë masa për të ndikuar në qëllimin e politikave të miratuara.⁵⁵

53 *AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 24 tetor 1986.

54 *AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 24 tetor 1986.

55 *Mellacher kundër Austrisë*, vendim, datë 19 dhjetor 1989.

Nëse shteti e ka kaluar pragun e vet të vlerësimit⁵⁶.

Çështje të tjera të shqyrtuara nga gjykata janë: volia,⁵⁷ siguria në ushtrimin e pushtetit shtetëror,⁵⁸ ndikimi i ndërhyrjes te individit,⁵⁹ masat mbrojtëse procedurale,⁶⁰ dhe pagesa e kompensimit⁶¹.

Pragu i gjerë i vlerësimit për shtetin në luftën kundër korrupsionit ilustron me shembullin e çështjes *Gogitidze kundër Gjeorgjisë*⁶².

Gogitidze kundër Gjeorgjisë kishte të bënte me konfiskimin e pronës në pronësi të një ish-ministri të qeverisë të Ajaris, në Gjeorgji. Ai akuzohej për keqpërdorim të detyrës dhe zhvatje në lidhje me pretendimet për korrupsion të bëra kundër tij gjatë kohës kur ishte në atë pozitë. Ndonëse parashtruesi i ankesës nuk ishte dënuar për ndonjë krim, pesë prej pronave të tij, të zbritura në pesë (nga gjashtë) pas ankimimit, ishin konfiskuar nga autoritetet gjeorgjiane me argumentin se ishte e pamundur që ai ta vinte një pasuri me vlerë prej 450,000 eurosh vetëm nga paga zyrtare që ishte nga 1,644 euro deri në 6,023 euro në vit. Parashtruesi i ankesës pohoi në gjykatë që konfiskimi i shkelte të drejtat e tij sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, dhe nenit 6. Gjykata u shpreh se procedura e konfiskimit ndiqte qëllimin legjitim të parandalimit të pasurimit të padrejtë përmes korrupsionit duke dërguar sinjal tek zyrtarët publikë që pasuria e tyre, e fituar në mënyrë të pandershme, mund të sekuestrohej edhe pa dënim penal. Gjykata e konsideroi të arsyeshme vendosjen e barrës së provës mbi parashtruesin e ankesës, duke u mbështetur atë në faktin që konventat ndërkombëtare mbi korrupsionin i lejonin shprehimisht në masat e tilla. Për më tepër, gjykata vërejtë që procedurat e përmendura të konfiskimit, që zbatoheshin sipas këshillave të MONEYVAL-it dhe GRECO-s, ishin efektive për ta ndihmuar Gjeorgjinë që të luftonte korrupsionin. Gjykata konstatoi po ashtu se konfiskimi i pasurisë së parashtruesit të ankesës para përcaktimit të fajësisë penale ishte legjitim, meqë kishte jashtëzakonisht shumë prova rrethore që dëshmonin që të ardhurat e ligjshme të parashtruesit të ankesës nuk do të kishin mjaftuar për ta fituar pasurinë në fjalë.

Ndonëse autoritetet e brendshme duhet të jenë të lira të marrin masa që kanë ndikim mbi qëllimin e politikave të miratuara prej tyre, këto masa duhet po ashtu të jenë proporcionale.

56 *Pressos Compania Naviera SA kundër Belgjikës*, vendim, datë 20 nëntor 1995.

57 *Erkner and Hofauer kundër Austrisë*, vendim, datë 23 prill 1987.

58 *Hentrich kundër Francës*, vendim, datë 22 shtator 1994.

59 *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, vendim, datë 23 prill 1987.

60 *Hentrich kundër Francës*, vendim, datë 22 shtator 1994.

61 *Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 8 korrik 1986.

62 *Gogitidze kundër Gjeorgjisë*, vendim i Dhomës së Madhe, datë 12 maj 2015.

Parashtruesja e ankesës në çështjen *Gabric kundër Kroacisë* ishte ndalur nga policia teksa po kalonte kufirin ndërmjet Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Kroacisë. Policia i sekuestroi 20,000 marka gjermane dhe 61 kuti kartoni me cigare nga vetura e saj. Parashtruesja e ankesës ishte e dënuar për shmangie të kontrollit doganor, ishte dënuar gjashtë muaj me kusht dhe i ishin konfiskuar cigaret. Ajo ishte dënuar po ashtu për një shkelje administrative lidhur me 20,000 markat gjermane, për të cilat ishte gjobitur, dhe paratë i ishin konfiskuar. Parashtruesja e ankesës pretendonte se këto masa ishin të tepruara dhe i shkelnin të drejtat e saj sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata pranoi që konfiskimet e autoriteteve ishin të ligjshme dhe përbënin kontroll të shfrytëzimit të pasurisë. Megjithatë, meqë parashtruesja e ankesës tashmë ishte gjobitur lidhur me mosdeklarimin e parave, nuk ishte dënuar penalisht lidhur me paratë, dhe i kishte fituar paratë në fjalë në mënyrë të ligjshme, gjykata vendosi që qeveria nuk kishte treguar në mënyrë bindëse që gjobitja fillestare nuk kishte shërbyer si frenim dhe dënim i mjaftueshëm. Prandaj, konfiskimi nuk ishte proporcional dhe përbënte shkelje të Konventës.

Qasja ndaj proporcionalitetit në çështjen *Gabric* pasqyrohet në çështjen e dërguara para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED) *Chmielewski kundër Nemzeti Adó- és Vámhivatal Dél-alföldi Regionális Vám-és Pénzügyőri Főigazgatósága*.⁶³

Chmielewski kundër Nemzeti Adó- és Vámhivatal Dél-alföldi Regionális Vám-és Pénzügyőri Főigazgatósága kishte të bënte me vënien e gjobës për Z. Chmielewski në barasvlerë të 60% të shumës së parave, të cilat parashtruesi i ankesës nuk i kishte deklaruar kur kishte hyrë në BE prej Serbisë në Hungari. Z. Chmielewski ngriti padi ndaj vendimit, duke pretenduar që ligji sipas të cilit ishte gjobitur ai, nuk ishte në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së. GJED-ja theksoi që ashpërsia e dënimit duhet të ishte në përpjestim të drejtë me seriozitetin e shkeljeve për të cilat jepet dënimi. Ndonëse shtetet anëtare kanë liri veprimi për të vendosur lidhur me mënyrën e sigurimit të pajtueshmërisë me detyrimet e tyre për ta zbatuar të drejtën e BE-së, vlera e gjobës në këtë rast ishte gjykuar si joproporcionale meqë shkonte përtej asaj që nevojitej për të arritur pajtueshmëri. Një gjobë apo një shumë më e vogël, së bashku me masën për t'i mbajtur paratë e padeklaruara, do të ishin në gjendje që të përmbushnin në mënyrë proporcionale objektivat e ndjekura nga rregulloret përkatëse.

GJED-ja nënvizoi që ashpërsia e dënimit duhet të jetë në përpjestim të drejtë me seriozitetin e shkeljeve për të cilat jepet vendimi. Ndonëse shtetet anëtare kanë liri veprimi për të vendosur lidhur me mënyrën e sigurimit të pajtueshmërisë me detyrimet e tyre për ta zbatuar të drejtën e BE-së, vlera e gjobës në këtë rast u gjykua si joproporcionale meqë shkonte përtej asaj që nevojitej për të arritur pajtueshmërinë. Një gjobë apo një shumë më e vogël, së bashku me masën për t'i mbajtur paratë e padeklaruara, do të ishin në gjendje që të përmbushnin në mënyrë proporcionale objektivat e ndjekura nga rregulloret përkatëse.

Shembuj të tjerë ku Gjykata ka konsideruar që veprimi i shtetit nuk ka qenë proporcional mund të lexohen në vijim:

Grifhorst kundër Francës:⁶⁴ Konfiskimi i parave të parashtruesit të ankesës përbënte shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, pasi nuk mund të paraqitej asnjë provë që dëshmonte që paratë ishin

63 *Chmielewski kundër Nemzeti Adó- és Vámhivatal Dél-alföldi Regionális Vám- és Pénzügyőri Főigazgatósága*, vendim i GJED-së, datë 16 korrik 2015.

64 *Grifhorst kundër Francës*, vendim, datë 26 shkurt 2009.

të lidhura me ndonjë aktivitet të paligjshëm dhe urdhri për konfiskim ishte shumë më i ashpër se sa ndëshkimi i zakonshëm në rrethana të tilla.

Tandem kundër Spanjës:⁶⁵ Gjykata u shpreh që, në rast se pronari i pasurisë lirohet nga akuzat përkatëse kundër tij, duhet të merren masa të arsyshme për ruajtjen e pasurisë së sekuestruar.

Gladysheva kundër Ruisë:⁶⁶ Lënia pa pronë e blerëses *bona fide* të apartamentit, pa kompensim, në rrethanat ku nuk kishte interesa private konfliktuese, dhe pa arsyetim të mjaftueshëm që kjo ishte në interes publik, përbën ndërhyrje joproporcionale.

2.5.1.2 Palët e treta *bona fide*

Një problem i rëndësishëm paraqitet në rastet kur pala e tretë, duke vepruar në mirëbesim, vuan pasojat e sekuestrimit apo të konfiskimit të pasurisë. Gjykata ka shprehur keqardhjen për parashtruesit e ankesave të tilla në të shkuarën, duke pranuar që palët e treta kanë vuajtur pasoja të rënda për shkak të urdhrave të sekuestrimit ose konfiskimit. Gjatë vendimmarrjes lidhur me pretendimet e palëve të treta lidhur me nenin 1 të Protokolit nr. 1, gjykata merr parasysh dy faktorë kryesorë. Së pari, gjykata merr parasysh nëse pala e tretë e prekur ka patur mundësi t'i paraqesë pretendimet ndaj pasurisë në mënyrë efektive, dhe nëse këto pretendime janë shqyrtuar në proceset e zbatimit. Së dyti, gjykata merr parasysh sjelljen e parashtruesit të ankesës dhe nivelin e fajit dhe nëse këta faktorë janë shqyrtuar mjaftueshëm nga gjykatat kombëtare⁶⁷.

Çështje të rëndësishme të lidhura me palët e treta janë: *AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar* (më sipër) *Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁶⁸ ku është pranuar që palët e treta kanë vuajtur pasoja të rënda për shkak të urdhrave të sekuestrimit dhe konfiskimit.

Në çështjen *Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dogana dhe Akciza e MB-së sekuestruan një avion që i përkiste Air Canada, pasi në të ishte gjetur një sasi e madhe droge. Konfiskimi ndodhi pas një historie të gjatë të trafikimit të drogës lidhur me incidentet në të cilat ishin të përfshirë Air Canada dhe aeroportet britanike, si edhe pas shumë kërkesave të autoriteteve britanike drejtuar Air Canada që t'i shtrëngonin procedurat e sigurisë në Aeroportin Hithrou, ku ndodhi sekuestrimi. Avioni u mbajt disa orë dhe u liruar vetëm pasi kompania pagoi £50,000 për kthimin e tij. Kompania u ankua në gjykatë duke u shprehur se sekuestrimi i avionit dhe kushtet e caktuara për kthimin e tij, i kishin shkelur të drejtat e saj sipas nenit 1 të Protokolit nr. 1 dhe nenit 6. Në çështjen *Air Canada*, si edhe *AGOSI*, në fund nuk u gjet asnjë shkelje e nenit 1 të Protokolit nr. 1. Në këtë rast historia e incidenteve të kompanisë ankimuese lidhur me trafikimin e drogës dhe mosshtrëngimi i masave të sigurisë ishin përfshirë në vendimin e Komisionerit të Doganës dhe Akcizës për të konfiskuar avionin. Për më tepër, gjykata theksoi që vendimi për konfiskimin e pronës ishte objekt ankimi në gjykatë dhe se kompania kishte mundur të argumentonte në mënyrë efektive lidhur me rastin e saj dhe të ofronte dëshmi për mbështetjen e argumenteve të tyre. Kompania kishte po ashtu mundësi të kërkonte rishikim gjyqësor të vendimit, por nuk e kishte bërë një gjë të tillë. Prandaj, nuk kishte shkelje.

65 *Tandem kundër Spanjës*, vendim, datë 13 korrik 2010.

66 *Gladysheva kundër Ruisë*, vendim, datë 02 dhjetor 2011.

67 *AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 24 tetor 1986.

68 *Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 5 maj 1995.

Kërkuesi në çështjen *Air Canada* mund të dallohet nga kërkuesi në çështjen *Gladysheva kundër Ruisë*.⁶⁹

Në çështjen *Gladysheva kundër Ruisë* parashtruesen e ankesës e kishte dëbuar shteti nga banesa e saj mbi arsyetimin që pasuria ishte fituar me mashtrime nga pronari i mëparshëm. Parashtruesja e ankesës u ankua që privimi nga prona ishte shkelje e nenit 1 të Prokolit nr. 1 dhe që dëbimi ishte shkelje e të drejtës së saj për respektimin e shtëpisë sipas nenit 8. Në çështjen *Gladysheva* gjykata u shpreh se parashtruesja e ankesës i kishte ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm dhe i kishte dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse (tek organet përkatëse) për t'u bërë pronare e ligjshme e pronës. Në të kondërtën, mashtrimi kishte ndodhur gjatë kohës kur autoritetet shtetërore e zhvillonin procedurën. Prandaj, gjykata, duke e marrë parasysh sjelljen e parashtrueses së ankesës dhe shkallën e fajit, kishte gjetur shkelje të nenit 1 të Protokolit nr. 1. Çështja e përmendur më parë *Denisova dhe Moiseyeva kundër Ruisë* thekson po ashtu njohurinë dhe sjelljen e palës së pafajshme: gjykata konstatoi se, në rastet kur pasuria është fituar në mënyrë kriminale dhe më vonë është regjistruar në emrin e bashkëshortes së pafajshme në mënyrë që të parandalohet konfiskimi, urdhëri për konfiskim mund të përfshinte vetëm pjesë e pasurisë martesore të bashkëshortit fajtor.

Qasja e gjykatës lidhur me shqyrtimin nëse pala e tretë e prekur ishte në gjendje të ngriste pretendime ndaj pasurisë në mënyrë efektive mund të shihet në çështjen *Andonoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*.⁷⁰

Në çështjen *Andonoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vetura e parashtruesit të ankesës ishte sekuestruar pasi ishte ndalur nga policia ndërsa në veturë kishte disa shtetas të huaj pa dokumenta. Edhe ai, edhe udhëtarët e tjerë, ishin arrestuar dhe vetura ishte sekuestruar përkohësisht. Parashtruesi i ankesës ishte akuzuar për kontrabandim të qenieve njerëzore, edhe pse më vonë akuza ishte tërhequr meqënëse shte provuar ai nuk kishte qenë në dijeni që udhëtarët e tjerë ishin migrantë të paligjshëm. Megjithatë, njëri prej udhëtarëve ishte dënuar për kontrabandim të qenieve njerëzore dhe gjykata kombëtare kishte urdhëruar konfiskimin e veturës së parashtruesit të ankesës me cilësimin e saj si mjeti me të cilit ishte kryer vepra penale. Parashtruesi i ankesës u ankua në gjykatë duke pretenduar se i ishin shkelur të drejtat e parashikuara në nenin 1 të Protokolit nr. 1. Gjkata u shpreh se konfiskimi i veturës ishte transferim i përhershëm dhe përfundimtar e pronësisë që, sipas rregullit të dytë të nenit 1 të Prokolit nr. 1, përbënte privim të pasurisë. Ndonëse gjykata vendosi që ishte e qartë se parashtruesi i ankesës kishte vepruar në mirëbesim dhe që konfiskimi ishte joproportional, ajo po ashtu vërejti që e drejta e brendshme, në veçanti, parashikonte konfiskim automatik të të gjitha automjeteve të përdorura për kontrabandim, pa përjashtim. Kjo e privonte parashtruesin e ankesës nga çfarëdo mundësie për ta argumentuar rastin e tij ose për të kërkuar kompensim. Prandaj, ka gjetur shkelje të nenit 1 të Protokolit nr. 1.

Në disa çështje, të tilla si *B.K.M. Lojistik Tasimacilik Ticaret Limited Siketi kundër Sllovenisë*,⁷¹ gjykata ka shqyrtuar faktorë të tjerë unikë, lidhur me rastet e palëve të treta, për të përcaktuar nëse ka patur shkelje apo jo.

69 *Gladysheva kundër Ruisë*, vendim, datë 6 dhjetor 2011.

70 *Andonoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, aktgjykimi i datës 17 shtator 2015.

71 *B.K.M. Lojistik Tasimacilik Ticaret Limited Siketi kundër Sllovenisë*, aktgjykimi i datës 17 janar 2017.

Në çështjen *B.K.M. Lojistik Tasimacilik Ticaret Limited Siketi kundër Sllovenisë* kamioni i kompanisë ankimuese përpara gjykatës ishte ndalur nga policia kufitare, e cila i kishte gjetur 105 kg heroinë të fshehur brenda tij. Si pasojë, u arrestua shoferi dhe kamioni së bashku me rimorkoi u sekuestruan. Ndërsa mallrat e ligjshme që gjendeshin në kamion në fund u kthyen dhe rimorkioja u kthye, shoferi u dënua për trafikim të lëndëve narkotike dhe kamioni u konfiskua. Ndonëse, fillimisht gjykata sllovene urdhëroi kthimin e kamionit tek kompania parashtruese e ankesës, ky vendim u ndryshua në apel. Kompania parashtruese e ankesës u ankua në gjykatë duke pretenduar që sipas nenit 1 të Prokollit nr. 1 i ish-in shkelur të drejtat. Në çështjen *B.K.M.*, gjykata vendosi që autoritetet kombëtare, gjatë gjykimit lidhur me faktin nëse kishin patur ndonjë mundësi të siguronin kthimin e kamionit, nuk e kishin marrë parasysh sjelljen e përgjegjshme të kompanisë parashtruese të ankesës. Gjykata po ashtu vendosi që në rastet kur përfshihet konfiskimi i pronës së palës së tretë, privimi mund të arsyetohej vetëm nëse interesat e palës së tretë që t'ju kthehej prona peshonin më shumë se sa rreziku që kthimi i pronës do ta minonte qëllimin legjitim të autoriteteve. Meqenëse kamioni nuk ishte përshtatur për kontrabandim, nuk ishte përdorur për kontrabandim në të shkuarën dhe shoferi ishte dënuar me burgim me nëntë vjet, gjykata nuk shihte ndonjë arsye që të arritur në përfundimin që kamioni do të përdorej për kontrabandim në të ardhmen. Prandaj, veprimet e autoriteteve ishin të paarsyeshme, joproporcionale dhe shkelnin nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Është me rëndësi të përmendet që ndonëse elementet e palës së tretë janë të rëndësishme për gjykatën, ato nuk janë vendimtare për gjetjen e shkeljes së nenit 1 të Prokollit nr. 1. Në fund, vendimi është çështje e ekuilibrit të fakteve.

2.5.1.3 Bashkëpunimi me një shtet të huaj

Të gjitha instrumentet ndërkombëtare të përmendur në pjesën e parë të këtij doracaku përfshijnë detyrimet e shteteve për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Çështja *Saccoccia kundër Austrisë*⁷² tregon mënyrën si bashkëpunimi ndërmjet shteteve me qëllim sekuestrimin e pasurisë mund të jetë në përputhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, me kusht që e drejta e brendshme e shtetit kontraktues që bën zbatimin siguron respektimin e nenit 1 të Prokollit nr. 1.

Në çështjen *Saccoccia kundër Austrisë* parashtruesi i ankesës ishte dënuar në Shtetet e Bashkuara për shkak të udhëheqjes së një operacioni shumë të madh të pastrimit të parave për një kartel droge, ku përfshiheshin më shumë se 100 milionë dollarë. Shtetet e Bashkuara kishin lëshuar urdhër për sekuestrim të pasurisë së parashtruesit të ankesës, përfshirë edhe 9 milionë dollarë që mbaheshin në Austri. Më pas, autoritetet austriake lëshuan një urdhër të përkohshëm për konfiskim, ndërsa parashtruesi i ankesës u ankua më pas në gjykatë duke u shprehur që autoritetet e brendshme i kishin shkelur të drejtat e parashkuara në nenin 1 të Protokollit nr. 1 dhe nenin 6. Gjykata konstatoi që ekzekutimi i urdhërit për sekuestrim, i lëshuar në Shtetet e Bashkuara, nga ana e autoriteteve austriake bazohej në ligjin e Austrisë, si edhe në një qëllim legjitim, në mënyrë specifike, përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të siguruar që paratë e fituara nga marrja me drogë të sekuestroheshin. Duke i përmendur tërthorazi vështirësitë me të cilat përballeshin shtetet gjatë luftimit kundër trafikimit të lëndëve narkotike dhe nevojës për masa parandaluese, gjykata konstatoi që ishte arritur një ekuilibër i drejtë ndërmjet të drejtave të parashtruesit të ankesës dhe qëllimit legjitim.

72 *Saccoccia kundër Austrisë*, vendim, datë 18 dhjetor 2008.

2.5.1.4 Kërkesat për kontroll gjyqësor

Përkundër mungesës së kërkesave të qarta procedurale në paragrafin dy të nenit 1 të Protokollit nr. 1, gjykata është shprehur që procedurat në tërësi duhet t'i ofrojnë parashtuesit të ankesës një mundësi të arsyeshme për paraqitjen e rastit të tij tek autoritetet kompetente, me qëllim që t'i mundësojë atij/asaj vendosjen e ekuilibrit të drejtë ndërmjet interesave kundërthënëse në fjalë. Kështu që, gjykatat e brendshme kanë detyrimin t'i ushtrojnë kompetencat e tyre për shqyrtim të mëtejme sipas kërkesës, në mënyrë specifike për të përcaktuar nëse është ruajtur ekuilibri i domosdoshëm ndërmjet të drejtave të parashtuesit të ankesës për posedim të qetë të pronës së vet dhe qëllimit legjitim të autoriteteve. Në çështjen *Paulet kundër Mbretërisë së Bashkuar*, një çështje e lidhur me konfiskimin e fitimit të siguruar përmes punës së paligjshme, është konstatuar që fusha e rishikimit e gjykatës së apelit ishte tepër e ngushtë për t'i përmushur kushtet e gjetjes së ekuilibrit të drejtë të mishëruar në nenin 1 të Protokollit nr. 1⁷³.

2.5.1.5 Pikat kryesore

Në përmbledhje, në vijim është dhënë një listë e pyetjeve që janë bërë nga gjykata gjatë shqyrtimit nëse ka pasur shkelje të të drejtave pronësore:

- Në kuadër të nenit 1 të Protokollit nr. 1 a ekziston e drejta e pronës ose posedimit?
- A ka patur ndërhyrje në këtë posedim?
- Në cilën prej të tri rregullave kategorizohet ndërhyrja?
- A është ndërhyrja në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë?
- A i shërben ndërhyrja objektivit legjitim të interesit publik ose interesit të përgjithshëm?
- A është ndërhyrja proporcionale – a është arritur ekuilibri ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe nevojës për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit?

Si përfundim, fusha e veprimit e nenit 1 të Protokollit nr. 1 është e gjerë dhe përcakton si të drejtën për posedim të qetë të pasurisë ashtu edhe pragun e gjerë të vlerësimit, duke u bërë të mundur shteteve të ndërhyjnë në këtë të drejtë. Megjithatë, ashtu siç përcaktohet në këtë pjesë, ka disa çështje dhe kritere që duhet të vlerësohen nga gjykata para se ta konstatohet një shkelje të tillë.

Përmbledhja e çështjeve në vijim ofron një pasqyrë të çështjeve të rëndësishme, ku parashtuesit të ankesës kanë pretenduar për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 në kontekstin e sekuestrimit dhe të konfiskimit të pasurisë dhe të të ardhurave nga krimi.

2.5.1.6 Lista e çështjeve kryesore

- **AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar:**⁷⁴ Konfiskimi i monedhave të kontrabanduara nuk përbën automatikisht privim nga prona.
- **Raimondo kundër Italisë:**⁷⁵ Mbajtja e sekuestrimit parandalues të pasurisë lidhur me të ardhurat nga krimi i llojit të mafioz për 4 vjet dhe 8 muaj, pas deklarimit të parashtuesit të ankesës të pafajshëm lidhur me veprat penale për të cilat ishte akuzuar, përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.

⁷³ *Paulet kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 13 maj 2014.

⁷⁴ *AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 24 tetor 1986.

⁷⁵ *Raimondo kundër Italisë*, vendim, datë 22 shkurt 1994.

- **Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar:**⁷⁶ Kërkesa për të paguar £50,000 (€60,000) për lirimin e avionit të sekuestruar nga kompania parashtruese e ankesës nuk ishte joproportionale për qëllimin e parandalimit të importimit të lëndëve narkotike të ndaluara në vend.
- **Arcuri kundër Italisë:**⁷⁷ Konfiskimi i pasurisë së anëtarëve të familjes, nën dyshimin që është fituar përmes mjeteve të paligjshme, nuk përbën shkelje e nenit 1 të Protokolit. Personat në fjalë kanë mundur të kundërshtojnë akuzën dhe të sjellin prova, të cilat i kanë konsideruar të domosdoshme për mbrojtjen e interesave të tyre.
- **Gabric kundër Kroacisë:**⁷⁸ Konfiskimi i 20,000 markave gjermane nga parashtruesja e ankesës, teksa po kalonte kufirin nga Bosnje dhe Hercegovina në Kroaci, u konsiderua shkelje e nenit 1 të Protokolit nr. 1. Nuk ishte arritur ekuilibër proporcional ndërmjet të drejtave të parashtrueses së ankesës dhe të qëllimit legjitim të qeverisë, për shkak se autoritetet nuk kishin demonstruar që gjobitja fillestare e ankimeses nuk ishte frenim dhe dënim i mjaftueshëm.
- **Grifhorst kundër Francës:**⁷⁹ Konfiskimi i parave të parashtruesit të ankesës përbën shkelje të nenit 1 të Protokolit nr. 1, pasi nuk mund të paraqitej asnjë provë që dëshmonte që paratë ishin të lidhura me ndonjë aktivitet të paligjshëm dhe urdhëri për konfiskim ishte shumë më i ashpër se sa ndëshkimi i zakonshëm në rrethana të tilla.
- **Chmielewski kundër Nemzeti Adó- és Vámhivatal Dél-alföldi Regionális Vám-és Pénzügyőri Főigazgatósága:**⁸⁰ Parashtruesi i ankesës ishte gjobitur pasi nuk e kishte deklaruar shumën e parave që kishte me vete gjatë kalimit të kufirit nga Serbisë në Hungari. GJED-ja vendosi që ligji sipas të cilit ishte urdhëruar gjobitja nuk ishte në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së, pasi gjoba nuk ishte proporcionale dhe shkonte përtej asaj që ishte e domosdoshme për të siguruar pajtueshmëri.
- **Riela dhe të tjerët kundër Italisë:**⁸¹ Në lidhje me nenin 1 të Protokolit 1, shteteve ju jepet liria e vlerësimit gjatë kontrollimit të shfrytëzimit të pasurisë në luftën kundër krimit të organizuar
- **Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar:**⁸² Sekuestrimi i parave në bazë të supozimit të përcaktuar me ligj, në kontekstin e trafikimit të lëndëve narkotike, nuk përbën shkelje të nenit 1 të Protokolit 1, pasi parashtruesi kishte mundësi ta kundërshtonte një supozim të tillë.
- **Webb kundër Mbretërisë së Bashkuar:**⁸³ Konfiskimi i pasurisë së parashtruesit të ankesës, në bazë të standardit civil të dëshmisë, nuk përbën shkelje e nenit 1 të Protokolit 1
- **Baklanov kundër Rusisë:**⁸⁴ Sekuestrimi i pasurisë së parashtruesit të ankesës, pa ndonjë bazë ligjore në të drejtën e brendshme, përbën shkelje të nenit 1 të Protokolit nr. 1.
- **Bosphorus Airways kundër Irlandës:**⁸⁵ Konfiskimi dhe mbyllja e avionit të parashtruesit të ankesës, për shkak të zbatimit të Rregulloreve të BE-së, nuk përbën shkelje të nenit 1 të Protokolit nr.1
- **Saccoccia kundër Austrisë:**⁸⁶ Sekuestrimi i mjeteve të parashtruesit të ankesës në Austri, pas urdhërit për sekuestrim të lëshuar nga Shtetet e Bashkuara, nuk përbën shkelje të nenit 1 të Protokolit nr. 1.

76 *Air Canada kundër the Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 5 maj 1995.

77 *Arcuri kundër Italisë*, vendim, datë 5 korrik 2001.

78 *Gabric kundër Kroacisë*, vendim, datë 5 shkurt 2009.

79 *Grifhorst kundër Francës*, vendim, datë 26 shkurt 2009.

80 *Chmielewski kundër Nemzeti Adó- és Vámhivatal Dél-alföldi Regionális Vám-és Pénzügyőri Főigazgatósága*, vendim i GJED-së, datë 16 korrik 2015.

81 *Riela dhe të tjerët kundër Italisë*, vendim, datë 4 shtator 2001.

82 *Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 27 qershor 2002.

83 *Webb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 17 dhjetor 2002.

84 *Baklanov kundër Rusisë*, vendim, datë 9 qershor 2005.

85 *Bosphorus Airways kundër Irlandës*, vendim, datë 30 qershor 2005.

86 *Saccoccia kundër Austrisë*, vendim, datë 18 dhjetor 2008.

- **Grifhorst kundër Francës:**⁸⁷ Konfiskimi dhe gjoba për parashtuesin e ankesës lidhur me mosdeklarimin e shumës së parave tek autoritetet doganore ishte joproportional, duke çuar në shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.
- **Tendam kundër Spanjës:**⁸⁸ Refuzimi për të kompensuar humbjen dhe përcaktimi i pronës së sekuestruar në procedurë penale që kishte si rezultat shfajësimin, përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.
- **Denisova dhe Moiseyeva kundër Ruisë:**⁸⁹ Pamundësia për të kundërshtuar urdhërin për konfiskim i cili ishte nxjerrë gjatë procedurës penale ku nuk ishin palë parashtueset e ankesës përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.
- **Gladysheva kundër Ruisë:**⁹⁰ Mosvlerësimi i proporcionalitetit nga ana e autoriteteve të shtetit gjatë dëbimit të blerësit nga banesa e blerë në *bona fide*, e cila ishte fituar në mënyrë mashtruese nga pronari i mëparshëm, përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.
- **Silickienė kundër Lituanisë:**⁹¹ Konfiskimi i pasurisë së bashkëshortes së një polici të korrumpuar nuk përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit 1, pasi bashkëshortja duhej ta kishte patur dijeni që pasuria e konfiskuar mund të ishte blerë vetëm nga të ardhurat e aktiviteteve të organizatave kriminale.
- **Paulet kundër Mbretërisë së Bashkuar:**⁹² Moskryerja e një rishikimi të gjerë nga ana e gjykatës së brensdhme, lidhur me faktin nëse ishte mbajtur ekuilibri i nevojshëm, në përputhje me të drejtën e parashtuesit të ankesës për posedim të qetë të pasurisë, përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.
- **Gogitidze kundër Gjeorgjisë:**⁹³ Sekuestrimi i pasurisë së fituar në mënyrë të padrejtë nga nëpunësi civil, si pjesë e masave të brendshme kundër korrupsionit, nuk përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

2.5.2 Neni 6

2.5.2.1 Neni 6 – Vështrim i përgjithshëm

E drejta për proces të rregullt garantohej me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa ose KEDNJ-ja). Në nenin 6 thuhet:

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, deri sa fajësia e tij të provohet ligjërisht.
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
 - a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

87 *Grifhorst kundër Francës*, vendim, datë 26 shkurt 2009.

88 *Tendam kundër Spanjës*, vendim, datë 13 korrik 2010.

89 *Denisova dhe Moiseyeva kundër Ruisë*, vendim, datë 1 prill 2010.

90 *Gladysheva kundër Ruisë*, vendim, datë 6 dhjetor 2011.

91 *Silickienė kundër Lituanisë*, vendim, datë 10 prill 2012.

92 *Paulet kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 13 maj 2014.

93 *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, vendim, datë 12 maj 2015.

- b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- e) të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjykatë.

Neni 6 zbatohet lidhur me *'të drejtat dhe detyrimet civile'* dhe *'akuzat penale'*. Këto shprehje interpretohen në mënyrë autonome dhe në Konventë mund të kenë kuptim të ndryshëm nga legjislacioni i brendshëm.

Shkurtimisht, "përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve civile" përfshin mosmarrëveshjet e natyrës së vërtetë dhe të rëndë, si të drejtat dhe detyrimet e personave privatë, për shembull, sipas ligjit për kontrata, ligjit komercial, ligjit për familjen, ligjit për pronën dhe ligjit për punësimin. Parashtruesi i ankësës duhet të jetë në gjendje të kërkojë, në baza të argumenteve, një të drejtë, e cila njihet në legjislacionin e brendshëm, pasi neni 6 nuk e lehtëson krijimin e të drejtave të reja. Neni 6 vlen vetëm për të drejtat civile që janë kryesore për procesin në fjalë. Për shembull, mosmarrëveshjet lidhur me pronën në kuadrin e shpronësimit dhe të konfiskimit civil mund t'i prekin "të drejtat dhe detyrimet civile".

Sa i përket kontekstit penal, neni 6 mund të zbatohet madje edhe nëse në legjislacionin e brendshëm akuza nuk klasifikohet si "penale" por, për shembull, si "administrative". Kur mendohet nëse është i zbatueshëm neni 6, duhet të merret parasysh natyra e veprës dhe qëllimi, natyra dhe ashpërsia e dënimit. Shprehja "i akuzuar" ka po ashtu kuptim autonom, përfshirë indikacionin zyrtar që i jepet një individit se ai/ajo dyshohet për kryerje të veprës penale, dhe është në një situatë ku i dyshuari është prekur në mënyrë substanciale për shkak të dyshimit në këtë aspekt.

Ajo çfarë ka rëndësi të theksohet është se neni 6(2) kërkon prezumimin e pafajësisë; do të thotë që anëtarët e një tribunali nuk duhet të kenë paragjykim që i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohen. Megjithatë, është e rëndësishme që sekuestrimit i pasurisë, i cili urdhërohet si rezultat i procesit civile, në vetvete të mos shkaktojë ndonjë problem të parashikuar në nenin 6(2).⁹⁴

2.5.2.2 Neni 6 – Konfiskimi i pasurisë

Neni 6 përmendet kryesisht në kuadrin e proceseve kundër korrupsionit dhe të atyre të konfiskimit sepse konfiskimi i pasurisë së ankimuesit bëhet pa një procedurë të pajtueshme me nenin 6(1),⁹⁵ urdhërat për konfiskim bazohen në akuzat për të cilat akimuesi është shfajësuar,⁹⁶ ose ankimuesi mendon që gjykata, e cila ka vendosur për akuzën penale dhe ka nxjerrë urdhërin e konfiskimit kundër tij, nuk ka qenë kompetente⁹⁷.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata ose GJEDNJ-ja) ka përcaktuar parimet themelore të cilat vlejnë për procedurën e konfiskimit dhe nenin 6 në çështjen *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*⁹⁸.

94 *Gogitidze kundër Gjeorgjisë*, aktgjykimi i Dhomës së Madhe i datës 12 maj 2015.

95 *Al-Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës*, aktgjykimi i datës 5 shtator 2016.

96 *Geerings kundër Holandës*, aktgjykimi i datës 1 mars 2007.

97 *Iliya Stefanov kundër Bullgarisë*, aktgjykimi i datës 22 maj 2008.

98 *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 5 korrik 2001.

Phillips kishte të bënte me një shtetas britanik, i cili ishte dënuar për përfshirje në kontrabandimin e kanabisit, vepër për të cilën ishte dënuar me nëntë vjet burgim. Gjyqtari zbatoi një dispozitë sipas legjislacionit të brendshëm, e cila i bënte të mundur gjykatës të supozonte që e tërë pasuria e fituar brenda gjashtë vjetëve të mëparshme nga personat e dënuar për veprën e trafikimit të lëndëve narkotike ishte vënë me të ardhurat nga trafikimi i lëndëve narkotike. Për rrjedhojë, kundë parashtuesve të ankesës u nxorr një urdhër konfiskimi për 91400 paund (102954.18 euro). Parashtuesi i ankesës pohoi që ky supozim i përcaktuar me ligj shkelte të drejtat e tij për t'u prezumuar i pafajshëm, ashtu siç parashikohet në nenin 6(2). Në çështjen *Phillips* gjykata konstatoi që urdhëri për konfiskim nuk përbënte përcaktim të fajësisë sipas nenit 6(2), dhe që supozimi kishte të bënte në fakt me procesin për t'i mundësuar gjykatës vlerësimin dhe të përcaktonte shumën e urdhërit të konfiskimit, në mënyrë të ngjashme ose analoge, dhe për t'i mundësuar gjykatës së brendshme përcaktimin e gjobës apo kohëzgjatjen e burgimit që do të vendoste si dënim për autorin. Meqë procedura e konfiskimit përcaktonte karakterin dhe sjelljen e të akuzuarit si pjesë e procesit të dënimit, dënimi për trafikim të lëndëve narkotike nuk ishte në rrezik. Prandaj, neni 6(2) nuk ishte i zbatueshëm, përveç nëse parashikimi i tij shërbente si bazë për ngritjen e një akuze të re në kuadër të kuptimit autonom të Konventës. Megjithatë, gjykata konstatoi që neni 6(1) ishte i zbatueshëm duke u mbështetur në praktikën e vet gjyqësore sipas së cilës neni 6 § 1 është i zbatueshëm gjatë tërë kohëzgjatjes së procesit për "përcaktimin e ... ndonjë vepre penale", pëfshirë procesin përmes së cilit dënimi është fiks. Prandaj, neni 6(1) ishte i zbatueshëm, meqë lëshimi i urdhërit për konfiskim ishte i ngjashëm me procesin e dënimit. Lidhur me themelin e kësaj dispozite, gjykata konstatoi që mundësia që i ishte dhënë parashtuesit të ankesës për të kundërshtuar supozimin që pasuria ishte fituar përmes mjeteve legjitime, përbënte mbrojtje të mjaftueshme të të drejtave të tij. Për më tepër, gjykata u shpreh se e drejta e brendshme ishte proporcionale, për aq kohë sa ajo kishte arritur ekulibër të drejtë ndërmjet të drejtave të parashtuesit të ankesës dhe qëllimit legjitim të qeverisë. Prandaj, nuk kishte shkelje të nenit 6(1).

Ky përfundim në çështjen *Phillips* lidhur me nenin 6(2) mund të krahasohet me faktet dhe vendimin e gjykatës në çështjen *Geerings kundër Holandës*.⁹⁹

Në çështjen *Geerings*, parashtruesi i ankesës ishte akuzuar për disa vepra dhe për disa prej tyre ishte dënuar, por ishte shfajësuar për shumicën prej tyre. Më pas prokuroria kishte dorëzuar një kërkesë për një urdhër konfiskimi në lidhje me të gjitha veprat me arsyetimin që kishte indikacione të mjaftueshme që ankimuesi i kishte kryer të gjitha krimet. Duke u mbështetur në nenin 6(2) të Konventës, ankimuesi pretendonte që urdhëri për konfiskim e kishte shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë meqë ishte mbështetur në akuza prej të cilave ai ishte liruar në procese penale të pavarura të zhvilluara kundër tij. Në çështjen *Geerings* gjykata përsëriti që e drejta e prezumimit të pafajësisë sipas nenit 6(2) paraqitet vetëm në lidhje me veprën e caktuar penale për të cilën akuzohet personi. Kur një person shpallet fajtor për një vepër, nuk zbatohet neni 6(2) lidhur me procesin sipas të cilit gjykata bën vlerësimin dhe cakton shumën për urdhërin për konfiskim, përveç rasteve kur ngrihet një akuze e re. Gjykata ka bërë dallimin midis çështjeve *Geerings nga Phillips*, duke thënë që ankimuesi në çështjen *Geerings* nuk kishte poseduar kurrë pasuri të cilës nuk mund t'ia shpjegonte prejardhjen. Konfiskimi pas dënimit ishte i papërshtatshëm në lidhje me pasurinë për të cilën nuk kishte dijeni nëse ishte në posedim të kriminelit të dënuar, në veçanti kur konfiskimi kishte të bënte me krimet për të cilat personi nuk ishte shpallur fajtor. Në të vërtetë, në këtë rast urdhëri për konfiskim është lëshuar në lidhje me veprat penale për të cilat ankimuesi ishte shfajësuar. Neni 6(2) nuk e lejon ngritjen e dyshimeve të fajësisë për veprat penale për të cilat individit është shfajësuar në mënyrë bindëse. Në këtë rast ka pasur shkelje të Konventës, pasi ankimuesi është trajtuar si fajtor pa u shpallur fajtor sipas ligjit¹.

Përfundimet në çështjen *Phillips* lidhur me nenin 6(1) janë shtjelluar më tej në vendimin e çështjes *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁰⁰.

Në çështjen *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar* ishte vërtetuar që ankimuesi kishte qenë i përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike për disa vite me radhë. Ai më pas iu nënshtrua një urdhëri konfiskimi për një shumë të caktuar, që pretendohet të kishte ardhur si rezultat i vepra penale të trafikimit të lëndëve narkotike. Gjatë këtyre proceseve gjyqësore, barra e provës kishte rënë mbi ankimuesin, në mënyrë që ai të tregonte përtej dyshimit të arsyeshëm që paratë në fjalë kishin ardhur nga një burim legjitim. Ndërsa ai pohonte që kjo ishte shkelje e nenit 6(1), gjykata konsideroi që në kuadrin e shpërndarjes së vërtetuar të lëndëve narkotike nga ana e tij, nuk ishte e paarsyeshme që të pritej nga ai ta sqaronte legjitimitetin e parave të tij. Për këtë arsye gjykata nuk gjeti shkelje dhe vendosi që procedurat e konfiskimit ishin në pajtueshmëri me Konventën.

99 *Geerings kundër Holandës*, vendim, datë 1 mars 2007.

100 *Grayson dhe Barnham kundër MB*, vendim, datë 23 dhjetor 2008.

Ky përfundim mund të krahasohet me çështjen *Al-Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës*.¹⁰¹

Al-Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës ka të bëjë me ngrirjen e pasurisë së z. Al-Dulimi dhe Montana Management Inc në Zvicër, në pajtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për vënien e sanksioneve ekonomike kundër anëtarëve të ish-regjimit të Irakut. Parashtruesit e ankesës ankoreshin që procedura e cila kishte çuar te konfiskimi i pasurisë së tyre nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 6(1) të Konventës. Në çështjen *Al-Dulimi* gjykata theksoi që ankimuesve duhet t'u ishte dhënë e drejta për shqyrtimin e ankesave të tyre në një gjykatë kombëtare dhe për dorëzimin e provave të duhura. Fakti që ata nuk kishin mundësi ta kundërshtonin konfiskimin për një periudhë të gjatë (për vite), nuk ishte në pajtueshmëri me atë që është e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Veçanërisht, kjo binte ndesh me sanksionet në fjalë, të urdhëruara në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Pajtueshmëria me nenin 6 kërkon që personat që janë objekt i urdhërave për konfiskim të kenë mundësi të kërkojnë nga gjykatat kombëtare të kërkojnë shqyrtimin e masës/sanksionit të marrë kundër tyre. Gjykata duhet, të paktën, të verifikojë që masat e vendosura nuk janë arbitrare, gjë e cila në anën tjetër kërkon që gjykatave t'ju ofrohen informacione të sakta të mjaftueshme, nga të dyja palët, në mënyrë që të jetë në gjendje të arrijnë në një përfundim të tillë. Është po ashtu jetike që personat e prekur nga urdhërat për kontroll dhe sekuestrim të kenë mundësi të sigurojnë shqyrtim gjyqësor para një tribunali të pavarur, si për urdhërat ashtu edhe për zbatimin e tyre.

Duke u bazuar në këtë parim, çështja *Ravon kundër Francës* tregon që nuk është e mjaftueshme që ligjet e vendit thjeshtë të ofrojnë mundësi për kundërshtimin e bazës ligjore të urdhërit të konfiskimit. Parregullësitë në zbatimin e urdhërave duhet po ashtu të jenë të hapura për kundërshtim dhe çfarëdo mbrojtje që ofrohet në këtë kontekst duhet të jetë e vërtetë dhe efektive, jo vetëm teorike¹⁰².

2.5.2.3 Çështjet kryesore

- Neni 6 nuk zbatohet për urdhërat për konfiskim lidhur me proceset penale, përveç nëse urdhëri çon në ngritjen e një "akuze" të re.
- Urdhërat e konfiskimit nuk mund të zbatohen në lidhje me krimet për të cilat parashtruesi i ankesës është shpallur i pafajshëm, kur ky urdhër nënkupton përgjegjësinë penale të personit.
- Duhet të ketë masa mbrojtëse për të siguruar që parashtruesit e ankesës të mund të kundërshtojnë çdo prezumim që pasuria e tyre është fituar me para të paligjshme.
- Parashtruesit e ankesës kanë të drejtë që ankesat e tyre të shqyrtohen nga gjykatat kombëtare, domethënë kur ata duan ta kundërshtojnë urdhërin për konfiskim.

2.5.2.4 Lista e çështjeve kryesore

- ***Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar***:¹⁰³ Prezumimi statutor që e tërë pasuria e zotëruar gjatë gjashtë viteve të fundit nga personi i dënua për veprën e trafikimit të lëndës narkotike ishte fituar në mënyrë të paligjshme nuk përbën shkelje të prezumimit të pafajësisë ose të së drejtës për proces të rregullt ligjor sipas nenit 6.

101 *Al-Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës*, vendim, datë 5 shtator 2016.

102 *Ravon kundër Francës*, vendim, datë 21 shkurt 2001.

103 *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 5 korrik 2001.

- **Geerings kundër Holandës:**¹⁰⁴ Lëshimi i urdhërit të konfiskimit pavarësisht vendimit të pafajësisë përbën shkelje të nenit 6(2).
- **André dhe një tjetër kundër Francës:**¹⁰⁵ Pamundësia për t'u ankuar për zbatimin e urdhërit të kontrollit dhe sekuestrimit përbën shkelje të nenit 6(1).
- **Grayson dhe Barnham kundë Mbretërisë së Bashkuar:**¹⁰⁶ Kalimi i barrës së provës mbi të pandehurin e shpallur fajtor për trafikim të lëndëve narkotike, për të kundërshtuar prezumimin e vënies së pasurisë përmes mjeteve ligjore nuk përbën shkelje të nenit 6.
- **Al-Dulimi dhe Montana Management Inc. kundër Zvicrës:**¹⁰⁷ Moslejimi i personave dhe i subjekteve, të cilët gjenden në listat e regjimit të sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, që të kërkojnë nga gjykatat kombëtare shqyrtim të masave të ndërmarra në pajtueshmëri me regjimet e tilla, përbën shkelje të nenit 6.
- **Janssen Cilag kundër Francës:**¹⁰⁸ Operacionet e kontrollit dhe të sekuestrimit, të cilat kryhen në objektet e kompanisë, nuk përbëjnë shkelje të nenit 6(1) të Konventës.
- **Matanović kundër Kroacisë:**¹⁰⁹ Mungesa e një procedure efektive për të përcaktuar zbulimin e provave të mbledhurave përmes survejimit të fshehtë përbën shkelje të të drejtave të mbrojtjes të parashtruesit të ankesës sipas nenit 6.

2.5.3 Neni 7

2.5.3.1 Neni 7: Vështrim i përgjithshëm

Neni 7 parashikon që nuk ka dënim pa ligj, në kontekstin e së drejtës penale: *nullem crimen, nulla poena sine lege*.¹¹⁰ Ai përban një element thelbësor të sundimit të ligjit që përbën një të drejtë absolute. Neni 7 thotë:

1. *Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale..*
2. *Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhet vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.*

Qëllimi themelor i nenit 7 është të sigurojë masa efektive mbrojtëse kundër ndjekjes penale, dënimit dhe ndëshkimit arbitrar¹¹¹. Neni 7 mishëron parimin e përgjithshëm që veprat penale duhet të bazohen në ligj dhe që individit duhet të jetë në gjendje të dijë, nga formulimi i dispozitës përkatëse, nëse është nevoja me ndihmën e interpretimit të gjykatës, se cilat veprime apo mosveprime e bëjnë atë të mbajë përgjegjësi penale. Prandaj, ligji duhet të jetë i qasshëm dhe i parashikueshëm në mënyrë të përshtatshme. Nuk nevojitet siguri absolute, mjafton standardi i “parashikueshmërisë të arsyeshme”.

104 *Geerings kundër Holandës*, vendim, datë 1 mars 2007.

105 *André dhe një tjetër kundër Francës*, vendim, datë 24 korrik 2008.

106 *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim, datë 23 shtator 2008.

107 *Al Dulimi dhe Montana Management Inc. kundër Zvicrës*, vendim, datë 21 qershor 2016.

108 *Janssen Cilag kundër Francës*, vendim, datë 21 mars 2017.

109 *Matanović kundër Kroacisë*, vendim, datë 4 prill 2017.

110 *Kafkaris kundër Qipros*, vendim, datë 12 shkurt 2008.

111 *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë*, vendim, datë 22 mars 2001.

Po ashtu vlen të theksohet që fjalia e dytë e nenit 7, e cila e ndalon dhënien e dënimit më të rëndë se dënimi i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale, është zgjeruar për ta përfshirë të drejtën e të pandehurit për të përfituar nga një dënim më i lehtë që mund të ketë hyrë në fuqi pas kryerjes së veprës penale.

2.5.3.2 Bashkëveprimi ndërmjet nenit 7 dhe konfiskimit

Pretendimet për shkeljen e nenit 7 bëhen kryesisht në rastet kur parashtruesi i ankesës kërkon kundërshtimin e penalitetit së dhënë kundër tyre nga gjykatat e brendshme. Zbatueshmëria e nenit 7 për masat e konfiskimit, për pasojë, varet nëse gjykata vendos që masa në fjalë është penalitet, brenda kuptimit autonom të fjalës në Konventë, ose ndonjë masë tjetër¹¹².

Në çështjen *Welch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtruesi i ankesës ishte shpallur fajtor për importim të sasive të mëdha të kanabisit dhe ishte dënuar me 22 vjet burgim. Gjyqtari nxorri po ashtu edhe një urdhër konfiskimi në shumën prej 66,914 paund (përafërsisht 75,000 euro) në përputhje me *Aktin për veprat penale të trafikimit të drogës 1986* (Akti i vitit 1986). Urdhëri për konfiskim ishte nxjerrë para se të hynte në fuqi Akti i vitit 1986 dhe parashtruesi i ankesës u ankua që urdhëri për konfiskim kishte efekt prapaveprues për dënimin penal, në kundërshtim me nenin 7. Duke e përmendur natyrën autonome të përkufizimit të dënimit sipas nenit 7, gjykata u shpreh që në mënyrë që të sigurohet efektiviteti i nenit 7, ajo duhet të përcaktonte nëse në thelb konfiskimi përbënte dënim. Për këtë qëllim, gjykata shqyrtoi nëse masa ishte marrë pas dënimit penale, si edhe shqyrtoi natyrën dhe qëllimin e masës, kategorizimin e saj sipas të drejtës kombëtare, procedurat e përfshira në krijimin dhe në zbatimin e masës dhe ashpërsinë e urdhërit të konfiskimit. Referimi tek Akti i vitit 1986 varej nga ekzistenca e dënimit penal dhe gjykata nuk i mori parasysh aspektet parandaluese dhe riparuese të konfiskimit për t'i përjashtuar aspektet e tij ndëshkuese. Në të vërtetë, gjykata vërejti që parandalimi dhe riparimi mund të shihen si elemente përbërëse të dënimit. Ndonëse ashpërsia e masës nuk konsiderohej si relevante, procedurat e përfshira në dhënien e masës, përfshirë mundësinë e futjes në burg në rast të mospajtueshmërisë, tregonin fuqishëm që masa përbënte pralimizim. Prandaj, duke pasur parasysh përmbajtjen e masës, neni 7 i Konventës është i zbatueshëm për urdhërin për konfiskim dhe gjykata konstatoi shkelje të tij.

112 Këshilli i Evropës, "Udhëzues për nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. 31 dhjetor 2017. Mund ta gjeni në adresën: http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_7_ENG.pdf.

Vendimi i gjykatës që urdhëri për konfiskim përbën penalitet është me rëndësi, por jo gjithmonë vendimtar, ashtu siç demonstrohet në çështjen *G.I.E.M. dhe të tjerët kundër Italisë*¹¹³.

G.I.E.M. dhe të tjerët kundër Italisë kishte të bënte me ndërtimin e ndërtesave për turizëm në një tokë, e cila sipas ligjit italian ishte e mbrojtur. Ndonëse të gjithë ankimuesit përpara GJEDNJ-së ishin deklaruar jo fajtor për ndonjë vepër të paligjshme kriminale gjatë proceseve përkatëse penale, toka e tyre dhe pasuria e ndërtuar mbetën të sekuestruara dhe më pas të konfiskuara. Në vendimin e saj, gjykata theksoi nevojën për ta shikuar përmbajtjen e çdo mase për ta përcaktuar nëse, sipas kuptimit autonom të nenit 7, ato përbëjnë penalitet. Gjykata nënvizoi që mungesa e dënimit penal nuk e përjashton automatikisht mundësinë e konfiskimit si dënim, por që duhet të merreshin parasysh një sërë faktorësh. Në të drejtën e brendshme masat e konfiskimit ishin përfshirë nën titullin «Sanksionet penale», natyra dhe qëllimi i proceseve të konfiskimit ishte ndëshkuese në natyrë dhe qëllim, dhe konfiskimi i pasurisë gjykohej të ishte veçanërisht i rreptë dhe ndërhyrës, dhe, në fund, gjykatat penale kishin urdhëruar masat e konfiskimit, të cilat u konsideruan se nuk vepronin në cilësi administrative. Si e tillë, gjykata vendosi që, në thelb, sipas nenit 7 masa e konfiskimit përbënte dënim. Gjykata arriti në përfundimin që në rastin e një ankimuesi të vetëm, proceset gjyqësore ndaj të cilit (në gjykatën kombëtare) në thelb e kishin vërtetuar përgjegjësinë e tij, nuk kishte shkelje të nenit 7. Megjithatë, duke qenë se pjesa dërrmuese e ankimuesve ishin kompani me përgjegjësi të kufizuar dhe, si të tilla, nuk ishin palë në proceset penale që çuan tek urdhërat e konfiskimit, gjykata konstatoi që ata kishin qenë viktimë e shkeljes meqënëse, në thelb, ishin dënuar për një vepër për të cilën nuk mbanin përgjegjësi penale.

Vendimi në çështjen *Welch* dhe *G.I.E.M.* është në kundërshtim me vendimin e çështjes *M kundër Italisë*¹¹⁴.

Në çështjen *M kundër Italisë* parashtruesi i ankesës ishte dënuar për “anëtarësim në një organizatë kriminale”, ndërmjet akuzave të tjera, dhe ishte dënuar me disa periudha burgimi. Për të ishin kërkuar masa parandaluese, përfshirë sekuestrimin e pasurisë. Më pastaj ishte lëshuar një urdhër konfiskimi kundër tij me arsyetimin që mënyra e vetme për vënien e një pasurie aq të madhe ishte përmes ushtrimit të aktiviteteve të paligjshme. Ankimuesi pretendonte që gjykatat e brendshme të Italisë e kishin privuar nga pasuria përmes dispozitave të zbatuara në mënyrë prapavepruese, meqënëse ai e kishte fituar pasurinë para se të hynte në fuqi ligji i brendshëm përkatës. Në këtë rast, gjykata vendosi që masat parandaluese të konfiskimit i kishin shërbyer qëllimit legjitim të “goditjes së organizatave të llojit mafioz” dhe burimeve të tyre. Në ligjin italian, masa të tilla parandaluese nuk ishin kriminale për nga karakteri dhe nuk përbënin dënim për një vepër. Prandaj, gjykata arriti në përfundimin që masa nuk përfshinte konstatimin e fajit pas një akuze penale dhe prandaj nuk përbënte dënim.

113 *G.I.E.M. dhe të tjerët kundër Italisë*, vendim, datë 28 qershor 2018.

114 *M kundër Italisë*, vendim, datë 15 prill 1991.

Ky parim shqyrtohet më tej në çështjen *Yildirim kundër Italisë*¹¹⁵.

Në çështjen *Yildirim kundër Italisë*, parashtruesi i ankesës posedonte një autobus të cilin e kishte dhënë me qira. Gjatë kohës kur ishte i dhënë me qira, autobusi u gjet duke transportuar migrantë të paligjshëm. Shoferët u arrestuan dhe u dënuan me ndalim dhe autobusi u sekuestrua. Ankimuesi nisi procedurën për kthimin e autobusit. Duke u mbështetur në nenin 1 të Protokollit nr. 1 dhe në nenin 7, ai kontestoi refuzimin e kërkesës të marrë autobusin dhe refuzimin për t'ia kthyer automjetin e tij. Në lidhje me nenin 7, gjykata vërejtë se ndaj ankimuesit nuk ishte ngritur ndonjë akuzë penale, proceset e konfiskimit nuk kishin të bënin me ndonjë akuzë penale ndaj tij dhe, për pasojë, konfiskimi nuk mundur të përfshinte gjetjen e fajit pas një akuze penale. Prandaj, sipas nenit 7 urdhëri i konfiskimit nuk mund të ishte dënim.

2.5.3.3 Përfundimet kryesore

Bashkëveprimi ndërmjet nenit 7 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 është shpesh delikat dhe vendimi i gjykatës nëse konfiskimi përbën dënim ose jo, në fakt varet nga dallime të vogla. Me rëndësi thelbësore për arsyetimin e gjykatës është përcaktimi nëse masat e konfiskimit janë pasojë e akuzave penale dhe nëse ato karakterizohen vetë si dënime penale sipas të drejtës së brendshme.

2.5.4 Neni 8

2.5.4.1 Neni 8: Vështrim i përgjithshëm

Neni 8 parashikon respektimin e jetës private dhe familjare, e cili përbëhet po ashtu nga e drejta për respektimin e shtëpisë dhe të korrespondencës. Kjo është një e drejtë e kufizuar.

Në nenin 8 thuhet:

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Koncepti i jetës private vlen për personat fizikë dhe juridikë dhe përfshin identitetin personal, autonominë, informacionet personale, seksualitetin, vetëzhvillimin, raportet me individët e tjerë, reputacionin dhe integritetin fizik dhe moral (domethënë mirëqenien fizike dhe psikologjike). Jeta familjare përfshin njësitë familjare biologjike, ligjore dhe sociale, si për shembull, raportet në një familje tradicionale ndërmjet çifteve të martuara, prindërve dhe fëmijëve, gjyshërve dhe nipave dhe mbesave, dhe vëllezërve dhe motrave. Po ashtu ajo përfshin çiftet e fejuara/të angazhuara, çiftet që bashkëjetojnë, prindërit e ndarë të fëmijëve, çiftet homoseksuale, prindërit birësues dhe fëmijët, dhe prindërit kujdestarë dhe fëmijët. Në fund, organet e Konventës i japin konceptit të shtëpisë një përkufizim të gjerë, i cili aplokohet si mbi shtëpitë *de jure* dhe mbi ato *de facto*, dhe për personat fizikë dhe juridikë, me përkufizimin që lidhet më shumë me profesionin se sa ndonjë bazë ligjore. Për më tepër, meqë “shtëpia” dhe “jeta private” mund të gërshetohen me aktivitetet e biznesit dhe profesionale, është konstatuar që mbrojtja e nenit 8 përfshin edhe zyrat personale dhe, në rastin e kompanive, edhe ambientet e kompanisë.

115 *Yildirim kundër Italisë*, vendim, datë 10 prill 2004.

Shteti ka detyrim negativ për të mos ndërhyjë në jetën private të individit, në jetën familjare, në shtëpi dhe korrespondencë. Në rastet kur shteti zbaton masat që prekin këto të drejta, do të konstatohet se ka shkelje përveç nëse ndërhyrja ka qenë “në pajtueshmëri me ligjin”, ka ndjekur një qëllim legjitim dhe i përmbush kërkesat e proporcionalitetit. Neni 8(2) përmend disa prej këtyre qëllimeve legjitime, përfshirë sigurinë kombëtare, parandalimin e trazirave ose të krimit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Në disa rrethana, shteti ka detyrim pozitiv për të ndëmarrë hapa për të siguruar respektim efektiv të nenit 8. Kjo ka të bëjë jo vetëm me raportin ndërmjet shtetit dhe individit, por edhe ndërmjet individit dhe organeve private, dhe po ashtu edhe ndërmjet individëve privatë.

2.5.4.2 Bashkëveprimi ndërmjet nenit 8 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1

Nuk është e pazakontë për ankimuesit të cilët pretendojnë një shkelje të së drejtës së tyre për respektimin e shtëpisë sipas nenit 8, që të mbështeten gjithashtu edhe në nenin 1 të Protokollit nr. 1 – në veçanti në rastet kur shtëpia është vendi i banimit për ankimuesin. Hyrja e policisë në një shtëpi të banimit ose në një vend pune, me qëllim sekuestrimin e sendeve, është shfrytëzuar për t’i argumentuar shkeljet sipas nenit 8 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 ashtu siç sqarohet në çështjen *Niemietz kundër Gjermanisë*¹¹⁶.

Niemietz kundër Gjermanisë kishte të bënte me hetimin tatimor që çoi tek akuza penale e shpifjes. Ishte nxjerrë një urdhër kontrolli për kontrollin e zyrës ligjore të parashtruesit të ankesës për ta zbuluar identitetin e autorit të një letre. Gjatë kontrollit, ishin kontrolluar skedarët që përmbanin informacione konfidenciale të klientëve, të cilët nuk ishin objekt i urdhërit të kontrollit. Parashtruesi u ankua mbështetur në nenin 8(1) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 duke pretenduar që kontrolli kishte shkelur të drejtën e tij të respektimit të shtëpisë dhe korrespondencës, që ai ishte joproporcional dhe ishte urdhëruar për t’iu shmangur ligjeve të konfidencialitetit. Gjykatat vërejtën që urdhëri ishte i gjerë pasi urdhëronte kontroll dhe sekuestrim të “dokumentave” pa ndonjë kufizim. Prandaj, ai ishte joproporcional dhe nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike, kështu që, në rastin në fjalë, kishte shkelje të nenit 8. Ankesa e ankimuesit bazuar në nenin 1 të Protokollit nr. 1 që urdhëri për kontroll i kishte shkatërruar reputacionin si avokat, ishte shqyrtuar tashmë në kuadrin e nenit 8 dhe prandaj nuk ishte i nevojshëm asnjë shqyrtim shtesë sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1.

116 *Niemietz kundër Gjermanisë*, aktgjykimi i datës 19 dhjetor 1992.

Megjithatë, në çështjet e lidhura me urdhrat për konfiskim, Gjykata ka qenë e gatshme të gjejë shkelje edhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1, edhe të nenit 8.

Në çështjen *Gladyшева kundër Ruisë* shteti e kishte dëbuar ankimuesen nga banesa e saj me arsyetimin që pronari i mëparshëm e kishte fituar pronën me mashtrime. Parashtruesja u ankua që ajo ishte privuar nga prona, gjë e cila përbënte shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, dhe që dëbimi ishte shkelje e të drejtës së saj për respektimin e shtëpisë sipas nenit 8. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, gjykata theksoi që konfiskimi i banesës së ankimueses, pa i ofruar asaj strehim alternativ, i vendoste asaj barrë të madhe si individ. Prandaj, nuk ishte arritur një ekuilibër i drejtë dhe proporcional ndërmjet interesave të përgjithshme të komunitetit dhe të drejtave themelore të individit dhe kishte shkelje të këtij neni. Gjykata vazhdoi duke theksuar që ndërhyrja në nenin 8 kishte ndodhur me lëshimin e urdhërit për dëbim, pavarësisht zbatimit të tij. Më tej, gjykata u shpreh që liria e vlerësimit për çështjet e banimit është më e ngushtë në bazë të nenit 8 se sa në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, për shkak të rëndësisë kryesore të nenit 8 për identitetin, vetëvendosjen, integritetin fizik dhe moral të individit, mbajtjen e raporteve me të tjerët dhe të vendit të qëndrueshëm dhe të sigurtë në shoqëri. Meqenëse qeveria nuk i kishte përfillur të drejtat e parashikuara në nenin 8 në rastin e ankimueses, dilnin çështje të pavarura në bazë të të dyja dispozitave dhe prandaj gjykata konstatoi shkelje të të dyja neneve.

2.5.4.3 Neni 8 dhe kontrollet në pronë

Të gjitha konventat dhe standardet ndërkombëtare të përmendura në Pjesën A të këtij doracaku imponojnë ose inkurajojnë, në kuptim të përgjithshëm, zbatimin e kompetencave hetuese dhe të kontrollit, në mënyrë që zbatimi i ligjit të mund të jetësohet në mënyrë efektive. Prandaj, neni 8 mund të zbatohet para sekuestrimit të pasurisë, për shembull, deri sa të bëhet hetimi i pretendimeve për korrupsion. Në rastet kur autoritetet e brendshme kërkojnë të realizojnë kontrollin e shtëpisë apo të ambienteve të biznesit të ankimuesit, neni 8 përcakton që kontrolli duhet të bëhet “në pajtueshmëri me ligjin.” Sipas kësaj, kontrolli nuk duhet vetëm të bazohet në legjisllacionin e qasshëm dhe të parashikueshëm, por ky legjisllacion duhet po ashtu të ofrojë garanci adekuate kundër arbitraritetit. Prandaj, në përgjithësi, kontrollet duhet të bëhen me mandat gjyqësor.

Në rastet kur nuk ka mandat gjyqësor, kontrolli mund të legjitimohet *post-facto* përmes shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së kontrollit dhe disponueshmërisë së korigjimit gjyqësor, nëse kontrolli rezulton i paligjshëm. Në çështjen *Gutsanovi kundër Bullgarisë*,¹¹⁷ gjykata konstatoi që nuk ishte e mjaftueshme që gjyqtari i gjykatës kombëtare thjesht të nënshkruante dhe të vuloste një proces-verbal kontrolli me fjalën “miratohet”, pa dhënë asnjë arsye për miratimin në fjalë. Kjo nuk përbënte masë të mjaftueshme mbrojtëse kundër keqpërdorimit. Për më tepër, fushëveprimi i çfarëdo urdhëri gjyqësor për kontroll duhet të jetë në përpjestim me “domosdoshmërinë” e tij. Për shembull, në çështjen *Iliya kundër Stefanov kundër Bullgarisë*, gjykata konstatoi që shtrirja e gjerë e kushteve të udhrit për kontroll, e pasqyruar në mënyrën sipas e ekzekutimit të tij, nuk mund të konsiderohej e domosdoshme dhe proporcionale në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 8.

117 *Gutsanovi kundër Bullgarisë*, vendim, datë 15 tetor 2013.

2.5.4.4 Përfundimet kryesore

Neni 8 dhe neni 1 i Protokolit nr. 1 mund të shfrytëzohen dhe të ndërveprojnë në shumë mënyra. Është me rëndësi të thuhet që shteti duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar që sekuestrimi i pasurisë nuk shkon përtej kufijve të domosdoshëm, domethënë që urdhrat për kontroll dhe sekuestrim nuk duhet të jenë të papenguara. Siç u sqarua më sipër, është konstatuar që masa të tilla kanë shkelur edhe nenin 1 të Protokolit nr.1 edhe nenin 8.

2.5.4.5 Lista e çështjeve kryesore

- **Iliya Stefanov kundër Bullgarisë:**¹¹⁸ Shtirja e gjerë e urdhrave për kontroll dhe sekuestrim ka shkelur nenin 8
- **Gutsanov kundër Bullgarisë:**¹¹⁹ Mungesa e arsyeve në miratimin gjyqësor të kontrollit të banesës së ankimueses nuk i përmbush kërkesat e ligjshmërisë të mishëruara në nenin 8.

118 *Iliya Stefanov kundër Bullgarisë*, vendim, datë 22 maj 2008.

119 *Gutsanov kundër Bullgarisë*, vendim, datë 15 tetor 2013.

III. ANALIZË KRAHASUESE E PROCESIVE TË KTHIMIT TË PASURISË

3.1. SHQIPËRIA

Legjislacioni i kthimit të pasurisë në Shqipëri përbëhet nga Kodi Penal (2017) dhe nga Kodi i Procedurës Penale (2017), të cilët mbulojnë konfiskimin e rregullt, duke u bazuar në lidhjen e fuqishme ndërmjet veprave penale dhe produkteve të krimit. Në lidhje me përmbajtjen e tij thelbësore, si masë që bazohet në lidhjen fleksibile ndërmjet veprave penale dhe produkteve të krimit, konfiskimi i zgjeruar mbulohet nga ligji antimafia, (Ligji AM) (2017), duke qenë *lex specialis*.

3.1.1. Hetimet financiare

3.1.1.1. Fillimi i hetimeve financiare

Hetimet financiare zhvillohen në kuadër të procedurës penale si edhe të procedurës parandaluese. Sa i përket lidhjes ndërmjet këtyre dy llojeve të procedurave, duhet të theksohet se, ashtu siç parashikohet në nenin 5 të Ligjit AM (2017), ato janë dy procedura të ndara dhe autonome. Kjo do të thotë që procedura parandaluese shpesh nuk ndikohet nga statusi ose shkalla e procedurës penale, dhe anasjelltas. Ajo mund të fillojë e pavarur nga procesi penal.

Së fundi Udhëzimi nr. 6, datës 20.11.2018, i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi hetimin e pasurisë, konfiskimin dhe sekuestrimin e produkteve të veprave penale” (2018), ka krijuar një seksion të posaçëm të lidhur me Prokurorinë e Krimeve të Rënda (PKR), e cila ka juridiksion në tërë vendin. Sipas nenit 1 të Udhëzimit (2018), seksioni i posaçëm ka kompetenca të trajtojë të gjitha proceset parandaluese. Sipas nenit 3 të Udhëzimit (2018) secila prokurori e vendit është e detyruar të informojë seksionin e posaçëm në PKR lidhur me rezultatet e hetimeve financiare të zhvilluara gjatë procedurës penale të juridiksionit të tyre.

Hetimi financiar nuk është rregulluar në mënyrë të qartë si kategori e posaçme e hetimit në kuadër të kornizës së procedurës penale. Ai fillon për secilin rast veç e veç dhe kryhet sipas dispozitave të KPP-së (2017), të cilat shfrytëzohen për të gjitha hetimet e veprave penale në përgjithësi. Fushëveprimi i hetimit penal është të gjejë dhe të paraqesë prova në mënyrë që të vërtetohet fajësia e të pandehurit në gjykatë, sipas standardit “përtej dyshimit të bazuar”, si edhe të sigurojë zbatimin e ndëshkimit të mundshëm të të pandehurit me gjobë, konfiskim apo pagesë të borxheve të tij ndaj shtetit ose viktimave të krimit.

Ndërsa në procedurën parandaluese hetimi financiar rregullohet përmes *lex specialis*, përkatësisht Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Mbi luftimin e trafikimit dhe të krimit të organizuar përmes masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar me Ligjin 24/2014 dhe Ligjin 70/2017, të njohur si Ligji Antimafia (ligji AM) [2017], dhe ka për qëllim mbledhjen e provave në mënyrë që, duke u bazuar në standardin e “shkakut të mundshëm”, të plotësojë të gjitha kushtet e kërkuara për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë në pronësi, posedim ose nën kontrollin e personit të dyshuar për një kategori të aktiviteteve kriminale.

Në ligj nuk ka asnjë dispozitë e cila parashikon disa kushte të përgjithshme të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të fillojë hetimi financiar.

Nevojën për fillimin e hetimit financiar gjatë një procedure penale e vlerëson prokurori ose zyrtari i Policisë Gjyqësore për secilin rast veçmas. Hetimet e tilla financiare mund të fillojnë pa patur nevojë për një miratim që lejon formalisht ndërmerren e një nisme të tillë. Kushti i vetëm themelor për fillimin e një hetimi financiar në një proces penal mbetet fillimi i vetë procesit penal.

Ndërsa në procedurën parandaluese, kushtet themelore për fillimin e hetimit financiar mund të nxirren nga neni 3 dhe 6 i Ligjit AM (2017). Sipas nenit 6, hetimi financiar ka për qëllim të verifikojë mjetet financiare, pasurinë, etj., të cilat ju përkasin personave të përmendur në nenin 3 të Ligjit AM (2017). Kur i referohemi nenit 3 të Ligjit AM (2017), dispozitat e ligjit AM janë të zbatueshme për pasurinë e personave për të cilët, sipas treguesve, ekziston dyshim i arsyeshëm se ata kanë kryer njërin nga veprat penale të përmendura në këtë nen, apo kanë marrë pjesë në kryerjen e saj¹²⁰.

Sipas ligjit (KPP ose ligjit AM) nuk nevojitet miratimi i prokurorit apo i gjykatës për fillimin e hetimit financiar, as gjatë procedurës penale, as gjatë asaj parandaluese. Ndodh kështu sepse në këtë fazë ligji nuk parashikon ndonjë kontroll gjyqësor ende. Miratimi kërkohet vetëm për fillimin e procesit penal. Në raste të tilla, sipas nenit 287 të KPP (2017) përmes miratimit të njohur si “regjistrimi i procesit penal” prokurori realizon fillimin e procesit penal. Sipas Udhëzimit nr. 6 të Prokurorit të Përgjithshëm (2018), prokurorët e seksionit të posaçëm e zbatojnë miratimin vetëm për të filluar procedurën parandaluese, pasi të arrijnë në përfundimin që hetimet financiare, të cilat zhvillohen ose në lidhje me procedurën penale ose me procedurën parandaluese, mjaftojnë për të nisur procesin e sekuestrimit ose konfiskimit në gjykatë.

3.1.1.2. Qëllimet e hetimit financiar

Qëllimi i hetimit financiar në një proces penal është paraqitja e provave në gjykatë për të përfunduar sipas standardit përtej dyshimit të arsyeshëm që një pasuri e caktuar përbën të ardhura ose produkte të veprës penale, si edhe për të paraqitur prova lidhur me fajësinë e të pandehurit për një akuzë penale.

Në bazë të analizimit të ligjit AM (2017), në veçanti të nenit 2, 3, 6, 9, 11 dhe 12/a, del se qëllimi kryesor i hetimit financiar është paraqitja e provave në gjykatë, për të arritur në përfundimin, sipas standardit të shkakut të mundshëm, që pasuri të caktuara përbëjnë të ardhura të kategorisë së ve-

120 Kjo analizë arrin në përfundimin që kushti i vetëm për fillimin e hetimit penal në një proce parandaluese është ekzistenca e disa treguesve që mbështesin dyshimin e arsyeshëm për pjesëmarrje në një aktivitet kriminal. Ligji AM (2017) nuk parashikon ndonjë kusht tjetër për fillimin e hetimit financiar, si, për shembull, një prag i caktuar monetar ose shuma të caktuara të të ardhurave.

prave penale dhe, si të tilla, ato duhet të sekuestrohen ose të konfiskohen¹²¹.

3.1.1.3. Specifikat e kryerjes së hetimit financiar

Veprimet operacionale para fillimit të hetimit financiar kryhen sipas *lexis specialis*, siç është Ligji 9917, 19.05.2008 “Mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit”, (2008) të ndryshuar (Ligji kundër pastrimit të parave). Sipas këtij ligji (2008) disa persona dhe profesionistë juridikë janë të detyruar t'i raportojnë të gjitha transaksionet e dyshimta financiare tek Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), një agjenci nën kompetencat e Ministrisë së Financave.

NJIF-i kryen analiza financiare duke u bazuar në të dhënat që vijnë nga subjektet e mësipërme dhe të cilat janë hedhur në baza të të dhënave të institucioneve shtetërore dhe të regjistrit publik. Ajo i analizon informacionet e këmbëryera me agjencitë e zbatimit të ligjit në vendit ose jashtë shtetit.

Rezultatet e veprimeve operacionale të NJIF-it mund të shfrytëzohen pa paragjykim në dy mënyra, ose për fillimin e procesit penale ose të procedurës parandaluese. Në të dyja rastet, sipas nenit 22.1 të ligjit kundër pastrimit të parave (2017), informacion nuk mund të përdoret si provë në gjykatë, por shërben vetëm si bazë për fillimin e procedurës penale ose të procedurës parandaluese.

Veprimet hetuese (dëshmuere) të përdorura në procesin penal, përfshirë veprimet e hetimeve financiare, kryhen sipas dispozitave të KPK-së (2017). Nuk ka ndonjë regjim të posaçëm ose ndonjë lloj kufizimi për veprimet hetuese që kanë të bëjnë me hetimin financiar. Hetimet financiare kryhen sipas bazës së njëjtë procedurale si edhe të gjitha llojet e tjera të hetimeve dhe nuk ka ndonjë regjim të posaçëm lidhur me to.

Veprimet hetuese (dëshmuere) të përdorura në procedurën parandaluese, parashikohen parashikohen në Ligjin AM (2017) dhe plotësohen me dispozitat e KPP (2017).

Siç parashikohet me nenin 6 të Ligjit AM (2017), prokurori dhe zyrtarët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të marrin deklaratat nga dëshmitarët, si edhe të kryejnë ekzaminime ekspertësh. Ata madje

121 Në mënyrë më specifike, hetimi financiar ka për qëllim të sqarojë si në vijim:

1. Cila është pasuria në pronësi ligjore ose nën kontrollin e personit të dyshuar, të të afërmeve ose të trashëgimtarëve të tij dhe cili është burimi i tyre i ligjshëm, i parashikuar në nenin 3 të ligjit AM (2017).
2. Cilat janë të ardhurat e përgjithshme të personit të dyshuar, si edhe të afërmeve dhe të trashëgimtarëve të tij.
3. Kush janë personat fizikë ose juridikë që janë nën kontrollin e personit të dyshuar dhe cila është pasuria që ata kanë në pronësi të ligjshme dhe burimi i saj i ligjshëm.
4. Nëse ekziston ndonjë shpërpjestim ndërmjet vlerës së përgjithshme të pasurisë në pronësi ose në posedim nga personat e sipërpërmendur dhe vlerës së përgjithshme të të ardhurave të tyre të ligjshme, siç parashikohet me nenin 2, 11 dhe 24 të ligjit AM (2017).
5. Nëse ekziston një rrezik i vërtetë për humbjen apo tjetërsimin e pasurisë në lidhje me të cilën zbatohet urdhri për konfiskim sipas ligjit AM (2017), ose nëse ekziston dyshim i arsyeshëm që ekziston rreziku që posedimi i pasurisë së tillë bie nën ndikimin e një organizate kriminale ose mund ta lehtësojë aktivitetin e një organizate të tillë. Kjo nevojë për provat lidhur me praninë e rreziqeve të tilla shërben vetëm si kërkesë për konfiskim drejtuar gjykatës, ashtu siç parashikohet hollësisht në nenin 11 të ligjit AM (2017).
6. Cila është pasuria që ju përket ligjërisht personave të përmendur më sipër, e cila mund të jetë shënjestër e mundshme e sekuestrimit të barasvlershëm ose të konfiskimit të barasvlershëm, siç parashikohet në nenin 12/a të ligjit AM (2017). Sipas këtij neni, në rast se pasuria që është e përshtatshme për sekuestrim apo konfiskim transferohet, tjetërsohet, fshihet apo zhvlerësohet nga pronarët e ligjshëm, me qëllim bërjen të pamundur të sekuestrimit dhe konfiskimit të saj, sekuestrimi ose konfiskimi i saj mund të shtrihet në mënyrë të barasvlershme edhe mbi pasuritë e tjera të këtyre personave me prejardhje të ligjshme.

mund t'i shfrytëzojnë edhe konventat ndërkombëtare për ndihmë ndërkombëtare juridike të ndërsjellë.

Prokurori dhe zyrtarët e policisë gjyqësore shpesh kanë po ashtu të drejtë të kërkojnë nga një zyrë publike, person fizik apo person juridik, t'u dërgojë informacionin ose dokumentacionin që posedon, ashtu siç parashikohet në nenin 9 të Ligjit AM (2017). Sipas të njëjtit nen, zyrtarët e policisë gjyqësore kanë të drejtë që, përmes autorizimit të prokurorit, të sekuestrojnë dokumente për t'u përdorur si prova në gjykatë, duke respektuar të njëjtat rregulla procedurale si për sekuestrimin e dokumenteve të parashikuara në KPP (2017).

Këto janë veprimet e vetme hetuese (dëshmuere) të cilat mund të shfrytëzohen në procesin parandalues pa autorizimin e gjykatës. Prokurori dhe zyrtarët e policisë gjyqësore mund të shfrytëzojnë edhe mjetet e tjera hetuese, të cilat parashikohen në KPP (2017), vetëm me autorizimin e gjykatës, të nxjerrë *ex officio* ose me kërkesë të prokurorit apo të palëve, ashtu siç parashikohet në nenin 10 të Ligjit AM (2017). Për shembull, gjatë procesit penal, KPP-ja (2017) u mundëson zyrtarëve të policisë gjyqësore ose prokurorëve që, në disa situata urgjente, të kryejnë kontrollin e vendeve, inspektimin e banesave, madje edhe përgjimin e telefonave ose të vendeve private pa autorizimin e gjykatës, vetëm me detyrimin që këtë veprim hetimor ta vërtetojnë brenda 48 orëve para gjykatës. Në procesin parandalues kjo nuk është e mundur pasi neni 10 i Ligjit AM (2017), mundëson shfrytëzimin e mjeteve hetuese të parashikuara në KPP (2017), ndryshe prej atyre të parashikuara me ligjin AM, vetëm me autorizimin e gjykatës.

Prokuroria ka prezantuar kohët e fundit sistemin e vet të bazës së të dhënave, të njohur si Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve (CMS). Ky sistem ju ofron të gjithë prokurorëve qasje të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të sigurisë së informacionit të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm, në disa baza të rëndësishme të të dhënave, si: (1) TIMS – Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Trafikimin, (2) Regjistri Kombëtar i Pasurisë, (3) Regjistri Kombëtar i Automjeteve Motorike dhe (4) Qendra Kombëtare e Biznesit.

KPP-ja (2017) dhe ligji AM (2017) nuk ofrojnë ndonjë listë të subjekteve të cilat mund të urdhërohen nga prokurori ose gjykata të japin të dhëna për qëllime të hetimit financiar. Në parim, sipas nenit 9 të ligjit AM (2017) prokurori mund të urdhërojë çdo institucion shtetëror, zyrë publike apo private, ose agjenci, t'i japë të dhënat që ka në dispozicion me qëllim kryerjen e hetimit financiar për qëllimin e procesit parandalues. E njëjta situatë ndiqet madje edhe në procesin penale. Sipas nenit 191 të KPP-së (2017), prokurori ka të drejtë të ketë qasje në çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm për procesin penale pavarësisht në posedim të kujt është dokumenti, të ndonjë personi fizik, personi juridik, zyre private apo publike. Sipas nenit 203, prokurori dhe oficerët e policisë gjyqësore, me autorizim të prokurorit, kanë të drejtë të marrin të dhëna bankare mbi transaksionet ose dokumentet, në mënyrë që të identifikojnë dokumentet ose të dhënat e mundshme që mund të kërkohen në gjykatë për t'u depozituar si prova (KPP, 2017).

3.1.1.4. Përfundimi i hetimit financiar dhe zbatimi i rezultateve të tij

KPP-ja (2017) nuk ka ndonjë dispozitë që tregon në mënyrë të qartë kushtet sipas të cilave konsiderohet formalisht që ka filluar apo ka përfunduar hetimi financiar. Por tërthorazi, hetimi financiar konsiderohet formalisht i përfunduar kur prokurori nxjerr vendimin për dërgimin e çështjes në gjykatë. Kur prokurori nxjerr dekretin për pushimin e procesit penal, atëherë hetimi financiar konsiderohet se ka përfunduar formalisht, nëse gjykata e pranon kërkesën e prokurorit për pushimin e procesit penal.

Para se procesi penal të dërgohet në gjykatë për gjykim, hetimet financiare konsiderohen të përfunduara kur, duke u bazuar në provat e mbledhura gjatë hetimit, mund të arrihet përfundimi

përtej dyshimit të aryeshëm që pasuria përbën mjete ose produkte të krimit, shpërblim ose madje edhe premtim për shpërblim për kryerjen e krimit.

Madje edhe ligji AM (2017), i cili mbulon proceset parandaluese, nuk vendos ndonjë kufizim kohor për përfundimin e hetimit financiar. Në rast se prokurori paraqet kërkesë për sekuestrim ose konfiskim, atëherë hetimi financiar është i lidhur me afate kohore për sekuestrim deri sa gjykata të nxjerrë urdhërin e konfiskimit. Pra, duke ju referuar nenit 12 të ligjit AM (2017) afati i sekuestrimit pa urdhër për konfiskim është deri në gjashtë muaj; ky afat mund të shtyhet edhe gjashtë muaj, por nuk mund të zgjasë për më shumë se dy vjet. Në anën tjetër, sipas nenit 23 të ligjit AM (2017) gjykata duhet ta nxjerrë një urdhër konfiskimi brenda afatit kohor prej tre muajsh deri në më së shumti një vit nga data e paraqitjes së kërkesës për konfiskim nga ana e prokurorit. Nëse konsiderojmë që hetimet financiare mund të shtrihen madje edhe gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim, ashtu siç parashikohet në nenin 6 të ligjit AM (2017), afati i përgjithshëm i mundshëm kohor i hetimit financiar, pas nxjerrjes së urdhrit për sekuestrim nga gjykata, është minimumi gjashtë muaj deri në maksimumi tre vjet, duke e marrë si të mirëqenë që kërkesa për konfiskim e prokurorit dorëzohet në kohë në gjykatë.

Në anën tjetër, mungesa e ndonjë dispozite në ligjin AM (2017) mbi afatat kohore të hetimit financiar në proceset parandaluese duket të jetë problematike në rastet kur prokurori nuk paraqet në gjykatë kërkesë për sekuestrim. Në rastet e tilla, hetimi praktikisht nuk ka kurrfarë kufizimesh kohore. Në teori, ai mund të zgjasë përgjithmonë¹²².

As në ligjin AM (2017) nuk ka asnjë dispozitë që lejon rihapjen e një hetimi të mbyllur.

Në procesin penal, prokurori i shfrytëzon rezultatet e hetimit financiar për të mbështetur kërkesat e mundshme për sekuestrimin ose konfiskimin e ndonjë pasurie që rezulton të jetë mjet për realizimin e veprës penale, produkt i veprës penale, shpërblim ose premtim për shpërblim për kryerjen e një krimi, ose për të mbështetur akuzën penale si edhe hetimet e tjera në përgjithësi. Këto rezultate prokurori i paraqiten në kërkesën për regjistrimin e çështjes për gjykim në gjykatë. Neni 331 i KPP-së (2017) jep formën e kësaj kërkesë.

As në KPP (2017) as në ligjin AM (2017) nuk ka ndonjë dispozitë lidhur me llojin e provave që duhet të paraqes në gjykatë prokurori për të mbështetur akuzat penale ose kërkesën për sekuestrim ose për konfiskim. Por, duke pasur parasysh natyrën e hetimit financiar, pothuajse çdo herë prokurorët e shfrytëzojnë ekspertizën financiare, në veçanti lidhur me vlerën e pasurisë dhe natyrën e veprimeve financiare të lidhura me të.

3.1.2. Masat e përkohshme (ngrirja dhe sekuestrimi i produkteve të krimit)

3.1.2.1. Korniza ligjore për masat e përkohshme

Koncepti që përdoret më së shumti në legjislacionin shqiptar është “sekuestrimi” i produkteve të krimit. Ende ekzistojnë disa dallime ndërmjet sekuestrimit dhe ngrirjes si koncepte, meqë sekuestrimi konsiderohet bllokimi i një pasurie me urdhër të gjykatës dhe ngrirja bllokimi i pasurisë vetëm me urdhër të qeverisë.

122 Në përpjekje për të prezantuar një lloj vetëkontrolli në kushtet e mospërcaktimit të afateve kohore lidhur me hetimin financiar, prokurorët veprojnë sipas praktikës së nxjerrjes së kërkesës për pushimin e hetimit financiar, sipas analogjisë me rastin kur kërkojnë pushimin e hetimit penal. Sidoqoftë, kjo kërkesë nuk është e parashikuar me ligj dhe, duke qenë kështu, gjykata nuk mund të ushtrojë ndonjë kontroll gjyqësor mbi të, për shkak se nuk ekziston ndonjë dispozitë në ligj lidhur me këtë lloj kontrolli.

Sipas këtij konceptualizimi, mund të verifikohen dy raste të ngrirjes.

Rasti i parë parashikohet me Ligjin Nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit” (2008), të ndryshuar (neni 22). Sipas nenit 22 të këtij ligji, Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), pjesë e Ministrisë së Financave, ka të drejtë të nxjerrë një urdhër për ngrirje ose bllokim për veprime apo transaksione të caktuara financiare (deri në 72 orë), në rast se e konsideron të nevojshme të ndër marrë disa veprime verifikuese lidhur me natyrën e vërtetë të atyre transaksioneve¹²³.

Rasti i dytë ka të bëjë me regjimin e posaçëm të “ngrirjes” të parashikuar në Ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar me Ligjin 43/2017, i cili i ngjan më shumë konceptit të ngrirjes se sa atij të sekuestrimit (Ligji për masat kundër financimit të terrorizmit, 2017). Sipas këtij regjimi të posaçëm, Ministria e Financave ka të drejtë të urdhërojë bllokim dhe sekuestrim të përkohshëm të pasurisë që ju takon njerëzve, të cilët, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, janë të regjistruar në listën e njerëzve të shpallur si terroristë nga Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Sekuestrimi, si masë e përkohshme, mund të nxirret gjatë dy llojeve të procedurave: të procedurës penale dhe të procedurës parandaluese.

Pavarësisht nga lloji i procedurës, procedurë penale apo procedurë parandaluese, parimi i sekuestrimit si masë e përkohshme dallon nga ngrirja sepse në çdo rast sekuestrimi (ose konfiskimi) i përkohshëm zbatohet vetëm me urdhër të gjykatës. Ndërsa ngrirja është një lloj bllokimi i pasurisë sipas urdhrit të nxjerrë nga qeveria (Ministria e Financave ose NJIF-i).

a) Sekuestrimi gjatë procesit penal

Gjatë procesit penal, sekuestrimi (si edhe konfiskimi) bëhen sipas KP-së (2017) si edhe KPP-së (2017).

Ashtu siç parashikohet me KPP (2017), prokurori dhe gjykata mund të urdhërojnë dy lloje sekuestrimi: sekuestrimin si mjet provues dhe sekuestrimin si masë sigurie.

Sekuestrimi si mjet provues. Sekuestrimi provues, ashtu siç parashikohet në nenin 208 të KPP-së (2017), mund të nxirret nga prokurori si edhe *ex officio*. Ai urdhërohet për cilindo send apo pasuri që konsiderohet të jetë e rëndësishme për t’u paraqitur si provë materiale para gjykatës gjatë një procesi penal. Në raste urgjente, ashtu siç parashikohet në nenin 300 të KPP-së (2017), madje edhe oficerët e policisë gjyqësore (OPGJ) kanë kompetenca të bëjnë sekuestrim si mjet prove. OPGJ-të mund të bëjnë sekuestrim të tillë në rastet kur konsiderojnë që artikujt e tillë mund të përdoren si prova materiale dhe në rastet kur nuk ekziston mundësia e kontaktimit të prokurorit menjëherë dhe ka rrezik për humbjen apo ndryshimin e tyre.

Sekuestrimi si masë sigurie. Gjatë procedurës penale mund të nxirren madje dy lloje të tjera të sekuestrimit, do të thotë 1) sekuestrimi parandalues dhe 2) sekuestrimi konservativ. Këto dy sekuestrime kërkohen nga prokurori në çdo rast dhe ekzekutohen sipas urdhrit të gjykatës.

123 Kur NJIF-i arrin në përfundimin që ka dyshime të arsyeshme që transaksioni përbën një formë të pastrimit të parave ose ndonjë vepër të tjetër të lidhur penale, ia nis menjëherë rastin prokurorisë. Më pas, Prokuroria shqyrton nëse do të bëjë kërkesë në gjykatë për sekuestrim, ashtu si vepron në përgjithësi në kuadër të procesit penal, apo do të përdorë procesin parandalues.

- 1) Sekuestrimi parandalues. Neni 274.1 i KPP-së (2017) parashikon që sekuestrimi parandalues mund të zbatohet me arsyetimin që pasuria është e lidhur me vepër penale dhe nëse ka rrezik që disponueshmëria e saj mund t'i përkeqësojë pasojat e veprës penale ose ta lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Sa i përket pasurisë, sekuestrimi parandalues mund të vlejë për cilëndo pasuri "të lidhur me vepër penale", përfshirë mjetet ose produktet e krimit.
- 2) Sekuestrimi konservativ. Sipas nenit 270 të KPP (2017), sekuestrimi konservativ mund të zbatohet me arsyetimin që i pandehuri nuk ka ndonjë garanci për t'u paguar dëmet financiare vikimave ose shtetit. Sa ju përket llojeve të pasurisë, ndryshe nga sekuestrimi parandalues, sekuestrimi konservativ nuk e ka në objektin pasurinë e lidhur me veprën penale. Ai vlen vetëm për pasurinë me prejardhje të ligjshme, me qëllim që të garantohet pagesa e borxheve financiare të të pandehurit, vikimave ose shtetit, në rast se i pandehuri do të shpallej fajtor në fund të procesit penal.

b) Sekuestrimi gjatë procesit parandalues

Sipas nenit 5 të ligjit AM (2017) procedurat e sekuestrimit /të konfiskimit në procesin parandalues bazohen në dispozitat e vetë ligjit AM, të ndryshuar, të plotësuar me dispozitat e KPP-së (2017). Në rastet kur nxirret urdhri për sekuestrimin/konfiskimin për pasurinë e njëjtë në kuadër të dy proceseve, të procesit penal dhe të atij parandalues, gjykata e cila e ka nxjerrë urdhrin për sekuestrim/konfiskim gjatë procesit parandalues, urdhëron pezullimin e masave të tilla, deri në momentin kur urdhri për sekuestrim/konfiskim i nxjerrë gjatë procesit penal të tërhiqet nga gjykata që ka juridiksion për procesin penal në fjalë¹²⁴.

Ligji AM po ashtu mundëson zbatimin e ashtuquajtur të barasvlershëm të sekuestrimit/konfiskimit, një formë e zgjeruar e sekuestrimit/konfiskimit. Siç parashikohet në nenin 12/a sekuestrimi/konfiskimi mund të vlejë vetëm për pasurinë tjetër përveç asaj që është e sekuestruar ose e konfiskuar, madje edhe me prejardhje të ligjshme, në rast se pronari i saj i ligjshëm e transferon, keqpërdor, shkatërron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë që është sekuestruar ose konfiskuar, me qëllim që t'i shmanget ekzekutimit (Ligji AM, 2017). Ky mekanizëm mund të vlejë madje edhe kur pasuria fitohet pandershmërisht nga palët e treta. Në fund, neni 12/b mundëson sekuestrimin/konfiskimin e barasvlershëm madje edhe në bazë të një marrëveshjeje të arritur ndërmjet prokurorit dhe të pronarëve të ligjshëm të pasurisë (Ligji AM, 2017).

Elementet ose baza ligjore e sekuestrimit në kuadër të procedurës parandaluese gjenden në nenin 3 dhe 11 të ligjit AM (2017) dhe mund të përmbliken si në vijim:

3.1.2.2. Mocioni ose kërkesa për masa të përkohshme

Nuk ekzistojnë dispozita të cilat në mënyrë specifike përshkruajnë formën e kërkesës së prokurorit lidhur me sekuestrimin ose konfiskimin, as në procesin penal as në procesin parandalues. Ligjet përkatëse (KPP dhe ligji AM) nuk i japin shumë rëndësi formës së tyre. Ligji thekson si kusht të përgjithshëm që kërkesa duhet gjithmonë të jetë e arsyeshme dhe të ketë bazë ligjore.

Sa i përket emërimit të kërkesës të prokurorit për sekuestrim, ai shprehet si në vijim:

Për sekuestrimet gjatë procesit penal, nëse është sekuestrim dëshmues – bëhet fjalë për vendim (ashtu siç parashikohet në nenin 208 të KPP [2017]). Nëse njëri prej sekuestrimeve është sekuestrim

124 Sipas nenit 12 të ligjit AM (2017), i ndryshuar, një kërkesë e mundshme e prokurorit për heqjen e sekuestrimit nuk është e detyrueshme për gjykatën, e cila mundet lirisht të nxjerrë një urdhrë për konfiskim, pavarësisht nga kërkesa për heqjen e sekuestrimit.

për qëllim mase sigurie (sequestrimi parandalues ose ai konservativ) – prokurori bën kërkesë (ashtu siç parashikohet në nenin 270 dhe 274 të KPP [2017]).

Për sequestrimin gjatë procesit parandalues, bëhet fjalë për kërkesë.

Prokurori nuk mund t'i kërkojë gjykatës në mënyrë kumulative në të njëjtën kërkesë si ngrirjen e asetëve edhe sequestrimi ose konfiskimin e tyre, pasi kërkesa për zbatimin e ngrirjes nuk bie në fushën e kompetencave të gjykatës. Ngrirja urdhërohet me urdhër të Ministrit të Financave ose NJIF-it (shih më sipër).

3.1.2.3. Urdhërimi i masave të përkohshme

Në parim, gjatë procesit penal gjykata mund ta vendosë sequestrimin/konfiskimin vetëm me kërkesë të prokurorit. Përgjatë bën sequestrimi provues, ashtu siç parashikohet në nenin 208 të KPP (2017), i cili mund të jepet nga gjykata *ex officio*, pa ndonjë kërkesë nga ana e prokurorit, kur ajo konsideron që një artikull i caktuar është i rëndësishëm të jetë i pranishëm në gjykatë si provë materiale. Nëse më vonë, gjatë procesit penal, prokurori mendon për tërheqjen e sequestrimit/konfiskimit, duhet të paraqitet një kërkesë në gjykatë dhe sequestrimi/konfiskimi mund të hiqet vetëm me vendim të gjykatës.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për sequestrimin gjatë procesit parandalues. Gjykata mund të vendosë sequestrim/konfiskim vetëm me kërkesë të prokurorit. Në rast se prokurori kërkon tërheqje të sequestrimit, gjykata mundet po ashtu të vendosë konfiskim të pasurisë së sequestruar nëse e konsideron këtë të ligjshme, ashtu siç parashikohet në nenin 12 të ligjit AM (2017).

Gjatë procesit parandalues

Baza ligjore e urdhrimit të gjykatës për vendimin për sequestrimin është e njëjtë me atë të përshkruar më sipër gjatë sqarimit në parim të bazës ligjore për sequestrim.

Forma e vendimmarrjes së gjykatës është – vendimi.

Sa i përket procedurës, ashtu siç parashikohet në nenin 12 të ligjit AM (2017), kërkesa për sequestrim shqyrtohet në praninë e prokurorit, brenda pesë ditësh prej datës së dorëzimit të saj dhe duke u bazuar në dokumentat e dorëzuara si dëshmi nga prokurori, të cilat i bashkëngjiten kërkesës. Vendimi i gjykatës bëhet i zbatueshëm pas shpalljes, brenda një periudhe prej gjashtë muajve. Gjykata cakton seancën e posaçme dëgjimore, në prani të prokurorit si edhe të palës së interesuar dhe të avokatëve të tyre të mundshëm, jo më vonë se pesë ditë para skadimit të këtij afati kohor. Në fund të kësaj seance dëgjimore, gjykata merr vendim ose ta tërheqë sequestrimin ose të bëjë konfiskimin, madje edhe në rast se prokurori e kërkon tërheqjen e sequestrimit. Mosçaktimi i seancës së posaçme nga ana e gjykatës, shkakton shuarjen e sequestrimit.

Gjatë procesit penal

Baza ligjore e urdhrimit të gjykatës që imponon sequestrimin në një proces penal është e njëjtë siç përshkruhet gjatë sqarimit të parimit të bazës ligjore të sequestrimit në procesin penal.

Sa i përket emrit të aktit të gjykatës për sequestrim, ai është si në vijim:

Në rastet kur bëhet fjalë për sequestrim dëshmuar/provues – vendim (ashtu siç parashikohet në nenin 208 të KPP [2017]).

Në rastet kur bëhet fjalë për masë sigurimi (sekuestrimi parandalues ose sekuestrimi konservativ – vendim (ashtu siç parashikohet në nenin 270 dhe 274 të KPP [2017]).

KPP (2017) nuk i përshkruan me hollësi elementet e proceseve gjyqësore në rast të vendimit për sekuestrim dëshmues¹²⁵.

Njëlloj, KPP-ja (2017) nuk i përshkruan në hollësi elementet e procedurave gjyqësore në rast të vendimit për sekuestrim si masë sigurimi (sekuestrimi parandalues dhe sekuestrimi konservativ). Por, meqë ky lloj sekuestrimi kërkohet nga prokurori gjatë fazës hetuese të procedurës penale, vendimi i gjykatës merret në seancë të mbyllur (dhoma e këshillit) dhe vetëm në praninë e prokurorit. Pas ekzekutimit të sekuestrimit, vendimi i gjykatës është i hapur për palët të cilat mund të ushtrojnë ankesë kundër tij në Gjykatën e Apelit brenda një periudhe prej 10 ditëve prej marrjes së njoftimit për vendimin.

Në procesin penal

Sipas nenit 217 dhe 218 të KPP (2018), gjyqtari i njëjtë i gjykatës ose prokurori i njëjtë, të cilët individualisht e kanë kërkuar sekuestrimin dëshmues, mund ta urdhërojnë tërheqjen e tij, në rastet kur konsiderojnë që artikulli objekt sekuestrimi nuk shërben më si provë në procesin penal.

Edhe në lidhje me sekuestrimet si masë sigurimi (sekuestrimi parandalues dhe sekuestrimi konservativ), në rastin e sekuestrimit konservativ, ai mund të tërhiqet nga gjyqtari individual i gjykatës që e ka kërkuar atë, ashtu siç parashikohet në nenin 272 të KPP (2017), në rast se i pandehuri ofron një garanci tjetër të përshtatshme ligjore (hipotekë, paradhënie, dorëzani etj). Ndërsa, sipas nenit 275 të KPP (2017), sekuestrimi parandalues mund të tërhiqet më pas nga trupa gjyqësore, në rast të vendimit për pafajësi ose hedhje poshtë të akuzave penale në fund të gjykimit¹²⁶.

Në procesin parandalues

Sipas nenit 12 të ligjit AM (2017), sekuestrimi parandalues shqyrtohet nga gjyqtari i njëjtë që e ka kërkuar masën në fjalë, jo më vonë se pesë ditë para skadimit të afatit gjashtë mujor. Për këtë qëllim, gjykata cakton një seancë të posaçme dëgjimore, e cila mbahet në praninë e prokurorit si edhe të palës së interesuar dhe të avokatëve të tyre të mundshëm. Në fund të kësaj seance dëgjimore, gjykata merr vendim ose ta tërheqë sekuestrimin ose ta vendosë për konfiskimin, madje edhe në rast se prokurori kërkon tërheqjen e tij. Moscaktimi i seancës dëgjimore nga ana e gjykatës shkakton shuarje të sekuestrimit.

Sipas nenit 12/b të ligjit AM (2017), i njëjti gjyqtar që ka vendosur për sekuestrimin mund ta tërheqë sekuestrimin e një pasurie duke vendosur sekuestron mbi një pasuri tjetër me vlerë të njëjtë, por vetëm me konsensus të palëve.

Parimi i proporcionalitetit në përcaktimin e masave të përkohshme nuk përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe specifike në asnjë nen të KPP-së (2017) ose të ligjit AM (2017). Por ai trajtohet tërthorazi në dispozita të ndryshme të këtyre ligjeve.

125 Në praktikë, shumë rrallë ndodh që gjykata të marrë vendim të tillë, pasi në parim palët i paraqesin provat në gjykata. Por, në parim, gjykata e merr këtë vendim vetëm gjatë fazës së gjykimit të procedurës penale dhe vendimi, si i tillë, merret gjatë seancës dëgjimore të gjykatës, në prani të palëve. Ky vendim i gjykatës është i hapur për ankesë vetëm pasi gjykata të marrë vendim të formës së prerë lidhur me akuzat penale.

126 Madje edhe në këtë rast, sekuestrimi konservativ nuk mund të tërhiqet nëse në fund të gjykimit pasuria e sekuestruar rezulton të ketë qenë mjet apo produkt i veprës penale. Në rast të vendimit fajësues, sekuestrimi konservativ mbetet në fuqi.

Kështu që, sipas nenit 12/b të ligjit AM 92017), gjatë procesit parandalues, me kërkesë të palëve, gjykata mund ta lirojë pasurinë nga sekuestrimi madje edhe para afatit kohor prej 6 muajve të parashikuar në nenin 12 të ligjit. Gjykata madje mund ta tërheqë konfiskimin në një pasuri të caktuar, duke vendosur për sekuestrimin e një pasurie tjetër nëse palët bien dakord.

Ndërsa në procesin penal, ashtu siç parashikohet me nenin 272 të KPP (2017), gjykata mund ta tërheqë sekuestrimin konservativ nëse i pandehuri ofron garanci se do t'i paguajë borxhet e tij përmes hipotekës, paradhënies, dorëzansisë, etj.

3.1.2.4. Procedura e ankesës

Sa i përket shqyrtimit të masave të përkohshme nga një gjykatë më e lartë.

Shqyrtimi i sekuestrimit në procesin penal

Sekuestrimi provues (ose dëshmues) është i hapur për apelim në Gjykatën e Apelit vetëm pasi gjykata të marrë vendim përfundimtar për akuzat penale dhe vetëm në mënyrë kumulative me ankesën e paraqitur kundër vendimit të gjykatës për akuzat penale.

Sekuestrimi i masës së sigurisë

Palët e interesuara mund të bëjnë ankesë në Gjykatën e Apelit kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin parandalues si edhe atë konservativ, ashtu siç parashikohet në nenin 276 të KPP (2017), brenda një periudhe prej 10 ditësh prej marrjes së njoftimit. Gjykata e Apelit e shqyrton ankesën brenda 15 ditëve prej datës së dorëzimit.

Shqyrtimi i sekuestrimit në procesin parandalues

Lidhur me juridiksionin e gjykatës për procedurën parandaluese, duhet të thuhet që sipas nenit 7 të ligjit AM (2017), ai i përket Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe përkatësisht Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKKO), në pajtim me kompetencat e tyre lëndore për veprat penale, ashtu siç përshkruhet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale (2017). Shqyrtimi i vendimit të tyre është nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por, ashtu siç parashikohet me dispozitat kalimtare të ligjit AM (2017, neni 38), ky rregull i re për juridiksionin nuk do të zbatohet deri në kohën kur të krijohet GJKKKO-ja. Deri në këtë kohë, juridiksionin për procedurën parandaluese do ta ketë vetëm Gjykata për Krime të Rënda dhe përkatësisht Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

Sipas nenit 27 të ligjit AM (2017) kundër vendimit të gjykatës për sekuestrim, ose për tërheqjen e tij, mund të bëhet ankesë në Gjykatën e Apelit, në fakt në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, deri sa të krijohet GJKKKO-ja. Afati kohor për ankesë është 15 ditë, i njëjti afat ashtu siç parashikohet në nenin 415 të KPP (2017) për ankesat kundër vendimit të gjykatave të rretheve gjyqësore.

3.1.3. Procedurat e konfiskimit

3.1.3.1. Llojet e procedurave dhe karakteristikat e tyre themelore

Konfiskimi në procesin penal

Ekzistojnë dy lloje të dispozitave për konfiskimin në procesin penal, do të thotë dispozitat e KP-së (2017) për konfiskimin si dënim dhe dispozitat e KPP-së (2017) për procedurën e konfiskimit.

1. Konfiskimi – si dënim.

Duke ju referuar nenit 36 të Kodit Penal (KP) [2017], gjykata mund ta zbatojë konfiskimin, si formë të dënimit plotësues ndaj dënimit kryesor, për tërë pasurinë që rezulton të jetë instrument i krimit, produkt krimi, shpërblim i fituar ose madje shpërblim i premtuar për të kryer krimin në fjalë. Në rast se të ardhurat nga krimi transformohen, tjetërsohen ose përzihen, krejt ose pjesërisht, me pasuri të tjera, konfiskimi – si dënim mund të shtrihet edhe te pasuria që rrjedh nga to. Mund të shtrihet madje edhe te fitimet ose ndonjë e ardhur që është gjeneruar nga pasuri që ka rezultuar të jetë produkt krimi, ose te fitimi i gjeneruar nga pasuria tjetër që ka rezultuar të jetë e përzier me të ardhurat nga krimi, ose në rastet kur të ardhurat nga krimi transformohen ose tjetërsohen. Sidoqoftë, konfiskimi - si dënim zbatohet në pasuri të tilla deri në vlerën e vetë produkteve të krimi.

Në rastet kur i pandehuri vdes gjatë procesit penal, ashtu siç parashikohet në nenin 329/b dhe 387 të KPP (2017), procesi penal mbyllet me vendim të gjykatës. Në rastet të tilla nuk mund të merret vendim konfiskimi – si dënim lidhur me produktet e krimit. Në mënyrë të ngjashme, gjykata nuk mund të nxjerrë ndonjë urdhër për konfiskim në raste të tilla madje edhe nëse pasuria është e sekuestruar (sekuestrimi dëshmues, sekuestrimi parandalues dhe sekuestrimi konservativ)¹²⁷.

2. Procedura e konfiskimit

Në parim, procedura e konfiskimit ndodh në rastet kur është bërë më parë sekuestrimi. Në rastet kur është zbatuar sekuestrimi dëshmues, procedurat e konfiskimit bazohen në nenin 190 të KPP-së (2017). Në raste të tilla, pasuria e sekuestruar konfiskohet në rastet kur del që bëhet fjalë për mjete, produkte krimi, shpërblime apo premtime për shpërblim për kryerjen e krimit, por vetëm me kusht që pronarët e ligjshëm të kësaj pasurie të kenë marrë pjesë në krim. Përndryshe, pasuria e sekuestruar ju kthehet pronarëve të ligjshëm të cilët nuk kanë marrë pjesë në krim, madje edhe nëse rezulton të jetë mjet, produkt krimi, shpërblim apo premtim për shpërblim për kryerjen e krimit.

Pasi që të jetë zbatuar sekuestrimi parandalues, procedurat e konfiskimit bazohen në nenin 275 të KPP (2017). Pasuri konfiskohet nëse, në fund të procesit penal, gjykata, përmes vendimit të formës së prerë, urdhëron konfiskimin – si dënim plotësues ndaj dënimit kryesor të të pandehurit. Përndryshe, pasuria lirohet nga sekuestrimi dhe ju kthehet personave të cilëve ju takon.

Në fund, në rast se është zbatuar sekuestrimi konservativ, procedura e konfiskimit bazohet në nenin 271 të KPP (2017). Në këtë rast, pasuria mbetet nën sekuestro madje edhe kur gjykata merr vendim për hedhjen poshtë të të gjitha akuzave penale, deri në momentin kur vendimi merr formë të prerë. Pasuri mbetet ende në sekuestrim konservativ edhe pasi vendimi fajësues merr formën e prerë, nëse i pandehuri duhet të paguajë gjobë, si dënim kryesor apo plotësues, ose kur i pandehuri ka borxhe financiare ndaj shtetit apo viktimës. Përndryshe gjykata e liron pasurinë nga sekuestrimi, duke ua kthyer personave që ju takon ajo.

Konfiskimi në procesin parandalues

Në procesin parandalues konfiskimi bazohet në ligjin AM (2017), të plotësuar me KPP (2017). Sipas nenit 24 të ligjit AM (2017), gjykata mund të vendosë për konfiskim kur konsideron që janë plotësuar kushtet në vijim:

¹²⁷ Kur i pandehuri vdes, prokurori, gjatë fazës së hetimeve paraprake apo gjykata gjatë fazës së gjykimit, urdhërojnë lirimin nga sekuestrimi duke ua kthyer pasurinë përkatëse pronarëve të vetë. Në KPP ose në KP nuk ka ndonjë dispozitë që bën përjashtim nga ky rregull. Por, në anën tjetër, gjykatës nuk i ndalohet të vendosë konfiskimin – si dënim për një të pandehur në arrati.

- a) Ekziston dyshim i arsyeshëm, duke u bazuar në prova, për pjesëmarrjen e një personi në aktivitete kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji (2017);
- b) Prona është drejtpërdrejt apo tërthorazi në posedim të plotë apo të pjesëshëm të personit të dyshuar, të të afërmeve të tij ose të ndonjë personi fizik apo juridik nën kontrollin e tij.
- c) Kur personi i dyshuar, të afërmit e tij, personat fizikë apo juridikë nën kontrollin e tij, nuk e vërtetojnë që pasuria e tyre ka prejardhje të ligjshme.
- d) Në rastet kur vlera e pasurisë në pronësi të ligjshme të personave të sipërpërmendur vlerësohet të jetë në shpërpjestim substancial me të ardhurat e tyre nga burimet e ligjshme.

Sipas nenit 3 të ligjit AM (2017), gjykata mund ta bëjë sekestrimin ose konfiskimin madje edhe pas vdekjes së personit të dyshuar, të të afërmeve të tij ose të personave fizikë ose juridikë që janë nën kontrollin e personit të dyshuar. Pasuria e tyre mund të konfiskohet nga trashëgimtarët e tyre. Në parim, nuk ekziston ndonjë afat kohor për bërjen e konfiskimit në procedurën parandaluese, përveç konfiskimit të pasurisë së trashëgimtarit, e cila, deri në pesë vjet prej vdekjes së personit nga i cili e trashëgon atë, i nënshtrohet konfiskimit.

Sipas nenit 5 të ligjit AM (2017), gjatë procesit parandalues gjykata mund ta shprehet për konfiskimin, pavarësisht fazës së procesit së mundshëm penal ndaj pronarëve të ligjshëm të pasurisë e cila i nënshtrohet konfiskimit në procesin parandalues. Konfiskimi nuk varet as nga mënyra e përfundimit të procesit të mundshëm penal.

Gjatë procesit parandalues

Siç parashikohet me nenin 22 të ligjit AM (2017), procedura e konfiskimit bazohet në dispozitat e ligjit AM si edhe në ato të KPP për sa është e mundur kjo. Sipas këtij neni, gjykata i mban seancat dëgjimore madje edhe në mungesë të palëve, në rastet kur pasi palët janë njoftuar nuk janë gjetur në adresat e tyre ose kanë ikur jashtë vendit. Në këtë rast gjykata i shpall ata si “të pagjetur” duke u caktuar atyre një avokat *ex officio*, në përjashtim të rasteve kur avokati përcaktohet nga të afërmit e tij.

Në dispozitat e ligjit AM nuk ka shumë hollësi lidhur me procedurat që duhet të respektojë gjykata gjatë gjykimit. Ligji AM parashikon që procedura mund të bazohet në dispozitat e KPP-së por pa i saktësuar llojet e dispozitave¹²⁸.

Gjatë procesit penal

Gjykata urdhëron konfiskimin në fund të seancave dëgjimore për veprat penale. KPP-ja nuk parashikon procedurë të posaçme lidhur me seancat dëgjimore për konfiskimin si veprim i pavarur nga seancat dëgjimore kryesore për akuzat penale. Kjo do të thotë që në procedurën penale, prokurori ia paraqet gjykatës të gjitha provat e rastit gjatë seancës kryesore, pa bërë ndonjë dallim në prezntim ndërmjet provave të lidhura me akuzat penale dhe të atyre të lidhura në mënyrë specifike me konfiskimin.

128 Në praktikë, seancat në gjykatë janë të hapura për publikun dhe në to merr pjesë prokurori, palët e interesuara dhe avokatët e tyre të mundshëm. Seancat dëgjimore fillojnë me paraqitjen e kërkesës për konfiskim nga ana e prokurorit si edhe të provave të mbledhura gjatë hetimeve financiare. Më pas palët bëjnë paraqitjen e tyre të mbrojtjes dhe kërkojnë nga gjykata t'i dëgjojnë provat. Seancat dëgjimore mund të zgjasin deri në tre muaj, por sidoqoftë, jo më gjatë se një vit, ashtu siç parashikohet në nenin 23 të ligjit AM (2017).

3.1.3.2. Të drejtat procedurale të personave të cilëve ju konfiskohen të ardhurat nga krimi

Gjatë procesit parandalues

Duke e analizuar nenin 22 të ligjit AM (2017), si rregull seancat gjyqësore duhet të mbahen në praninë e prokurorit si edhe të palëve të interesuara, do të thotë të njerëzve pasuria e të cilëve ka mundësi t'i nënshtrohet urdhrorit të mundshëm të konfiskimit, personit të dyshuar ose të afërmeve të tij, personave fizikë ose juridikë nën kontrollin e tij¹²⁹.

Ligji AM parashikon që procedura mund të bazohet në dispozitat e KPP-së, pa e saktësuar llojin e dispozitave. Në praktikë, seancat gjyqësore janë të hapura për publikun dhe në to merr pjesë prokurori, palët e interesuara dhe avokatët e tyre të mundshëm. Seancat dëgjimore fillojnë me parashtrimin e prokurorit lidhur me kërkesën për konfiskim si edhe provat e mbledhura gjatë hetimeve të tij financiare. Pastaj palët bëjnë paraqitjen e mbrojtjes së tyre dhe kërkojnë nga gjykata t'i dëgjojë provat përkatëse. Ata mund të kërkojnë nga gjykata të dëgjojë çfarëdo lloj prove që e konsiderojnë të përshtatshme dhe gjykata mund t'i pranojë ose t'i refuzojë ata, ashtu siç parashikohet me dispozitat përkatëse të KPP-së. Palët kanë po ashtu të drejtë të bëjnë pyetje lidhur me çdo provë, duke ua drejtuar pyetjet dëshmitarëve dhe ekspertëve. Palët, madje, kanë të drejtë të japin deklaratë. Por ligji AM nuk është i qartë lidhur me statusin e palëve kur ata bëjnë deklaratë para gjykatës. A mund të konsiderohet si deklaratë e dëshmitarit apo vetëm si deklaratë e "të pandehurit", njësoj si në procedurën penale.

Gjatë procesit penal

Gjykata urdhëron konfiskimin në fund të seancave dëgjimore lidhur me akuzat penale. Sipas dispozitave të KPP-së (2017), si rregull, seancat gjyqësore mbahen në prani të prokurorit dhe të të pandehurit. Por, ashtu siç parashikohet në nenin 352 të KPP (2017), kur i pandehuri, pasi që të jetë njoftuar, nuk gjendet, gjykata e shpall pezullimin e seancën duke urdhëruar policinë ta kërkojë të pandehurin. Pezullimi i seancës mund të zgjasë deri në 1 vjet. Pas kësaj, gjykata urdhëron të fillojë çështjen përsëri, duke e shpallur të pandehurin të arratisur dhe duke caktuar një avokat *ex officio*. Në rastet kur pranon gjykata, viktimat e krimit mund të jetë pjesë e procedurës penale. Në raste të tilla seancat mbahen në praninë e tij, me statusin e paditësit civil. Siç parashikohet në nenin 67 të KPP (2017) viktimën mund ta përfaqësojë përfaqësuesi i tij ligjor ose avokati.

Të pandehurit kanë të drejtë ta paraqesin rastin e tyre, t'i kërkojnë provat e tyre dhe të bëjnë pyetje të tërthorta lidhur me provat e paraqitura nga prokurori.

Dispozitat e KPP-së nuk e e konceptojnë procesin si seancë të posaçme gjyqësore ose si një veprim të pavarur nga seancat kryesore për akuzat penale. Kjo do të thotë që në një proces penal prokurori ia paraqet gjykatës të gjitha provat e çështjes gjatë seancës kryesore, pa bërë ndonjë dallim gjatë seancës kryesore ndërmjet provave lidhur me akuzat penale dhe të atyre që kanë të bëjnë në mënyrë specifike me konfiskimin.

129 Gjykata mund t'i mbajë seancat edhe në mungesë të palëve të interesuara, në rastet kur ato nuk mund të gjenden në adresat e tyre, ose kur kanë ikur jashtë vendit, pasi janë njoftuar. Në këtë rast, gjykata i shpall ata si "të pagjetur" duke e caktuar një avokat *ex officio*, ose pranon caktimin e një avokati të marrë nga të afërmit e tyre.

3.1.3.3. Vendimet për konfiskim

Në procesin penal

Në parim, urdhrin për konfiskim gjatë procesit penal e nxjerr gjykata në rast se pasuria është pjesë e ndonjërit prej sekuestrimeve, d.m.th. sekuestrim dëshmues, sekuestrim parandalues ose sekuestrim konservativ. Në rastet e tilla, sipas dispozitave përkatëse të KPP-së (2017), nenit 190 (konfiskimi i pasurisë në sekuestrim dëshmues ose sekuestrim parandalues), nenit 273 (konfiskimi i pasurisë në sekuestrim konservativ) gjykata mund ta nxjerrë një urdhër konfiskimi *ex officio* pa pasur nevojë për ndonjë kërkesë për konfiskim nga ana e prokurorit.

Gjykata nxjerr të njëjtin urdhër *ex officio* për konfiskim, kur në fund të procesit penal, mendon ta dënojë të pandehurin me dënim konfiskues, ashtu siç parashikohet në nenin 36 të KP (2017). Në këtë rast dënimi konfiskues përfshin jo vetëm pasurinë që është nën urdhrin e mëparshëm të sekuestrimit, por madje edhe pasuri të tjera me prejardhje të ligjshme, në rast se pasuria që i nënshtrohet sekuestrimit mungon, transformohet, tejtrësohet ose përzihet me pasurinë me prejardhje të ligjshme.

Në procesin parandalues

Si rregull, siç parashikohet në nenin 21 të ligjit AM (2017), gjykata mund të vendosë masën e konfiskimit gjatë procesit penal vetëm me kërkesë të prokurorit.

Por ekziston një përjashtim nga ky rregull. Siç parashikohet në nenin 12 të ligjit AM (2017), jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sekuestrimit 6 mujor, gjykata duhet ta caktojë një seancë të posaçme, në prani të prokurorit dhe të palëve të interesuara. Në rastin kur në fund të kësaj seance të posaçme dëgjimore prokurori kërkon të bëhet tërheqja e sekuestrimit, gjykata ka të drejtë të marrë vendim për konfiskim, *ex officio*, pa pasur nevojë të ketë kërkesë për konfiskim nga ana e prokurorit.

KPP-ja si edhe ligji AM nuk i japin shumë rëndësi formës së vendimit për konfiskim¹³⁰.

3.1.3.4. Procedura e ankesës

Në procesin penal

Urdhri për konfiskim i gjykatës gjatë procesit penal është i hapur për apelim në Gjykatën e Apelit që ka juridiksion territorial mbi atë gjykatë. Ankesa kundër urdhrin të gjykatës për konfiskim nuk paraqitet si pjesë e ndarë e ankesës por vetëm në kuadër të së njëjtës ankese kundër vendimit të gjykatës lidhur me akuzat penale. E drejta e ankesës i takon prokurorit, siç parashikohet në nenin 408 të KPP (2017), viktimave të krimit, neni 409 i KPP (2017), të pandehurit, neni 410 i KPP (2017) dhe palëve civile, neni 411 i KPP (2017). Ankesa duhet të paraqitet me shkrim brenda 15 ditëve nga njoftimi për vendimin e gjykatës, ashtu siç parashikohet në nenin 415 të KPP-së (2017).

Sipas nenit 417 të KPP-së (2017), ankesat kanë ndikim pezullues mbi të gjitha palët e vendimit gjyqësor dhe, për pasojë, edhe mbi urdhrin e gjykatës për konfiskim të përfshirë në vendimin e gjykatës.

¹³⁰ Në ligj nuk ka ndonjë dispozitë të posaçme në të cilën vendimet e gjykatës parashikohen në elementet siç janë pjesa operative, lloji i të ardhurave, vlera e tyre, etj. Por elementet e tilla formale të vendimit, edhe pse nuk janë të pranishme në ligj, zhvillohen nga gjykata gjatë praktikës së tyre.

Në procesin parandalues

Ankesa ndaj urdhrimit të gjykatës për konfiskim në procesin parandalues bëhet sipas nenit 27 të ligjit AM (2017). Rregullat formale, si edhe kushtet e ankesës të parashikuara me KPP, vlejnjë njëjloj. Duhet vënë re që ankesa kundër urdhrimit të gjykatës për konfiskim në procesin penal nuk ka ndikim pezullues mbi urdhrin e gjykatës për konfiskim. Në anën tjetër, në rast të ndonjë ankese nga prokurori kundër urdhrave të gjykatës për tërheqjen e sekuestrimit, ose të vendimit të gjykatës për refuzimin e konfiskimit, këto urdhra të gjykatës nuk hyjnë në fuqi deri sa Gjykata e Apelit të marrë vendim të formës së prerë.

3.1.3.5. Njoftimi i Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë dhe i personave të tjerë

Procedurat për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për konfiskim fillojnë menjëherë pas shpalljes së tij, ashtu siç parashikohet në nenin 28 të ligjit AM (2017). Gjatë fazës së ekzekutimit, gjykata nxjerr urdhra, në Dhomën e Këshillit, të cilat ua drejtohen aktorëve përkatës që marrin pjesë në procesin e ekzekutimit, duke përcaktuar veprimet që duhet të kryejnë ose masat e posaçme që duhet të ndërmerren, me afate të sakta kohore dhe mënyrën për kryerjen e detyrave të caktuara. Njëkohësisht, njoftohet edhe prokurori përgjegjës për zbatimin e vendimeve të gjykatës lidhur me vendimin për konfiskim dhe urdhrat e gjykatës.

Siç parashikohet në nenin 29 të ligjit AM (2017), pasi vendimi i gjykatës për konfiskim të marrë formë të prerë, ai i dërgohet menjëherë Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë (AMP). Brenda periudhës prej 90 ditëve AMP-ja i dorëzon një raport Ministrisë së Financave lidhur me vlerësimin teknik dhe financiar të secilës pasuri të konfiskuar.

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pasurisë së patundshme caktohen me urdhër të Ministrisë së Financave, e cila jep udhëzime lidhur me përdorimin e tyre, brenda një afati prej 30 ditëve. Ndërsa, AMP-ja, përmes administratorit të caktuar, është përgjegjëse për shfrytëzimin e pasurisë së patundshme sipas kriterëve të caktuara në nenin 32 të ligjit AM (2017).¹³¹

3.1.4. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatës lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprave penale

3.1.4.1. Procedurat për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprave penale

Lidhur me ekzekutimin e ngrirjes së transaksioneve financiare

Ngrirja bëhet nga NJIF-i, siç parashikohet me Ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit” (2008), i ndryshuar. Sipas nenit 22, NJIF-i është përgjegjëse për nxjerrjen e urdhrimit për ngrirje ose bllokim të veprimeve apo të transaksioneve të caktuara financiare, në rast se e konsideron të domosdoshme të ndërmarrë disa veprime verifikuese për natyrën e vërtetë të transaksioneve. Transaksioni i tyre bëhet përmes urdhrimit të drejtpërdrejtë drejtuar institucioneve përkatëse financiare, prokurorit ose gjykatës, pa i njoftuar palët në transaksion lidhur me këtë. Afati kohor i këtij lloji të “ngrirjes” është vetëm deri në 72 orë, i lëshuar pa ndonjë urdhër paraprak të gjykatës. Palët në transaksion nuk kanë të drejtë të ankohen në gjykatë kundër ngrirjes së këtij lloji.

131 Mund të thuhet që ligji AM nuk i përshkruan në hollësi procedurat e njoftimit të gjykatës për prokurorët ose aktorët e tjerë që marrin pjesë në procedurat e ekzekutimit, duke i parashikuar procedurat e tilla në mënyrë shumë të thjeshtësuar.

Lidhur me ekzekutimin e ngrirjes së pasurisë së terroristëve

Siç parashikohet me Ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit ” (2013), i ndryshuar me Ligjin (2017), Ministria e Financave ka të drejtë të urdhërojë bllokim të përkohshëm dhe sekuestrim të pasurisë që i takon njerëzve, të cilët sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, janë të regjistruar në listën e njerëzve të shpallur si terroristë nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të KB.

Siç parashikohet në nenin 16 të Ligjit (2013), urdhrin e përkohshëm për bllokim nxirret nga Ministria e Financave dhe ekzekutohet menjëherë pas lëshimit, pa ndonjë paralajmërim të palëve të interesuara. Urdhri u komunikohet për ekzekutim menjëherë organeve përkatëse shtetërore si:

- a) Bankës Kombëtare të Shqipërisë ose Autoritetit Mbikëqyrës Financiar në emër të institucioneve financiare të licencuara nga to ose në juridiksionin e tyre.
- b) Ministrisë së Drejtësisë, në emër të Agjencisë Kombëtare për Regjistrimin e Pasurisë së Patundshme,
- c) Cilëndo ministrie në emër të agjencive shtetërore të licencuara nga to, ose të cilat i mbajnë fondet e Regjistrave ose të Regjistrave pronësorë në juridiksionin e tyre,

Siç parashikohet në nenin 16 të Ligjit (2013), palët e interesuara kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në Gjykatën Administrative brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së informacionit lidhur me urdhrin. Ankesa shqyrtohet nga gjykata brenda 10 ditësh prej dorëzimit të saj. Ankesa nuk ka ndikim pezullues mbi urdhrin e përkohshëm për bllokim.

Siç parashikohet në nenin 22 të Ligjit (2013), Ministria e Financave ka të drejtë të nxjerrë urdhër sekuestrimi, pasi qeveria të marrë vendim për regjistrimin e personit në listën e terroristëve, duke u bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kjo masë është e përhershme deri në një vendim tjetër të mundshëm të Këshillit të Ministrave për çrregjistrimin e tyre nga lista e terroristëve, gjithmonë duke u bazuar në një rezolutë tjetër të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Urdhri për sekuestrim i Ministrisë së Financave i përcillet menjëherë për ekzekutim Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë (AMP), si edhe subjekteve përkatëse shtetërore apo private, të cilat administrojnë apo zotërojnë një pasuri të tillë. Urdhri për sekuestrim i komunikohet në të njëjtën kohë madje edhe palës së interesuar, e cila ka të drejtë të ushtrojë ankesë në Gjykatën Administrative, sipas Kodit Administrativ Procedural. Sekuestrimi mbetet në fuqi deri sa gjykata të marrë vendim të formës së prerë.

Lidhur me ekzekutimin e sekuestrimit në procesin parandalues

Siç parashikohet në nenin 14 të ligjit AM (2017), procesi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës për sekuestrim në procedurë parandaluese fillon menjëherë pas shpalljes së tij nga gjykata.

Gjykata ia dorëzon vendimin për sekuestrim prokurorit, i cili është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme, përmes oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratorit të pasurisë. Prokurori e fillon formalisht procesin e ekzekutimit përmes një kërkesë të quajtur “urdhër ekzekutimi” që i drejtohet oficerit të policisë gjyqësore (OPGJ). OPGJ-të i respektojnë masat e nevojshme që duhet të merren për ekzekutim, të cilat i përcakton prokurori në urdhrin e tij për ekzekutim.

Siç parashikohet në nenin 14 të ligjit AM (2017), procedura e ekzekutimit të vendimit të gjykatës për sekuestrim zhvillohet si në vijim:

- a) për pasurinë e tundshme dhe atë monetare, në zotërim të palëve të treta apo të huamarrësve, përmes procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile;

- b) për pasurinë tjetër të tundshme apo të patundshme, përmes dorëzimit të deponimit të vendimit të gjykatës në agjencinë përkatëse shtetërore përgjegjëse për regjistrimin e tyre;
- c) për pasurinë në zotërim të kompanive tregtare, përveç procedurave të mësipërme, përmes regjistrimit të vendimit në Regjistrin e Kompanive Tregtare;
- d) për aksionet, përmes publikimit të vendimit për sekuestrim në Regjistrin e Kompanive Tregtare dhe në Regjistrat e Kontabilitetit të asaj kompanie tregtare.

Oficeri i policisë gjyqësore i njofton palët e interesuara lidhur me vendimin për sekuestrimin e pasurisë dhe merr masa për dorëzimin e tërë pasurisë së sekuestruar tek administratori i caktuar.

Në rast se pasuria është pronë pa titull pronësie ose në rastet kur titulli daton para datës së vendimit për sekuestrim dhe personi që e zotëron atë nuk pranon ta dorëzojë pasurinë vullnetarisht, OPGJ-ja njofton gjykatën, e cila e lëshon një urdhër për dorëzimin e pasurisë. Urdhri e gjykatës e ekzekuton OPGJ-ja.

Inventarizimi i pasurisë regjistrohet nga OPGJ-ja gjatë dorëzimit tek administratori i caktuar. Raportin e nënshkruajnë personat e pranishëm në procedurë. Pasuria e sekuestruar, së bashku me dokumentet përkatëse ligjore, i dorëzohet administratorit.

Lidhur me ekzekutimin e konfiskimit në procesin parandalues

Procedurat për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për konfiskim fillojnë menjëherë pas shpalljes së vendimit, ashtu siç parashikohet në nenin 28 të ligjit AM (2017). Gjatë fazës së ekzekutimit, gjykata i dorëzon urdhrat të cilat u drejtohen aktorëve përkatës që marrin pjesë në procesin e ekzekutimit në Dhomën e Këshillit, duke caktuar veprimet që do të ndërmarrin apo masa e posaçme, me afate dhe mënyra specifike kohore për t'i kryer detyrat e caktuara. Në të njëjtën kohë, prokurori përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës njoftohet lidhur me vendimin për konfiskim dhe urdhrat e gjykatës.

Siç parashikohet në nenin 29 të ligjit AM (2017), pasi vendimi i gjykatës për konfiskim të marrë formë të prerë, ai i komunikohet menjëherë Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë (AMP). Brenda afatit prej 90 ditëve, AMP-ia i dorëzon Ministrisë së Financave një raport lidhur me vlerësimin teknik dhe financiar mbi secilën pasuri të konfiskuar.

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pasurisë së patundshme caktohen me anë të urdhrat të Ministrisë së Financave, i cili jep udhëzime lidhur me shfrytëzimin e tyre, brenda afatit prej 30 ditëve. Ndërsa AMP është përgjegjëse për shfrytëzimin e pasurisë së patundshme, përmes administratorit të caktuar, sipas kriterëve të caktuara në nenin 32 të ligjit AM (2017).

Mund të thuhet që ligjit antimafia nuk i përshkruan në hollësi procedurat e njoftimit të gjykatës për prokurorin ose për aktorët e tjerë që marrin pjesë në procedurat e ekzekutimit, duke i parashikuar këto procedura në mënyrë shumë të thjeshtë.

Në parim, sipas nenit 12 të Ligjit 8331, datës 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Penale" (2008), i ndryshuar, si edhe nenit 463 të KPP (2017), prokurori është përgjegjës për ekzekutimin e të gjitha vendimeve dhe urdhrave të gjykatës në procesin penal, përfshirë urdhrat e gjykatës për sekuestrim dhe konfiskim¹³².

132 Kjo përgjegjësi e prokurorit fillon menjëherë pas vendimit të gjykatës në rast sekuestrimi. Ndërsa në rastin e vendimit të gjykatës për konfiskim, përgjegjësia e prokurorit për ekzekutim fillon vetëm pasi vendimi i gjykatës të marrë formën e prerë, domethënë pas përfundimit të afatit të ankesës ose pasi gjykata më e lartë të marrë vendim të formës së prerë lidhur me ankesat e kundër vendimit fajësues. Procesi i ekzekutimit fillon kur prokurori nxjerr të ashtuquajturin "urdhër ekzekutimi", për të cilin njoftohet avokati i të pandehurit si edhe gjykata.

Sidoqoftë, prokurori pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor ka detyrimin për ekzekutim, madje edhe nëse çështjen e shqyrton Gjykata e Lartë, ashtu siç parashikohet me nenin 463 të KPP-së (2017).

Lidhur me ekzekutimin e sekuestrimit në procesin penal

Sekuestrimin në procesin penal e urdhërojnë si prokurori ashtu edhe gjykata, ashtu siç parashikohet në nenin 208 të KPP-së (2017) (sekuestrimi dëshmues), si edhe vetëm gjykata, siç parashikohet në nenin 270 dhe 274 të KPP (2017) (sekuestrimi konservativ dhe sekuestrimi parandalues).

Në rastet kur sekuestrimin dëshmues e urdhëron prokurori, gjatë hetimit paraprak, urdhëri i drejtohet oficerit të policisë gjyqësore për ekzekutim. Palët që kanë interes, kurdo që informohen lidhur me sekuestrimin, mund të bëjnë ankesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor. Çështja gjykohet brenda afatit prej 10 ditësh, siç parashikohet me nenin 212 të KPP-së (2017). Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit brenda 5 ditëve, ndërsa ajo duhet të vendosë lidhur me të brenda afatit prej jo më shumë se 10 ditësh. Ankesa dhe apelimi nuk kanë efekte pezulluese mbi ekzekutimin e sekuestrimit.

Në rastet kur gjykata urdhëron sekuestrimin dëshmues, d.m.th. gjatë gjykimit të akuzave penale, gjykata ia drejton urdhrin OPGJ-ve për ta zbatuar atë. Në këtë rast, palët me interes mund të ankohen kundër urdhrin të gjykatës për sekuestrim vetëm pasi që të përfundojë gjykimi dhe vetëm nëse është ushtruar ankesë kundër vendimit të gjykatës lidhur me akuzat penale.

Në rastet kur gjykata vendos për sekuestrimin si masë sigurimi (sekuestrimi parandalues ose sekuestrimi konservativ), procesi i ekzekutimit fillon menjëherë. Çfarëdo ankese e mundshme kundër vendimit të gjykatës për sekuestrim nga ana e palëve të interesuara nuk ka ndikim pezullues mbi procedurën e ekzekutimit. Procedurat e ekzekutimit fillojnë kur prokurori nxjerr “urdhër e ekzekutimit” të cilin ia drejton Zyrës së Përmbarrimit Shtetëror. Zyra e Përmbarrimit Shtetëror e mbështet procedurën e ekzekutimit në dipozitat e Kodit të Procedurës Penale, siç parashikohet me nenin 271 të KPP (2017).

Lidhur me ekzekutimin e konfiskimit në procesin penal

Konfiskimet që urdhërohen nga gjykata gjatë procesit penal janë si vijon:

- a) konfiskimi - dënim dhe
- b) konfiskimi i pasurisë së sekuestruar (sekuestrimi dëshmues, sekuestrimi parandalues ose sekuestrimi konservativ)

Të dyja konfiskimet i urdhëron gjykata në fund të gjykimit, përmes vendimit të formës së prerë lidhur me akuzat penale. Si pjesë e vendimit të gjykatës, përgjegjësinë për ekzekutimin e tyre e mban prokurori, ashtu siç parashikohet në nenin 12 të sipërpërmendur të Ligjit 8331, datës 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Penale” (1998). Sidoqoftë, procesi i ekzekutimit fillon me “urdhrin e ekzekutimit” të prokurorit. Ky urdhër nxirret menjëherë pasi vendimi fajësues të marrë formë të prerë, domethënë pas skadimit të afatit të ankesës ose pasi Gjykata e Lartë të ketë marrë vendim të formës së prerë lidhur me ankesat e mundshme kundër vendimit fajësues, ashtu siç parashikohet në nenin 34 të Ligjit 8331, datës 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimit të gjykatave penale” (1998). Urdhri i prokurorit për ekzekutim i drejtohet Agjencisë së Rezervave Shtetërore, përmes Zyrës së Përmbarrimit Shtetëror, lidhur me vendin ku gjendet pasuria, ashtu siç parashikohet në nenin 17 dhe 40 të Ligjit 8331, datë 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimit të gjykatës penale” (1998). Agjencia Shtetërore e Rezervave është autoriteti kompetent përgjegjës për administrimin e pasurisë së konfiskuar, ashtu siç parashikohet në Ligjin Nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për Rezervat Shtetërore” (2008).

Nga ana e saj, Zyra e Përmbartimit Shtetëror i mbështet veprimet e veta të ekzekutimit në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve civile.

Gjatë procesit penal mund të konfiskohen të ardhurat nga krimi, duke u bazuar në KPP, kur vendimi fajësues i gjykatës merr formë të prerë. Konfiskime e tilla janë:

- 1) Konfiksimi – dënimi
- 2) Konfiskimi i një pasurie në sekuestrim dëshmues ose sekuestrim parandalues.

Të ardhurat nga krimi mund të konfiskohen po ashtu gjatë procesit parandalues, duke u bazuar në ligjin antimafia, siç u sqarua më sipër.

Në ligj nuk ka procedura të qarta lidhur me ekzekutimin vullnetar të urdhrave të gjykatës për konfiskim ose në rast mospajtimi.

3.1.4.2. Mbrojtja e të drejtave të palëve të treta

Procedura e ekzekutimit të urdhrave të gjykatës për konfiskim, të nxjerrë gjatë procesit penal ose procesit parandalues fillon me urdhrin e prokurorit dhe zbatohet përmes veprimeve të Zyrës së Përmbartimit Shtetëror, në bazë të Kodit të Procedurës Civile (2017). Nga ana tjetër, neni 609-614 i Kodit të Procedurës Civile (2017), ju ofron palëve të treta garanci të mjaftueshme gjatë procedurave ekzekutuese të përmbartimit si lidhur me të drejtën për të ndërhyrë në proces, aksesin në gjykatë kundër veprimeve të përmbartuesit, etj.

3.2. BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Për shkak të rregullimit kompleks kushtetues dhe juridik, që implikon ekzistencën e katër sistemeve të drejtësisë penale në Bosnje dhe Hercegovinë, në nivel shtetëror të BH-së ekzistojnë vetëm ligje sistemike, Kodi Penal (KP) dhe Kodi i Procedurës Penale (KPP), që rregullojnë këtë fushë (me shtimin e legjislacionit zbatues), ndërsa legjislacioni i entitetit të Distriktit të Bërçkos (DB) karakterizohet nga ekzistenca e njëkohshme e këtyre ligjeve sistemike, por edhe specifike që rregullojnë sekuestrimin e produkteve të veprave penale. Raporti i tyre nga pikëpamja e *ratione legis* (thënë shkurt) mund të përcaktohet si avantazh i ligjit të posaçëm, dhe të miratuar më vonë, ndaj rregullave të përgjithshme të miratuara më parë.

3.2.1. Hetimet financiare

3.2.1.1. Fillimi i hetimeve financiare

Hetimet financiare si instrument i veçantë hetimor i dedikuar për zbulimin, monitorimin dhe identifikimin e produkteve të krimeve, janë të rregulluara me ligj në masë të ndryshme. Në nivelin e BH-së, në kuadër të KPP-së, hetimet financiare nuk përkufizohen saktësisht me ligj dhe se as nuk janë rregulluara kushtet e as mënyra e zhvillimit të tyre. Mund të thuhet se vlejnë dispozitat e KP-së të BH-së (2018), sipas të cilave nuk mund të mbahen përfitimet pasurore të fituara me vepër penale (neni 110), dhe se është e drejtë e prokurorit në cilësinë *dominus litis* t'i konstatojë faktet e nevojshme për të nxjerrë vendimin për konfiskimin e produkteve të veprave penale (neni 35. paragrafi 2. pika g.).

Në nivelin entiteti, ekzistojnë dispozita të ngjashme në KPP-në e FBH-së (2014, neni 45, paragrafi 2. pika g), KPP DB (2014, neni 35. paragrafi 2. pika g.), ndërsa KKP-ja e Republikës Serbe (RS) e përcakton specifikisht këtë detyrim në dispozitën që rregullon të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme të prokurorit (2018, neni 43).

Ligji për Konfiskimin e Përfitimit Pronësor të Fituar me Vepër Penale (2014) në FBH, me dispozitat e neneve 8 dhe 9 parashikohen në detaje hetimet financiare dhe, sipas dispozitës së nenit 3 të këtij Ligji përcaktohet se ai zbatohet si *lex specialis* në raport me KPP-në dhe KP-në e FBH-së duke patur epërsi mbi to dhe dispozitat e tjera që e rregullojnë këtë çështje, në kuadër të proceseve të konfiskimit të produkteve të veprave penale të parashikuara në KP-në e FBH-së, për të cilat parashikohet dënimi me tre ose më shumë vite.

Në Republikën Serbska (RS) është në fuqi Ligji "Për konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Kryerjen e Veprës Penale" i vitit (2018), i cili me dispozitat e neneve 9-14 e përcakton në detaje hetimin financiar. Ky Ligj, në bazë të dispozitave të nenit 2 dhe nenit 3 paragrafi 4, në raport me Kodin Penal (KP) dhe Kodin e Procedurës Penale (KPP) zbatohet si *lex specialis* në procedurat për konfiskimin e pasurisë që buron nga veprat penale të listuara dhe të parashikuara në KPRS (2017), respektivisht në rastet kur kemi të bëjmë me produktet apo të ardhurat e veprave penale që kanë vlerë më të madhe se sa 50.000 KM (marka konvertibile), pavarësisht nëse përfitimi pasuror ka ardhur si rezultat i veprave penale të parashikuara nga KPRS-ja (2017), ligjet e tjera dhe madje edhe ligjet q nuk janë më në fuqi.

Në Distriktin e Bërçkos, ligji i veçantë për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale (2016), e rregullon hetimin financiar në dispozitat e neneve 8 dhe 9. Në bazë të dispozitës së nenit 4 të këtij ligji, në raport me KPP dhe KP të Distriktit Bërçko si dhe rregullave të tjera të cilat e rregullojnë këtë materie, ky ligj aplikohet si *lex specialis*, në kuadër të procedurave të konfiskimit të përfitimeve materiale të fituara me vepra penale të përcaktuara me Kodin Penal, ku parashikohet dënimi minimal me tre vjet.

Në nivelin e BH-së, veprimet e prokurorit për konstatimin e fakteve të nevojshme për të vendosur lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore, ndërmerren në kuadër të veprimeve të zbulimit dhe ndjekjes së autorit të veprave penale që janë në kompetencë të Gjykatës së BH-së (2018, neni 35). Dobia pasurore konstatohet sipas detyrës zyrtare, ndërsa prokurori ka për të detyrë që gjatë procedurës penale të mbledhë dëshmi dhe të shqyrtojë rrethanat që janë me rëndësi për konstatimin e dobisë pasurore. Dispozita krejt të ngjashme ekzistojnë edhe në ligjet e etniteteve, më specifiku në KPP-në e FBH-së (2014, neni 413), KPPRS (2018, neni 386 paragrafi 2), dhe KPP-në e Distriktit Bërçko (2014, neni 392 paragrafi 2).

Në Federatën e BH-së, ligji i veçantë (2014) parashikon që prokurori mund të nxjerrë urdhër për hetime financiare, nëse është e nevojshme për konstatimin e gjithanshëm të origjinës së vërtetë për vlerën dhe strukturën e dobisë pasurore së fituar me vepër penale (pra, nuk është e detyrueshme forma e veprimeve hetimore). Si kusht, për ndërmarrjen e këtij veprimi, neni 8. 1. i Ligjit (2014) përcakton bazën e dyshimit që është kryer vepra penale (sipas KP FBH), për të cilën mund të caktohet dënimi prej 3 apo më shumë vitesh.

Në Republikën Serbska, si kusht për realizimin e hetimeve financiare është prania e bazës së dyshimit se pronara e pronarit të pasurisë e ka vënë pasurinë nga produktet e veprave penale (2018, neni 9 paragrafi 1).

Ligji i veçantë, në Distriktin e Bërçkos (2016), në dispozitën e nenit 8 paragrafi 1, përcakton po ashtu ekzistencën e bazës së dyshimit. Ligjdhënësi përdor shprehjen "Pasuri e fituar në mënyrë jo të ligjshme".

Në kuadër të dispozitave sistematike, zbatimi i masave dhe veprimeve lidhur me hetimet financiare (edhe pse ligjdhënësi nuk i njeh si të tilla në dispozitat e KPP-së), mund të urdhërohen në kuadër të urdhërit të hetimit (KPP BH, 2018, neni 2016; KPP FBH, 2014, neni 231; KPP RS, 2018, neni 224; KPP Distrikti Bërçko, 2014, neni 2016).

Në Federatën e BH-së, përcaktohet me ligj të veçantë urdhër për zbatimin e hetimeve financiare (2014 neni 8 paragrafi 1), ashtu si edhe në ligjet e posaçm në Republikës Serbe (2018, neni 11) paragrafi 1), dhe Distriktin Bërçko (2016 neni 8 paragrafi 1).

3.2.1.2. Qëllimet e hetimit financiar

Dispozitat sistematike në kuadër të katër ligjeve të procedurës penale nuk i përkufizojnë qëllimet e hetimeve financiare.

Në Federatën e BH-së ligji i veçantë i përkufizon hetimet financiare si: gjithë përfshirjen e origjinës reale, vlerën dhe strukturën e dobisë pasurore nga vepra penale (2014, neni 8 paragrafi 1).

Në Republikën Serbska dispozita e nenit 9 paragrafi 2 përcaktohen që hetimi financiar ka për qëllim të mbledhë të dhëna për pasurinë dhe të ardhurat ligjore të fituara nga pronari, për mënyrën dhe shpenzimet e jetesës së pronarit të pasurisë, pastaj mbledhja e të dhënave për pasurinë e trashëguar si trashëgimtar i ligjshëm, respektivisht dëshmi për pasurinë dhe kompensimin për të cilin pasuria transferohet te personi i tretë.

Dispozita e nenit 8 paragrafi 1 i Ligjit të veçantë të Distriktit Bërçko (2016) parashikon se hetimi financiar ka për qëllim përkufizimin gjithëpërfshirës të origjinës reale, vlerën dhe strukturën e dobisë pasurore nga vepra penale.

Kur është fjala për çeljen e hetimeve financiare në raporte normale, në procedurën për zgjerimin e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale duhet theksuar se kjo nuk është vetëm çështje formale e vëllimit të aplikimit të ligjeve të veçanta ndaj ligjeve sistemike (të cilat madje në nivelin e BH-së, FBH-së dhe Distriktit të Bërçkos përmbajnë dispozita për konfiskimin e zgjeruar) dhe se edhe çështje *questionstio facti* respektivisht vlerësimi i prokurorit lidhur me drejtimin e hetimit financiar (konfiskimi i dobisë pasurore nga vepra penale e veçantë ose veprimtaria e plotë kriminale sipas kushteve të përcaktuara me ligj) domethënë shuma dhe lloji i provave që do të mblidhen për këto qëllime.

3.2.1.3. Specifikat e zbatimit të hetimit financiar

Në përputhje me dispozitat e KPP-së (BH, 2018, neni 219, FBH, 2014, neni 234, RS, 2018, neni 227 dhe neni 219 2014 i Distrikti Bërçko), mundësohet aplikimi i veprimeve të përgjithshme të hetimeve (policia dhe zyrtarë të tjerë) me qëllim mbledhjen e të dhënave dhe dëshmimeve të veprës penale nga e cila është nxjerrë përfitimi pasuror. Sigurisht që, gjithsesi, duhet të përmenden edhe dispozitat e ligjit të veçantë të policisë (kryesisht ligjet për zyrtarët policor, por edhe për punët e brendshme, si dhe ligjet që përcaktojnë kompetencat e organeve të caktuara për zbatimin e ligjit) që autorizojnë ndërmarrjen e veprimeve të caktuara operative në këtë drejtim.

Ligjet procedurale në fushën e provave njohin një specifikë, me qëllim të kryerjes së hetimeve financiare për një operacion të caktuar, në lidhje me ato të dhëna që kanë të bëjnë me depozitat bankare dhe transaksionet e tjera financiare dhe punët e personave për të cilët ka bazë dyshimi se kanë kryer veprën penale lidhur me dobinë pasurore, por edhe të personave për të cilët besohet se janë përfshirë në transaksione të tilla financiare ose biznesin e të dyshuarit. Këto të dhëna në përgjithësi merren në bazë të vendimit të gjykatës në bazë të kërkesës të prokurorit, me kusht që të jetë e pritshme që të këto të dhëna të mund të përdoren si dëshmi në procedurën penale (KPP BH, 2018, neni 72, paragrafi 2, KPP FBH, 2014, neni 86, paragrafi 1, KPP, 2018, neni 136, paragrafi 1, KPP QB, 2014, neni 72, paragrafi 1).

Është e rëndësishme të theksohet se në të njëjtin vend ligji mundëson përdorimin e veprimeve të posaçme hetimore për të përcaktuar dhe gjetur pronën e fituar në mënyrë të paligjshme dhe për të mbledhur prova për te. Mund të vërehet se në këtë vend, ligjdhënësi, në vend të shprehjes “dobisë pasurore” përdor shprehjen “pasuri e fituar në mënyrë jo të ligjshme”, dhe me të tregohet në fakt se në këtë mënyrë mund të mblidhen të dhëna edhe në kuadër të hetimeve financiare për konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Kur është fjala për dispozitat e veçanta, ato, sipas ligjit, përmbajnë dispozita udhëzuese në lidhje me kompetencat dhe veprimet e mbledhjes së të dhënave dhe dëshmimeve në kuadër të hetimeve financiare. Ashtu si, për shembull, në ligjin e posaçëm të FBH-së (2014), dispozita e neni 8, paragrafi 2, udhëzon drejt zbatimit të dispozitave gjegjëse të KPP-së së FBH-së, që rregullon kushtet dhe mënyrat e zbatimit të veprimeve gjegjëse të cilat e përmbajnë hetimin financiar sipas qëllimit dhe përmbajtjes së tyre. Me këtë është lënë hapësirë mjaft e gjerë për zbatimin e të gjitha veprimeve të rregullta dhe, siç u tha më herët, edhe të veprimeve të posaçme të parashikuara nga KPP-ja e FBH-së. Dhe jo vetëm lidhur me përcaktimin e përfitimit pronësor nga vepra penale konkrete, por nga i tërë veprimi kriminal i të dyshuarve dhe personave lidhur me ta.

E njëjta dispozita është parashikuar edhe në ligjin e veçantë në Distriktin e Bërçkos (2016.).

Në Republikën Serbska, ligji i veçantë, në rradhë të parë parashikon se dëshmitë e mbledhura në procesin penal (dëshmitë të mbledhura në zbatim të KPP-së së RS-së), mund të shfrytëzohen në procesin e konfiskimit të pasurisë, që do të thotë në kuadër të konfiskimit të zgjeruar (2018, neni

3, paragrafi 2). Në vazhdim, ligji e autorizon njësinë përgjegjëse, e cila mund të veprojë në bazë të kërkesës së prokurorit publik apo *ex officio*, por edhe nën mbikëqyrjen e prokurorit publik (2018, neni 11. Paragrafi 3). Nëse mbledhja e të dhënave behët ekskluzivisht në kuadër të procedurës së konfiskimit të pasurisë, që do të thotë që nëse këto të dhëna nuk janë mbledhur më herët në procesin penal, Ligji (2018) jep mundësinë e ndërmarrjeve të disa veprimeve dëshmuese siç janë: kontrolli i banesës dhe hapësirave të tjera si dhe objekteve/pronave të lëvizshme të pronarit apo personave të tjerë nga neni 12; konfiskim i përkohshëm i lëndëve që mund të shërbejnë si dëshmi në proces nga neni 13; marrja e të dhënave nga bankat dhe organizime të tjera financiare lidhur me gjendjen e llogarive të biznesit dhe financiare si dhe kasafortave të pronarit të pasurisë e gjithashtu edhe qasje në përmbajtje të kasafortave, nga neni 14.

Në kushtet e sistemit të ndërlikuar të rregullimit kushtetues juridik të BH-së, dhe me decentralizimin e shquar, është jo falënderuese të prezantohet modalitet e zbatimit të hetimeve financiare nga ana e prokurorive kompetente, në kuptimin e nxjerrjes së përgjigjeve të sakta për mënyrën si si prokurorët i mbledhin të dhënat, informacionet dhe dëshmitë e nevojshme për përcaktimin e përfitimit pronësor të fituar me vepër penale.

Për këtë arsye, pyetja thelbësore është se cilat të dhënat dhe informacione i përmbajnë saktë regjistrat publik si dhe evidenca të tjera, se si u qasemi nga aspekti juridik dhe teknik atyre, a ekzistojnë kufizime gjegjëse dhe cilat janë mënyrat e drejtpërdrejta dhe/apo lehtësuese të qasjes me qëllim rritjen e efektivitetit të hetimeve financiare¹³³. Para së gjithash mund thuhet se në bazë të autorizimeve ligjore nga KPP-ja, prokurori ka të drejtë të kërkoj t'i dërgohen informacionet nga organe shtetërorë, ndërmarrjet, si dhe personat fizik dhe juridik (KPP BH 2018, neni 35 paragrafi 2, pika d; KPP FBH 2014, neni 45 paragrafi 2 pika d; KPP RS 2018 neni 43,. Paragrafi 2 pika g; KPP DB, 2014 neni 35 paragrafi 2 pika d).

Nëse është fjala për të dhënat që kanë të bëjnë me të dhënat bankare dhe financiare, respektivisht, të dhëna që mbledhen në kuadër të veprimtarisë për mbledhjen e dëshmitë (p.sh. urdhëresa bankës apo ndonjë personi tjetër juridik), dispozitat në fuqi parashikojnë që duhet kësaj ti parapri urdhëresa gjyqësore, respektivisht të behet koonvalidimi i urdhëresës së lëshuar nga prokurori , në rast se ekziston nevoja për veprim urgjent (KPP BH, 2018 neni 72, paragrafi 3; KPP, 2014, neni 86 paragrafi 3, KPP RS , 2018, neni 136 paragrafi 3; KPP DB , 2014 neni 72 paragrafi 3). Në të gjitha rastet tjera zbatohen dispozitat mbi veprimet e rregullta dhe të veçanta të hetimeve siç i rregullojnë ligjet e procedurës.

Ligjet e veçanta, gjithashtu përmbajnë dispozita me të cilat prokurorit i japin autorizime në kohë zgjatjen e hetimeve financiare të jap urdhra, që mund të përfshi edhe dërgimin e të dhënave dhe informacioneve nga disa evidenca zyrtare të organeve gjegjëse.

Në Federatë kjo çështje është zgjedhur me dispozitën e nenit 8 paragrafi 2 të ligjit të veçantë (2014), dhe veçanërisht e thekson rendësin që e kanë organet policore, Drejtoria e tatimeve të FBH, Regjistri i letrave me vlerë në FBH, Komisioni për letra me vlerë në FBH, për dërgimin e të dhënave në kuadër të hetimeve financiare, me kohë.

Në Republikën Serbska, ligji i veçantë (2018, dispozita e nenit 7 paragrafi 2 e parashikon obligimin e ofrimit të ndihmës dhe dërgimin e të gjitha të dhënave që gjenden në Njësinë e MPB-së të RS –së dhe në Agjencinë për qeverisjen me pasurin e konfiskuar, të dhëna të nevojshme për realizimin e detyrave nga kompetencat e tyre . Ky obligim ka të bëjë edhe me spektrin e gjerë të institucioneve

133 Për më tepër informata për qasjen në disa baza të të dhënave shih linkun: <https://kriminaliseneisplati.ba/pritup-baza-ma-podataka-u-finansijskim-istragama/>

publike, shoqërive tregtare, dhe në organe dhe organizata. Në vazhdim neni 13 paragrafi 3 i Ligjit të veçantë (2018) parashikon që Njësia e MPB-së së RS-së ka të drejtë qasje, shqyrtimi dhe marrje të të dhënave nga baza elektronike si dhe qasje dhe dërgim të evidencave, dokumenteve, të dhënave dhe lëndëve të tjera që posedojnë ato subjekte. Në këtë mënyrë janë krijuar kushtet normative për qasje të drejtpërdrejtë në disa regjistra dhe evidenca të subjekteve të theksuar në ligj, e që gjithsesi mund të këtë rendësi të madhe për zbatimin e hetimit financiarë.

Në Ligjin e veçantë të Distriktit të Bërçkos (2016) në dispozitën nga neni 8. paragrafi 3. i detyron të gjitha autoritetet dhe institucionet Distriktit vepronë në kuadër të kompetencave të tyre në pajtim me urdhrat e prokurorit që e ka lëshuar urdhëresën për të zbatimin e hetimit financiar.

Është me rëndësi të ceket dispozita nga neni 6, paragrafi i. 1, pikat a. dhe d. të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2011), i cili parashikon të drejtën e përpunimit të dhënave personale dhe pa pëlqimin e bartësit të të dhënave, në rastet e zbatimit të ligjit ose përmbushjen e detyrave në interes të përgjithshëm.

3.2.1.4. Përfundimi dhe aplikimi i rezultateve të hetimit financiar

Në rastet kur veprimet me karakter dhe qëllim të hetimit financiar janë pjesë përbërëse e hetimit penal që kryhet sipas dispozitave të KPP, zbatohen rregullat e parashikuara nga ligjet procedurale në lidhje me përfundimin e hetimit dhe paraqitjen e një kërkesë për konfiskimin e fitimit material (zakonisht si pjesë përbërëse e aktakuzës, por edhe si propozim i veçantë).

Sipas disa analogjive të rregullave procedurale dhe dispozitave të Ligjit të posaçëm në Federatën e BH-së, përcaktohet se prokurori përfundon hetimin financiar kur konstaton se gjendja është sqaruar mjaftueshëm për të qenë e mundur të paraqesë kërkesë për sekuestrimin e përfitimit pronësor të fituar nga vepra penale, sipas dispozitave të atij Ligji (2014, neni 9, paragrafi 9). Si rregull, këtij veprimi i paraprind raporti i zyrtarëve të autorizuar që kanë vepruar me urdhrin e prokurorit dhe kanë mbledhur të dhëna dhe prova në kuadër të hetimit financiar. Gjithashtu, sipas analogjisë së ligjeve procedurale, janë parashikuar edhe kushtet e pezullimit (mungesa e provave) dhe rifillimi i hetimeve financiare (zbulimi i fakteve dhe rrethanave të reja). Sa u përket afateve, ato rregullohen në mënyrë të njëjtte me afatet për përfundimin e një hetimit penal (si rregull, gjashtë muaj me vazhdim të mëvonshëm sipas vendimit të kolegjiut të prokurorëve).

Në Republikën Serbska ligji i veçantë e parashikon se hetimi financiar përfundon kur gjendja e çështjes është mjaft e qartësuar për tu paraqit kërkesa për konfiskimin e përhershëm të pasurisë, ndërsa hetimi ndërpritet në rastet kur nuk mund të konstatohet se ekzistojnë kushtet për paraqitjen e propozimit të tillë (2018 , neni 9 paragrafi 3).

Ligi i veçantë (2016) i Distriktit të Bërçkos, në mënyrë identike si dhe në Federatën e BH –së e rregullon këtë çështje në kuadër të dispozitave të neni 9.

Nëse veprimet e hetimit financiar kanë qenë pjesë përbërëse e veprimeve në kuadër të hetuesie penale që zhvillohet sipas dispozitave të ligjeve penale, prokurori në mënyrë të pavarur vendos për dëshmitë, respektivisht mjetet dëshmuese që do ti deponoj se bashku me aktakuzën dhe do të propozoj prezantimin e tyre para gjykatës në mënyrë që të provoj dëshmitë nga propozimi për konfiskimin e përfitimit pronësor. Këtu gjithsesi vjen në konsiderim edhe propozimi për dëgjimin e ekspertit gjyqësor, nëse i njëjti ka qenë i angazhuar në bazë të urdhëresës së prokurorit (KPP BH) 2018, neni 227, KPP FeB , 2014, neni 242., KPP RS , 2018 242; KPP DB , 2014 neni 227).

Ligji i veçantë në Federatën e BH-së (2014) në mënyrë të detajuar e përpunon përmbajtjen e

propozimit për konfiskimit të përhershëm të përfitimit pronësor si në procedurën e rregullt ashtu edhe në procedurën e veçantë për konfiskim të pavarur (objektiv). Kur është fjala për propozimin e konfiskimit të përhershëm në procedurën e rregullt, Ligji parashikon se i njëjti përmban të dhëna lidhur me personin nga i cili do të konfiskohet përfitimi pronësor, përshkrimi ligjor dhe emri i veprës penale, të dhënat dhe përshkrimi i përfitimit pronësor që duhet konfiskuar, dëshmitë lidhur me pasurin e cila është lëndë e konfiskimit e që deri aty është arritur me zbatimin e hetimit financiar, dëshmitë për të hyrat ligjore të atij personi dhe rrethanat të cilat tregojnë ekzistimin e dallimit të dukshëm në mes të pasurisë dhe të hyrave ligjore të atij personi. Propozimi kundër personit lidhur me te përmban dëshmi që i njëjti ka trashëguar pasuri të fituar me vepër penale, ndërsa propozimi kundër personit të tretë dëshmon se dobia pasurore është arritur me kryerjen e veprës penale dhe bartur me ose pa kompensim e që nuk paraqet vlerën reale për të pamundësuar konfiskimin (2014, neni 10 paragrafi 3). Nga përshkrimi ligjor i këtij propozimi është e qartë se i njëjti mund të shqiptohet jo vetëm në rastin e konfiskimit të përfitimit pronësor nga vepra konkrete penale, por edhe me qëllim konfiskimin e pasurisë e cila është fituar me aktivitetin e tërësishëm kriminal, që drejtpërdrejt vjen nga fakti që ligjdhënësi e thotë se ekzistimi i dukshëm i mos përputhshmërisë në mes të hyrave dhe pasurisë së personit kundër të cilit është paraqit kërkesa e tillë, mund të jetë njëra nga rrethanat për konfiskim të përhershëm.

Kur është fjala për propozimin për konfiskim të përhershëm, në kuadër të veprimit të veçantë për konfiskim të pavarur (objektiv), ligji i veçantë parashikon se propozimi përmban të dhënat për personin të cilit i konfiskohet përfitimi, përshkrimi dhe emri ligjor i veprës penale, të dhënat dhe përshkrimi i përfitimit pronësor që duhet konfiskuar, dëshmitë për pasurin e cila është lëndë e konfiskimit, e dëshmi të cilat janë nxjerr me zbatimin e hetimit financiar, dëshmitë për të hyrat ligjore të atij personi, rrethanat të cilat tregojnë për ekzistimin e dukshëm të mos përputhjes në mes të pasurisë dhe të hyrave të atij personi si dhe shkaqet të cilat e arsyetojnë nevojën për konfiskim të përhershëm të pasurisë. Propozimi kundër personit lidhur me te, përmban dëshmi që ka trashëguar pasuri të fituar me vepër penale, ndërsa propozimi kundër personit të tretë përmban dëshmi që pasuria e përfituar me vepër penale është bartur pa ose me kompensim e që nuk i përgjigjet vlerës reale për qëllim të pamundësimin të konfiskimit (2014, neni 5 paragrafi 7).

3.2.2. Masat e përkohshme të sigurimit të dobisë pronësore (bllokimi/ngrirja/sekuestrimi /konfiskim i përkohshëm)

3.2.2.1. Korniza ligjore për zbatimin e masave të përkohshme të sigurimit të dobisë pasurore

Rregullat sistemore të karakterit procedural, në shume vende të ndryshme e normojnë materien e masave të përkohshme të sigurimit të përfitimit pronësor. Se pari, kjo behet në kuadër të dispozitave të KPP-së të cilat e rregullojnë veprimin e dëshmimit, më saktësisht konfiskimin e përkohshëm të lëndëve të pasurisë ashtu që është parashikuar që me vendim gjyqësor, me propozim të prokurorisë mund të shqiptohet masa e sekuestrimit (konfiskimit të përkohshëm të pasurisë). Pasuri që do të konfiskohet sipas dispozitave të KP-së, masë e sekuestrimit ose masë tjetër e përkohshme e nevojshme me qëllim të pamundësimin të shfrytëzimit, tjetërsimit apo dispononit me atë pasuri (KPP BH 2018, neni 73; KPP FBH, 2014, neni 87; KPP RS 2018 neni 138; KPP DB 2014, neni 73). Pra, ky veprim sipas përmbajtës së vet vërtet përbehet nga sekuestrimi – konfiskimi i përkohshëm i pasurisë, ndërsa qëllimet dhe natyra e veprimit (mbledhja dhe sigurimi i dëshmive për nevoja të procedurës penale) janë plotësisht të ndryshëm në raport me masat e sigurimit të përfitimit material, sepse këtë materie e rregullon kapitulli i veçantë i ligjit procedural.

Në kuadër të këtyre veprimeve të dëshmimit duhen theksuar edhe veprimi i urdhëresës bankave apo personave të tjerë juridik, në kuadër të se cilës është parashikuar se gjykata me vendim mund

të urdhëroj personin juridik apo fizik që përkohësisht të ndërpres ekzekutimin e transaksioneve financiare për të cilat ekziston dyshimi se paraqesin vepër penale apo janë të destinuara për kryerjen e veprës penale që shërbejnë për mbulimin e veprës penale apo mbulimin e përfitimit pronësor me vepër penale (KPP BH 2018, neni 72; KPP FBH, 2014, neni 86; KPP RS 2018 neni 136; KPP DB 2014 , neni 72) .

3.2.2.2. Propozimi ose kërkesa për marrjen e masave të përkohshme për sigurimin e përfitimit pronësor

Ligjet në fuqi, në kuadër të dëshmisë, parashikojnë që me vendim gjyqësor, por me propozim të prokurorisë, mund të shqiptohet masa e sekuestrimit të pasurisë e cila do të sekuestrohet sipas dispozitave të Kodit Penal, masa e sekuestrimit apo masë tjetër e nevojshme e përkohshme e cila ka për qëllim pamundësimin e shfrytëzimit, tjetërsimin apo disponimin me atë pasuri (KPP BH 2018, neni 73; KPP FBH, 2014, neni 87; KPP RS 2018 neni 138; KPP DB 2014 , neni 73) .

Veprohet sipas propozimit të prokurorit (që dallon në raport me zgjidhjet nga KPP-a që flasin për *ex officio* të veprimit gjyqësor), ndërsa gjykata vendos me vendim, dhe me atë rast ka për obligim që saktësisht ta definoj afatin e masës që shqiptohet dhe ta kontrolloj arsyeshmerinë e kohëzgjatjes të asaj mase që është dallim i rëndësishëm në raport me zgjidhjen sipas KPP FBH dhe se direkt kjo zgjidhje ligjore është në funksion të mbrojtës së të drejtave të njeriut (2004, neni 17 paragrafi 3). Ligji e parashikon kompetencën funksionale brenda gjykatës e cila vendos për propozimin (varësisht prej fazës në të cilën ndodhën procedurat, krahas obligimit që të veprojnë në harmoni me afatin (instruktiv) prej shtat ditësh nga dita e dërgimit të propozimit të prokurorisë.

Me Ligjin e veçantë në RS është parashikuar se propozimi i prokurorit me të gjitha të dhënat se pari i dërgohet pronarit për reflektim dhe paraqitje të dëshmimeve mbi origjinën ligjore të pasurisë, të cilit i jepet afat prej 15 ditësh që ta bëjë këtë (2018, neni 15, paragrafi 3) .

3.2.2.3. Marrja e masave të përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore

Kur është fjala për kapitullin i cili, mes të tjerash rregullon procedurën për konfiskimin e përfitimit pronësor, rregullat procesore parashikojnë se masat e përkohshme të sigurimit mund të shqiptohen kur vije në shprehje konfiskimi i përfitimit pronësor të fituar me vepër penale. Në ato raste gjykata ka për obligim që sipas detyrës zyrtare , sipas dispozitave në fuqi t'i caktoj masat e përkohshme të sigurisë (KPP BH, 2018, neni 395; KPP FBH, 2014, neni 416; KPP RS, 2018, neni 389; KPP DB, 2014, neni 395).

Është e evidente që në mënyrë dominante fjala është për dispozita referuese, dhe se me strukturë e tillë ligjore i mbetet gjykatës të marrë parasysh nevojën për t'i përcaktuar këto masa, për të vepruar sipas detyrës zyrtare në çdo rast të veçantë. Përveç kësaj, këto dispozita nuk janë harmonizuar me ndryshimet dispozitave të procedurës së përmbartimore ose procedurës civile, për shkak se fusha e masave të përkohshme të sigurimit (që referohen nga dispozitat e KPP-së) e që në ndërkohë nga Ligji për procedurën përmbartimore u transferuan në ligjet për procedurën civile, dhe se dispozitat e theksuara janë pak a shumë të pa zbatueshme në praktikë. Kështu që, konkluzioni i përgjithshëm është se para miratimit të rregullave të posaçme ka ekzistuar baza ligjore, vërtetë jo shumë e qartë dhe e saktë për përcaktimin e masave të përkohshme për sigurimin e përfitimit pronësorë, por që mungonte një numër elementësh thelbësorë që duhej të siguronin jo vetëm efektivitetin e veprimit të autoriteteve procedurale por edhe standardet e mbrojtjes të drejtave të njeriut, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pronës pa pengesa.

Në Federatën e BH, në kuadër të seksionit të posaçëm të Ligjit special (2014), rregullohen masat për sigurimin e dobisë pasurore. Ligjdhënësi, përndryshe fushën e rregulluar modeste në KPP të FBH kishte për qëllim që ta rregullojë në mënyrë ligjore, gjithëpërfshirëse, unike dhe me saktësi për të përmbushur kërkesat aktuale nga praktika dhe standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Thënë shkurtë, qëllimi i masave të sigurimit është sigurimi i pretendimeve të ardhshme të Federatës së BH në lidhje me konfiskimin e përfitimit pronësor. Ligjvënësi ka shfrytëzuar mundësinë për të përcaktuar, si bazë ligjore për përcaktimin e këtyre masave, ekzistencën e supozimit ligjor që përbën rrezikun që një kërkesë e tillë do të pamundësohet ose të vështirësohet nëse masat nuk të ishin parashikuar qartas. Masat e sigurimit mund të përcaktohen *ex parte*, d.m.th. madje edhe para se të lejohet të dyshuarin, të akuzuarin ose personin e lidhur me të që të deklarohet në lidhje me propozimin e prokurorit (2014, neni 16). Masat e sigurimit, nga aspekti kohorë mund të përcaktohen gjatë ose pas përfundimit të procedurës penale, respektivisht, nëse ka kushte për zhvillimin e procedurës së veçantë për sekuestrimin e pavarur (objektiv) të përfitimit pronësor. Si rregull, ligjvënësi nuk bën dallim midis masave të bllokimit (ngrirjes) të konfiskimit të përkohshëm (sekuestrimit), dhe kështu që në dispozitën nga neni 17 paragrafi 2. i përpunon disa prej këtyre masave, duke filluar nga lloji i pronës që është objekt i masës së sigurimit (pasurive të patundshme, paratë e gatshme dhe letrat me vlerë të materializuara, detyrimet dhe të arkëtueshmet, paratë në llogaritë bankare, letrat me vlerë të dematerializuara, aksionet, aksionet në fonde, aksionet e biznesit, gjëra, të drejtat dhe transaksionet e tjera monetare), duke u mundësuar në rastin konkret, nëse është e mundur të përcaktojnë, në mënyrë të pavarur ose në të njëjtën kohë, të dyja masat: masat e bllokimit dhe / ose konfiskimit të përkohshëm. Gjykata është e detyruar të përcaktojë ato masa që mund të arrijnë me efikasitet qëllimin e sigurimit.

Ligji aktual dhe i fundit në fuqi, Ligji i veçantë në RS, në këtë lëmi është ndaras i normuar, lidhur me sekuestrimin e përkohshëm të pasurisë dhe masave të përkohshme të sigurimit të asaj pasurie (bllokadë/ngrirje). Kjo njëherë është edhe diferenca më e madhe me dispozitat federale për këto masa. Të dyja veprimet janë përpunuar në detaje dhe se do të prezantohen vetëm dallimet thelbësore në mes të këtij dhe ligjit federativ BH. Të sekuestrimi i përkohshëm, dallimi i parë vërehet në aspektin e mënyrës së vendimit. Propozim i prokurorit, me të gjitha të dhënat, së pari i dërgohet personit për deklarim dhe prezantimin e dëshmimeve mbi origjinën ligjore të pasurisë, i cili duhet që këtë ta bëjë në afati prej 15 ditësh (2018, neni 15 paragrafi 3). Pra, nuk është e mundur që *ex parte* që pasuria të sekuestrohet përkohësisht. Pastaj, dallimi në këtë segment është në faktin se gjykata ka për obligim që ta caktoj datën e gjykimit pas deklarimit të pronarit, gjykim në të cilin pa tjetër ftohen të gjitha palët, se bashku me mbrojtësit apo të plot fuqishmit (të autorizuarit). Vërehet se në atë gjykim paraqiten dëshmitë e palëve për pasurin e ligjshme –jo të ligjshme, e cila është lëndë në procedurë, respektivisht rrethanat që shkaktajnë qojnë kah nevoja për sekuestrimin e pasurisë 2018, neni 17). Zgjidhje të tilla nuk ekzistojnë në dispozitat federale. Për të nxjerr vendim për sekuestrim të pasurisë, në mënyrë kumulative duhet të plotësohen këto tri kushte: të konstatohet ekzistimi i dyshimit të bazuar së është kryer vepra penale; që pasuria kontestuese është e fituar më kryerjen të asaj vepre penale; dhe se ekzistojnë arsye ose rrethana të cilat kërkojnë që të caktohet masa e përkohshme e sekuestrimit (2018, neni 18, paragrafi 3). Është interesant edhe pse është fjala për dispozitën më të cilën rregullohet sekuestrimi (marrja fizike e përkohshme e pasurisë nga posedimi i pronarit), në kuadër të se cilës theksohet së vendimi gjyqësor duhet të përfshij urdhëresën për evidentimin e kësaj mase në regjistrin publik të patundshmërive dhe të drejtave sendore mbi to, respektivisht në regjistra tjerë. Më këtë në mënyrë kumulative është përcaktuar jo vetëm masa e sekuestrimit por edhe masa e bllokadës dhe se mund të parashtrohet pyetja, pse vërtet janë nominuar këto dy masa veç e veç kur dihet se ne raste të shumta ato duhet që patjetër të shqiptohen njëkohësisht?! Dispozita e nenit 18. Paragrafi 5.e përmban zgjidhjen mbi mbrojtjen e përfituesve të ndërgjegjshëm, si dhe dispozitën e cila ja mundëson gjykatës që pronarit t' ia lë në dispozicion një pjesë të pasurisë së sekuestruar për shfrytëzim, nëse sekuestrimi e bien në pik pyetje ekzistencën e pronarit apo të personave që ai ka për detyrë ti mbaj. Edhe pse është fjala për *lex specialis*, gjykata me gjithë atë nuk e lejon sekuestrimin e pasurisë e cila në bazë të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore është përjashtuar nga përmbarrimi

(2008, neni 18, paragrafi 8). Është e rëndësishme dispozita e cila i parashikon afatet për kohëzgjatjen e masës së sekuestrimit, kontrollin gjyqësor të arsyeshmërisë së kësaj mase, zëvendësimin e kësaj mase me masë më të butë, etj., më anë të së cilës ky segment i normativës ligjore për kufizimin e përkohshëm të së drejtës për shfrytëzim të papenguar të pasurisë vërtet e rregullon në mënyrë adekuate mbrojtjen e të drejtave të njeriut 2018, neni 20)¹³⁴.

Dallimet në sferën e masave të përkohshme të sigurisë, të cilat, janë normuar veç e veç, ndaj rregullës federale, para së gjithash duhet të përcaktohen para fillimit të procedurës penale. Për më tepër, një ligj i veçantë parashikon afatin e një viti pas përfundimit të plotë fuqishëm të procedurës penale, deri kur mund të përcaktohen këto masa, gjë që nuk është në ligjin e FBH-së (2018, neni 22, paragrafi 1).

Ligji i veçantë në Distriktin e Bërçkos përmban vendime pothuajse identike për sigurimin e sekuestrimit të pasurisë së fituar ilegalisht si rregulla e njëjtë në Federatën e BH, me një dallim të vogël që i referohet standardizimit të juridiksionit aktual të gjykatës për të vendosur. Duke marrë parasysh organizimin specifik të gjyqësorit në Distrikt, që është gjithmonë Gjykata e Qarkut e Shkallës së Parë si gjykatë e shkallës së parë, ndërsa vendimet për ankesat e ngritura kundër vendimit të asaj gjykate për masat e sigurimit i janë besuar Gjykatës së Apelit të Distriktit.

3.2.2.4. Procedura ankimese

Kundër vendimit me të cilin janë shqiptuar masat e sigurimit lejohet ankesa e cila nuk ka veprim suspendim (që do të thotë vendimi në ditën e nxjerrjes behët ekzekutiv dhe u dërgohet organeve për ekzekutim), ankesa i drejtohet direkt gjykatës së lartë, gjë që prapë pjesërisht ka shmangie nga rregullat e zakonshme sipas KPP-së, por në anën tjetër do të kontribuojë efikasitetit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut (2014 neni 17, paragrafi 6). Edhe pse u theksua më herët që masat e sigurisë duhen të caktohen për kohëzgjatje të saktë krahas kontrollit të rregullt gjyqësor të arsyeshmërisë, ligdhënësi e ka parashikuar afatin absolut të kohëzgjatjes së këtyre masave. Pas, plotfuqishmërisë së aktgjykimit të nxjerrë në kuadër të procedurës së rregullt për sekuestrim të pavarur (objektiv), masat e sigurisë mund të zgjasin deri në 60 ditë nga dita kur propozuesit (prokurorit) i dërgohet informacion mbi plotfuqishmërinë, respektivisht vendimi i organit të shkallës së dytë mbi verifikimin e aktgjykimit, nëse është zhvilluar procedura e ankimit (2004, neni 21). Kur është fjala për kontrollin gjyqësor dhe në përgjithësi për respektimin e parimit të proporcionalitetit, Ligji, jo vetëm që e obligon gjykatën që ta bëjë kontrollimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së masave të sigurisë, por e mundëson edhe zëvendësimin e një mase me masën tjetër më të butë (p. sh. vend të shqiptimit kumulativ të bllokadës dhe sekuestrimit, në fuqi mbetet vetëm bllokada ndërsa pasuria i kthehet pronarit në shfrytëzim), respektivisht madje i jepet edhe mundësia e deponimit të garancisë me para veçanërisht me sende apo të drejta nga ana e propozuesit të sigurimit apo personit të tretë (2014, neni 20). Duke pas parasysh mbrojtjen e të drejtave të personave që kanë pësuar dëm si rrjedhojë e shqiptimit të masave të sigurisë se profitit pronësor, Ligji qartas e parashikon se FBH, mban përgjegjësi për demin e krijuar. Afati për iniciimin e procesit kontestimor për kompensim të dëmit është një vit nga dita kur është bërë i plotfuqishëm vendimi me të cilin është refuzuar propozimi për sekuestrimin e përfitimit pronësor, çoftë në kuadër të vendimit për liri nga fajësia apo refuzimin e ankesës ose në kuadër të procedurës së veçantë për sekuestrim të pavarur (objektiv) të dobisë pasurore (2014, neni 23).

Ky ligj i RS –së e ka mbajtur zgjidhjen sipas të cilës ankesa i parashtrohet kolegjit të procedurës

134 Pastaj, për dallim nga dispozitat në FBH, zgjidhjet nga neni 21, Agjencisë për qeverisje me pronën e konfiskuar i jep rol aktiv në këtë pjesë të procedurës që të inicioj ndaj prokurorit i cili atë propozim mund ta paraqet në gjykatë, në rast se qeverisja me pasurinë e sekuestruar krijon vështirësi të veçanta apo shkakton shpenzime të mëdha ta rishqyrtoj vendimin dhe eventualisht ta zëvendësoj me masat e sigurisë (bllokim/ ngrirje).

paraprake në afatin prej tri ditësh nga data e pranimit e që nuk ka veprim suspenziv (2018, neni 24, paragrafi 1). Dispozitat tjera thuaja se janë të ngjashme me ato të FBH, dhe se nuk do të shqyrtohen dhe arsyetohen veçanërisht.

Duke marrë parasysh organizimin specifik të gjyqësorit në Distrikt, Gjykata themelore Distriktit të Bërçkos është gjithmonë Gjykatë e Shkallës së Parë, ndërsa vendimet për ankesat e ngritura kundër vendimeve të asaj gjykate për masat e sigurimit me ligj i janë besuar Gjykatës së Apelit të Distriktit.

3.2.3. Veprimet për sekuestrim të përhershëm të dobisë pronësore, të përfituar me vepër penale

3.2.3.1. Llojet e veprimeve dhe karakteristikat e tyre themelore

Për shkak të rregullimit të ndërlikuar politiko-territorial dhe ekzistencës së sistemeve të ndryshme penalo juridike, BH, ke zgjidhje të ndryshme, sa u përket procedurave për konfiskimin e përhershëm të përfitimit pronësor të fituar me vepër penale. Procedura për sekuestrim të rregullt pranohet nga të gjitha legjislaturat dhe nënkupton që kur faktet dhe rrethanat tregojnë se përfitimi ka ardhur delikuenca, ajo dobi pasurore do të konfiskohet. Përcaktimi i faktit nëse me kryerjen e veprës penale është nxjerrë përfitim, është jashtëzakonisht me rëndësi kur fitimi është pjesë e përshkrimit ligjor të veprës (domethënë, është fakt vendimtar) dhe moszbatimi i saj përbën një shkelje të rëndë të procedurës penale. Por, kur e mira materiale është e fituar dhe nuk është vepër e përshkrimit të pjesshëm ligjor, edhe më tej është fjala për njërin nga parimet e së drejtës penale: askush nuk mund ta mbaj përfitimin e realizuar me vepër penale (KP BH, 2018, neni 110; KP FBH, 2017, neni 114, respektivisht, Ligji për Sekuestrimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale, FBH, 214, neni 2; KP RS 2017, neni 8; KP DB, 2018 neni 114, respektivisht Ligji për Sekuestrimin e Pasurisë së Fituar në mënyrë jo ligjore QB 2016, neni 3.

Procedura për sekuestrim të pavarur objektiv të pasurisë së fituar me vepër penale është e parashikuar me legjislacione të veçanta për sekuestrimin e asaj pasurie, e që duke pasur parasysh në nivelin e Bosnjës dhe Hercegovinës nuk ka një ligj të tillë të veçantë, që do të thotë se procedura e tillë nuk është e mundur që të zhvillohet para organeve shtetërore¹³⁵. Në RS ekziston mundësia e sekuestrimit të pavarur objektiv, në rast së paraqiten rrethanat specifike (pa aftësia e kryerësit të veprës që të merr pjesë në procedurë për shkak të paraqitjes së sëmundjes mentale), ndërsa në Distriktin e Bërçkos janë dhe rrethana të tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale (Karas Ivçevići (2011) thekson se këto mund të jenë rrethana materiale juridike, dhe juridiko procesore, si rrethanë që vepra është përfshirë me amnisti apo falje, rrethanë që personi i caktuar gëzon imunitet juridik-penalo procesor, etj). Duke pas parasysh se janë parashikuar me lige të veçanta, kjo do të thotë se pasuria, përmes regjimit të sekuestrimit në Federatën e BH nuk mund të sekuestrohet, për ato vepra penale për të cilat si maksimum të veçante nuk e kanë të parashikuar dënimin me burgim deri në tri vjet, apo prej tri ose më shumë vite burgim, si dhe as për ato vepra me të cilat ligji e kërcënon me burgim (kohë zgjatja e dënimit në mes të minimumit dhe maksimumit, pra dënimi nuk i përfshin tri vite; në QB të gjitha këto janë vepra të cilat si minimum të veçantë nuk janë të dënueshme prej tri vitesh, ndërsa në RS këto janë vepra të cilat nuk janë të parashikuara në nenin 2. Të Ligjit për Sekuestrimin e Pasurisë e cila është fituar me kryerjen e veprës penale, RS (2018), dhe se nëse nga ato vepra nuk është fituar pasuri e cila nuk ka mos përputhshmëri me të hyrat ligjore të pronarit (kryerësit të veprës, trashëgimtarit juridik, personit fizik apo juridik tek të cilët është bartur pasurie e fituar e vepër penale):

135 Sekuestrim të pavarur objektiv nënkupton se i njëjti ndërmerret kundër personit i cili nuk është shpallur fajtor në procedurën penale dhe nënkupton se edhe përkundër pengesave për zbatimin e ndjekjes penale konstatohet se është realizuar profit me kryerje të veprës penale dhe se caktohet sekuestrimi i asaj pasurie. Ato pengesa mund të jenë vdekja dhe arratia e kryerësit të veprës, këto i pranojnë të tri legjislatonet.

Konfiskimi i zgjeruar i përfitimeve nga vepra penale është e njohur për të tria legjislacionet në Bosnje dhe Hercegovine. Teoria ligjore e konfiskimit të zgjeruar është sekuestrimi i të ardhurave të pasurisë jo vetëm nga vepra penale për të cilën kryhet një procedurë penale specifike, por edhe për çdo dobi pasurore që supozohet të ketë origjinën nga të njëjtat vepra apo vepra të tjera që kanë paraprirë ose që përkojnë me të njëjtën (Datzer, 2017). Legjislacioni i BH në përgjithësi nuk njihon ndonjë dispozitë specifike procedurale për zbatimin e kësaj procedure, por zbatohet njësoj si për procedurën e rregullt. Përjashtimi i vetëm është Republika Serbe, Ligji konfiskimit të pasurisë së fituar me vepër penale i RS është plotësisht e përkushtuar për konfiskimin e zgjeruar.

Konfiskimi i përfitimit pronësor në Bosnje dhe Hercegovine kryhet sipas propozimit / kërkesës së prokurorit dhe duhet të diskutohet në shqyrtimin gjyqësor. Kur merret në konsideratë konfiskimi, dallohen dy situata parimore: 1) përfitimi merret nga kryerësit ose aktorët e tjerë të veprës, kur faktet dhe rrethanat konstatohen gjatë seancës kryesore (gjykimit). Edhe pse teoria konsideron se është fjala për të ashtuquajturën "procedura e asociimit" (e që nënkupton që me të nuk zgjidhet çështja penale), d.m.th. ekzistenca e veprës penale dhe fajësia e kryerësit [Tomasheviqi, 2009], por nëse dhe në çfarë forme është arritur ndonjë dobi pasurore që është në një marrëdhënie shkakësore me veprën penale), veprimet brenda saj merren së bashku me veprimet tjera dhe shpesh gjatë zbatimit të tyre nuk tregohet në mënyrë eksplicite se ato janë veprime brenda bashkëpunimit, por procese kryesore; 2) nëse përfitimi konfiskohet nga pala e tretë (të cilës i është transferuar fitimi material), si dhe në rastin e konfiskimit nga personi juridik, të njëjtët (respektivisht përfaqësuesit e tyre) duhet të thirren në seancën kryesore për të reflektuar mbi konfiskimin. Ata janë të autorizuar të propozojnë prova dhe, pas lejes së gjyqtarit ose kryetarit të kolegjit, t'u parashirojnë pyetje të akuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve (KPP BH, 2018, neni 393, KPP FBH, 2014, neni 414, KPP RS, 2018, neni 387; KPP DB, 2014, neni 393).

Faktet që shërbejnë për ta dëshmuar formën dhe lartësinë e përfitimit të realizuar, janë ato që zakonisht shërbejnë si për vërtetimin e fakteve në procedurën penale, siç janë ekspertiza në vendin e ngjarjes, dëshmitë e të pandehurve, dëshmitë e dëshmitarëve, dëshmitë e ekspertëve, dokumentet teknike të fakteve. Për prezantimin e tyre, të autorizuar janë palët në procedurë, si dhe persona të tjerë (personat të cilëve u është transferuar fitimi material) dhe përfaqësues të personave juridik.

Përfitimi në parim konfiskohet nga kryerësit dhe nga personat e lidhur me ta dhe veprën penale. Personat lidhur me ta dhe veprën penale konsiderohen pjesëmarrësit në akt (nxitës dhe ndihmës), trashëgimtarët ligjorë të kryerësit ose të pjesëmarrësit, si dhe çdo person fizik ose juridik për të cilin gjykata konstaton se është transferuar prona ose e drejta që përbën dobi pasurore të përfituar nga vepra penale dhe ky transferim nuk ishte qëllim mirë. Nëse përfitimi realizohet për personin juridik, konfiskimi është i mundur ndaj tij. Në këtë rast përfaqësuesi i tij i ka kompetencat e cekura më lartë.

Mundësia e prezencës në shqyrtimin kryesorë u është dhënë, në radhë të parë, palëve në procedurë, por edhe publikut të gjerë (qytetarëve): ç'do person i moshës madhore mund të jetë prezent në shqyrtimin kryesorë. Për shkaqë, siç janë: interesat e sigurisë së shtetit apo nevoja për ruajtjen e sekretit shtetëror, sekretit ushtarak, sekretit zyrtar apo afarist, ruajtja e rendit publik, ruajtja e moralit në shoqërinë demokratike, etj. mund të përrjashtohet publiku i gjerë nga shqyrtimi kryesorë ku konstatohet dobia pasurore e fituar me vepër penale. Nuk përrjashtohen palët në procedurë, mbrojtësit e tyre, nuk përrjashtohet i dëmtuari, nuk përrjashtohet përfaqësuesi ligjorë apo personi që e ka plotfuqishmëri. Meqenëse personat nga të cilët konfiskohet përfitimi, mund t'i përfshijnë edhe personat tek të cilët është transferuar përfitimi material dhe përfaqësuesit e personave juridikë, ligjet janë decidiv që përrjashtimi nuk zbatohet ndaj tyre (KPP BH, 2018, neni 393, KPP FBH, 2014, neni 414, KPP RS, 2018, neni 387, KPP DB, 2014, neni 393).

3.2.3.2. Të drejtat procedurale të personave për të cilët merret masa e konfiskimit të pronës

Siç është përshkruar te çështja paraprake, mundësia e prezencës në shqyrtimin kryesorë u sigurohen pa kufizim të akuzuarit dhe pjesëmarrësve në veprën penale, mbrojtësve të tyre, përfaqësuesve si dhe atyre që u është dhënë plotfuqishmëria për rastin. Prezenca e tillë u mundësohet edhe personave të cilëve u është bartur pasuria, përfaqësuesve të personave juridik nëse personi juridik ka pasur dobi nga ajo vepër penale. Në procedurën objektive të pavarur e drejta e prezencës i është rezervuar edhe të *ashtuquajturit kujdestarit të pasurisë* (personit që i përfaqëson interesat pronësore të personit të cilit i konfiskohet pasuria), si dhe trashëgimtarit juridik të kryerësit të veprës dhe pjesëmarrësit në vepër. Mundësia e mëvonshme nga aspekti i trashëgimtarëve juridik) nuk është i parashikuar qartë për procedurat e rregullta për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Të gjithë subjektet e procesit që e realizojnë funksionin e mbrojtjes kanë të drejtë të propozojnë argumente, me të cilat dëshmohet origjina e dobisë së fituar, respektivisht me të cilat hidhen poshtë pretendimet e prokurorisë mbi pasorin e fituar në mënyrë jo të ligjshme, e që drejt për drejt i përfshinë edhe pyetjet kryq e tërthor apo pyetjet shtesë drejtuar dëshmitarëve ose ekspertëve. Për personat e tretë dhe në rast të konfiskimit nga personat juridik, ligjet janë jashtëzakonisht të qartë në aspektin e autorizimit për ti propozuar dëshmitë dhe për të parashtruar pyetje të akuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve (KPP BH, 2018, neni 393; KPP FBH, 2014, neni 414; KPP RS, 2018, neni 387; KPP DB, 2014, neni 393). Në procedurën objektive të pavarur, të drejtën e plotë për parashtrimin e dëshmimeve, duke përfshirë thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve apo ekspertëve, është e garantuar vetëm në Republikën Serbe (Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale (RS, 2018 neni 30) ndërsa në Federatën e BH dhe Qarkun e Bërkçkos, sipas Ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale (FBH 2014 neni 6.paragrafi 2.) dhe Ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale të DB (2016, neni 6 paragrafi 2), ekziston mundësia që personat e lidhur me veprën penale të intervistohen lidhur me rrethanat e përfitimit të pasurisë, por jo edhe të marrin pjesë aktivisht në procedurë.

3.2.3.3. Vendimi që përcaktohen konfiskimin e pronës

Mbledhja e dëshmimeve dhe hetimi i rrethanave të rëndësishme për vërtetimin e përfitimit pronësor të fituar me vepër penale është obligim i prokurorit (KPP BH 2018, neni 392; KPP FbH 2014, neni 413; KPP RS, neni 386; dhe KPP DB 2014, neni 392). Nëse lëshohet rasti për propozim/kërkesën për konfiskim, gjykata në mënyrë të pavarur e nxjerr vendimin konfiskim, kjo mundësi është e parapare ekskluzivisht vetëm në Federatën e BH (Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale 2014, neni 2) dhe në QB (Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale 2016, neni 3). Pasi që është fjala për ligje *lex specialis* që nuk aplikohen për të gjitha veprat penale, mundësia e veprimtimit në këtë mënyrë, atje, është e kufizuar.

Përfitimi pronësorë i fituar me vepër penale , në procedurën e rregullt konfiskohet në rast se shpallet aktgjykimi dënues apo aktgjykimi verifikues (aktgjykimi verifikues vetëm e verifikon se janë realizuar karakteristikat e ndonjë vepre penale, por për arsye të ndryshme, siç janë: 1. pa përgjegjshmëria ligjore e kryerësit të veprës penale, (p.sh. për shkak të metave mendore), 2.në raste se në procedurën e pavarur objektive nuk mund të konstatohet fajësia e kryerësit të veprës penale) si dhe vendimit mbi shqiptimin e masës edukuese ose vendimit mbi shqiptimin e vërejtjes gjyqësore.

Përmbajtja e vendimit për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale nuk është unik në të gjitha legjislationet në BH. Ligjet e procedurës penale përcaktojnë se është e nevojshme që të ceket lënda - sendi i cili konfiskohet dhe i cili në mënyra të ndryshme mund të rrjedhë nga vepra penale (drejt për drejt, tërthorazi – të hyrat, pasuria në të cilën është shndërruar dobia pasurore e fituar me

vepër penale apo pasuria me të cilën është bashkuar përfitimi pronësor), dhe në rast se konfiskimi nuk është i mundur, shumta e parave në proporcion me përfitimin pronësor, (KPP BH 2018, neni 396; KPP FBH 2014, neni 417; KPP RS, 2018, neni 390; KPP DB BH 2014, neni 396). Ligjet e veçanta në FBH (2014) DB BH (2016) e parashohin obligimin e cekjes së gjërave dhe të drejtave që janë pasuri e fituar me vepër penale, por për dallim nga ligjet sistemore të cilët si alternativë e parashohin shumë parash, por vetëm në situata të veçanta dhe ekskluzivisht kërkojnë që të ceket shumta e parave si kundërvlerë e përfitimit që konfiskohet. Krahas kësaj, vendimi për konfiskim duhet të përmbajë edhe konstatimin që sendet e konfiskuara dhe të drejtat kalojnë dhe bëhen pronësi e FBH, respektivisht DB, e ashtuquajtur kërkesë kondemnative (obligim i krijuar me vendim gjyqësor për ta bërë apo për ti bartur pasojat, ashtu që i akuzuari ose personat e lidhur me të i dorëzojnë sendet dhe ti kalojnë të drejtat, të bëhet kompensimi – pagesa që është në proporcion me përfitimin pronësor të fituar me vepër penale ose që në regjistrat publik të organeve kompetentë të regjistrohen të drejtat e pronësisë në dobi të bashkësisë politiko shoqërore (Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale FBH, 2014 neni 11 dhe Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar jashtëligjshëm QB 2016, neni 11). Krahas asaj që u cek, në RS, neni 43 i Ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale 2018, edhe më striktë kërkon që të ceket vendimi për shpenzimet e qeverisjes me pasurinë e sekuestruar, vendimi mbi kërkesën pronësore – juridike të të dëmtuarit, si dhe për shpenzimet e përfaqësimit (nëse ka).

3.2.3.4. Procedura ankimese

Dispozitat sistemore parashikojnë se ankesa kundër vendimit gjyqësor për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale mund të deponohet më së largu 15 ditë nga dita e pranimit të përshkrimit të vërtetuar të atij vendimi. Nëse ankesën e parashtron subjekti i autorizuar (prokurori, i dëmtuari apo në emër të tij përfaqësuesi zyrtarë, partneri bashkëshortorë apo jashtëmartesor, prindi, fëmijët, i adoptuari, respektivisht adoptuesi i të akzuarit dhe personi nga i cili është konfiskuar dobia pasurore fituar me vepër penale), dhe e parashtruar me kohë, konsiderohet si ankesë e lejuar dhe se me këtë ankesë shtyhet ekzekutimi i vendimit të gjykatës për konfiskim. Sipas dispozitave sistemore, ankesa, kryesisht i drejtohet gjykatës që e ka shqiptuar aktgjykimin e shkallës së parë (përrjashtim ka vetëm në FBH, ndërsa sipas dispozitave të *lex specialis* drejt për së drejti gjykatës së lartë.

Konfiskimi i përfitimit pronësor i fituar me vepër penale mund të jetë lëndë e ankesës në disa baza të ndryshme. Në rastet ku dobiapasurore është pjesë e përshkrimit ligjorë i veprës penale, duhet të vërtetohen forma dhe lartësia dhe se duhet që të jepet arsytimi në bazë të cilave fakte. Nëse ndodh të mos arsyetohen faktet vendimtare konsiderohet si shkelje thelbësore e procedurës. (KPP BH, 2018, neni 297; KPP FBH, 2014, neni 312; KPP RS, 2018, neni 311; KPP QB, 2014, neni 297). Dispozita e atij neni, dhe neni 397 të KPP BH (2018), neni 418. KPP FBH (2014), neni 391 KPP RS (2018), neni 397. KPP DB (2014) flasin në përkrahje për faktin se shkelja thelbësore absolute e procedurës dhe baza e fortë e ankesës janë dështimi për të siguruar praninë personave, në shqyrtimin gjyqësor të, prania e të cilëve është e detyrueshme, dmth. personat të cilëve u janë transferuar të ardhurat, si dhe në rast të konfiskimit nga personi juridik, përfaqësuesi i ti. Gabimet me rastin e konfiskimit të pasurisë së fituar me vepër penale, janë gjithashtu bazë për anulimin e aktgjykimit, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe gabimit në vendimin për masën e konfiskimit të dobisë pasurore. Shkelje e kodit penal është, kur gjykata e zbaton masën e konfiskimit të përfitimit pronësor ndërsa duhej aplikuar një tjetër institut apo sanksion (p.sh. në vend të konfiskimit të sendeve si masë sigurie, e aplikon konfiskimin e dobisë pasurore), kurse gabimi në vendimin për masën e konfiskimit të përfitimit pronësor mund të qëndroi në aplikimin e regjimit të gabuar të konfiskimit (p.sh. aplikohet konfiskim i zgjeruar në vend të konfiskimit të rregullt).

3.2.3.5. Informimi i Agjencisë së Administrimit, ose subjekteve të tjera

Ligjet e procedurës penale nuk e saktësojnë procedurën pas nxjerrjes së aktgjykimit apo vendimit mbi konfiskimin. Që do thotë se vlejnë dispozitat e përgjithshme për veprimin e gjykatës pas zgjidhjes së lëndës penale në procedurë (përshkrimi i verifikuar u dërgohet palëve, mbrojtësit, të dëmtuarit, personit që sendi i sekuestruar i është konfiskuar [nëse ishte si rast], dhe nëse dallon nga i akuzuari, personit që i është shqiptuar konfiskimi i dobisë pasurore- Sijerçiq – Çoliq, 2008). Dispozitat *Lex specialis* për konfiskim parashikojnë zgjidhje të ndryshme. Në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në Distriktin Bërçkos, aktgjykimi i dorëzohet pjesëmarrësve në procedurë, dhe Agjencisë Federale për Qeverisjen e Pasurisë së Konfiskuar, ose Autoritetit për Qeverisjen e Pasurisë së Konfiskuar në Qarkun e Bërçkos. Nga përmbajtja e vendimit që përcakton konfiskimin e përfitimeve të fituara nga vepra penale, del që pasuritë e patundshme, aksionet në shoqëri dhe letrat me vlerë janë regjistruar në regjistrat përkatës si pronë e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, respektivisht Qarkut të Bërçkos, kështu që kopja e aktgjykimit duhet t'u dorëzohet regjistrave kompetentë. Nëse pasuria dhe të drejtat më herët ishin të siguruara në mënyrë të përkohshme në mënyrë ashtu që i ishin besuar Agjencisë Federale për Qeverisjen e Pasurisë së Konfiskuar për kujdestari dhe menaxhim, d.m.th, bankës ose personit tjetër juridik u është urdhëruar që të dysuarit, të pandehurit ose personin e lidhur me ta të mos ia bëjë pagesën e fondeve nga llogaritë e tyre, Agjencia Federale i ndërmerr veprimet e nevojshme për të marrë pronësinë e këtyre pasurive ose veprime të tjera në kuptimin e menaxhimit të pasurisë së konfiskuar. Nëse paraprakisht nuk është siguruar përkohësisht, urdhërohet personi i akuzuar ose personi i afërt që t'i dorëzojë menjëherë sendet ose të paguajë shumën e parave në përpjesëtim me pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme. Prona mund të shitet, ndërsa veprat artistike, ekspozitat dhe objektet tjera me rëndësi kulturore dhe historike mund t'u jepen për ruajtje ose përdorim galerive të artit, muzeve dhe institucioneve kulturore. Në rast të refuzimit të propozimit për sekuestrimin e përfitimit pronësor të fituar nga vepra penale, të dhënat nga dosja do t'i dërgohen Administratës Tatimore të Federatës së BH, ose Distriktit të Bërçkos, për përpunim të mëtejshëm. Në Republikën Serbe informohen prokurori, kryerësi veprës, pjesëmarrësit në vepër dhe mbrojtësit e tyre, trashëgimtarët ligjorë, njësia e Ministrisë së Punëve të Brendshme përgjegjëse për zbulimin e pronës që rezulton nga kryerja e veprës penale dhe Agjencisë për Qeverisjen e Pasurisë së Konfiskuar. Patundshmëritë, aksionet në shoqëritë aksionare dhe letrat me vlerë regjistrohen në regjistrat gjegjës si pasuri e Republikës Serbe, mjetet financiare paguhen në llogaritë gjegjëse të hyrave të buxhetit të Republikës Serbe, ndërsa për pasurinë e tundshme, metalet fisnike e ngjashëm, vendos Qeveria. Objektet tjera me rëndësi kulturore, shkencore dhe historike u jepen për ruajtje institucioneve kompetente për ruajtjen e gjërave të tilla.

3.2.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë

3.2.4.1. Veprimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë

Kur është fjala për dispozitat sistemore me karakter të procedural, ato dispozita nga aspekti i ekzekutimit të vendimeve për masat e përkohshme të sigurimit e parashikojnë aplikimin e dispozitave që vlejnë për procedurën përmbarimore (KPP BH, 2018, neni 395; KPP FBH, 2014, neni 416; KPP RS, 2018, neni 388; KPP QB, 2014, neni 395). Prandaj nëse gjykata vepron sipas KPP-së, d.m.th. nëse nuk janë plotësuar kushtet për aplikimin e ligjeve të veçanta për konfiskimin e përfitimit pronësor, sipas detyrës zyrtare i cakton masat e përkohshme të sigurimit, në bazë të dispozitave të së drejtës përmbarimore, të cilat i rregullojnë të gjitha çështjet specifike: llojet masave të sigurisë, periudha kohore e zbatimit të tyre, dërgimi si dhe afatet për ekzekutim etj.

Duhet theksuar se me dispozitat gjegjëse të Ligjit për procedurën penale, nga aspekti i masave të përkohshme të ndalesës së transaksioneve financiare, është e parashikuar se kjo masë shqiptohet deri në përfundimin e procedurës penale, respektivisht deri sa nuk plotësohen kushtet për kthimin e mjeteve financiare, por këto dispozita nuk i rregullojnë çështjet specifike për afatet dhe mënyrën e ekzekutimit të vetë masës, informimin e gjykatës që e njëjta është ekzekutuar etj. (KPP BH, 2018, neni 72., paragrafi 5; KPP FBH, 2014, neni 86. paragrafi 5; KPP RS, 2018, neni 136. paragrafi 5; KPP QB, 2014 neni 72. paragrafi 5).

Ligji i veçantë në FBH (2014), nga aspekti i ekzekutimit të masave të përkohshme të sigurimit të dobisë pasurore, në radhë të parë e përcakton gjykata, pastaj Agjencia Federale për Qeverisje me Përfitim të Konfiskuar ose organi tjetër i caktuar me ligj i zbaton zgjidhjet me të cilat janë parashikuar masat e përkohshme. Gjykata e cila e ka nxjerrë atë vendim, të njëjtin do ua dërgoi këtyre subjekteve me një herë, respektivisht ditën e parë të punës që pason pas nxjerrjes së vendimit. Ligji, në mënyrë imperative e parashikon se procedura e ekzekutimit të këtyre vendimeve do të konsiderohet urgjente (2014, neni 17. paragrafi 7, 8 i 9). Këto zgjidhje bëhen ekzekutive në momentin e marrjes së vendimit nga ana e gjykatës, d.m.th. parashtrimi i ankesës nuk e shtyn ekzekutimin.¹³⁶ Ligji, gjithashtu rregullon lëshimin e urdhrave (brenda vendimit të gjykatës për masat e përkohshme) për hyrjen e masave në libra publike, regjistra dhe regjistra publike (2014, neni 18, pika 1), që tregojnë se në çdo rast konkret duhet bërë identifikimi i saktë i entitetit ose vendi ku futet masa e përkohshme e bllokimit / ngrirjes.

Në Republikën Serbska, ligjvënësi, me ligj të veçantë, ka sekuestruar përkohësisht pronën (e konfiskuar) dhe ka parashikuar se vendimi, përveç palëve i dërgohet edhe Njesisë së Ministrisë së Brendshme të RS dhe Agjencisë për Qeverisje me Pasurinë e konfiskuar (2018, neni 18, paragrafi 6) dhe bëhet i ekzekutueshëm në kohën e miratimit (2018, paragrafi 19, paragrafi 1). Ligji nuk specifikon afatin për dërgimin ose për ekzekutimin e këtij vendimi. Ligji parashikon që ekzekutimi i vendimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të pronës për shkak të dorëzimit në Agjenci, si rregull, bëhet nga punonjësit e policisë të njesisë së MPB-së të RS-së, respektivisht, me ligj tjetër, autoritetet kompetente në përputhje me llojin e pronës që është (përkohësisht) sekuestruar (2018, paragrafi 19, paragrafi 4). Kur janë në pyetje letrat me vlerë, Ligji përcakton që përmbarimi i vendimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të kësaj forme të pronës do të bëhet nga Regjistri Qendror i Letrave me Vlerë, përkatësisht nga gjykata kompetente e regjistrimit të aksioneve në shoqëritë tregtare (2018, paragrafi 19, pika 5). Në rastin e masave të përkohshme për sigurimin e pronës, e cila është e bllokuar / e ngrirë me Ligj të veçantë, parashikohet që ato të përcaktohen me vendim të gjykatës, i cili bëhet i zbatueshëm në ditën e miratimit dhe i dorëzohet pronarit, mbrojtësit të tij ose të autorizuarit të tij fuqplotë, prokurorit publik, Njesisë së MPB të RS-së, Agjencinë për Qeverisje me Pasurinë e Konfiskuar ose ndonjë organi tjetër përgjegjës për përmbarimin. Afati për dorëzimin e vendimit për ekzekutim është dita e parë e punës pas ditës së miratimit. Ligji përcakton se ekzekutimi i vendimit ekzekutohet nga gjykata, Njësia e MPB të Republikës Serbe ose nga organet të tjera të caktuara me ligj (2018, nr.24). Si rregull, këto lloje të masave të përkohshme futen në regjistrat gjegjës, regjistrat dhe evidencat e duhura dhe se dispozita e nenit 25 të Ligjit (2018) gjithashtu përshkruan procedurën për regjistrimin ose fshirjen e këtyre masave.

136 Duhet theksuar se në rastet e veçanta, masë e përkohshme e sigurisë mund të jetë vetëm bllokimi (masë juridike me të cilën më së shpeshti ndalohen disa veprime në aspektin e pasurisë, por nuk e përfshijnë konfiskimin fizik të pasurisë nga posedimi), ndërsa në rastet tjera pasuria mund të sekuestrohet (konfiskim i përkohshëm). Në fund, në rastet e veçanta, me vendim gjyqësor, mund të caktohet masa e sigurimit të përkohshëm, masë e cila përmban njëkohësisht edhe masën e bllokimit (p.sh. regjistrim ndalese në regjistrin gjegjës të pasurisë) krahas urdhrat për sekuestrimin e përkohshëm dhe deponim deri në vendimin tjetër të gjykatës (p.sh. sekuestrim i përkohshëm i automjetit dhe ruajtjen e tij nga ana e Agjencisë). Në këto raste, te dy organet i marrin dhe në afatin ligjorë i zbatojnë vendimet gjyqësore për masën e sigurimit të dobisë pasurore.

Ligji i Veçantë (2016) që është në fuqi në Distriktin e Bërçkos, gjithashtu e parashikon procedurën e ekzekutimit në mënyrën pothuajse identike siç është bërë sipas Ligjit të posaçëm në Federatën e BH, me përjashtim të rasteve që në Distriktin e Bërçkos, përveç gjykatës, si autoritete përgjegjëse për zbatimin e zgjidhjes së masave të përkohshme quhen “autoritete të tjera sipas ligjit”. Shih dispozitat e paragrafiëve 17, 8, 9 dhe 10 dhe 18.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për konfiskimin e përhershëm të përfitimi pronësorë është shumë i rëndësishëm, por njëkohësisht edhe faza më komplekse e tërë procesit, nga i cili zbatimi i suksesshëm shpesh varet drejtpërdrejt nga vlerësimi i efektivitetit të gjithë sistemit në këtë fushë. Si rregull, zbatohen rregullat e ekzekutimit dhe parashikojnë që vendimi për konfiskim të përmbushë të gjitha kushtet e parashikuara nga këto rregulla, domethënë të ketë karakterin e dokumentit ekzekutiv (të jetë i përshtatshëm për ekzekutim), dhe duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- a) kërkuesi i përmbarimit,
- b) ekzekutuesi,
- c) subjekti,
- d) lloji,
- e) vëllimi, dhe
- f) koha e përmbushjes së detyrimit.

Në nivelin e BH, ekzekutimi i vendimeve për konfiskimin e përhershëm të përfitimit pasurorë të fituar nga vepra penale është rregulluar me Kodin e Procedurës Penale të BH si dhe me Ligjin e posaçëm të Bosnjës dhe Hercegovinës për ekzekutimin e sanksioneve penale, paraburgimit dhe masave të tjera. Prandaj, dispozita e nenit 180 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të BH (2018) parashikon zbatimin e dispozitave të procedurës përmbarimore dhe ato që aplikohen në vendin ku zbatohet vendimi. Në anën tjetër, neni 246 (1) i Ligjit të Bosnjës dhe Hercegovinës për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (2016), paraburgimit dhe masave të tjera parashikon që “në kuptim të juridiksionit dhe procedurës për konfiskimin e përfitimit pronësorë zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përmbarimit të BH, nëse me këtë ligji nuk është specifikuar ndryshe “. Paragrafi 2 i të njëjtit nen parashikon që sektori Penal i Gjykatës së BH-së fillon procedurën ex officio për ekzekutimin e vendimit për konfiskimin e dobisë pasurore. Në praktikën e deritanishme, janë vërejtur disa probleme në marrëdhëniet mes këtyre rregulloreve lidhur me dilemën rreth kompetencës së Prokurorisë Publike të BH për t’i filluar procedurat e përmbarimit. Duhet gjithashtu të theksohet se dispozitat e KP të BH dhe KPP të BH nuk rregullojnë në detaje përmbajtjen e vendimit të gjykatës me të cilën konfiskohet përfitimi pronësor, në dobi të së cilit (p.sh. shteti i BH) e bën konfiskimin, vlerë (përfshirë edhe kundërvlerën monetare) e atij përfitimi është afati i kryerjes së pagesës para se të ekzekutohet me detyrim vendimit, që shpeshherë janë vendime jo-të realizueshme duke marrë parasysh elementet e përmendura më parë të një dokumenti ekzekutiv të ngjashëm, të cilat nënkuptohen nga dispozitat e Ligjit përmbarues. Në këtë aspekt, është e ngjashme me situatën për rregullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore të fituar nga vepra penale dhe në kudër të kodeve penale në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikën Serbe, dhe Qarkun Bërçko, ashtu që në vazhdim prezantohen vetëm dispozitat e rregullave të posaçme të cilat i rregullojnë këto çështje.

Në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, një Ligj i veçantë (2014) parashikon: përmbajtjen e aktgjykimit që përcakton konfiskimin e dobisë pasurore në procedurën e pavarur (neni 6 paragrafi 2) ose procedurën për konfiskim të rregullt dhe të zgjeruar të fitimit material (neni 11 paragrafi 1) i Ligjit për Procedurën e Përmbarimit në Federatën e BH dhe juridiksionin e Prokurorisë Federale për fillimin e procedurës së përmbarimit (neni 24). Në këtë mënyrë sigurohet përmbarimi vullnetar dhe i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore të nxjerra sipas dispozitave të Ligjit të veçantë. Dispozitat e Neneve 43 dhe 44 të Ligjit mbi Procedurën e Zbatimit në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës (2018) gjithashtu duhet të përmenden në dritën e nevojës për të përcaktuar më saktë kompetencat e kategorive

të caktuara të zyrtarëve (përmbaruesit, zyrtarët e Agjencisë Federale për Qeverisjen me pronën e Sekuestruar, Policisë Gjyqësore) në sferën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar nga vepra penale.

Në Republikën Serbe, dispozita e nenit 33 paragrafi 2 e Ligjit të posaçëm (2018) e parashikon përmbajtjen e vendimit në kuadër të procedurës së veçantë, ndërsa dispozita nga neni 43 paragrafi 2 parashikon përmbajtjen e vendimit për konfiskimin e përhershëm të pronës. Këto dispozita ligjore, ndonëse rregullojnë shumë çështje të ngjashme, megjithatë pjesërisht dallojnë. Në procedurën e veçantë, vendimi për konfiskim duhet të përmbajë të dhëna mbi çështjet dhe të drejtat që përfaqësojnë pronë të përfituar, vlerën monetare të përfitimit, vendosmërinë që këto sende dhe të drejta të bëhen pronë e Republikës Serbe, është një periudhë prej 15 ditësh për pagesë vullnetare nga ana e personit nga i cili konfiskohet prona, si dhe urdhri për regjistrimin e të drejtave në dobi të Republikës Serbe në regjistrat gjegjës dhe në regjistrat publik. Me dispozitën e nenit 43 paragrafi 2, këto elemente të shpalljes së vendimit nuk janë specifikuar në këtë mënyrë, gjë që ka një rëndësi të drejtpërdrejtë për procedurën e ekzekutimit. Gjithashtu, ky ligj (2018) nuk përmban dispozita që përcaktojnë autoritetin e organit (për shembull, Zyra prokurorit të shtetit) për të filluar një procedurë për zbatimin e vendimeve që heqin pasurinë e fituar me vepër penale, megjithëse është një element i përshtatshëm i dokumentit të zbatimit (kush e kërkon ekzekutimin).

Në Distriktin e Bërçkos, Ligji i veçantë (2016) në dispozitën e nenit 24, i cili pak dallon nga dispozitat federale, përcakton që Prokurori i Distriktit është i autorizuar të fillojë procedurën përmbaremore pranë Gjykatës themelore të Distriktit, e cila zakonisht merr vendime për konfiskim në procedurat për konfiskim të pavarur ose të rregullt (dhe të zgjeruar). E njëjta gjykatë me të njëjtën dispozitë ligjore është kompetente për zbatimin e urdhrin të përmbaremit. Dispozitat e neneve 6 dhe 10 të Ligjit të veçantë (2016) specifikojnë përmbajtjen e vendimit të aktgjykimeve me të cilat është marrë dobia pasurore ashtu që specifikohen elementet që për ndryshe kërkohen në Ligjin e Procedurës përmbaremore me qëllim që aktgjykimi të tillë e ka karakterin e një dokumenti ekzekutiv.

3.2.4.2. Pjesëmarrësit në procedurat për ekzekutimin e vendimeve për konfiskimin e përhershëm të përfitimit pronësor

Në varësi të asaj se cilat dispozita zbatohen (ligjet sistemore ose të veçanta), procedura e përmbaremit, nëse nuk e bën vullnetarisht në të ashtuquajturën “periudha paricion”, fillon me propozimin e prokurorit kompetentë, e që zakonisht vendoset nga gjykatat komunale, ndërsa zbatimi i urdhrin të përmbaremit i është besuar gjykatave, agjencive për qeverisje me asetet konfiskuara dhe organeve kompetente, varësisht nga lloji dhe destinimi i pronës së konfiskuar në mënyrë të përhershme.

3.2.4.3. Mbrojtja e të drejtave të personave të tretë

Kur kemi të bëjmë me dispozitat sistemore në nivel të BH-së, entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos, ato i referohen zbatimit të dispozitave të zbatueshme të ligjit, të cilat përsëri përmbajnë dispozita mbi të drejtat e palëve të treta gjatë procedurës së përmbaremit, lidhur me ekzekutimin e aktgjykimeve për konfiskimin e përhershëm të përfitimit pronësorë.

Ligjet e veçanta parashikojnë dispozita të veçanta në këtë drejtim, kështu që në Federatën BH (2014), sipas dispozitës së nenit 23, parashikohet që personi i tretë ka të drejtë të paraqesë kundërshtim deri në marrjen e vendimit për përmbaremin dhe të drejtën për të kërkuar pezullimin e masës së përkohshme (nëse është e përcaktuar në procedurë). E njëjta dispozitë parashikon veprimin e gjykatës sipas këtij kundërshtimi si dhe të çështje tjera që kanë të bëjnë me përdorimin e dokumenteve publike për vërtetimin e të drejtave të palëve të treta, por edhe për zbatimin e dispozitave dhe supozimeve ligjore etj.

Në Republikën Serbe, dispozitat për të drejtat e palëve të treta në procedurën përmbartimore nuk janë parashikuar në Ligjin e veçantë (2018).

Në Qarkun e Bëçkos, dispozita e nenit 23 të Ligjit të veçantë (2016) e rregullon këtë çështje në të njëjtën mënyrë sikurse edhe dispozitat federale.

3.3. MALI I ZI (MZ)

Në Malin e Zi janë në fuqi dispozitat sistemore , saktësisht Kodi Penal (KP, 2018) dhe Kodi i Procedurës Penale (KPP, 2018), si dhe dispozita të veçanta në formën e Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Veprimtari Kriminale (LKPFVK, 2015) i cili si *lex specialis*, ndër të tjera, rregullon procedurën e konfiskimit të zgjeruar të pasurisë së fituar me veprimtari kriminale.

3.3.1. Hetimet Financiare

3.3.1.1. Nisja e hetimeve financiare

KPP (2018) nuk i njeh hetimet financiare si procedurë të veçantë. Megjithatë KPP-ja (2018) neni 257 b parashikon mbledhjen e të dhënave për llogaritë bankare dhe transaksionet bankare dhe paragrafi (1) specifikon se nëse ka baza për dyshim se një person ka kryer, është duke kryer ose përgatitet për kryerjen e veprave penale të ndjekura sipas detyrës zyrtare, me propozim të prokurorit të shtetit, gjyqtari hetues, me vendim, mund ta detyrojë bankën të dërgojë të dhëna në llogaritë bankare dhe transaksionet bankare të këtij personi, brenda një periudhe të caktuar, për të zbuluar autorin dhe për të mbledhur prova ose për ta gjetur, identifikuar personin dhe për të gjurmuar për personin që është në arrati apo personat për të cilët është lëshuar fletë arrest ndërkombëtar.

Me nenin 11 të LKPFVK-së (2015) është përcaktuar që me urdhër të prokurorit të shtetit mund të fillohet hetimi financiar nëse ka :

- 1) Bazë të dyshimit se pasuria e zotëruesit është dukshëm jo proporcionale me të ardhurat e tij legjitime;
- 2) dyshim të bazuar se dobia pasurore është fituar me veprimtari kriminale; dhe
- 3) bazë për dyshimin se është kryer vepra penale nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji.

Në urdhrin nga paragrafi 1 i këtij neni, definohet personi kundër të cilit kryhet hetim financiar (LKPFVK, 2015).

Pika 3) e këtij neni e lidhë bazën për dyshimin me veprën penale nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji (2015).

Ligji për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Veprimtari Kriminale parashikon që policia të kryejë hetimin financiar me qëllim të zbulimit të të ardhurave nga krimi, me iniciativën e vet ose me urdhër të Prokurorit të Shtetit, i cili i udhëheq hetimet financiare (LKPFVK, 2015, neni 14).

3.3.1.2. Qëllimet e hetimeve financiare

Qëllimet e hetimeve financiare pasqyrohen në mbledhjen e të dhënave dhe provave mbi pronën, të ardhurat legale dhe shpenzimeve personit, të cilat kërkohen nga prokurori i shtetit për të paraqitur kërkesë për konfiskim të përhershëm të dobisë pasurore.

Ligji (2015) specifikon se hetimi financiar duhet të japë përgjigje për pyetjet në vazhdim:

- cilat janë të dhënat dhe dëshmitë e pasurisë ose të ardhurave ligjore të mbajtësit pas zbritjes së taksave dhe tarifave të tjera të paguara, si dhe pariteti : të ardhura - pasuri;
- cilat janë të dhënat dhe dëshmitë e pasurisë së transferuar tek palët e treta ose të transferuara tek një pasuesi ligjor, si dhe mënyra e fitimit dhe e transferimit të pronës.

Ligji (2015) lë mundësinë për të hetuar të dhëna të tjera dhe dëshmi relevante për konfiskimin e pasurisë së fituar nëpërmjet aktivitetit kriminal.

Ligji (2015) parashikon që me kërkesë të Prokurorit të Shtetit, gjykatësi hetues me vendim të detyrojë bankën ose institucionin tjetër financiar që të dërgoi të dhënat e nevojshme për zbulimin dhe identifikimin e të ardhurave nga krimi. Konsiderohet se këto të dhëna ofrojnë një mundësi praktike për të monitoruar lëvizjen e aseteve financiare.

Në rendin juridik të MZ nuk mund të gjendet normë e qartë që lejon monitorimin e fshehtë të llogarive gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe mund të thuhet se nuk ekziston.

Nga kjo rrjedh se LKPFVK (2015) ka të bëjë me konfiskimin e zgjeruar të fitimit material, në mënyrë që nominimi eksplicit i hetimit financiarë, vërtetë t'i referohet atij regjimi të veçantë të konfiskimit.

3.3.1.3. Specifikat e kryerjes së hetimit financiar

Siç u tha më parë, Ligji (2015) parashikon që, në bazë të urdhrit të gjyqtarit hetues, bankat dhe institucionet e tjera financiare duhet të ofrojnë të dhëna që mund të jenë dëshmi për qëllim të kryerjes së hetimeve financiare.

Gjithashtu, Ligji (2015) me nenin 14 parashikon masa dhe veprime për zbulimin dhe identifikimin e të ardhurave nga veprimtaria kriminale, në mënyrë që policia, duke vepruar me iniciativën e vet ose me urdhër të prokurorit të shtetit, të ndërmerr masa dhe veprime për zbulimin dhe identifikimin e të ardhurave nga krimi.

Në harmoni me nenin 16. LKPFVK (2015) nuk ka kufizime në përdorimin e provave për qëllime të hetimit financiar.

Ligji (2015) parashikon që organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, organet e vetëqeverisjes lokale, personat juridik që ushtrojnë autoritet publik dhe subjekte të tjera janë të detyruar t'i sigurojnë policisë të dhënat e kërkuara të nevojshme për zbulimin dhe identifikimin e të ardhurave nga krimi.¹³⁷

KPP (2018, neni 89) Parashikon pjesërisht se prokurori i shtetit mund të kërkojë nga autoritetet shtetërore që të kryejnë kontrollin e biznesit të personave të caktuar dhe të sigurojnë dokumenta-

137 Nëse policia vepron me iniciativën e vet, lind pyetja se me cilin akt i kërkon të dhënat, a ka ndodhur në praktikë që të mos ia dërgojnë ato të dhëna, duke u thirrur në atë se nuk ka baza të vlefshme ligjore etj.?. Për shembull, në rastin e qasjes në të dhënat nga kadastra, me një shkallë të qartë të pa definuar të dyshimit, të dhënat kërkohen për një numër më të madh personash dhe, për shembull, kërkohet historia e regjistrimit dhe ndryshimit. Praktika vë në dukje se më së shpeshti është qasja indirekte në informacion. Kjo mënyrë bëhet përmes qasjes në informata nëpërmjet drejtuesit të institucionit ose personit të autorizuar. Kjo mënyrë krijon probleme të caktuara, të cilat reflektohen në faktin se minimum një person është i njoftuar me qëllimin e policisë për të kryer hetim, tjetri është problemi se qasja e tillë do të zgjasë më shumë. Kohë të gjatë, është duke u planifikuar krijimi i një sistemi të vetëm informacioni, përmes të cilit do të merren drejtpërdrejt të dhënat, të cilat do të përdoren për hetime efikase financiare. Ky sistem ende nuk ekziston në një mënyrë që do të garantonte qasje të shpejtë, të mbrojtur, mbështetur në bazën ligjore për qasje në informacionin e nevojshëm. Praktika tregon se policia mund të qaset në të dhënat e mbledhura p.sh. në lidhje me pronarët e automjeteve. Parashtrohet pyetja nëse prokuroria e posaçme dhe policët tjerë mund ta bëjnë këtë, sa është numri i tyre që mund të shihet se kanë pasur qasje në të dhëna për qëllime të hetimit financiar. Nëse është kështu, mund të konkludohet se ka shumë persona që e dinë ose që do ta dinë se kryhet një hetim financiar dhe në këtë mënyrë e gjithë procedura mund të rrezikohet.

cionin dhe të dhënat që mund të shërbejnë si dëshmi e veprës penale ose pasurie të fituar me veprë penale, si dhe njoftimet për transaksione të dyshimta të parave.

Për më tepër, prokurori i shtetit ka autoritetin të kërkojë që organi ose organizata kompetente të pezullojë përkohësisht pagesën ose dhënien e parave të dyshimta, letrave me vlerë ose sendeve, maksimalisht për gjashtë muaj.

Gjithashtu, me propozim të prokurorit të shtetit, gjykata mund të nxjerrë vendim për pezullimin e përkohshëm të ekzekutimit të transaksionit të caktuar monetar për të cilin ekziston dyshimi i arsyeshëm se përbën veprë penale ose që ka për qëllim të ekzekutimit ose fshehjes së veprës penale ose përfitimeve të kryera nga vepra penale.

Gjykata konstaton se fondet në formën e tyre të kambialeve ose parave të gatshme përkohësisht konfiskohen dhe depozitohen në një llogari të posaçme me qëllim të mbajtjes së tyre deri në përfundimin e procedurës penale, ose deri sa të plotësohen kushtet për kthimin e tyre.

Të drejtat e njeriut janë të garantuara në mënyrë që pala dhe avokati mbrojtës të bëjnë ankesë ndaj vendimit (aktvendimit) të gjykatës. Ankesa mund të bëhet nga pronari i fondeve monetare ose mbrojtësi i tij, respektivisht personi juridik nga i cili fondet janë marrë përkohësisht. Për ankesën vendos kolegji i së njëjtës gjykatë.

Marrja e informacionit mbi llogaritë dhe transaksionet bankare është përcaktuar nga neni 257b. KPP (2018), në rastet kur ka baza për dyshim se personi i caktuar ka kryer, kryen ose po përgatitet për kryerjen e veprave penale të ndjekura sipas detyrës zyrtare, me propozim të prokurorit të shtetit, gjykatësi hetues me një vendim, mund ta detyrojë bankën që brenda një kohe të caktuar t'i dorëzojë të dhënat mbi llogaritë dhe transaksionet bankare të atij personi, me qëllim të zbulimit të kryerësit dhe mbledhjes së provave ose me qëllim gjetjen, identifikimin e personit si dhe për kërkimin e personit në arrati ose personit për të cilin ka fletë arrest ndërkombëtar. Marrja e të dhënave në lidhje me regjistrimet e komunikimeve telefonike, përjashtimi i të dhënave të mbajtura nga trafiku i telekomunikacionit, dhe që mund të lidhen me hetimet financiare, merren me urdhër të gjyqarit hetues, por me propozim të prokurorit të shtetit.

3.3.1.4. Përfundimi dhe zbatimi i rezultateve të hetimeve financiare

LKPFVK (2015, neni 17) parashikon që, nëse të dhënat dhe dëshmitë e nxjerra gjatë hetimit financiarë, tregojnë se ekziston bazë dyshimi se përfitimi material i fituar nëpërmjet veprimtarisë kriminale është transferuar tek personi tjetër i cili nuk përfshihet me urdhrin për tu hetuar, prokurori i shtetit do të nxjerrë një urdhër për ta zgjeruar hetimin financiar edhe ndaj atij personi.

LKPFVK-ja (2015) në nenin 18 parashikon që:

- Prokurori i shtetit e përfundon hetimin financiar kur ai e konstaton se gjendja është sqaruar mjaftueshëm për paraqitjen e kërkesës për konfiskimin e përhershëm të përfitimit pronësorë ose për pezullimin e hetimit financiar;
- Prokurori i Shtetit do të urdhërojë pezullimin e hetimit financiar nëse gjatë hetimit financiar ose në fund të hetimit konstaton se nuk ka kushte për paraqitjen e kërkesës për konfiskim të përhershëm të përfitimit pronësorë.

Rezultati i hetimit financiar duhet të jetë kërkesë për konfiskim të përhershëm të përfitimit pronësorë. LKPFVK (2015) në nenin 16 përcaktohet se hetimi financiar do të kryhet në pajtim me këtë ligj dhe KPP (2018).

Për qëllime të hetimit financiar mund të përdoren provat e nxjerra në procedurën penale për veprën penale nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji (2015). Provat e marra në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni mund të përdoren në procedurën penale (LKPFVK, 2015). Çështja e ekspertizës së detyrueshme përshkruhet nga dispozitat e KPP-së (2018). KPP (2018, neni. 480) përcakton se “gjykata do ta përcaktoj shumën e përfitimeve si pas vlerësimit të lirë, nëse vendimi i saj do të shkaktonte vështirësi disproporcionale ose dukshëm do t'i zgjaste procedurat”.

3.3.2. Masat e përkohshme të sigurimit të pasurisë (bllokimi/ngrirja dhe konfiskimi/ sekuestrimi i përkohshëm)

3.3.2.1. Kuadri ligjor për zbatimin e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë

Për konfiskimin e rregullt të dobisë pasurore, zbatohen dispozitat e KPP-a (2018, neni 481 dhe dispozitat tjera relevante), ndërsa për sekuestrimin e zgjeruar dispozitat *lex specialis* (Ligji për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Veprimtari Kriminale, 2015). Përmbajtja e KPP-a (2018) i LKPFVK-a (2015) tregon se nuk ka dallim midis bllokimit dhe sekuestrimit.

Neni 34. i *lex specialis*-a përcakton në mënyrë eksplicite se dispozitat e këtij ligji që rregullojnë procedurën, juridiksionin dhe kohëzgjatjen e masave të përkohshme të sigurisë zbatohen në përputhje me procedurën, juridiksionin dhe kohëzgjatjen e sekuestrimit të përkohshëm të pronës (Ligji për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Veprimtari Kriminale, 2015).

Dispozita e KPP-a (2018, neni 90a) e parashikon se gjykatësi hetues vendos për sekuestrimin e përkohshëm të dobisë pasurore. Kur është fjala për sekuestrimin në fazën e shqyrtimit kryesor gjyqësor, atëherë vendos kryetari i kolegjit, i cili drejton procesin gjyqësor. Procedurën e fillon prokurori i shtetit. Prokurori cek arsyet për dyshimin se sendet ose dobia pasurore të fituara në mënyrë të paligjshme dhe arsyet për mundësinë që deri në përfundim të procedurës sekuestrimi i sendeve ose përfitimeve pronësore të pengohet dukshëm ose të pamundësohet sekuestrimi i sendeve apo i dobisë pasurore.

Kur është fjala për konfiskimin e zgjeruar, atë e parashikon *lex specialis*. Ky ligj (2015) parashikon që kushtet për sekuestrimin e përfitimit pronësor, që kryerësi me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar për vepër penale, nëse i akuzuari ose personi të cilit i është transferuar prona nuk e dëshmon një origjinën ligjore të pronës.

3.3.2.2. Propozimi ose kërkesa për dhënien e masave të përkohshme të sigurimit të përfitimit pronësor

Në KPP, është fjala për kërkesë (2018, neni 481., lidhur me nenin 243, dhe nenin 90a) për shqiptimin e masave të përkohshme të sigurisë. Ligji nuk është i qartë në aplikimin e të dyja llojeve të masave të sigurimit, kështu që mund të konkludohet se nuk e ndalon aplikimin kumulativ.

Si pas nenit 21. LKPFVK (2015), masën e përkohshme të sigurisë me vendim e përcakton gjykata, me propozim të prokurorit të shtetit. Në raste urgjente, prokurori i shtetit mund të urdhërojë:

- ndalimin e posedimit dhe përdorimit e pasurisë së patundshme, me regjistrimin e ndalimit në kadastrën e patundshmërive;
- bankën që të mos e bëjë pagesën e shumës monetare për të cilën përcaktohet masa e përkohshme e sigurisë;
- ndalimin e mundësinë së kërkesave të borxheve nga marrëdhëniet detyimore;
- ndalimin e tjetërsimit dhe barrën e aksioneve ose interesave në kompani, me shënimin e ndalimit në regjistrat publik;

- ndalimin e përdorimit ose disponimin e të drejtave të bazuara në aksione dhe interesa në një kompani dhe letra me vlerë të tjera;
- përcaktimin e sekuestrimit të përkohshëm të pasurisë së tundshme (konfiskim).

Prokurori i Shtetit njofton pa vonesë gjyqtarin për urdhrin dhe paraqet propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë. Urdhri do të jetë në fuqi deri në marrjen e vendimit nga gjykata. Në bazë të kësaj, mund të konkludojmë se është i mundur urdhri kumulativ.

3.3.2.3. Shqiptimi i masave të përkohshme për sigurimin e përfitimit pronësorë

Ligji (2015) e parashikon veprimin me propozim të prokurorit, siç u tha më lartë. KPP (2018, neni 481) parashikon se kur ekzistojnë kushtet për sekuestrimin e pasurisë, gjykata, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit, përcakton masat e përkohshme të sigurisë sipas dispozitave të ligjit që rregullon procedurën e përmbarimit. Në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e nenit 243 në përputhje me këtë Kod (2018). neni 243. KPP (2018), si në vijim:

- 1) Me propozimin e personave të autorizuar nga neni 235 i këtij Kodi, në procedurën penale, në pajtim me dispozitat e ligjit që rregullon procedurën e përmbarimit mund të përcaktohen masat e përkohshme për sigurimin e kërkesës pronësore juridike të paraqitur për shkak të kryerjes së veprës penale.
- 2) Vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni në hetuesi e nxjerr gjyqtari hetues. Pas ngritjes së aktakuzës, vendimi merret nga kryetari i kolegjit, jashtë seancës kryesore, ndërsa në seancën kryesore kolegji.
- 3) Nuk lejohet ankesë kundër vendimit të kolegjit për masat e përkohshme të sigurisë. Në raste të tjera, kolegji vendos për ankesën e përmendur në nenin 24 paragrafi 7 të këtij Kodi. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit).

Si pas KPP-së fjala është për vendimin (2018, neni 481., lidhur me nenin 243, dhe nenin 90b), që do të thotë se gjykata i përcakton masat për sigurimin e përfitimit pronësor me vendim. Gjyqtari hetues e cakton seancën dëgjimore për të vendosur mbi propozimin për masën e përkohshme. Seanca do të mbahet jo më vonë se tri ditë pas dorëzimit të propozimit për përcaktimin e masës së përkohshme të sigurisë. Prokurori i shtetit thirret në seancë, prania e të cilit është e detyrueshme. Pas dëgjimit, dhe jo më vonë se tri ditë pas seancës dëgjimore, gjyqtari hetues do të bjerë vendim që përcakton masën e përkohshme të sigurisë ose vendim që refuzon propozimin për përcaktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Duhet arsyetuar vendimi për përcaktimin e masës. Gjykatësi hetues nuk i detyrohet propozimit të prokurorit të shtetit për të përcaktuar masën e përkohshme të sigurisë lidhur me llojin e masës.

Me nenin 22. LKPFVK (2015) parashikohet që propozimi për përcaktimin e masës së përkohshme të sigurisë përmban: informacionin mbi poseduesin ose pronarin e sendit, titullin ligjor të veprës penale dhe përfitimin material që është objekt i masës së përkohshme të sigurisë; dëshmi për bazën ligjore të pronësisë; rrethanat nga të cilat lind dyshimi i bazuar se të përfitimi pronësorë rezultojnë nga veprimtaria kriminale dhe arsytet që justifikojnë nevojën për përcaktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Masa e përkohshme e sigurisë me vendim përcaktohet nga gjykata me propozim të prokurorit të shtetit. Gjyqtari hetues është kompetent për përcaktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ndërsa për ankesën vendos kolegji që përbëhet nga tre gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë.

LKPFVK (2015) neni 19. i përcakton masat e sigurisë. Për qëllim të ruajtjes së përfitimeve pronësore

nga krimi dhe për sekuestrimin e mundshëm të më vonshëm të këtyre përfitimeve, prokurori i shtetit mund të propozojë masën e përkohshme të sigurisë (ngrirjen e aseteve), si në vijim:

- 1) ndalim posedimit dhe përdorimit të pasurive të patundshme, dhe me shënim të ndalimit në kadastrën e patundshmërive;
- 2) urdhëron bankën që të mos e bëjë pagesën e shumëve monetare për të cilën përcaktohet masa e përkohshme e sigurisë;
- 3) ndalimin e mundësinë së kërkesave të borxheve nga marrëdhëniet detyrimore;
- 4) ndalimin e tjetërsimit dhe barrën e aksioneve ose interesave në kompani, me shënimin e ndalimit në regjistrat publik;
- 5) ndalimin e përdorimit ose disponimit të drejtave të bazuara në aksione dhe interesa në një kompani dhe letra të tjera me vlerë;
- 6) aplikimin e administratës së përkohshme në kompani.

Për ta ruajtur përfitimin pronësorë që rezulton nga veprimtaria kriminale dhe për të mundësuar konfiskimin e përhershëm të përfitimit të tillë, gjykata mund të urdhërojë sekuestrimin e përkohshëm të pasurisë së tundshme, me propozim të prokurorit të shtetit.

Gjatë përcaktimit të masës së përkohshme të sigurisë, gjykata do të kufizohet në vërtetimin e shpërpjesëtimit të dukshëm midis vlerës së pasurisë pas zbritjes së taksave të paguara dhe tarifave të tjera dhe të ardhurave ligjore të poseduesit.

Duket se LKPFVK (2015) nuk e parashikon në mënyrë eksplicite parimin e qartë të proporcionalitetit, por supozohet se gjykatat, përmes trajtimit të rasteve të veçanta, i përmbahen të njëjtës gjë gjatë një pjese të procedurës kur përcaktohen masat e përkohshme të sigurisë.

KPP (2018, neni 85) parashikon në lidhje me sekuestrimin e përkohshëm të përfitimit pronësor zbatohet dispozita e nenit 481, lidhur me nenin 243 dhe 245 të KPP-së. Vendimin për hetim e jen gjyqtari hetues. Pas ngritjes së aktakuzës, vendimi merret nga kryetari i kolegjit, jashtë seancës kryesore, dhe në seancën kryesore nga kolegji.

Sipas LKPFVK (2015), masat e sigurimit / sekuestrimit kanë të bëjnë kryesisht me poseduesin e sendit, persona të cilët janë të parashikuar në nenin 7 të Ligjit .¹³⁸

3.3.2.4. Procedura ankimuese

LKPFVK (2015) me nenin 27 e parashikon që kundër vendimit të gjyqtarit hetues që refuzon propozimin e prokurorit të shtetit për përcaktimin e masës së përkohshme të sigurisë, prokurori i shtetit mund të bëjë ankesë brenda tetë ditëve nga data e dorëzimit të vendimit.

Kundër vendimit të gjyqtarit hetues, i cili përcakton masën e përkohshme të sigurisë, poseduesi, mbrojtësi ose i autorizuari i tij mund të ushtrojnë ankesë, brenda tetë ditëve nga data e dorëzimit të vendimit, e që nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

138 Posedues është i akuzuari, paraardhësi ligjorë, pasardhësi ligjor dhe anëtar i familjes së të tij ose personi i tretë. I dyshuari, është personi kundër të cilit është iniciuar aktakuzë penale ose personi i dënuar për vepër penale. Palë e tretë është person fizik ose juridik të cilit dobia pasurore e fituar me veprimtari kriminale i është transferuar pa pagesë ose për një kompensim që padyshim nuk korrespondon me vlerën reale dobisë pasurore, që e ka ditur ose mund të ketë ditur se dobia pasurore e fituar me veprimtari kriminale ose do të duhej ta dinte. Pasardhësi ligjor është trashëgimtari i të akzuarit, personit të tretë ose pasuesit të tij, respektivisht person fizik ose juridik tek i cili janë transferuar të drejtat e pronës me transaksion ligjor

Përveç ankesës nga paragrafi 2 i këtij neni, poseduesi e dorëzon dëshminë e origjinës së përfitimit material për të cilin është caktuar masa e përkohshme e sigurisë (LKPFVK, 2015).

Në procedurën ankimore kundër vendimit që urdhëron masën e përkohshme të sigurisë, kolegji cakton seancën në cilën ftohen: poseduesi, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit.

Për të vendosur për ankesën kundër vendimit që e refuzon propozimin e prokurorit të shtetit për përcaktimin e masës së përkohshme të sigurisë, kolegji cakton një seancë dëgjimore dhe fton prokurorin e shtetit.

3.3.3. Veprimet për sekuestrim të përhershëm të produkteve të veprave penale

3.3.3.1. Llojet e veprimeve dhe karakteristikat e tyre themelore

KP i MZ (2018) përcakton në nenin 112 se sekuestrimi i rregullt kryhet në përputhje me dispozitat e nenit 478 të KPP-së (2018).

LKPFVK (2015) e parashikon sekuestrimin e zgjeruar.

Procedura e pavarur objektive mund të përcaktohet në rast se ka pengesa procedurale (p.sh. vdekja e kryerësve, imuniteti, amnistia etj.) dhe me kusht që prona t'i nënshtrohet sekuestrimit sipas dispozitave të *lex specialis*.¹³⁹

Veprimi i rregullt konsiderohet procedura e aderimit (shoqërimit) dhe e nënkupton pjesëmarrjen e të interesuarve (personi nga i cili merren gjërat dhe të drejtat) ndërsa procedura për konfiskim të zgjeruar, pasi që fillon pas plotë fuqizimit të aktgjykimit penal, mund të konsiderohet si veprim i pavarur *post judicem*, e cila ka strukturën dhe veçantinë e vet.

Përfshirja e publikut nuk zbatohet për personat të cilëve u është transferuar përfitimi pronësorë ose për të cilin është mbledhur përfitimi pronësorë, si dhe përfaqësuesit e personit juridik nga i cili sekuestronhet ai përfitim.

3.3.3.2. Të drejtat procedurale të personave për të cilët merret masa e konfiskimit të dobisë pasurore

KPP-ja (2018, neni 485) përcakton se për veprimin e sekuestrimit të përfitimit aplikohen edhe dispozitat tjera të dispozitat e tjera të këtij KPP, nëse me dispozitat e kapitullit që përcakton procedurën për konfiskimin e përfitimit - dispozitat e përgjithshme mbi konfiskimin përfitimit pronësor nuk është specifikuar ndryshe. I njëjti Kod (2018, neni 476) përcakton se personi si dhe përfaqësuesi i personit juridik, nga i cili konfiskohen përfitimi i transferuar, dëgjohen në seancën kryesore. Përfaqësuesi i personit juridik do të dëgjohet në seancën kryesore pas të akuzuarit. Në këtë mënyrë, ai trajtohet ndaj personit tjetër, nëse nuk thirret si dëshmitar. **Këta persona, në lidhje me përcaktimin përfitimit, mund të propozojnë prova dhe t'u bëjnë pyetje të akuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve.**

¹³⁹ Ligji për amnisti përcakton se kjo gjithashtu nënkupton lirimin nga ndjekja penale. Këto dispozita nga rregullat e rendit juridik të Malit të Zi nuk e derogojnë dispozitën e *lex specialis* për konfiskimin e përfitimeve pronësore, edhe pse nuk mund të vazhdojë ndjekja për shkak të ekzistencës së rrethanave që e përjashtojnë atë përgjithmonë, përfitimet pronësore të fituara veprimtari penale do të konfiskohen në procedurën për konfiskim të përhershëm të përfitimeve pronësore në pajtim me këtë ligj. Akti i faljes i njohur në teori dhe praktikë në qenien e tij nuk nënkupton edhe abolimin e sekuestrimit të përfitimit pronësore të fituar me veprimtari kriminale.

Përveç dispozitave të lartpërmendura të KPP (2018) në lidhje me procedurat e rregullta, LKPFVK (2015), në veçanti neni 40, e parashikon që prokurori i shtetit depoziton dëshmi mbi pasurinë e të akuzuarit, të ardhurat e tij ligjore dhe rrethanat që tregojnë ekzistencën e shpërpjesëtimit të dukshëm ndërmjet vlerës së pronës pas zbritjes taksave të paguara dhe detyrimet e tjera me të ardhurat e ligjshme.

I akuzuari, ose avokati i tij mbrojtës, deklarohen për akuzat e Prokurorit të Shtetit.

Nëse lënda e padisë është pronë e pasuesit juridik, e anëtarit të familjes së të akuzuarit ose e personit të tretë, prokurori i shtetit paraqet prova se pasardhësi ligjor e ka trashëguar përfitimin pronësorë të fituar me veprimtari kriminale, domethënë i transferuar tek anëtari të familjes së të akuzuarit ose te personi i tretë, pa, ose me kompensim, i cili padyshim nuk korrespondon me vlerën reale, me qëllim që të mos e lejojë sekuestrimin.

Pasuesi ligjor, anëtari i familjes së të akuzuarit, personi i tretë, ose të autorizuarit e tyre, duhet të deklarohen për akuzat e prokurorit të shtetit.

3.3.3.3. Vendimi që urdhëron sekuestrimin e pasurisë

Gjykata *ex officio* i sekuestron përfitimet pronësore në procedurën e rregullt (KPP, 2018, neni 478), ndërsa për sekuestrim të zgjeruar nuk ka mundësi të tillë.

KPP (2018) në nenin 482 parashikon që: “në dispozitivin e aktgjykimit ose vendimit, gjykata do të listoi sendet me vlerë dhe shumat monetare ose ndonjë dobi pasurore tjetër që do të sekuestrohen”.

LKPFVK (2018, neni 41) parashikon që pas përfundimit të seancës kryesore, gjykata jen një vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesë për konfiskim të përhershëm të përfitimit pronësorë.

Vendimi për konfiskim të përhershëm të përfitimeve përmban të dhëna për poseduesin, emërtimin ligjorë të veprës penale nga aktgjykimi, të dhënat mbi përfitimin dhe vlerën e dobisë pasurore që i konfiskohet poseduesit, nëse poseduesi e ka pasur në disponim atë pasuri si dhe vendimin për shpenzimet e administrimit të përfitimit pronësor, për të cilin është caktuar masa e përkohshme e sigurisë, ashtu edhe për kërkesën pronësore – juridike që e parashtron i dëmtuari, por edhe për shpenzimet e përfaqësimit.

3.3.3.4. Procedura ankimese

KPP (2018) në nenin 382 e parashikon se ankesë mund të ushtrojnë palët, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari. Gjithashtu, në favor të akuzuarit mund të ushtroi ankesë edhe partneri/ja bashkëshortore i tij, një i afërm i gjakut në vijën e drejtë, adoptuesi, e adoptuari, vëllai, motra, ushqyesi dhe personi me të cilin jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Prokurori i shtetit mund të bëjë ankesë kundër ose në favor të akuzuarit.

Ankesa mund të bëhet kundër aktgjykimit të shkallës së parë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e dorëzimit të përshkrimit të aktgjykimit. Ankesa mund të miratohet, ashtu që gjykata me vendim e anulon aktgjykimin e shkallës së parë dhe e kthen në rigjykim, para së gjithash, për shkak të ekzistimit të shkeljes substanciale të procedurës penale ose mos konstatimit të plotë gjendjes faktike. Gjykata urdhëron gjykim të ri para gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit mund ta mbështesë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë.

Në procedurën për konfiskimin e përhershëm të përfitimit... , pas përfundimit të seancës kryesore, gjykata bien vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës për konfiskimin e përhershëm të përfitimit pronësorë. Kundër vendimit mund të ushtrojnë ankesë: poseduesi, mbrojtësi i tij respektivisht i autorizuari, prokurori, pala e dëmtuar dhe i autorizuari tij , brenda 15 ditëve nga data e pranimit të vendimit. Gjykata kompetente e shkallës së dytë vendos për ankesën

Duke vendosur si pas ankesës, gjykata e shkallës së dytë mund ta hedh poshtë ankesën si të vonuar ose të paligjshme, mund ta hedh poshtë ankesën si të pabazuar ose ta aprovoi, ta modifikoi ose ta ndryshoi vendimin ose ta anuloi dhe ta kthejë çështjen për rigjykim.

Nëse vendimi veç është anuluar një herë, gjykata e shkallës së dytë e cakton seancën dëgjimore dhe do të vendosë sipas ankesës, me ç' rast vendimi nuk mund të shfuqizohet që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Veprimi që në përputhje me këtë ligj është, përfunduar me vendim përfundimtar, mund të përsëritet me kërkesë të prokurorit të shtetit ose poseduesit në përputhje me nenet 424 deri 432 të KPP (2018).

3.3.3.5. Informimi i Agjencisë për Administrimin e Aseteve dhe subjekteve të tjera

Detyrat e menaxhimit kryhen nga autoriteti kompetent, d.m.th. Drejtoria e Pronave, ex officio ose me vendim gjyqësor, me kujdesin e nikoqirit të mirë, në një mënyrë që garanton shkallën më të lartë të ruajtjes së vlerës së dobisë pasurore të konfiskuar, me kostot më të ulëta.

Në evidencën mbi sekuestrimin e dobisë pasurore futen të dhënat për :

- 1) vendimet përfundimtare të gjykatave me të cilat janë caktuar masat e përkohshme të sigurisë, sekuestrimi i përkohshëm i pasurisë së tundshme dhe konfiskim i përhershëm i dobisë pasurore të fituar me veprimtari ose vepër kriminale, numri dhe data nxjerrjes së vendimit, titulli gjykatës si dhe data kur vendimi bëhet i plotë fuqishëm;
- 2) veprën penale nga neni 2, paragrafi 2 të Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Veprimtari Kriminale, respektivisht veprës penale me të cilën është realizuar dobi pasurore - emërtimi ligjor i veprës penale dhe neni i Kodit Penal të Malit të Zi, me të cilin parashikohet vepra penale;
- 3) llojin dhe vlerën e parashikuar të dobisë pasurore të konfiskuar, si vijon:
 - » për pasurinë e tundshme - listë të gjërave, vlerën e tyre të vlerësuar, dhe vendin ku janë të vendosura këto gjëra;
 - » për pasurinë e patundshme - të dhënat mi: sipërfaqen e patundshmërive, ndërtesave, të drejtat mbi pasurinë e patundshme dhe organin në të cilin pasuria e patundshme është e regjistruar në kadastrën e patundshmërive; për kohëzgjatjen e sekuestrimit të dobisë pasurore; për përfitimin pronësorë që është besuar për ta ruajtur dhe kujt i është besuar; për pasurinë tundshme të shitur për ta ruajtur vlerën dhe për vlerën për të cilën është shitur; për shitjen e pasurisë së konfiskuar përgjithmonë; për vlerën për të cilën është shitur; për asetet që transferohen pa kompensim; për asetet e asgjësuar;
- 4) personin nga i cili konfiskohet dobia pasurore - emri, mbiemri, numri unik i identifikimit dhe adresa e personit fizik, respektivisht emri, selia dhe numri i personit juridik dhe cilësia e personit nga i cili është sekuestruar dobia pasurore;
- 5) për kthimin e dobisë pasurore të konfiskuar - numrin e vendimit të formës së prerë të gjykatës që refuzon kërkesën për konfiskim të përhershëm të dobisë pasurore dhe datën e hyrjes së vendimit në fuqi; për numrin e vendimit përfundimtar dhe datën e hyrjes së aktgjykimit në fuqi si dhe masa e kthimit të përfitimit të konfiskuar;
- 6) për sendet e sekuestruara të e veprës penale, për sendet e sekuestruara përkohësisht në procedurat penale dhe të kundërvajtjes dhe pronën e dhënë në emër të garancisë.

Evidenca mbahen veçanërisht për masat e përkohshme të sigurisë, sekuestrimin e përkohshëm të pasurisë së tundshme, konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore, mjetet e konfiskuara të veprës penale, objektet e konfiskuara përkohësisht në procedurat penale dhe të kundërvajtës dhe pronën e dhënë në emër të garancisë. Regjistri mbahet në formën e një libri të përbërë nga faqet, faqet e të cilit janë të numëruara dhe në formë elektronike. Rregullat mbi funksionimin e zyrave në organet e administratës shtetërore zbatohen në përputhje me rrethanat në mbajtjen e evidencave mbi dobitë pasurore e konfiskuara pronësore.

3.3.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë

3.3.4.1. Veprimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë

Gjykata ia dërgon vendimin Administratës së Pronës. Organi kompetent, menjëherë pas marrjes së vendimit për përcaktimin e masave (paragrafi 1,2,3,4 më poshtë), lëshon urdhër për ekzekutim:

- 1) ndalim i posedimit dhe përdorimit të pasurive të patundshme, dhe me shënim të ndalimit në kadastrën e patundshmërive;
- 2) urdhëron bankën që të mos e bëjë pagesën e shumëve monetare për të cilën përcaktohet masa e përkohshme e sigurisë;
- 3) ndalimin e mundësinë së kërkesave të borxheve nga marrëdhëniet detyimore;
- 4) ndalimin e tjetërsimit dhe barrën e aksioneve ose interesave në kompani, me shënimin e ndalimit në regjistrat publik;

Urdhri e lartpërmendur, së bashku me vendimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, organi kompetent duhet t'ia paraqes pa vonesë organit administrativ kompetent për mbajtjen e kadastrës së patundshmërive ose personit juridik i cili e mbanë regjistrin publik ose evidentimet e dobisë pasurore që është subjekt i masës së përkohshme të sigurisë ose në të cilën mbahen llogaritë e personit me të cilin ka të bëjë masa e përkohshme e sigurisë.

Organi ose personi juridik është i detyruar të veprojë sipas urdhrit të organit kompetent, në përputhje me dispozitat e ligjit në bazë të cilit organi ose personi juridik punon.

3.3.4.2. Pjesëmarrësit në procedurat për ekzekutimin e vendimeve për konfiskimin e përhershëm të pronës

LKPFVK (2015, neni 54.) e parashikon mënyrën e menaxhimit. Organi menaxhues kryen detyrat e menaxhimit, nga neni 53 i këtij ligji, sipas detyrës zyrtare ose me vendim gjyqësor, me kujdesin e nikoqirit të mirë, ashtu që e garanton shkallën më të lartë të ruajtjes së vlerës së dobisë pasurore të konfiskuar pronësor, me koston më të ulët. Neni 53 LKPFVK (2015), si në vijim:

Qeverisja (menaxhimi) e dobive pasurore të konfiskuara, përfshinë:

- 1) ekzekutimin e masave të përkohshme të sigurisë të përcaktuara në përputhje me këtë ligj ose me Kodin e Procedurës Penale;
- 2) ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin e pasurisë së tundshme dhe konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore të fituar me veprimtari kriminale;
- 3) ekzekutimin e vendimeve për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me veprimtari kriminale, objektet e veprës penale dhe sendet e konfiskuara përkohësisht në procedurën penale dhe të kundërvajtjes dhe vendimet mbi pronën e dhënë në emër të garancisë;

- 4) vlerësimin e vlerës së dobisë pasurore të konfiskuar për qëllime të menaxhimit të pasurisë;
- 5) dhënien me qira të përfitimit konfiskuar ose në mirëbesim për menaxhim, në përputhje me këtë ligj;
- 6) dhënien e dobisë pasurore të konfiskuar për përdorim pa kompensim;
- 7) magazinimin, ruajtjen, shitjen dhe kthimin e përfitimit të konfiskuar;
- 8) depozitimin e fondeve të konfiskuara dhe fondeve të marra nga shitja e dobisë pasurore të konfiskuar në përputhje me ligjin;
- 9) shkatërrimi i dobisë pasurore të konfiskuar në përputhje me ligjin;
- 10) mbajtjen e evidencave mbi dobinë pasurore të konfiskuar dhe procedurat gjyqësore në të cilat është konfiskuar, si dhe masat e përkohshme të sigurisë; dhe
- 11) veprimet tjera në pajtim me ligjin.

Në ekzekutimin e vendimeve të përmendura në paragrafin 1 të pikës 1, 2 dhe 3 të këtij neni, policia e ndihmon organin kompetent.

3.3.4.3. Mbrojtja e të drejtave të palëve të treta

Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me veprimtari kriminale nuk ndikon në të drejtat që i ka në atë pronë personi i tretë i ndërgjegjshëm. Sipas ligjit të posaçëm të konfiskimit, personi i tretë i ndërgjegjshëm mund të hyjë në procedurat që zhvillohen në pajtim me këtë ligj derisa të merret vendimi përfundimtar për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore të fituar me veprimtari kriminale.

Personi i tretë i ndërgjegjshëm mund të paraqesë propozim për anulimin ose ndryshimin e masës së përkohshme të sigurisë, merr pjesë në seancën dëgjimore, parashtron ankesë kundër vendimit që urdhëron masën e përkohshme të sigurisë, sekuestrimin e përkohshëm të pasurisë së tundshme ose konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore me veprimtari kriminale, dhe ndërmerr veprime të tjera në përputhje me këtë ligj.

Nëse personi i tretë i ndërgjegjshëm është i njoftuar fillimin e procedurës dhe nuk hynë në procedurat që zhvillohen në pajtim me këtë ligj deri në hyrjen në fuqi të vendimit për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore të fituar me veprimtari kriminale, e humb të drejtën për të kërkuar kompensim nga përfitimi i konfiskuar.

Personi i tretë i ndërgjegjshëm, kërkesën e tij ose të drejtën tjetër e përcaktuar me vendim përfundimtar për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore të fituar me veprimtari kriminale, brenda dy muajve nga data e pranimit të vendimit përfundimtar, mund t'i paraqesë kërkesë organit kompetent me qëllim të zgjidhjes së kërkesës së tij ose ushtrimit të një të drejte tjetër nga dobia pasurore e pasurisë së konfiskuar.

Vendimi mi sekuestrimin e dobisë pasurore nga veprimtaria kriminale nuk përjashton ushtrimin e të drejtave nga mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve, në përputhje me Ligjin që e rregullon mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve.

Nëse në procedurën penale për veprën penale të cekur në nenin 2 paragrafi 1 të LKPFVK (2015) ose në procedurë civile është miratuar vendimi përfundimtar i cili e ka pranuar kërkesën pronësore-juridike të palës së dëmtuar, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar në vendimin për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore do të vendosë që kërkesa për kompensim të realizohet nga dobia pasurore e pasurisë së konfiskuar, nëse kërkesa nuk zgjidhet deri në hyrjen e vendimit në fuqi.

Nëse është duke u zhvilluar procedurë civile për realizimin kërkesë pronësore – juridike, për shkak të veprës penale nga neni 2 paragrafi 1 i LKPFVK (2015), gjykata, me kërkesë të palës së dëmtuar,

në vendimin për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore, e përcakton që shumën e kërkesës pronësore – juridike ta ndajë dhe veçmas ta ruajë ose depoziton në llogari të veçantë.

Nëse në procedurën e cekur në paragrafin 2 të LKPFVK (2015) nxjerrët aktgjykimi me të cilin miratohet kërkesa pronësore – juridike, përmbarimi do të kryhet nga fondet e alokuara ose të depozituara nëse ajo kërkesë nuk është zgjidhur ndryshe.

3.4. KOSOVA*

Normimi ligjor i materies së konfiskimit të dobisë pasurore, i përfituar me vepër penale në Kosovë*, është rregulluar në kuadër të dispozitave të ligjeve sistemore, më saktësisht me Kodin për Procedurën Penale dhe me Kodin Penal, por edhe me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfituar me Vepër Penale, i cili ka karakter të rregullave *lex specialis*.

3.4.1. Hetimi financiar

3.4.1.1. Fillimi i hetimit financiar

Baza ligjore për konfiskimin e dobisë pasurore në Kosovë* është përcaktuar në dispozitën 92 të Kodit Penal (KP) (2019) “konfiskimi i mjeteve dhe dobisë pasurore të përfituar me vepër penale”, e cila në paragrafin 1. përcakton se prona dhe mjetet e krijuara me vepër penale konfiskohen me ligj, ndërsa procedura është e përcaktuar në KPP-në të Kosovës*, ndërsa paragrafi 2. i nenit të njëjtë përcakton që kur nuk është i mundshëm konfiskimi në pajtim me paragrafin 1, gjykata e urdhëron kryesin, për ta paguar shumën ekuivalente (të barasvlefshme), në të kundërtën do të konfiskohet cilado pronë e të pandehurit në vlerë ekuivalente, që është parashikuar në KPP-në e Kosovës*. Hetimet financiare përfshihen në hetime penale, në bazë të KPP-së (Neni 267.-285.).

Lex specialis është Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pronës (2018), i cili në Nenin 1 parashikon kompetencat e zgjeruara për konfiskim, në rastet kur procedurat e parashikuara në KPP nuk janë bazë e mjaftueshme për konfiskim.¹⁴⁰ Ligji zbatohet për vepra të rënda penale nga KP i Kosovës*, përkatësisht, për veprat penale, për të cilat është përcaktuar census, si kusht për fillimin e hetimit financiar dhe ka të bëjë me shumën prej 10.000 Euro. (neni 2)

Hetimin për veprat penale në fushën e kriminalitetit financiar e zhvillon prokurori i shtetit *ex officio*, ndërsa kryesisht Prokuroria e Shtetit të RK-së, në bazë të ligjit për Prokurorinë Speciale (PS) (2008) dhe në bazë të Kodit për Procedurë Penale (Kodi nr. 06/L-74).

Zyrtarët doganorë dhe nëpunësit e Administratës Tatimore të Kosovës* (ATK) janë të njohur si “polici financiare” sipas KPP-së, ata kanë kompetencë, përgjegjësi dhe obligim për hetimin dhe zbulimin e veprave penale. Në drejtim të pastrimit të parave dhe financimit së terrorizmit (Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit 2013), po të njëjtit zyrtarë janë kompetentë për hetimin e këtyre veprave penale, nën mbikëqyrjen e prokurorit të shtetit. Dogana dhe ATK-ja caktojnë një zyrtar ndërmjetësues me Prokurorinë Speciale dhe prokuroritë tjera për bashkëpunim profesional.

Si mekanizëm specifik hetues Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës^{141*} (NJIFK) është institucion i pavarur kombëtar, përgjegjës për hetimin, grumbullimin dhe analizimin e informacioneve potenciale për shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (2013). Në Nenin 3 të këtij Ligji, precizohet se veprat penale sipas këtij ligji dhe sipas ligjit bazë bëjnë pjesë në kompetenca ekskluzive të Prokurorisë Speciale të

140 * Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Qëllimi i ligjëvendësve në Kosovë ishte që ky Ligj (vullnetarisht) të harmonizohet me Direktivën e Bashkimit Evropian 2014/42 për ngrirjen dhe konfiskimin e sendeve dhe dobisë pasurore, të krijuar me vepra penale në Bashkimin Evropian.

141 * Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Kosovës*, të themeluar sipas Ligjit për Prokurorinë Speciale të Kosovës* (2008).

Njësia Speciale për Parandalimin e Korrupsionit (NJPK) si pjesë e Policisë së Kosovës* vepron si njësi në kuadër të Drejtorisë për Hetim. Kjo njësi e specializuar, së bashku me Prokurorinë Speciale, bën hetimin e veprave penale, ndërsa kompetencë themelore e kësaj njësie është hetimi dhe lufta kundër veprave penale të nivelit të lartë të korrupsionit në Kosovë*.

Agjencia Kundër Korrupsionit është institucion i pavarur, i cili ka për detyrë dhe qëllim, që të merret me parandalimin e korrupsionit dhe luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve të lartë dhe profesioneve të tjera të rëndësishme. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kundër Korrupsionit në Kosovë* rrjedhin nga Ligji Kundër Korrupsionit (2005).

Kushti bazë për zbatimin e hetimit është dyshimi i bazuar se dikush ka kryer vepër penale nga kriminaliteti financiar. Në bazë të informacioneve të grumbulluara, policia ushtron kallëzimin penal, në të cilin janë theksuar provat e grumbulluara në procedurën e grumbullimit të informacioneve dhe ia dorëzon prokurorit të shtetit.

Prokurori i shtetit, në bazë të Nenit 102 të KPP-së, mund të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se po ndodhë ose ka gjasë të ndodhë, në një të ardhme të afërt vepra penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Hetimi paraprak fillohet me vendim të prokurorit nga Neni 104 i KPP-së.

Hetimi penal, sikur edhe çdo vepër penale tjetër, fillon me vendimin për fillimin e hetimit, të cilin e merr Prokurori (Neni 104. KPP), dhe Prokuroria Speciale e Kosovës*. Për veprimet e veçanta të provave është i domosdoshëm urdhi nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Me zbatimin e Ligjit të veçantë, në bazë të Nenit 17, prokurori në rastet e ekzistimit të dyshimit të bazuar se mund të parashtrohet kërkesë për «verifikim» të pronës nga Neni 4 i ligjit të njëjtë, mund të fillojë hetimin financiar. Afati në të cilin është e mundshme të bëhet, është shumë i gjerë, do të thotë nga momenti i marrjes së vendimit për zbatim të hetimit (penal) dhe deri në skadimin e afatit prej 5 vitesh, nga aktgjykimi i plotfuqishëm kundër pronarit të pronës. Në dispozitat e Nenit 17. paragrafi 3. dhe 4. të Ligjit, definohen autorizimet e prokurorit në hetimin financiar (përkatesisht të gjitha autorizimet nga KPP), dhe rregullon kompetencat e Gjykatës Themelore për emërimin e gjyqtarit të veçantë për zbatimin e procedurave hetimore në hetimin financiar.

3.4.1.2. Qëllimi i hetimit financiar

Sipas rregullave sistemore, qëllimi themelor i hetimit financiar është pengimi dhe parandalimi i kriminalitetit financiar, si faktor i destabilizimit të ekonomisë, sistemit ekonomik dhe i sigurisë së shtetit. Veprimet dhe masat që do të ndërmerren janë në varësi për çfarë veprave penale bëhet fjalë, p.sh. shpërlarja e parave (Neni 302), fshehja e tatimit (Neni 307), mashtrimet doganore dhe veprat e tjera penale nga ekonomia e zezë të KP-së (2019).

Prokurori duhet në procedurën hetimore të përcaktojë qartë dhe saktë shumën e përfituar me vepër penale dhe ku gjenden ato para (tek i pandehuri, personi i dytë ose në institucione bankare). Sendet, prona, dëshmitë dhe paratë mund të ndalohen përkohësisht me urdhër të prokurorit të shtetit, më së shumti pesë (5) ditë, në qoftë se zyrtarët e autorizuar policorë sigurojnë informacion për këto gjëra, pronë, dëshmi apo para, gjatë bastisjes ligjore dhe arrestimit. Pas këtij afati, prokurori kërkon nga gjyqtari urdhrin gjyqësor për procedurën paraprake.

Sipas rregullave *lex specialis*, qëllimi i hetimit financiar është grumbullimi i dëshmive, të cilat do ta mundësojnë “verifikimin” e pronës, përkatësisht prejardhjes së saj të vërtetë, në bazë të dispozitave të neneve 17, 4 dhe 3 (1.7) të këtij Ligji.

3.4.1.3. Specifikat e zbatimit të hetimit financiar

Në bazë të Nenit 69 të KPP-së, i cili rregullon hetimin policor, policia heton veprat penale, në pajtim me Nenin 70, i cili në detaje rregullon veprimet hetimore policore, dhe ia paraqet këto vepra penale, sa më parë që është e mundur, prokurorit të shtetit. Procedurës penale mund t’i paraprijnë veprimet fillestare që i ndërmerren policia dhe grumbullimi i informatave, në pajtim me Nenin 84 të KPP-së, dispozitë që rregullon veprimet para fillimit të procedurës penale.

Veprimet e veçanta që ndërmerren para procedurës penale, në bazë të Nenit 84. paragrafi 1. i KPP-së, prokurori i shtetit mund të autorizojë ose të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake autorizimin për ndërrmarjen e veprimeve hetuese të fshehta apo teknike, në pajtim me nenet 86-100 KPP, në qoftë se prokurori ka dyshime të bazuara se vepra penale nga Neni 90 i KPP-së është kryer, është duke u kryer apo ekzistojnë gjasat për t’u kryer.

Me qëllim të përcaktimit të faktit vendimtar relevant për këtë formë të kriminalitetit, prokurori duhet të ketë qasje në të gjitha institucionet, ku prona gjendet, pas lëshimit të urdhrin nga gjyqtari i procedurës paraprake (p.sh. bankat, administrata tatimore, kadastra etj).

Në qoftë se këtyre institucioneve apo personave fizikë u është urdhëruar me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nëse posedojnë (kanë) të dhëna, informacion dhe prova, të njëjtit janë të obliguar që t’ia dorëzojnë prokurorit.

Me rastin e konfiskimit të sendeve, duhet theksuar ku janë gjetur dhe të ofrohet përshkrimi i tyre. Nëse është i domosdoshëm konstatimi i identitetit të tyre, do të sigurohen në ndonjë mënyrë tjetër. Për sendet e konfiskuara lëshohet vërtetimi për konfiskim.

Në qoftë se personi ose organi, që është i ngarkuar për ruajtjen e sendeve, pronës, provave ose parave, që janë lëndë e urdhrin të gjyqtarit për procedurë paraprake, refuzon t’ia dorëzojë sendin, pronën, provën ose paratë, zyrtarit policor të autorizuar, që është përgjegjës për ekzekutimin e urdhrin, gjyqtari i procedurës paraprake mund ta dënojë me gjobë atë person apo organ, në shumë prej pesëdhjetë për qind (50%) të vlerës së sendit, pronës, provës ose parave kontestuese. Personit ose organit, të cilit iu caktua dënimi me gjobë, mund të parashtrijë ankesë ndaj gjobës së caktuar ose mund ta anulojë gjobën, në qoftë se pajtohet me urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake, që hollësisht definohet me dispozitat për konfiskimin e përkohshëm të sendeve. (Neni 112, paragrafi 10 dhe 11 i KPP-së).

Ligji i veçantë shfrytëzon një term specifik “verifikim” i pronës dhe qëllimi i hetimit financiar është grumbullimi i provave dhe informatave, që duhet të japin përgjigje në pyetjen kryesore - a është prona

e ligjshme në pajtim me përkufizimin e pronës në dispozitën 3 (1.5) të këtij Ligji.¹⁴²

3.4.1.4. Përfundimi dhe zbatimi i rezultateve të hetimit financiar

Kur hetimi dhe procedura financiare zhvillohet në bazë të dispozitave të KPP-së, prokurori, në kuadër të aktakuzës paraqet propozim dhe prova për konfiskimin e dobisë pasurore, me ç'rast dispozita nga Neni 241, paragrafi 1, pika 9 e KPP-së përcakton se në vetë aktakuzë mund të theksohen lloji dhe përshkrimi i pronës, e cila propozohet për konfiskim dhe provat relevante, që në këtë drejtim duhet të zbatohen.

Nëse hetimi financiar është zbatuar sipas dispozitave të Ligjit të veçantë (2018), prokurori në bazë të dispozitës nga Neni 4, ka të drejtë të parashtrijë kërkesë të veçantë për "verifikimin" e pronës, në afat prej pesë vitesh, nga dita e aktgjykimit të plotfuqishëm, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor për vepra penale, për të cilat zbatohet ky Ligj. Prokurori, në kuadër të kërkesës, dorëzon të gjitha informacionet lidhur me pronën që është objekt i lëndës, bashkëngjijt provat për pronësinë e pronës, si dhe lajmëron të pandehurin dhe personat e tretë, të cilët mund të kenë interes juridik për pronën lëndore.

Sa i përket pezullimit të hetimeve, në çfarëdo kohe, prokurori ka mundësi për pezullimin e hetimeve në çfarëdo kohe në qoftë se në bazë të provave të grumbulluara është e qartë që: nuk ekziston dyshim i bazuar se personi i caktuar e ka kryer veprën e theksuar penale; vepra e kryer nuk është vepër penale, që ndiqet sipas detyrës zyrtare etj. (Neni 158, par. 1 i KPP-së).

Pas pezullimit të hetimit, në qoftë se sigurohen prova të reja, prokurori mundet sërish ta fillojë hetimin. Hetimi pezullohet me vendim të prokurorit, ndërsa me vendim edhe përsëritet.

Te ky lloj i kriminalitetit, si rregull zbatohet ekspertiza financiare. Ekspertiza caktohet me urdhër-vendim nga gjyqtari i procedurës paraprake. Eksperti, pa vonesë zbaton ekspertizën dhe ia dorëzon prokurorit raportin me shkrim të ekspertizës, në pajtim me Nenin 138 të KPP-së. (p.sh. Neni 148, Analiza financiare). Në dispozitën e Nenit 148 të KPP-së, hollësisht përpunohet procedura e ekspertizës financiare dhe auditimit, me ç'rast në rolin e ekspertit mund të veprojnë edhe zyrtarët policorë dhe personat e tjerë profesionistë, me qëllim primar për të përcaktuar mënyrën e përfitimit dhe lartësinë e dobisë pasurore të përfituar.

142 Është e sigurt se kjo dispozitë që definohet është kyçe për të kuptuar drejtë konceptin e ligjit, kështu edhe vet hetimit financiar. Prona e të pandehurit është çdo lloj prone, thelbësore dhe jo thelbësore, e luajtshme dhe e paluajtshme, materiale dhe jo materiale, sikur edhe dokumenti juridik ose instrument, siç është definuar në paragrafin 2 dhe nënparagrafet 2.1 dhe 2.2 neni 8. i këtij Ligji, me të cilët provohet pronësia dhe interesi për pronën:

- 1.5.1. të cilën i pandehuri e ka fituar në afat prej dhjetë (10) vitesh, para ditës kur ka filluar hetimi për vepër penale, nga neni 2 i këtij Ligji; ose
- 1.5.2. që është në pronësi apo posedim të palës së tretë në llogari dhe dobi të të pandehurit, ose
- 1.5.3. të cilën i pandehuri e ka bartur në personin e tretë, i cili nuk ishte blerës *bona fide* ose më vonë e ka bartur gradualisht në pale të treta të tjera, të cilët nuk ishin blerës *bona fide*, në afat prej dhjetë (10) vitesh, para ditës kur ka filluar faza hetimore për vepër penale, siç është definuar në Nenin 2 të këtij Ligji.

3.4.2. Masat e përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore (bllokimi/ngrirja dhe sekuestrimi /konfiskimi i përkohshëm)

3.4.2.1. Korniza ligjore për aplikimin e masave të përkohshme të sigurimit të dobisë pasurore

Kur vepron sipas dispozitave të KPP-së, prokurori në mënyrë të pavarur dhe më vonë, me vendim gjyqësor, mund të ndërmarrë veprime për sekuestrimin e sendeve dhe dobisë pasurore. Sekuestrimi nga Neni 112 par. 1 i KPP, nënkupton se sendet që mund të sekuestrohen janë sendet që mund të jenë dëshmi në procedurën penale, sendet apo prona që e kanë lehtësuar kryerjen e veprës penale ose sendet dhe prona, që krijojnë përfitim material, të krijuar me vepër penale dhe të cilat, në bazë të ligjit mund të konfiskohen. Sendet, prona, provat ose paratë, mund përkohësisht të mbahen, me urdhrin e prokurorit të shtetit, më së gjati pesë (5) ditë, në qoftë se zyrtarët policorë të autorizuar marrin informacion për këto sende, pronë, provë apo para, gjatë bastisjes ligjore apo arrestimit. Prokurori i shtetit kërkon nga gjyqtari i procedurës paraprake, urdhrin e gjykatës.

KPP, gjithashtu parashikon më shumë mundësi për ngritjen e dobisë pasurore, të përfituar me kriminalitet. Në bazë të dispozitës të Nenit 264 të KPP-së, prokurori i shtetit mund të lëshojë urdhrë për ndalimin e shitjes, bartjen e pronësisë ose tërheqjen e mjeteve nga llogaria, të përcaktuar në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni. Çdo objekt, pronë e patundshme, pronë e tundshme, apo mjet për të cilat prokurori i shtetit posedon prova të qarta, që dëshmojnë dyshimin e bazuar që:

- a) objekti, prona e patundshme, prona e tundshme apo mjeti është përdorur në veprën penale, që është duke u hetuar;
- b) objekti, prona e patundshme, prona e tundshme apo mjeti janë provë e veprës penale, që është duke u hetuar;
- c) objekti, prona e patundshme, prona e tundshme apo mjeti, është krijuar me vepër penale, që është duke u hetuar.

Çdo llogari financiare në hetim, që i takon të pandehurit, që mund të përmbajë mjete monetare:

- a) të krijuara me vepër penale, që është duke u hetuar, ose
- b) që shfrytëzohen për vazhdimin e kryerjes së veprës penale, që është duke u hetuar.

Urdhri i prokurorit të shtetit nga Neni 264 i KPP-së ka këtë efekt:

- c) (a) Çdo bankë apo institucion financiar që merr urdhrin nga ky nen, menjëherë pengon çdo aktivitet të mëtejshëm në llogarinë bankare, të theksuar në urdhër.
- d) (b) Çdo palë tjetër, që e merr urdhrin nga ky nen, ndërmerr çdo masë të arsyeshme për të vepruar sipas urdhrit.

Urdhri i prokurorit të shtetit nga ky nen, lëshohet vetëm njëherë dhe mbetet në fuqi shtatëdhjetë e dy (72) orë nga lëshimi i urdhrit. Urdhri i prokurorit të shtetit përshkruan objektin, pronën e patundshme, pronën e tundshme, llogarinë financiare apo mjetin dhe urdhëron pranuesin që ta pengojë shitjen, bartjen e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria, në afat prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga lëshimi i urdhrit. Në urdhër theksohet koha e lëshimit dhe koha e skadimit të urdhrit. Urdhri mund ta ushtrojë vetëm prokurori i shtetit, në qoftë se gjyqtarit të procedurës paraprake, ia dorëzon kërkesën për lëshimin e një urdhri për sekuestrim, Neni 265 i KPP-së, për mjetet e theksuara në urdhër. Prokurori i shtetit që e nxjerrë urdhrin për ngrirje të përkohshme të mjeteve, nga Neni 264 i KPP-së, menjëherë ia parashtron gjyqtarit të procedurës paraprake, kërkesën për lëshimin e urdhrit për sekuestrimin e mjeteve, të theksuar në urdhër për ngrirje të përkohshme të mjeteve.

Ligji i veçantë, në dispozitën e Nenit 8, në mënyrë të hollësishme e përshkruan procedurën për masat e bllokimit/ngrirjen e pronës dhe këto masa quhen “urdhri i përkohshëm për kufizim” dhe kanë të bëjnë me sërë masash për pezullimin e kryerjes së transaksioneve lidhur me pronën (shitja, bartja, dhurimi etj.).

Në dispozitën e Nenit 10 të Ligjit të veçantë, janë parashikuar masat e përkohshme për sigurimin e pronës. Është shumë me rëndësi të theksohet se ligjvënësi e ka bërë lidhjen e materies së administruar me pronën përkohësisht të sekuestruar, kështu që në kuadër të kësaj dispozite, janë caktuar një sërë mundësish, jo vetëm për mbajtjen dhe mirëmbajtjen e pronës, por edhe shitjen e saj, bashkimin etj.

3.4.2.2. Propozimi ose kërkesa për caktimin e masave të përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore

Kërkesa për masa të përkohshme për sigurimin e pronës, sipas Nenit 268 të KPP-së, përcaktohet, ashtu që për objekte, pronën e patundshme, pronën e tundshme dhe mjetet, që janë sekuestruar përkohësisht dhe të cilat do të shërbejnë si material provues ose që mund të jenë objekt i sekuestrimit të përhershëm, prokurori i shtetit i dërgon gjyqtarit të procedurës paraprake, kërkesë me shkrim për masa të përkohshme për sigurimin e pronës.

Në bazë të dispozitës nga Neni 273 KPP, gjyqtari i procedurës paraprake, lëshon urdhër, ndryshon apo refuzon masat e përkohshme, që i ka kërkuar prokurori i shtetit, në pajtim me Nenin 268 të këtij Kodi.

Duke vepruar sipas Ligjit të veçantë, prokurori në fillim ka të drejtë që në mënyrë të pavarur të lëshojë urdhër të përkohshëm për kufizim, me të cilin personave të caktuar u ndalohet çfarëdo lloji i transaksionit të pronës, që është objekt i procedurës (Neni 8, par. 1). Është e rëndësishme të theksohet se përveç masave të theksuara të ndalimit (bllokadë/ngrirje), ky urdhër mundet, në bazë të Nenit 8, par. 6, të përfshijë edhe sekuestrimin e përkohshëm të pronës kontestuese. Ky urdhër mundet të mbetet në fuqi më së shumti shtatë ditë, kur prokurori duhet të paraqesë kërkesë për konfiskimin përfundimtar të pronës.

3.4.2.3. Caktimi i masave të përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore

Në bazë të KPP-së, gjykata nuk mund të caktojë masa të përkohshme të sigurimit *ex officio*, pa kërkesën e prokurorit të shtetit.

Gjykata vendos me vendim gjyqësor. I pandehuri, në bazë të Nenit 271 të KPP-së, mund të ushtrorë ankesë ndaj kërkesës për masa të përkohshme, nga Neni 268. Të gjithë personat që kanë interes juridik për objekt, pronën e patundshme, pronën e tundshme apo mjetet, të theksuar në Nenin 268, par 4, i KPPRK-së, kanë mundësinë e ushtrimit të ankesës ndaj masave të përkohshme, që i ka propozuar prokurori i shtetit (Neni 270 i KPP-së).

Gjyqtari i procedurës paraprake, vendos lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, që e ushtron prokurori i shtetit, në bazë të Nenit 273 të KPP-së, nëse gjykata nuk merr asnjë ankesë, në afat prej katërmëdhjetë (14) ditësh, nga parashtrimi i kërkesës (Neni 272).

Kompetenca funksionale e gjykatës është caktuar në bazë të fazave të procedurës (hetuese, aktakuza dhe deklarimi mbi fajësinë, shqyrtimi kryesor dhe ankesa), në të cilën gjendet procedura e caktuar penale, si dhe sipas shkallës në të cilën zhvillohet gjykimi.

Gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron masa të përkohshme, të cilat i ka kërkuar prokurori i shtetit, në bazë të Nenit 268 të këtij Ligji. Urdhri, me të cilin urdhërohet ose ndryshohet masa e përkohshme, të cilën Prokurori i Shtetit e kërkon përmban:

- a) objektin, pronën e patundshme, pronën e tundshme ose mjetet që janë objekt i kërkesës;
- b) dyshimin e bazuar se objekti, sendet e tundshme, sendet e patundshme, ose mjetet:
 - » janë krijuar me vepër penale, që është duke u hetuar ose;
 - » është shfrytëzuar ose ka pasur qëllim për t'u shfrytëzuar në kryerjen e veprës penale;
- c) gjasa të mëdha se objekti, prona e patundshme, prona e tundshme ose mjetet nuk do të jenë të qasshme për sekuestrim në fund të procedurës penale ose do të shfrytëzohet në kryerjen e veprës penale, në qoftë se nuk do të ndërmerren masat e përkohshme;
- d) masat e përkohshme nga Neni 269 i këtij Kodi, që do të zbatohen.

Urdhëresa përmban edhe arsyetimin për refuzimin e ankesës, në bazë të Nenit 270 dhe Nenit 271 të këtij Kodi ose zëvendësimin e masave të përkohshme për shkak të këtyre ankesave. Me urdhër mund të caktohet një afat i arsyeshëm për masë të përkohshme. Urdhri i dërgohet Agjencisë për Administrimin e Pronës së Sekuestruar dhe Konfiskuar, në afat prej (10) ditësh. Agjencia për Administrimin e Pronës së Sekuestruar dhe Konfiskuar ekzekuton urdhrin, në afat prej (15) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrin, përveç nëse nuk ushtrohet ankesë nga paragrafi 2.4 të Nenit 273 i këtij Kodi.

Në rastet kur nxjerret urdhri, me të cilin hedhet poshtë masa e përkohshme, që e ka kërkuar prokurori i shtetit, në bazë të Nenit 268 të këtij Kodi, në vend të kësaj urdhëron kthimin e pronës pronarit ose poseduesit, urdhri i dorëzohet Agjencisë për Administrimin e Pronës së Konfiskuar dhe Sekuestruar në afat prej (10) ditësh. Agjencia për Administrimin e Pronës së Sekuestruar dhe Konfiskuar ekzekuton urdhrin në afat prej (15) ditësh, nga dita e lëshimit të urdhrin, përveç nëse nuk ushtrohet ankesë.

Ankesën për caktimin e masave të përkohshme mund ta shqyrtojë Kolegji gjyqësor. Ankesa ndalon ekzekutimin e urdhrin nga ky nen deri në nxjerrjen e vendimit të Kolegjit gjyqësor.

Kartmonedhat ose monedhat metalike, që janë sekuestruar përkohësisht fotografohen dhe ruhen në vend të sigurt, kurse policia e autorizuar dhe prokurori i shtetit mbajnë evidencën e fotografuar, si evidencë gjatë ruajtjes së kartmonedhave dhe monedhave metalike.

Paratë që janë sekuestruar, të cilat gjenden në llogarinë bankare në Bankë, mbahen në llogarinë bankare, në kompetencë të gjykatës.

Parimi i proporcionalitetit nuk është normuar sipas Kushtetutës dhe KPP-së, por zbatohet në punën e subjektit në procedurë penale dhe në kuadër të veprimeve procedurale. Sa i përket parimit të drejtës procedurale, është normuar parimi i barazisë së veprimeve që gjithashtu aplikohet në këto procedura.

Gjykata, në fund të seancës, mund të urdhërojë që me pronën e sekuestruar të administrojë Agjencia për Administrimin e Pronës së Sekuestruar dhe Konfiskuar (Ligji për Administrimin e Pronës së Sekuestruar dhe Konfiskuar 2016), vetëm në qoftë se është e bindur se me urdhër për sekuestrim nuk do të arrijë për ta mbajtur pronën në kompetencë të saj.

Përveç mjeteve monetare, që mbahen të ngrira në llogaritë financiare të sekuestruara, i pandehuri ose shfrytëzuesi i pronës vazhdon ta shfrytëzojë pronën, por nuk mund ta shesë ose në një mënyrë tjetër ta bartë pronësinë e pronës.

Në ligjin e veçantë, prokurori me rastin e parashtrimit të propozimit për konfiskim, parashtron propozim dhe përshkruan masat e përkohshme të sigurimit (Neni 10). Me dispozitën e Nenit 12, par. 2, është përcaktuar se gjykata me vendim të saj cakton masat e sigurimit të përkohshëm dhe sipas nevojës, urdhëron shitjen e pronës së sekuestruar, në qoftë se këtë e ka kërkuar prokurori.

3.4.2.4 Procedura ankimuese

Ankesa ndaj urdhrit për sekuestrim afatgjatë, mund të ushtrohet në Gjykatën e Apelit, në afat prej dhjetë (10) ditësh, nga dita e lëshimit të urdhrit. Ankesa nuk ndalon ekzekutimin e urdhrit për sekuestrim afatgjatë.

Të gjithë personat që kanë interes juridik në objekt, pronën e patundshme, pronën e tundshme apo mjete të theksuara në Nenin 268, par. 4, KPP, kanë rastin që të ushtrojnë ankesë ndaj masës së përkohshme, që e ka propozuar prokurori i shtetit. Në qoftë se në afat prej katërbëdhjetë (14) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës, nuk merret asnjë përgjigje nga i pandehuri ose personi i tretë, gjyqtari i procedurës paraprake mund të lëshojë urdhrin me shkrim, nga Neni 273 i KPP, pa shqyrtim dhe pas shqyrtimit. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të kërkojë seancë para urdhrit për masat e përkohshme, nga neni 273. KPP, në qoftë se i pandehuri apo personi i tretë ka paraqitur çështjen faktike, që kërkon administrimin e dëshmive ose shqyrtimin e fakteve.

Gjyqtari i procedurës paraprake hedh poshtë masat e parakohshme, që i ka kërkuar prokurori i shtetit në bazë të Nenit 268. KPP.

Ankesën ndaj urdhrit për masat e përkohshme nga ky nen, mund ta shqyrtojë Kolegji gjyqësor. Ankesa ndalon ekzekutimin e urdhrit nga ky nen, deri në nxerrjen e vendimit të Kolegjit gjyqësor (Neni 273, par. 3, KPP)

3.4.3. Procedura për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale

3.4.3.1. Llojet e veprimeve dhe karakteristikat e tyre themelore

Në bazë të faktit se në Kosovë^{143*}, njëkohësisht janë në fuqi KP, KPP, dhe Ligji i veçantë, mund të dallohen më shumë veprime të ndryshme për konfiskimin e dobisë pasurore.

Ky së pari është veprim i rregullt që zhvillohet sipas dispozitave të KPP-së, kur dobia pasurore ose kundërvlera e saj, konfiskohet në bazë të dispozitës së Nenit 92 të KP-së.

Lloji i dytë i veprimit është konfiskimi i zgjeruar i dobisë pasurore, që bëhet në bazë të dispozitave të ligjit të veçantë, i cili aplikohet për pronën e personave, që janë të dënuar për veprat e rënda penale, përkatësisht, të cilët e kanë siguruar dobinë në vlerë prej 10.000 euro ose më e lartë (Neni 2).

Në fund, sipas Ligjit të veçantë, mund të zhvillohet procedurë për konfiskim të pavarur (objektiv) të dobisë pasurore në rast të vdekjes, arratisjes, çrregullimit ose paaftësisë mentale të akuzuarit ose personit të tretë (Neni 19).

143 * Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

3.4.3.2. Të drejtat procedurale të personave ndaj të cilëve caktohet konfiskimi i dobisë pasurore

KPP rregullon çështjet për procedurë të rregullt të konfiskimit. Kur bëhet fjalë për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale, personi mbi të cilin është bartur dobia materiale, duke përfshirë përfaqësuesin e organizatës tregtare ose personin tjetër juridik, thirret në dëgjim gjatë hetimit dhe në shqyrtimin kryesor. Ai paralajmërohet se procedura mund të zhvillohet edhe pa praninë e tij.

Përfaqësuesi i organizatës tregtare ose personit juridik, dëgjohe në shqyrtimin kryesor pas të pandehurit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në raport me pranuesin e dytë të dobisë pasurore, në qoftë se nuk është ftuar si dëshmitar.

Pranuesi i dobisë pasurore dhe përfaqësuesi i organizatës tregtare ose personi juridik, ka të drejtë që, lidhur me përcaktimin e dobisë materiale, të paraqesë dëshmi dhe, me leje të gjyqtarit të vetëm ose kryetarit të trupit gjykues, të parashtrijë pyetje për të pandehurin, dëshmitarët dhe ekspertët.

Përjashtimi i publikut nga shqyrtimi kryesor, nuk ka të bëjë me pranuesin e dobisë pasurore, duke përfshirë përfaqësuesin e organizatës tregtare ose personin tjetër juridik. (Neni 279, KPP).

Në kuadër të rregullave të veçanta, i pandehuri ose ndonjë palë e tretë, kanë të drejtë që ta dëshmojnë ligjshmërinë e prejardhjes së pronës (Neni 12, par 2.). Në kuadër të procedurës së veçantë për konfiskim të pavarur (objektiv) të palës, do të thotë i akuzuari, pala e tretë dhe trashëgimtarët juridikë mund të kenë përfaqësuesin ligjor gjatë procedurës, të cilin gjykata e cakton sipas detyrës zyrtare, në qoftë se këtë nuk e kanë bërë palët (Neni 17, par. 2)

3.4.3.3. Nxjerrja e aktgjykimit, me të cilin shqiptohet konfiskimi i dobisë pasurore

Kur bëhet fjalë për procedurë të rregullt, për konfiskimin e dobisë pasurore, gjykata duke vepruar në bazë të dispozitave nga Neni 280, par. 1 i KPP-së, vendimin për konfiskim mund ta marrë në kuadër të aktgjykimit, me të cilin i pandehuri shpallet fajtor, vërejtjes gjyqësore ose vendimit për trajtim të obliguar rehabilitues për varësit e drogave ose alkoolit.

KPP njeh edhe regjim të veçantë të konfiskimit të dobisë pasurore nga veprat penale të korrupsionit, Neni 281 i KPP-së, i cili ka karakteristikat e konfiskimit të pavarur (objektiv), ngase prona konfiskohet në rastet kur procesi penal nuk ka përfunduar me aktgjykim ndëshkues.

Në kuadër të veprimeve për konfiskim të zgjeruar, gjykata duke vepruar në bazë të Ligjit të veçantë, nxjerr urdhrin përfundimtar për kufizimin e pronës (Neni 12 dhe 13). Ligji shumë hollësisht e ka rregulluar procedurën, duke përfshirë kushtet për nxjerrjen dhe përmbajtjen e urdhrin, afatet, institucionet kompetente dhe çështjet e tjera.

Ligji i veçantë mundëson procedurën e konfiskimit të pavarur (objektiv), dhe në Nenin 20 janë parashikuar kushtet në të cilat prona i nënshtrohet konfiskimit në rast të vdekjes, arratisjes, çrregullimeve ose paaftësisë psikike të të pandehurit.

3.4.3.4. Procedura ankimese

Dispozita e Nenit 274, par.7 i KPP-së, parashikon të drejtën e ankesës ndaj urdhrin gjyqësor. Kundër aktgjykimit për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore, i pandehuri, përkatësisht personi i tretë kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pranë Gjykatës së Apelit.

Në dispozitën e Neni 284, par.7, KPP, gjithashtu definohet e drejta e ankesës ndaj urdhrit të gjykatës për konfiskimin e pronës.

Në bazë të Ligjit të veçantë, palët kanë të drejtë ankese (i pandehuri, prokurori i shtetit dhe pala e tretë, që pohon se ka interes juridik në pronën e lëndës) ndaj vendimit të gjykatës për “verifikimin” e pronës (Neni 6, par. 6). Ankesa zakonisht ka ndikim suspendues, për të njëjtën vendoset në bazë të dispozitave të KPP-së dhe ndaj vendimit për “verifikimin” e pronës nuk është e lejuar ankesa. Ligji lejon edhe ankesë ndaj urdhrit final për kufizimin e pronës, që nuk ka ndikim suspendues dhe e cila ushtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së urdhrit me shkrim (Neni 16).

Në fund, ankesa ndaj vendimit gjyqësor për konfiskimin e pronës në kuadër të procedurës së veçantë për konfiskim të pavarur (objektiv) të pronës, ushtrohet në bazë të dispozitave të KPP-së (Neni 19, par.11).

3.4.3.5 Informimi i Agjencisë për Administrim të Pronës ose subjekteve të tjera

Në bazë të dispozitës të Neni 284 par. 6 të KPP, gjykata me urdhër e urdhëron Agjencinë për Administrimin e Pronës së Konfiskuar që ta shesë, likuidojë ose ta mbajë objektin, pronën e paturdhshme, pronën e tundshme ose mjetin.

3.4.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për konfiskimin e përkohshëm dhe të përhershëm të dobisë pasurore

3.4.4.1. Procedurat për ekzekutimin e vendimeve për konfiskim të përkohshëm dhe përhershëm të dobisë pasurore.

Vendimi gjyqësor, me të cilin caktohet konfiskimi i përkohshëm dhe i përhershëm i dobisë pasurore, i dorëzohet palëve, personit të tretë dhe Agjencisë, menjëherë pas ekzekutimit (përkohësisht) përkatësisht plotfuqishmërisë (përhershëm) së vendimit.

Ekzekutimi i aktgjykimit në drejtim të konfiskimit të dobisë pasurore dhe kërkesave pronëso-ju-ridike, bën gjykata kompetente, në pajtim me dispozitat që zbatohen për procedurë përmbarimore.

Në qoftë se në aktgjykim është shqiptuar dënimi sporadik i konfiskimit të sendeve, këto sende automatikisht do të bëhen pronë shtetërore. Kopja e vërtetuar e aktgjykimit, menjëherë i dërgohet Agjencisë për administrimin e pronës së sekuestruar dhe konfiskuar, e cila mundet objektin ta shesë ose t’ia dorëzojë në shfrytëzim Qeverisë. Paratë e siguruar me shitjen e objektit derdhen në buxhet.

Ligji i veçantë parashikon mundësinë që policia t’i ekzekutojë vendimet për sekuestrimin e pronës, kështu që është e detyruar të kujdeset dhe mirëmbajë këtë pronë. (Neni 8, par. 6).

Kur bëhet fjalë për konfiskimin e përhershëm të pronës, në bazë të dispozitave të Ligjit të veçantë, ai përcakton që procedurat ekzekutimit të zbatohen në pajtim me KPP-në dhe Ligjin e veçantë (Neni 22).

3.4.4.2. Pjesëmarrësit në procedura për ekzekutimin e vendimeve për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore

Agjencia për Administrimin e Pronës së Sekuestruar dhe Konfiskuar, policia, institucionet bankare, Agjencia për Kadastër dhe regjistrat tjerë të pronës.

3.4.4.3. Mbrojtja e të drejtave të palëve të tjera

Në bazë të dispozitave të KPP-së, të gjithë personat që kanë interes juridik për objektin, pronën e patundshme, pronën e tundshme ose mjetet e theksuara në Nenin 270 të KPP-së, kanë mundësi që të ushtrojnë ankesë ndaj masës së përkohshme, të propozuar nga prokurori i shtetit. Nëse objekti, prona e patundshme, prona e tundshme ose mjetet, dyshohet janë përdorur në veprën penale, personi që ka ushtruar ankesë ndaj masës së përkohshme duhet të dëshmojë që:

- a) nuk ishte në dijeni për shfrytëzimin e pronës në vepër penale,
- b) nuk ka mundur të ketë dijeni për shfrytëzimin e pronës në vepër penale,
- c) prona nuk mundet sërish të shfrytëzohet për vepër penale,
- d) masa e përkohshme që propozohet paarsyeshëm do t'i rrezikonte interesat e personit, që ka ushtruar ankesë.

Nëse pretendohet se objekti, prona e patundshme, prona e tundshme ose mjetet, që paraqesin dobi pasurore, të përfituar me kryerjen e veprës penale, personi që ka ushtruar ankesë ndaj masave të përkohshme, duhet të dëshmojë që:

- a) ka pasur interes pronësor në objekt, pronë të patundshme, pronë të tundshme ose mjete, më shumë se gjashtë (6) muaj para sekuestrimit të pronës,
- b) ka paguar çmimin e tregut për interes pronësor në objekt, pronë të patundshme, pronë të tundshme ose mjete,
- c) nuk kishte dijeni për veprimet, me qëllim të ofrimit të ndihmës për vepër penale,
- d) i pandehuri dhe i akuzuari nuk mund të shfrytëzojnë, bartin ose në ndonjë mënyrë tjetër t'i qasen objektit, pronës së patundshme, pronës së tundshme ose mjeteve, dhe
- e) masa e propozuar e përkohshme do t'i rrezikojë paarsyeshëm interesat e personit, që ka ushtruar ankesë.

Në ankesë mund të propozohet një masë më e vogël restriktive ose mos të ushtrohet urdhri për masë të përkohshme. Në ankesë mund të kundërshtohet saktësia e përshkrimit të objektit pronës së patundshme, pronës së tundshme ose mjeteve, që janë objekt i kërkesës.

Edhe pas vendimit të plotfuqishëm për konfiskimin e përhershëm të pronës, personi i tretë ka të drejtë të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës së Apelit, vetëm në drejtim të konfiskimit të pronës.

Gjithashtu, në kuadër të procedurave të ekzekutimit, në bazë të Ligjit për procedurën përmbari-more, pala e tretë mund të ushtrojë ankesë.

Ligji i veçantë, gjithashtu kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë. Së pari, në kuadër të dispozitave të Nenit 4, par. 3, definohen obligimet e prokurorit që një kopje të kërkesës për verifikimin e pronës, t'ua dorëzojë personave të tretë, që mund të kenë interes juridik në pronën, e cila është objekt i verifikimit. Në bazë të Nenit 5, par. 3 i Ligjit të njëjtë, pala e tretë ka të drejtë që të marrë pjesë në dëgjim për verifikimin e pronës. Këta persona kanë të drejtë që të dorëzojnë fakte, me qëllim të dëshmimit të pronësisë, prejardhjen e ligjshme *bona fide* fitimi i pronës (Neni 5 par. 6).

Në drejtim të urdhrimit për konfiskim, personat e tretë kanë të drejtën për ushtrimin e ankesës në afat prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të vendimit dhe e njëjta ka efekt suspenziv (Neni 6, par. 6). Para lëshimit të urdhrimit final për konfiskim, personat e tretë kanë të drejtën për dorëzimin e dëshmive (Neni 11).

Pas lëshimit të urdhrin final për konfiskim, personat e tretë kanë të drejtë për ushtrimin e ankesës ndaj vendimit të gjykatës, në afat prej pesëmbëdhjete ditësh, nga dita e dorëzimit të vendimit dhe e njëjta nuk ka efekt suspensiv (Neni 16).

Te procedura e veçantë me konfiskim të pavarur (objektiv), në kuadër të Ligjit të veçantë, të drejtat e personave të tretë, kundër të cilëve mund të zhvillohet procedurë, mbrohen me obligim të gjykatës që ta caktojë mbrojtjen, sipas detyrës zyrtare (Neni 19). Personat e tretë kanë të drejtën ekskluzive për kompensimin e dëmit , në rastet kur nuk është i mundshëm konfiskimi i pronës, për shkak të mungesës së qasjes, me qëllim të konfiskimit të zgjeruar (Neni 19, par. 13), me ç'rast aplikohen dispozitat e KPP-së.

3.5. MAQEDONIA E VERIUT

Legjislacioni në Maqedoni të Veriut në fushën e konfiskimit të dobisë pasurore, të përfituar me veprë penale, përbëhet nga dispozitat materiale të Kodin Penal (2017), dhe Kodin për Procedurë Penale (2016), i cili, përveç tjerash, rregullon materien e procedurës për konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore.

3.5.1. Hetimi financiar

3.5.1.1. Fillimi i hetimit financiar

Hetimi financiar është i rregulluar me Kodin për Procedurë Penale (2016). Në lidhje me para hetimin, disa veprime mund të përfshijnë veprime të caktuara, që janë në lidhje, jo vetëm me prokurorinë e shtetit, por edhe me organet e tjera, siç janë policia financiare dhe Agjencia Kundër Korrupsionit. Kompetencat e tyre janë të rregulluara me ligje të veçanta, të cilët e rregullojnë veprimtarinë e këtyre institucioneve dhe materien për parandalimin e korrupsionit.¹⁴⁴ Në rastet kur konkludojnë, në bazë të provave të grumbulluara, se ekziston kriminaliteti financiar, procedura e mëtejshme i takon prokurorisë publike.

Hetimi financiar dhe zbatimi i hetimit financiar, më së shpeshti kanë të bëjnë me dyshimin e bazuar lidhur me veprat penale të shpëlarjes së parave dhe të ardhurave të tjera, të dënueshme sipas nenit 273 të Kodit Penal (2017), tregtia e palejuar, neni 277 i të njëjtit, kontrabanda, neni 278, fshehja e tatimeve, neni 279. Kodi Penal (2017) përdorë terminologjinë vlerë e konsiderueshme ose shuma më e madhe e parave, duke mos specifikuar shumën e parave për këto vepra penale.

Baza për hetimin financiar rrjedh nga *lex specialis* (Ligji për Policinë Financiare) dhe aktet nënligjore (Rregullat e shërbimit). Aty ku *lex specialis* nuk ofron zgjidhje, zbatohet Ligji për Procedurë Penale (2016) si *lex generalis*.

Në bazë të nenit 283 të Ligjit për Procedurë Penale (2016), si edhe hetimet të tjera, hetimi financiar inicohet në bazë të kallëzimit penal apo në bazë të informatës së policisë. Me procedurën para hetimore udhëheq prokurori publik, në pajtim me Kodin për Procedurë Penale (2016). Policia gjyqësore vepron sipas urdhrit dhe objektivave, që lëshon prokurori publik dhe i raporton prokurorit publik. Kodi për procedurën penale (2016) parashikon që policia gjyqësore të formohet në kuadër të prokurorisë publike. Deri më tash, kjo polici e specializuar nuk është formuar në kuadër të prokurorisë publike. Vetëm në kuadër të Prokurorisë Speciale për veprat penale që rrjedhin nga “përgjimi i bisedave”, kjo prokurori ka përdorur hetues të specializuar për kriminalitetin financiar¹⁴⁵

Në bazë të Kodit për procedurë penale (2016), hetimi financiar është përfshirë në akt, me të cilin inicohet hetimi penal i zakonshëm. Domethënë, procesi penal fillon me lëshimin e urdhrit për zbatimin e procedurës penale ose me ndërmarrjen e aktivitetit të parë hetimor, para lëshimit të urdhrit për zbatimin e procedurës hetimore. Në bazë të kësaj, *lex generalis* është Kodi për procedurë penale (2016), por disa veprime në fazën e hershme para hetimore janë të rregulluar me Ligjin për Policinë Financiare (2014).

144 Përveç ligjeve të tjera, janë: Ligji për Policinë Financiare (2014), Ligji për parandalimin e korupcionit dhe konfliktit të interesit (2019), etj.

145 Në procedurë është ndyshimi i Ligjit për prokurorinë publike dhe sipas propozimit të këtij Ligji, kjo Prokurori speciale dhe organet e saj, duket të fuzionohen në Prokurorinë publike të shtetit. Kjo përfshinë angazhimin edhe të hetuesve financiar.

3.5.1.2. Qëllimet e hetimit financiar

Ligji për policinë financiare (2014) përcakton se hetimi financiar ka për qëllim:

- Mbrojtjen e interesave financiare të Republikës së Maqedonisë në Veriut, përmes zbulimit dhe hetimit penal për veprat penale të shpëlarjes së parave dhe të ardhurave të tjera, të përfituara me vepër penale, tregtisë së paligjshme, kontrabandës, fshehjes së tatimit, si dhe veprave të tjera penale të dobisë pasurore të paligjshme, në vlerë të konsiderueshme;
- Mbrojtjen e interesave financiare të Bashkësisë Evropiane, me zbulimin dhe hetime të veprave penale, që janë në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve nga programi i BE-së, të cilat Republika Maqedonia e Veriut i merr nga buxheti i BE-së;
- Në rastet kur hetimin e fillon Policia financiare apo Drejtoria e doganave, qëllimi i punës së tyre është ushtrimi i kallëzimit penal, për prokurorin publik, që është kompetent për veprat penale në kompetencë të tij, që ndiqen sipas detyrës ;
- Me paraqitjen e iniciativës për fillimin e procedurës tatimore ose procedurës tjetër për caktimin dhe pagesën e tatimit ose detyrimeve të tjera publike pranë organit kompetent.

3.5.1.3. Specifikat e zbatimit të hetimit financiar

Me Kodin Penal (2017) rregullohen:

- Veprat penale të dobisë pasurore me vlerë të konsiderueshme, si dhe kapja e dhe paraqitja e kryesve të tyre, sigurimi i provave, si dhe masat dhe aktivitetet e tjera që mund të shfrytëzohen papenguar gjatë procedurës penale, sipas detyrës zyrtare apo në bazë të urdhrit të prokurorit publik;
- Ligji për Policinë Financiare (2014), rregullon hetimin financiar, që përfshin aktivitetet, me të cilat:
- zbulohet dhe zhvillohet hetimi kriminalistik për vepra penale, që ndiqen sipas detyrës zyrtare, siç është shpëlarja e parave dhe përfitimi tjetër nga vepra penale, neni 273 , qarkullimi i paligjshëm (neni 277), kontrabanda (neni 278), fshehja e tatimit (neni 279).
- grumbullimi dhe analiza e të dhënave lidhur me transaksionet e parave të gatshme,
- ndërmarrja e masave para hetimore dhe masave të tjera , në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar për veprat penale të kryera,
- përcjell gjurmët e parave, me qëllim të zbulimit të veprave penale, të përcaktuara me ligj,
- kryen analiza forenzike kompjuteristike të sistemeve kompjuteristike të sekuestruara dhe aparateve elektronike;
- dorëzon fletëparaqitje penale prokurorit publik kompetentë për veprat penale, që janë në kompetencë të tij dhe të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare;
- paraqet iniciativa për fillimin e procedurës tatimore dhe procedurës tjetër të përcaktimit dhe grumbullimit të dhënave pranë organit kompetent;
- koordinon, jep iniciativa, dorëzon fletëparaqitje penale.

Në bazë të nenit 200 të Kodit për Procedurë Penale (2016), në qoftë se ekziston dyshimi i bazuar se një person i caktuar në llogarinë e tij bankare pranon, ruan, bartë ose në ndonjë mënyrë tjetër ka në dispozicion të ardhurat, që rrjedhin nga vepra penale, kurse kjo shumë është e rëndësishme për hetimin e asaj vepre penale ose sipas ligjit i nënshtrohet konfiskimit të dhunshëm, në bazë të kërkesës së arsyetuar të prokurorit publik, gjykata mundet të nxjerr vendim, me të cilin bankës apo ndonjë institucioni tjetër bankar i lëshohet urdhër për dorëzimin e dokumentacionit dhe të dhënave nga llogaria bankare ose transaksioneve financiare, në qoftë se këto të dhëna mund të jenë provë në procedurën penale.

Kërkesa e prokurorit publik ka të bëjë me të dhënat e një personi juridik apo fizik lidhur me të gjitha të ardhurat që i pranon, ruan, bartë ose në ndonjë mënyrë tjetër i ka në dispozicion.

Në fazën parahetimore dhe hetimore, vendimin sipas kërkesës së prokurorit publik, nxjerr gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës, gjykata ku do të mbahet shqyrtimi gjyqësor. Gjyqtari i procedurës paraprake duhet të vendosë në afat prej 12 orësh, nga pranimi i kërkesës. Në qoftë se gjyqtari nuk e pranon kërkesën e prokurorit publik, do të kërkoj pa shtyrje që për këtë kërkesë të vendoset kolegji i gjyqtarëve. Kolegji i gjyqtarëve merr vendim në afat prej 24 orësh, nga pranimi i kërkesës së prokurorit publik.

Pas propozimit të arsyetuar të prokurorit publik, me vendim me shkrim, gjyqtari i procedurës paraprake mund ta urdhërojë bankën apo një institucion tjetër financiar, që ta monitoroj qarkullimin financiar lidhur me këtë person dhe rregullisht ta informoj prokurorin publik në periodha kohore të përcaktuara në vendim.

Në raste urgjente prokurori publik mund të përcaktohet për masa të veçanta lidhur me informacionet që janë në lidhje me transaksione financiare ose pronës, pa urdhër gjyqësor. Në raste të tilla, prokurori publik menjëherë e informon gjyqtarin e procedurës paraprake, i cili në afat 72 orësh duhet të lëshoj urdhër. Në rastet kur gjyqtari nuk do të lëshoj urdhrin, prokurori publik do t'i kthej këto të dhëna dhe nuk guxon që ti hapë para kësaj kohe.

Në kryerjen e punëve në kompetencë të tij, prokurori publik bashkëpunon me Policinë financiare, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Zyrën për të Ardhurat Publike, drejtorinë doganore, komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Zyrën Shtetërore për Auditim, Zyrën Shtetërore për Inspektim Devizor, Inspektoratin Tregtar të Shtetit dhe organet e tjera të inspektimit, organet shtetërore dhe personat juridik, që janë përgjegjës për parandalim dhe zbulimin e veprave penale, në bazë të ligjit.

Organet shtetërore qeverisëse dhe organet e tjera të shtetit, institucionet dhe personat juridik, që grumbullojnë të dhënat dhe mbajnë evidencën, në bazë të ligjit, janë të obliguar që të dhënat ti dorëzojnë në kërkesë të prokurorit publik ose në qoftë se këtë e kërkon policia financiare. Prokurori publik mund të bashkëpunojë dhe shkëmbej informacion me prokurorë nga shtetet e tjera, policinë e shteteve të tjera dhe organet shtetërore, organizatat e shteteve të tjera dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e kriminalitetit financiar, në bazë të marrëveshjeve bilaterale dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara lidhur me çështjet nga kompetenca e tyre. Policia financiare bashkëpunon me OLAF (Agjencia Evropiane në Luftën kundër Mashtrimeve).

Prokuroria mundet të kërkoj qasje në të gjitha bazat që janë në lidhje me transaksionet financiare të personave fizik apo juridik. Qasja është e mundur vetëm në bazë të urdhrin të gjykatës.

Në bazë të urdhrin të gjykatës, prokuroria mund të ketë qasje në të gjitha bazat, llogaritë bankare, evidencë dhe raporte të drejtorisë për financa, kadastër, regjistrin e letrave me vlerë, automjete dhe baza të tjera.

Nuk ekziston kufizim ligjor, në cilat institucione prokurori publik mund të kërkoj informacion lidhur me hetimet konkrete, derisa në bazë të kërkesës së tij disponon me urdhrin valid, që e ka lëshuar gjyqtari kompetent.

Në bazë të nenit 287 të Kodit për Procedurë Penale (2016), në kërkesë të prokurorit publik, organet shtetërore, organet e njësive të vetëqeverisjes lokale, organizatat, personat juridik dhe fizik do t'i dorëzojnë të gjitha të dhënat e kërkuara. Të gjitha subjektet e theksuara janë të obliguar që prokurorisë publike t'i dorëzojnë menjëherë, më së voni në afat prej 30 ditësh të dhënat, dokumentet,

llogaritë bankare, që janë të nevojshëm për procedurën. Prokurori mund të kërkojë që përkohësisht të konfiskohen. Në qoftë se subjektet e theksuara nuk veprojnë në pajtim me kërkesën e prokurorit publik, ai mund të propozojë që gjykata të shqiptojë gjobë në lartësi prej 2.500 deri 5000 euro në kundërvlerë me denarë. Në praktikë, qasja në baza të ndryshme me të dhënat që kanë lidhje me hetimin financiar, mundësohet menjëherë pas lëshimit të urdhrit të gjykatës.

Në bazë të urdhrit, prokuroria mund të ketë qasje në të gjitha bazat, llogaritë bankare, evidencë dhe pasqyra të Drejtorisë për të hyra, kadastër, regjistra të letrave me vlerë, automjeteve dhe baza të tjera.

3.5.1.4. Përfundimi dhe zbatimi i rezultateve të hetimit financiar

Kodi i procedurës Penale (2016), përcakton bazën ligjore për përcaktimin e rrethanave për përfitim e dobisë pasurore dhe fakteve të tjera, që kanë të bëjnë me identifikimin, vëzhgimin dhe konstatimin e dobisë pasurore. Faktikisht, për hetime financiare zbatohen afatet e njëjta si për vepra të tjera, përveç kur bëhet fjalë veprat penale, në lidhje me krimin e organizuar dhe në atë rast vlejnjë afatet e tjera .

Gjatë procedurës hetimore grumbullohen provat dhe të dhënat, që i nevojiten prokurorit publik për të vendosur nëse do të ngrit aktakuzën ose do të heq dorë nga ndjekja. Gjatë procedurës hetimore, prokurori publik është i obliguar që t'i grumbullojë provat, që e ngarkojnë të pandehurin ose që janë në favor të tij. Për këtë qëllim, prokurori publik lëshon urdhër për zbatimin e procedurës hetimore, që përfshinë të dhënat personale të të pandehurit, përshkrimin dhe kualifikimin juridik të veprës. Urdhri përmban rrethanat që duhet të hetohen, aktivitetet hetimore dhe personat që duhet hetuar lidhur me aktivitetet e veprës penale. Nëse ekziston dyshimi i bazuar se me kryerjen e kësaj vepre penale, i pandehuri ka krijuar dobi pasurore, prokurori publik mund të propozojë që prona dhe mjetet të vendosën nën mbikëqyrjen e gjykatës dhe të lëshojë një nga masat për sigurimin e përkohshëm të pronës dhe mjeteve që janë krijuar me vepër penale.

Prokurori publik përfundon procedurën hetimore, kur vlerëson se gjendja është sqaruar mjaftueshëm për ngritjen e aktakuzës ose të ndërprerët procedura.

Në qoftë se procedura hetimore nuk përfundon në afat prej 6 muajve nga dita e lëshimit të urdhrit për zbatimin e procedurës hetimore, prokurori publik është i obliguar që të informojë prokurorin e lartë publik, i cili në lëndët e ndërlikuara, mundet këtë afat ta vazhdojë edhe për 6 muaj. Në rastet e veçanta, ky afat mund të vazhdohet nga prokurori publik i shtetit edhe për 3 muaj. Veprat penale në lidhje me krimin e organizuar (ku bëjnë pjesë më së shpeshti veprat penale me karakter financiar, tek të cilat më së shpeshti është i pranishëm përfitimi i dobisë pasurore), ky afat mund të vazhdohet edhe për gjashtë muaj nga ana e prokurorit publik të shtetit. Para skadimit të afatit, prokurori publik duhet të lajmërojë të pandehurin dhe mbrojtësin e tij.

Në përfundim të procedurës hetimore dhe skadimit të afateve, prokurori publik duhet që në afat prej 15 ditësh të ngrit aktakuzë ose të ndalojë procedurën hetimore. Ky afat në raport me veprat penale nga fusha e krimin të organizuara zgjatë 30 ditë.

Zyrtari i policisë financiare mundet përkohësisht t'i sekuestrojë objektet, të dhënat kompjuteristike, letrat, telegramet dhe dërgesat e tjera, shkresat, dokumentet, incizimet teknike dhe sendet e tjera, të cilat sipas Kodit Penal duhet të konfiskohen ose të cilat mund të shërbejnë si provë në procedurën penale dhe të dorëzohen në mbajtje në prokurori ose trupave që janë caktuar me ligj të veçantë ose në një mënyrë tjetër. Kjo procedurë ka të bëjë me sekuestrimin e *instrumenta et producta sceleris*. Urdhri për sekuestrim lëshohet në propozim të policisë financiare. Me rastin e sekuestrimit

të sendeve, procedura më së shpeshti fillon aty ku janë gjetur dhe të njëjtat do të përshkruhen, dhe nëse është e nevojshme, edhe në ndonjë mënyrë tjetër do verifikohet identiteti i tyre. Për sendet e sekuestruara lëshohet vërtetim. Sekuestrimi, ruajtja dhe përdorimi i sendeve të sekuestruara zbatohet në bazë të mënyrës së përcaktuar në Kodin për Procedurë Penale (2016).

Në bazë të provave të grumbulluara për ekzistimin e dyshimit të bazuar se janë kryer vepra penale në kompetencë të Policisë financiare dhe përgjegjësisë penale të kryesit, Policia financiare dorëzon fletëpadinë prokurorit publik kompetent, me këtë rast i bashkëngjijt edhe provat. Dokumentet, objektet, skicat, fotografitë, raportet e grumbulluara, procesverbalet, shënimet zyrtare, deklaratat dhe provat e tjera dorëzohen me fletëpadi.

Policia financiare është organ i specializuar për hetime financiare dhe punon në mënyrë të pavarur nga Ministria e Punëve të Brendshme. Megjithatë, krahas policisë financiare, sipas KPP, si dhe në lidhje me veprat të tjera penale, fletëparaqitjen penale lidhur me kriminalitetin financiar mund ta iniciojnë edhe subjektet e tjera për prokurorin kompetent.

Zyrtari i policisë financiare është kompetent që ti kontrollojë sendet, hapësirat tregtare, hapësirat e organeve shtetërore dhe institucioneve që kanë kompetenca publike dhe persona të tjerë juridik, si dhe të kontrollojë dokumentacionin e caktuar, me qëllim të sigurimit të dokumentacionit me qëllim të zhvillimit të suksesshëm të procedurës penale dhe dorzohen prokurorit publik ose organit, të caktuar me Ligj të veçantë, ose në një mënyrë tjetër garanton ruajtjen e tyre.

Urdhrin për konfiskim të sendeve e merr gjykata, në bazë të propozimit të policisë financiare. Konfiskimi, ruajtja dhe veprimi me sendet e sekuestruar bëhet në mënyrën e përcaktuar me KPP (2016).

3.5.2. Masat e përkohshme të sigurimit të dobisë pasurore (bllokimi / ngirja dhe sekuestrimi)

3.5.2.1. Korniza ligjore për zbatimin e masave të përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore

Këto masa të veçanta janë rregulluar me KPP (2016, neni 194-204). Sekuestrimin e pronës dhe sendeve, me qëllim të sigurisë, gjykata mundet, në çfarë do kohe, gjatë procedurës penale, me kërkesë të prokurorit publik, të ndërmer masë të përkohshme të sekuestrimit të pronës ose të sendeve, që sipas Kodit Penal (2017), duhet të sekuestrohen, të caktohet masë e sekuestrimit ose një masë tjetër të përkohshme të domosdoshme për parandalimin e shfrytëzimit, tjetërsimit dhe përdorimit të pronës dhe sendeve të tilla.

Në bazë të kërkesës së arsyetuar të prokurorit publik, gjykata mund të urdhëroj institucionin financiar ose ndonjë personi tjetër juridik, të ndërpritet ekzekutimi i transaksionit financiar të caktuar dhe të sekuestrohet prona e caktuar.

Kur përmbushen kushtet për sekuestrim ose sekuestrimin e zgjeruar të pronës dhe dobisë pasurore, gjykata me propozimin e prokurorit publik do të caktojë masa të përkohshme të sigurimit, që mund ti zgjerojë edhe në palët e treta, për të cilët ekziston dyshimi se në emër të tyre është bartur dobia pasurore e përfituar me vepër penale, pa kompensim adekuat.

3.5.2.2. Propozimi ose kërkesa për caktimin e masave të përkohshme të dobisë pasurore

Kërkesa e prokurorit publik për sekuestrim të pronës ose të dobisë pasurore dhe sendeve, duhet të përmbaj:

- përkrahimin e shkurtër të veprës penale dhe titull i saj juridik,
- përkrahimin e pronës dhe sendeve, të përfituara nga kryerja e veprës penale,
- të dhënat për personin, që posedon këtë pronë apo objekte,
- provat në të cilat bazohet dyshimi se prona apo sendet janë përfituar nga vepra penale dhe arsyet për mundërishtë e shkatërrimit të pronës apo sendeve deri në përfundimin e procedurës penale, do të jetë veçanërisht e vështirë ose marrja e paqëllimshe pronësisë apo sendeve.

3.5.2.3. Caktimi i masave për sigurimin e dobisë pasurore

Gjykata mundet *ex officio*, sipas detyrës zyrtare, të caktojë masa për sigurimin e dobisë pasurore.

Para dhe gjatë procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit publik, gjyqtari i procedurës paraprake merr vendim, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës, gjykata pranë të cilës do të mbahet shqyrtimi. Lidhur me kërkesën e prokurorit publik, gjyqtari i procedurës paraprake vendosë menjëherë, më së voni në afat prej 12 orësh, nga pranimi i kërkesës. Në qoftë se gjyqtari i procedurës paraprake nuk e pranon kërkesën e prokurorit publik, menjëherë do të kërkojë vendim për dërgimin në Kolegjin gjyqësor, në bazë të KPP. Kolegji, nxjerr vendim në afat prej 24 orëve, nga pranimi i kërkesës. Në vendim për caktimin e masave, gjykata do të theksojë vlerën dhe llojin e pronës, përkatësisht të sendit dhe afatin për të cilën është sekuestruar.

Kundër vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për caktimin e masave për sekuestrimin e pronës dhe sendeve, mund të ushtrohet ankesë në afat prej 24 orëve, por ajo nuk shtyn ekzekutimin e vendimit.

Lidhur me ankesën vendos Kolegji gjyqësor, në bazë të nenit 25 par. 5 i Kodit të Procedurës Penale (2016).

Në qoftë se ekziston rreziku për shtyrje, përkohësisht mund të sekuestrohet prona apo sendet, ose të ndërmer masa të tjera të domosdoshme, me qëllim që të pengohet përdorimi i tyre, tjetërsimi ose të vihen në dispozicion.

Lidhur me masat që ndërmerren duhet të informohet prokurori publik, ndërsa ato duhet t'i aprovojë gjyqtari i procedurës paraprake, në afat prej 72 orësh, nga ndërmarrja e tyre. Nëse gjyqtari i procedurës paraprake nuk pajtohet, masat që janë ndërmarr, në bazë të këtij neni pushojnë, ndërsa prona dhe sendet e sekuestruara menjëherë i kthehen personit, nga i cili janë sekuestruar. Masat mund të qëndrojnë deri në përfundimin e procedurës penale, para gjykatës së shkallës së parë.

Nëse të pandehurit i gjendet ndonjë send, në pronësi dhe prejardhje të panjohur dhe i pandehuri nuk mund të dëshmojë prejardhjen e atij sendi, organi që e zhvillon procedurën do ta publikojë shpalljen lidhur me objektin dhe do ta përshkruaj në Këshillin drejtues të organit të komunës, në territorin ku jeton dhe në territorin ku është kryer vepra penale.

3.5.2.4. Procedura ankimuese

Nëse masat caktohen në procedurë paraprake, ato do të anulohen sipas detyrës zyrtare, në qoftë se procedura hetimore nuk fillon në afat prej tre muajve, nga dita e marrjes së vendimit. Para skadimit të këtij të këtij afati, masat mund të anulohen sipas detyrës zyrtare nga ana e gjykatës ose me kërkesë të prokurorit të shtetit, ose të personit të interesuar, nëse dëshmohet se nuk janë të domosdoshme dhe të arsyeshme, bazuar në peshën e veprës penale, rrethanat materiale të personit, për të cilin bëhet fjalë ose rrethanat e personave, që në bazë të ligjit janë të detyruar të paraqesin edhe rrethanat, që tregojnë se sekuestrimi i pronës ose i sendeve, nuk do të jetë e pamundësuar ose në veçanti e vështirësuar deri në përfundimin e procedurës penale.

Të gjitha veprimet lidhur me pronën dhe sendet, që janë objekt të sigurimit, që ndërmerren pas parashtrimit të kërkesës, do të anulohen.

Sendet e sekuestruara, si *instrumenta et producta sceleris*, gjatë procedurës penale, i kthehen pronarit, përkatësisht bartësit, nëse procedura është e pezulluar, dhe nuk ka arsye për sekuestrim.

3.5.3. Procedurat për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale

3.5.3.1. Llojet e procedurave dhe karakteristikat themelore

Bazë për konfiskimin e dobisë pasurore, neni 97 i Kodit Penal (2017). Askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore direkte apo indirekte, të përfituar me vepër penale. Dobia pasurore e përfituar me vepra penale do të konfiskohet me vendim gjyqësor, me të cilin përcaktohet kryerja e veprës penale, në bazë të kushteve të parashikuara me Kodin Penal. Gjykata do të nxjerr vendim për konfiskim, në bazë të procedurës së caktuar me ligj, edhe në rastin kur ndaj kryesit të veprës penale nuk mund të zhvillohet procesi penal për shkak të pengesave reale apo ligjore. Kështu, për shembull, nëse kryesi nuk është i qasshëm, gjendet në arrati, ndërkohë ka vdekur ose shteti ku ai jeton refuzon që ta ekstradojë. Në kushtet e përcaktuara me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, prona e konfiskuar mund të kthehet në shtetin tjetër.

Sekuestrimi i dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale, për personin juridik është i rregulluar me dispozitat e nenit 98 deri 100 të Kodit Penal (2017). Në qoftë se personit juridik nuk mund t'i konfiskohet prona apo dobia pasurore, sepse ka pushuar së ekzistuari para konfiskimit, themeluesi apo themeluesit e personit juridik, përkatësisht aksionarët apo shoqëritë aksionare janë të obliguar që ta paguajë shumën monetare, që i përgjigjet përfitimit të krijuar pronësor. Për konfiskimin e objekteve nga personi juridik, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e nenit 101a. të Kodit Penal (2017).

Veprimet për aplikimin e masave të konfiskimit të dobisë pasurore, konfiskimit të sendeve dhe të tjera, janë rregulluar me kapitullin 34 të KPP (2016).

Kundër vendimit gjyqësor, me të cilin konfiskohet dobia pasurore, personat që kanë të drejtë ankese, të njëjtën mund ta parashtrorjnë kundër Vendimit gjyqësorë, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimin të këtij vendimi.

Gjykata do ta zbatoj konfiskimin e zgjeruar, në bazë të kushteve të përcaktuara në Kodin Penal (2017), në qoftë se i akuzuari në afat prej 1 viti, nga fillimi i shqyrtimit kryesor, nuk mund të dëshmojë se prona apo dobia pasurore është krijuar në mënyrë të ligjshme. Në qoftë se gjykata nxjerr aktgjykimin të plotfuqishëm, në afat më të shkurtër se një vit, kur ekziston baza ligjore për shqiptimin e

konfiskimit të zgjeruar, Gjykata këtë masë do ta shqiptoj me aktgjykim plotësues, kundër të cilit është lejuar ankesa.

Gjykata, me vendim do të caktojë masën e konfiskimit të zgjeruar, të përcaktuar me Kodin Penal (2017) dhe ndaj personit të tretë, në qoftë se në afat prej 2 vitesh, nga fillimi i procedurës së veçantë të konfiskimit, nuk dëshmon se për pronën apo dobinë pasurore ka dhënë kundërvlerën, që i përshatatet vlerës së tyre. Kjo procedurë zhvillohet me propozim të prokurorit publik. Kundër këtij vendimi, personi i tretë ka të drejtë ankese pranë Gjykatës së Lartë, në afat prej 8 ditësh.

Në bazë të nenit 530, të KPP (2016), prona dhe dobia pasurore, e përfituar me vepër penale, përcaktohen me procedurë penale. Prokurori publik, gjatë procedurës duhet të grumbulloj prova dhe t'i hetoj rrethanat, që janë të rëndësishme për përcaktimin e pronës dhe dobisë pasurore dhe t'i propozojë masat nga neni 202 i KPP (2016).

Në procedurën e përcaktimit të vlerës së pronës dhe dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale, prokurori publik mund të kërkoj raport nga organet e tjera shtetërore, institucionet financiare, ndërsa personat juridik dhe qytetarët duhet, pa vonesë, këto informacion t'i dorëzojnë. Në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar se prona gjendet në shtetet tjera, Gjykata është e detyruar të shpallë fletëarrest ndërkombëtar dhe publikim.

3.5.3.2. Të drejtat procedurale të personave ndaj të cilëve merret masa e konfiskimit të dobisë pasurore

Me rastin e konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale, personi mbi të cilin është bartur prona ose dobia pasurore, si dhe përfaqësuesi i personit juridik, do të ftohen me qëllim të marrjes në pyetje në procedurën paraprake, si dhe në shqyrtimin kryesor. Do të informohen se procedura, në rast të mos paraqitjes së tyre, do të përfundojë në mungesë të tyre. Përfaqësuesi i personit juridik do të merret në pyetje në shqyrtimin kryesor, pas të pandehurit. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe në raport me personin, mbi të cilin është bartur prona apo dobia pasurore, në qoftë se nuk është ftuar si dëshmitar. Ata mbi të cilët është bartur dobia pasurore, si dhe përfaqësuesi i personit juridik janë të autorizuar lidhur me caktimin e dobisë pasurore, që të propozojnë prova dhe në bazë të autorizimit të parashtrajnë pyetje për të pandehurin, dëshmitarët dhe ekspertët. Kur gjatë shqyrtimit publik konstatohet se ekzistojnë kushtet për zbatimin e masave të konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore, prokurori publik do të propozojë ndërprerjen e shqyrtimit publik dhe ftohet personi, të cilit i është bartur prona apo dobia pasurore ose përfaqësuesi i personit juridik.

I dëmtuari, i cili në procedurë penale, në raport me këtë kërkesë juridike, është udhëzuar në kontest civil, mund të kërkojë pagesën nga shuma e vlerës së konfiskuar, në qoftë se fillon kontekstin në afat prej 6 muajve, nga dita e nxjerrjes së vendimit, për të cilin në afat prej 3 muajsh nga dita e nxjerrjes së vendimit, me të cilin është parashikuar kërkesa e tij, ka kërkuar kompensimin e vlerës së konfiskuar.

I dëmtuari, i cili nuk ka ushtruar padi në procedurën penale, mund të kërkojë kompensimin e vlerës së konfiskuar, me qëllim të konstatimit të kërkesës së tij, ka filluar kontekstin në afat prej 3 muajve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, me të cilin është konfiskuar dobia pasurore, më së voni në afat prej 2 viteve, nga hyrja në fuqi e vendimit për konfiskimin e dobisë pasurore dhe në qoftë se në afat prej 3 muajve, nga hyrja në fuqi e vendimit, me të cilin është konstatuar kërkesa e tij, kërkon kompensimin e vlerës së konfiskuar.

3.5.3.3. Nxjerrja e aktgjykimit, me të cilin shqiptohet konfiskimi i dobisë pasurore

Në bazë të Kodit të Procedurës Penale (2016), ekziston mundësia *ex officio* e konfiskimit të dobisë pasurore.

Konfiskimi i pronës dhe dobisë pasurore mund të shqiptohet në aktgjykim, me të cilin i pandehuri shpallet fajtorë, me Vendimin e Gjykatës për vërejtje gjyqësore ose me vendimin e Gjykatës për zbatimin e masës edukuese, si dhe vendimin në të cilin shqiptohet masa e sigurisë. Në shqiptimin e aktgjykimit ose në vendim, Gjykata do ta theksoj sendin pronësor, përkatësisht dobia pasurore, që konfiskohet. Një kopje të vërtetuar të aktgjykimit, përkatësisht të vendimit, do t'i dorëzohet personit mbi të cilin është bartur prona ose dobia pasurore, si dhe përfaqësuesit të personit juridik (në qoftë se Gjykata ka shqiptuar konfiskimin ndaj tyre).

Procedurë e veçantë për konfiskimin e pronës dhe dobisë pasurore dhe konfiskimi i objekteve zbatohet kur ekzistojnë faktet ose pengesat ligjore për zhvillimin e procedurës penale, kundër kryerësit të veprës penale. Në këto raste, Gjykata, me propozim të prokurorit publik, do të zbatoj procedurë të veçantë për konfiskimin e pronës dhe dobisë pasurore dhe konfiskimin e sendeve, në qoftë se janë përmbushur kushtet nga Kodi Penal (2017). Në këtë procedurë, me propozimin e Prokurorit të shtetit, do të prezantohen provat e nevojshme. Gjykata do të nxjerrë vendim të masës së konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore dhe konfiskimin e sendeve, në qoftë se dëshmohet se bëhet fjalë për pronën apo dobinë pasurore, të përfituar me vepër penale ose për objekte, që janë shfrytëzuar ose janë krijuar gjatë kryerjes të veprës penale ose duhet të konfiskohen, në bazë të dispozitave të Kodit Penal (2017). Personi nga i cili konfiskohet prona apo dobia pasurore, ose konfiskohen sendet, kundër këtij vendimi ka të drejtë anekse drejtpërdrejtë pranë Gjykatës së Lartë, në afat prej 8 ditësh.

Sendet që duhet të konfiskohen, në bazë të Kodit Penal (2017), do të konfiskohen edhe kur procesi penal nuk ka përfunduar me aktgjykim, me të cilin i pandehuri shpallet fajtor (neni. 529). Vendim të veçantë për këtë nxjerr organi ku është zhvilluar procedura, në momentin kur procedura ka përfunduar, përkatësisht pezulluar. Vendimi për konfiskimin e këtyre sendeve nxjerr Gjykata edhe atëherë kur kjo i lejohet me aktgjykim, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor. Kopja e vërtetuar e vendimit do t'i dorëzohet pronarit të këtyre sendeve, në qoftë se është i njohur. Kundër këtyre vendimeve pronari i sendeve ka të drejtë ankese. Vendimin ndaj ankesës nxjerr Kolegji gjyqësorë (KPP, 2016, neni. 25).

Kur me dënimin me kusht konstatohet se dënimi do të ekzekutohet në qoftë se i dënuari nuk e kthen dobinë pasurore, nuk e kompenson dëmin, ose nuk i plotëson obligimet e tjera, ndërsa i dënuari nuk i plotëson këto obligime në afatin e caktuar, Gjykata e shkallës së parë do të zbatojë procedurën për pezullimin e dënimit me kusht, me propozim të prokurorit publik apo sipas detyrës zyrtare. Me këtë rast, gjyqtari do ta marrë në pyetje të dënuarin, në qoftë se është i qasshëm dhe do të kryejë hetimet e nevojshme për përcaktimin e fakteve dhe grumbullimin e provave, që janë të rëndësishme për vendim. Kryetari i kolegjit, cakton seancën e kolegjit, dhe lidhur me këtë informon prokurorin, të dënuarin dhe të dëmtuarin. Mosprezenca e palëve dhe palës së dëmtuar, në qoftë se janë informuar me kohë, nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Në qoftë se Gjykata konstaton se personi i dënuar nuk e ka përmbushur obligimin e caktuar me aktgjykim, do të nxjerrë aktgjykim, me të cilin e vazhdon afatin për ta përmbushur këtë obligim, do ta liroj nga përmbushja e këtij obligimi ose do ta zëvendësojë me obligim tjetër adekuat, të paraparë me Ligj ose do ta revokojë dënimin me kusht dhe do ta caktoj dënimin, që do të ekzekutohet. Në qoftë se Gjykata konstaton se nuk ka bazë për nxjerrjen e ndonjë nga këto vendime, me aktvendim do ta pezullojë procedurën për konfiskimin.

3.5.3.4. Procedura ankimuese

Kundër vendimit për konfiskimin e pronës do të zbatohen nenet 412 parag. 2. dhe 3. si dhe nenet 420 dhe 424 të KPP (2016). Kërkesën për përsëritjen e procedurës penale në raport me vendimin për konfiskim, mund ta dorëzojë personi, me të cilin ka të bëjë konfiskimi, në bazë të nenit 449 të KPP (2016).

3.5.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për konfiskim dhe sekuestrim të dobisë pasurore

3.5.4.1. Veprimet për ekzekutimin e vendimeve për konfiskimin dhe sekuestrimin e dobisë pasurore

Ekzekutimi i konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore, përkatësisht konfiskimi i pronës dhe dobisë pasurore do të realizohet në afat prej 30 ditësh, nga hyrja në fuqi e atgjykimit.

Urdhri për ekzekutim e lëshon gjykata, e cila ka nxjerrë aktgjykimin e shkallës së parë. Ekzekutimi kryhet për pronën dhe dobinë pasurore, të caktuar me vendim gjyqësorë, në qoftë se pjesërisht apo në tërësi kjo është e pamundshme, ekzekutimi kryhet nga prona e mbetur e personit, të cilit i është shqiptuar masa.

Kundërshtimi ndaj ekzekutimit nuk lejohet, ndërsa ekzekutimi i dhunshëm pezullohet vetëm në rastet kur personi vullnetarisht e kthen pronën ose e paguan shumën e dobisë pasurore në llogari të gjykatës. Aktet juridike të arritur pas kryerjes së veprës penale, me qëllim të zvogëlimit të vlerës së pronës, që është e lëndë e konfiskimit, janë të pavlefshme. Kundërshtimi lejohet vetëm në bazë të urdhrit, me të cilin caktohet ekzekutimi ndaj pronës së mbetur. Kundërshtimi parashtrohet në afat prej 8 ditësh, në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë, e cila nxjerr aktvendim në afat prej 8 ditësh.

Ekzekutimi i vendimit për konfiskim të dobisë pasurore është rregulluar me Kodin Penal (2017) dhe KPP (2016). Gjithashtu, zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Mënyra e konfiskimit është rregulluar me nenin 98 të Kodit Penal (2016). Me pasuri në vlerë monetare nga kryerësi do të konfiskohet dobia pasurore, e krijuar me veprë penale, që përbëhet nga vlera monetare, objektet e tundshme dhe të patundshme, si dhe çfarëdo prone apo dobi pronësore, të drejtat materiale dhe jo materiale, ndërsa në qoftë se ky konfiskim nuk është i mundshëm, kryerësit do t'i konfiskohet edhe prona tjetër, që i përgjigjet dobisë pasurore të përfituar.

Kodi Penal (2017), në nenin 100a, përcakton se askush nuk mund të mbajë apo t'i fitojë sendet, që janë përfituar nga vepra penale. Sendet, që ishin të destinuara ose të përdorura për kryerjen e veprës penale do të konfiskohen nga kryerësi i veprës penale, pa marrë parasysh nëse është pronë e tij ose pronë e personit të tretë, në qoftë se kjo është në interes të sigurisë së përgjithshme dhe shëndetit të njerëzve.

Sendet që janë shfrytëzuar ose kanë qenë në shfrytëzim gjatë kryerjes së veprës penale, mund të konfiskohen, në qoftë se ekziston rreziku nga përdorimi i serishëm për kryerjen e veprës penale.

Asnjë send në pronësi të personit të tretë nuk do të konfiskohet, në qoftë se nuk ishte në dijeni ose është dashur të ketë dijeni se është përdorur ose ka pasur për qëllim për të kryer veprën penale. Për konfiskimin e sendeve, Gjykata vendos në bazë të procedurës të përcaktuar

me Ligj, edhe atëherë kur për shkak të pengesave faktike dhe ligjore, nuk është i mundshëm zhvillimi i procedurës penale kundër kryerësit të veprës penale.

Zbatimi i kësaj mase nuk ka të bëjë me të drejtën e personave të tretë për kompensimin e dëmit nga kryerësi i veprës penale. Në pajtim me kushtet e përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara, sendet mund t'i kthehen një shteti tjetër.

3.5.4.2. Pjesëmarrësit në procedurat për ekzekutimin e vendimeve për konfiskimin e dobisë pasurore

Bankat dhe institucionet e tjera financiare, në të cilat është llogaria ndaj të cilës zbatohet kjo masë, si dhe kadastrat dhe institucionet e tjera për regjistrimin e tokës, janë të obliguara që ta ekzekutojnë aktvendimin gjyqësorë, pa vonesë dhe të pengohet bartja e mundshme apo transaksionet financiare.

3.5.4.3. Mbrojtja e të drejtave për palët e treta

Dobia pasurore u konfiskohet edhe personave të tretë mbi të cilët është bartur, pa kompensim adekuat, në qoftë se nuk kanë pasur dijeni, kanë mundur ose kanë qenë të detyruar të kenë dijeni, se është krijuar me vepër penale. Objektet që janë shpallur trashëgimi kulturore dhe pasuri e rrallë natyrore, si dhe ato me të cilat personalisht është i lidhur personi i dëmtuar, i konfiskohen personave të tretë, pa marrë parasysh se nuk ka pasur dijeni ose nuk ka mundur, dhe as nuk kanë qenë të detyruar të kenë dijeni, se janë krijuar me vepër penale dhe pa marrë parasysh nëse janë bartur me kompensim adekuat. Prona e sekuestruar i kthehet të dëmtuarit, ndërsa në qoftë se nuk ka të dëmtuar, bëhet pronë e shtetit. Në qoftë se i dëmtuari në procedurë penale ka fituar kërkesën pronësore – juridike, Gjykata do ta caktojë konfiskimin e dobisë pasurore, në qoftë se e tejkalon shumën e kësaj kërkesë.

3.6. SERBIA

Korniza juridike për konfiskimin e dobisë pasurore, e përfituar me vepër penale në Serbi përbehet nga rregullat sistemore, përkatësisht Kodit Penal (2016) dhe Kodit për procedurë penale, si dhe Ligjit për konfiskimin e pronës¹⁴⁶, që është përfituar me vepër penale (2016), që është *lex specialis* dhe vetëm me këtë ligj rregullohet konfiskimi i zgjeruar i pronës, që ka të bëjë me pronën e tërësishme, për të cilën mund të supozohet, në bazë të këtij ligji, se është përfituar me aktivitete kriminale.

3.6.1. Hetimi financiar

3.6.1.1. Fillimi i hetimit financiar

Hetimi financiar, si formë e veçantë e hetimit, është parashikuar me Ligjin për Konfiskimin e Pronës, të përfituar me veprën penale (2016) (në tekstin e mëtejshëm Ligji), dhe zbatohet në kuadër të këtij ligji, si *lex specialis*. Ka të bëjë me procedurën e konfiskimit të zgjeruar të pronës për vepra penale, të theksuara në nenin 2 të këtij Ligji.

Format e veçanta e hetimit financiar janë të rregulluar dhe parashikuar me KPP (2014), në kuadër të veprimeve dëshmuuese, që janë theksuar në KPP dhe janë caktuar kushtet dhe vëllimi i zbatimit të tyre. Për shembull, mund të jetë urdhri për ekspertizë financiare, pastaj verifikimi i llogarive të transaksioneve të dyshimta, kërkimi i të dhënave kompjuterike, grumbullimi i të dhënave përmes bankave, organeve doganore dhe tatimore etj.

Në bazë të Ligjit për organizimin dhe kompetencat e organeve shtetërorë për parandalimin e kimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit (2016), i cili zbatohet nga 1 mars 2018, në Prokurori për krimin e organizuar dhe drejtoritë e veçanta të prokurorive publike të larta (në bazë të këtij Ligji janë katër prokurori rajonale), mund të formohet shërbimi i forenzikës financiare, të cilat punë i kryen një forenzik financiar.

Një forenzik financiar, sipas këtij ligji, është personi që i ndihmon prokurorit për analizimin e rrjedhës së parave dhe transaksioneve financiare, me qëllim të ndjekjes penale.

Në bazë të ligjit të veçantë, hetimi financiar fillon atëherë kur ekziston dyshimi i bazuar se pronari, përkatësisht personi posedon një pronë të konsiderueshme, që është përfituar me vepër penale. Nocioni i pronarit dhe pronës, që rrjedh nga vepra penale janë parashikuar me ligj të veçantë. Nuk ekziston censusi monetar, si kusht për fillimin e hetimit financiar, ndërsa termi “pronë e konsiderueshme” përcaktohet në praktikë.

Në bazë të KPP (2014), veprimet dëshmuuese lidhur me hetimin financiar, mund të zbatohen atëherë kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepra penale, ndërsa për veprimet dëshmuuese të veçanta, është e domosdoshme që të përmbushet kushti nga neni 162 KPP (2014), i cili përcakton veprat penale për të cilat zbatohen veprimet dëshmuuese të veçanta (p.sh. hetimi i të dhënave kompjuteristike).

Në bazë të ligjit të veçantë, hetimi financiar fillon me urdhër të prokurorit, derisa në procedurë të rregullt penale nuk ka akt të veçantë i tillë, por në bazë të KPP, në kuadër të hetimit penal, zbatohen veprimet dëshmuuese, ndërsa për veprimet dëshmuuese të veçanta, është i nevojshëm urdhri nga gjyqtari i procedurës paraprake. (2016).

¹⁴⁶ Emri në origjinal është *Zakon o oduzimanju imovine proistekle iz krivičnog dela*.

3.6.1.2. Qëllimet e hetimit financiar

Në kuadër të procedurës penale, qëllimi i veprimeve dëshmuuese, si dhe të atyre lidhur me transaksione financiare dhe gjendjes materiale të të pandehurit, zbulimi i elementeve të veprës penale, konstatimit të pronës së përfituarar me kryerjen e veprës konkrete penale dhe bartjen eventuale të kësaj prone mbi personin e tretë. Në bazë të nenit 538 parag. 2 KPP (2014), organi i procedurës duhet që gjatë tërë procedurës të grumbullojë dëshmi dhe të gjitha rrethanat, që janë të rëndësishme për përcaktimin e dobisë pasurore.

Me ligj të veçantë, tek konfiskimi i zgjeruar i pronës, dispozitat e hetimit financiar janë veçanërisht të normuara (2016, neni 17-22). Në bazë të nenit 17 parag. 2, qëllimi i hetimit financiar është grumbullimi i dëshmive për pronën, të ardhurave të ligjshme, mënyrën dhe shpenzimet e jetesës të të pandehurit, bashkëpunëtorin e pandehur ose trashëgimlënësin, pronën që e ka trashëguar pasardhësi ligjor, përkatësisht dëshmisë për pronën dhe kompensimin për të cilën prona është bartur mbi personin e tretë (Ligji për konfiskimin e pronës që është përfituar nga vepra penale, 2016).

3.6.1.3. Specifikat e zhvillimit të hetimit financiar

Lejohen dhe zbatohen të gjitha veprimet e rregullta dëshmuuese, që parashikohen me KPP (2014). Në procedurën para hetimore, policia në bazë të nenit 286 KPP (2014) mundet në mënyrë të pavarur të ndërmer veprime operative, të grumbullojë dëshmi dhe informata, si dhe të ketë qasje në dokumentacionin e organeve shtetërore, ndërmarrjeve, shitoreve dhe personave të tjerë juridik, si dhe tu konfiskohen mjetet dhe dokumentacioni. Lidhur me veprimet që ndërmerren menjëherë, dhe më së voni në afat prej 24 orëve, informohet prokurori publik.

Nuk ekzistojnë kufizime të veçanta tek zbatimi i veprimeve të rregullta dëshmuuese, përveç të atyre lidhur me kushtet e parashikuara për zbatimin e tyre, përkatësisht ligjshmëria për t'i ndërmarr.

Në veprimet e rregullta dëshmuuese, në bazë të nenit KPP (2014) bënë pjesë edhe neni 143 –verifikimi i llogarisë dhe transaksioneve të dyshimta, për çka janë parashikuar kufizimet në zbatim - vetëm për veprat për të cilat është caktuar dënimi 4 vjet me burg ose më i rëndë, si dhe veprat penale veçanërisht të listuara, në mesin e të cilave janë shpëlarja e parave dhe veprat penale të korrupsionit. Shkalla e veçantë e dyshimit është bazë e dyshimit.

Verifikimi në bazë të këtij veprimi dëshmuues nënkupton: sigurimin e të dhënave, mbikëqyrjen e transaksioneve të dyshimta dhe pezullimin e përkohshëm të transaksioneve të dyshimta.

Ky veprim zbatohet në bazë urdhrin të prokurorit, që mund t'i dërgohet bankës apo ndonjë institucioni apo organizate tjetër financiare.

Të dhënat e grumbulluara duhet të asgjësohen, në qoftë se prokurori, në afat prej 6 muajsh, nga dita e informimit me materiale, nuk inicion procedurë penale (që fillon me urdhrin për fillimin e hetimit).

Në bazë të nenit 145 i KPP (2014), prokurori publik mund të kërkojë nga gjykata, përkatësisht gjyqtari i procedurës paraprake, të caktojë vëzhgimin e transaksioneve të dyshimta. Urdhri nxirret për afatin prej 3 muajsh, i cili mundet, sipas nevojës, të vazhdohet edhe për 3 muaj.

Afatet për ruajtjen e këtij materiali janë të njëjtë sikur në nenin paraprak, por këtu vendimin për anulim, merr gjyqtari i procedurës paraprake.

Në bazë të nenit 146 KPP (2014), pas arsyetimit të kërkesës të prokurorit, gjyqtari i procedurës

paraprake, mund të nxjerr urdhër, me të cilin banka, ose ndonjë tjetër organizatë financiare do ta ndalojë transaksionin e dyshuar.

Kjo masë e ndalimit të përkohshëm mund të zgjasë më së shumti 72 orë, ndërsa në rast se përsihen edhe ditët në vijim, me urdhër të gjykatës mund të vazhdohet për më së shumti 48 orë.

Veprimet e veçanta dëshmuese, të parashikuara me KPP (2014), të cilat veçanërisht mund të bëjnë me hetimin financiar janë: punët e simuluar (neni 174-177) dhe mund të përshijnë blerjen e simuluar, shitjen apo ofrimin e shërbimeve tregtare, si dhënia apo pranimi i ryshfetit; hetimi i të dhënave kompjuteristike (neni 178-180); dërgesa e kontrolluar (neni 181-182).

Këto veprime të veçanta dëshmuese, sikur edhe të gjitha veprimet e veçanta dëshmuese të tjera, janë nën regjimin e kufizuar veçantë të shfrytëzimit. I urdhëron gjyqtari i procedurës paraprake, në bazë të kërkesës së arsyetuar të prokurorit, tek ekzistimi i dyshimit të bazuar se është kryer ndonjë vepër penale, e theksuar në nenin 162 të KPP (2014), ku, përveç tjerash, bëjnë pjesë edhe veprat penale të krimit të organizuar, shpëlarjes së parave, veprat penale të korrupsionit. Kohëzgjatja e tyre është e kufizuar dhe rishqyrtohen në afatet e përcaktuar me ligj. Për shembull, punët e simuluar mund të zgjasin më së shumti 6 muaj, ndërsa për veprat në kompetencë të prokurorisë speciale më së shumti një vit. Hetimi i të dhënave kompjuteristike mund të zgjas më së shumti 9 muaj. Të gjitha veprimet e veçanta dëshmuese rishqyrtohen pas 3 muajve dhe nxirret urdhri i ri i arsyetuar për vazhdimin e veprimit.

Në bazë të ligjit të veçantë për konfiskimin e pronës, neni 17 deri 22, janë rregulluar dispozitat lidhur me hetimin financiar (Ligji për konfiskimin e pronës të krijuar nga vepra penale 2016). Në këtë ligj nuk janë listuar veçanërisht veprimet dëshmuese, që ndërmer Njësia për hetimin financiar. Është theksuar se bastisja e hapësirave të pronarit dhe personave të tjerë, si dhe bastisja e personave bëhet në bazë të urdhrit të Gjykatës. Është parashikuar edhe obligimi i organeve shtetërore dhe të tjera, organizatave dhe shërbimeve publike, që Njësia për hetimin financiar t'i mundësojë qasje dhe dorëzim të evidencës, dokumenteve, të dhënave dhe mjeteve të tjera, që mund të shërbejnë si dëshmi në hetim financiar.

Në nenin 4 paragrafi 4 i këtij Ligj, theksohet se aplikohet KPP, në hetimin financiar mund të përdoren të gjitha veprimet dëshmuese nga KPP, si dhe të veçanta, me që në dispozitën 2 të këtij neni është theksuar se në procedurën e konfiskimit (të zgjeruar) të pronës mund të shfrytëzohen edhe dëshmitë e grumbulluara në procedurë penale (Ligji për konfiskimin e pronës, të përfutur me vepër penale , 2016).

Njësia për hetim financiar, që është themeluar në bazë të dispozitave të Ligjit të veçantë, me punë ka filluar në vitin 2008 dhe është e autorizuar që, në bazë të dispozitave të përgjithshme të KPP (2014 neni 286) të grumbullojë të dhënat nga bazat e ndryshme të të dhënave, ndërsa në shumicën e rasteve, në praktikë (95%) këtë e bënë në bazë të kërkesës së prokurorit .

Njësia ka qasje të drejtpërdrejtë në bazat e Entit Republikan për Gjeodezi, Agjencinë e Regjistrave Ekonomik, ndërmarrje të veçanta publike, llogaritë bankare të personave juridik dhe fizik.

Të dhënat nga Drejtoria për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Drejtorisë Tatimore, sigurohen në bazë të kërkesës.

Njësia për hetimin financiar në bankat tregtare, ka kontakt listën, me personat e ngarkuar për bashkëpunim direkt.

Në bazë të nenit 20 të Ligjit për organizimin dhe kompetencat e organeve shtetërore në parandalimin e krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit (2016), Drejtoria Tatimore – Policia tatimore, Drejtoria e Doganave, Banka Popullore e Serbisë, Drejtoria për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave, Agjencia për Regjistrat Ekonomik, Regjistri Qendrorë dhe kliring – letrat me vlerë, Agjencia Shtetërore e Auditimit, Enti Republikan i Gjeodezisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Fondi Republikan për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Fondi Republikan për Sigurim Shëndetësor, Drejtoria Republikane për Pronë të Republikës së Serbisë dhe Drejtoria për Prokurim Publik, duhet të caktojnë së paku një zyrtar për lidhje, me qëllim të realizimit të bashkëpunimit dhe dorëzimit efikas i të dhënave të këtyre organeve dhe organizatave për Prokurorinë për krimin e organizuar dhe departamente të veçanta të prokurorive publike, për parandalimin e korrupsionit, me qëllimi të ndjekjes penale për veprat penale, të caktuara me këtë Ligj.

Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në kërkesë të prokurorit publik kompetent, zyrtarët për lidhje duhet të jenë të caktuar edhe në organet dhe organizatat e tjera (Ligji për organizime dhe kompetencat e organeve shtetërore në parandalimin e krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, 2016).

Në rast të nevojës, zyrtarët për lidhje kanë statusin e zyrtarit shtetërorë, mundën përkohësisht të zhvendosen në Prokurorinë për krim të organizuar dhe Departamentin e veçantë të prokurorisë publike për parandalimin e korrupsionit.

KPP nuk parashikon fushëveprimin e subjektit, por përdoren kompetencat e përgjithshme ligjore për detyrat e organeve shtetërore dhe të tjera, që në bazë të urdhrit të policisë, Prokurorisë ose Gjykatës, të dorëzojnë të dhënat e kërkuara.

Policia, në procedurën para hetimore, grumbullon të dhënat kryesisht në bazë të kërkesës së Prokurorisë, kurse në nenin 286 të KPP (2014), mundet në mënyrë të pavarur të grumbullojë të dhënat e veçanta, me obligim të informimit të prokurorit lidhur me të dhënat e grumbulluara.

Në bazë të nenit 48 të Ligjit për Bankat (2015), obligimi i ruajtjes të fshehtësisë bankare nuk ekziston, nëse ndërmjet tjerash, të dhënat bëhen të ditur, në bazë të gjykatës kompetente, policisë, organit kompetent në luftë kundër krimit të organizuar dhe organit kompetent për parandalimin e shpëlarjes së parave, në bazë të rregullave.

Në bazë të ligjit të veçantë për konfiskimin e pronës, njësia kompetente për hetim financiar, e formuar në kuadër të MPB, punët e hetimit financiar i kryen sipas detyrës zyrtare dhe sipas vendimit të prokurorit publik, neni 6 i Ligjit, ndërsa në bazë të nenit 7 organet shtetërore dhe të tjera, organizatat dhe shërbimet publike, janë të detyruara që njësisë, pa vonesë, t'i dorëzojnë të dhënat e kërkuara (Ligji për konfiskimin e pronës, të përfituar me vepër penale, 2016). Kjo ka të bëjë me hetimin financiar, në bazë të ligjit të veçantë, qëllimi i të cilit është përshkruar më herët.

Prokurori publik mund të urdhërojë organizatën bankare apo ndonjë organizate tjetër financiare që Njësisë për hetimin financiar t'ia dorëzojë të dhënat për gjendjen e llogarive tregtare dhe personale, si dhe kasafortave të pronarëve (Ligji për konfiskimin e pronës, të përfituar me vepër penale, 2016, neni 22).

3.6.1.4. Përfundimi dhe zbatimi i rezultateve të hetimit financiar

Me KPP nuk janë përcaktuar veçanërisht afatet për përfundimin e hetimit financiar, që formalisht nuk zbatohet me këtë emër, por me veprime dëshmuese. Kohëzgjatja e tij kushtimisht është përcaktuar për veprime dëshmuese të veçanta. Dëshmitë mund të grumbullohen në procedurë të rregullt penale deri në përfundim të plotë.

Me Ligj të veçantë, neni 16a theksohet se policia është e detyruar që prokurorit publik, me rastin e ushtrimit të fletëpadisë për ndonjë vepër penale, për të cilën aplikohet ky ligj, ti dorëzisë të dhënat lidhur me pronën e personit të tretë të dyshuar, të cilat janë grumbulluar gjatë procedurës parahetimore (Ligji për konfiskimin e pronës, të përfituar me vepër penale, 2016).

Në bazë të Ligjit të veçantë, hetimi financiar mund të vazhdojë deri në përfundimin procedurës për konfiskim të pronës.

Nuk janë përcaktuar kushtet për pezullimin e hetimit financiar, në bazë të Ligjit, ajo pezullohet në rast të aktgjykimit të plotfuqishëm lirues për veprën penale, e cila është parashikuar me ligj të veçantë.

Nuk është përcaktuar ekspertiza e obliguar, por zbatohet në bazë të nevojës, me urdhër të prokurorit apo gjykatës, në varshmëri nga faza e procedurës, ndërsa në bazë të dispozitave të përgjithshme të KPP-së (2014, që përcaktojnë mënyrën e zbatimit të ekspertizës, pa norma të veçanta, që kanë të bëjnë me ekspertizën financiare.

Rezultatet e hetimit financiar shfrytëzohen në procedurë të rregullt penale dhe mund të shërbejnë si dëshmi për konstatimin e elementeve të veprës penale, por edhe si dëshmi për konfiskim të dobisë pasurore. Në aktakuzë theksohen të dhënat për gjendjen pronësore të të pandehurit dhe të anëtarëve të familjes së tij, përkatësisht për pronën që e posedojnë.

Në bazë të Ligjit të veçantë, është parashikuar përmbajtja e kërkesës së prokurorit për sekuestrim të pronës, si dhe për konfiskim të pronës (Ligji për konfiskimin e pronës, të përfituar me vepër penale, 2016, neni 23 dhe 38). Krahas theksimit të pronës që duhet të konfiskohet, prokurori në arsyetim kërkon, praktikisht thekson rezultatet e hetimit financiar, duke ofruar dëshmi për pronën, dyshimin e bazuar se rrjedh nga vepra penale, përkatësisht për ekzistimin evident të disbalansit me të ardhura të ligjshme.

3.6.2. Masat e përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore (bllokimi/ngrrirja dhe sekuestrimi/konfiskimi i përkohshëm)

3.6.2.1. Baza ligjore për zbatimin e masave të përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore

Në bazë të nenit 540 i KPP (2014) Gjykata mundet, sipas detyrë zyrtare, të caktoj masa të përkohshme të sigurisë për konfiskimin e dobisë pasurore. Këto masa caktohen në bazë të Ligjit, me të cilin rregullohet procedura e ekzekutimit dhe sigurimit, Ligji për ekzekutim dhe sigurim (2017). Për caktimin e kësaj mase, është e nevojshme besueshmëria se konfiskimi i dobisë pasurore do të jetë i vështirësuar ose penguar nga i pandehuri.

Në bazë të ligjit të veçantë (Ligji për konfiskimin e pronës, të krijuar me vepër penale , 2016, neni 24) prokurori publik mundet, para se Gjykata të vendos për konfiskimin e përkohshëm të pronës, të nxjerrë urdhër për ndalesën e shfrytëzimit të pronës dhe për konfiskim të përkohshëm të pronës së patundshme. Këtë urdhër prokurori e nxjerr në qoftë se ekziston mundësia se pronari do ta shfrytëzoj pronën, që rrjedh nga vepra penale.

Në bazë të ligjit të veçantë, ndalesa e shfrytëzimit të pronës dhe konfiskimi i përkohshëm i pronës, në bazë të urdhrit të prokurorit, mund të zgjasë deri në nxjerrjen e vendimit të Gjykatës, në bazë të kërkesës së prokurorit për konfiskim të përkohshëm të pronës, më së gjati 3 muaj (Ligji për konfiskimin e pronës, të përfituar me vepër penale, 2016).

Gjykata nxjerr vendim lidhur me kërkesën e prokurorit për konfiskim të përkohshëm të pronës, më së voni në afat prej 3 muajve, nga parashtrimi i kërkesës prokurorit. Vendimi për miratim të kërkesës merret, në bazë të nenit 25 të Ligjit të veçantë, në qoftë se ekziston: mundësia se konfiskimi i mëvonshëm i pronës do të jetë i vështirësuar ose pamundësuar dhe në qoftë se ekziston dyshimi i bazuar se personi fizik ose juridik ka kryer veprën penale, nga neni 2 i këtij Ligji; ekziston dyshimi i bazuar se prona e pronarit është përfituar me vepër penale; vlera e pronës, për të cilën kërkohet konfiskimi, tejkalon shumë prej një milion e pesëqind mijë dinarë (Ligji për konfiskimin e pronës, të përfituar me vepër penale, 2016).

Në qoftë se nuk janë përmbushur kushtet e theksuara, gjykata me aktvendim do ta refuzoj kërkesën e prokurorit.

3.6.2.2. Propozimi ose kërkesa për caktimin e masave të përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore

Lidhur me masën e përkohshme të sigurimit të dobisë pasurore, në procedurë në rregullt, gjykata e merr me aktvendim, sipas detyrës zyrtare. Propozimi i prokurorit në është i obligueshëm, prandaj mund të paraqitet gojarisht dhe me shkrim, pa ndonjë formë të caktuar.

Me Ligj të veçantë, është përcaktuar përmbajtja e kërkesës, me të cilën prokurori kërkon sekuestrimin e pronës, dhe e njëjta përmban të dhënat për pronarin, titullin ligjorë të veprës penale, shënimi i pronës që duhet konfiskuar, dëshmitë për pronën, rrethanat nga të cilat buron dyshimi i bazuar se prona është përfituar me kryerje të veprës penale dhe shkaqet që arsyetojnë nevojën e masave të përkohshme për konfiskimin e pronës, përkatësisht gjasat që pronari do ta shfrytzojë pronën (Ligji për konfiskimin e pronës së fituar me vepër penale 2016).

Më vonë, gjatë rishqyrtimit të kësaj mase, gjykata mundet të njëjtën ta zëvendësojë me masën ndalimi i shfrytëzimit të pronës së konfiskuar.

3.6.2.3. Caktimi i masave të përkohshme të sigurimit të dobisë pasurore

Siq u tha, caktimi i këtyre masave është i mundshëm në procedurë të rregullt dhe në bazë të dispozitave të ligjit të veçantë.

Në bazë të ligjit të veçantë, gjykata këto masa nuk mund ti merr sipas detyrës zyrtare. Ajo mundet masën e sekuestrimit ta zëvendësojë me masën e ndalimit të shfrytëzimit të pronës së sekuestruar, dhe këtë me rastin e rishqyrtimit zyrtar të kësaj mase ose me propozimin e Drejtorisë për Administrimin e Pronës së Sekuestruar, por mundet edhe me propozim të pronarit. Gjykata është e detyruar që masën e sekuestrimit të pronës që ta rishqyrtoj deri në nxjerrjen e vendimit për konfiskim dhe atë së paku një herë në vit.

Me procedurë të rregullte penale, gjykata me aktvendim vendos për masën e përkohshme të sigurisë për dobinë pasurore. Këtë masë, në varshmëri nga faza e procedurës, e cakton gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm ose kolegji gjyqësor. Nuk është e përcaktuar procedurë e rregullt, përveç kur bëhet fjalë për pronën e personave të tjerë, mbi të cilin është bartur dobia pasurore. Këta persona do të dëgjojnë në procedurë paraprake ose në shqyrtimin kryesor, ndërsa vendimi mund të merret edhe pa praninë e tyre, në qoftë se janë ftuar në mënyrë të rregullte (KPP, 2014 neni 539).

Me këto masa në procedurë të rregullte vendos gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm ose kolegji, në varëshmëri nga lloji i veprës penale, përkatësisht nëse zhvillohet procedurë e shkurtuar (për vepra penale për të cilat është parashikuar dënimi me burg deri në 8 vjet, gjykon gjyqtari i vetëm, me procedurë të shkurtuar).

Me procedurë të veçantë, në varësi nga faza e procedurës, masat e përkohshme i merr gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i kolegjit, ku mbahet shqyrtimi kryesor. E njëjta ka të bëjë edhe për aktvendimin për ndalimin e shfrytëzimit të pronës, që vendoset në këtë procedurë.

Praktikisht, mund të merren të gjitha masat, përkatësisht ato që parashikohen me Ligjin për përmbarimin dhe sigurimin (2017). Mund të caktohet çdo masë, me të cilën sigurohet kërkesa monetare dhe jomonetare, veçanërisht; konfiskimi i sendeve të patundshme dhe të tundshme ose ndalesa e tjetërsimit të të njëjtave, konfiskimi i mjeteve monetare, përkatësisht bllokimi i llogarive bankare, ndalesa e ngarkesës së paluajtshmërisë.

Parimi i proporcionalitetit, para së gjithash është rregulluar me dispozitat e Ligjit për përmbarim dhe sigurim (2017), në bazë të cilit caktohet masa e përkohshme në procedurë të rregullt penale. Kështu, gjykata me rastin e zgjedhjes së mjeteve për sigurimin e përmbarimit, duhet të ketë kujdes për proporcionalitetin në mes të lartësisë së obligimit dhe vlerës së përmbarimit. Praktikisht, kjo do të thotë se në procedurë penale, me rastin e caktimit të masës së përkohshme për konfiskimin e dobisë pasurore, gjykata duhet të ketë parasysh lartësinë eventuale të dobisë pasurore, për të cilën dyshohet se është përfituar me vepër penale, kështu në proporcion me këtë edhe merr masën e përkohshme të sigurimit.

Me zbatimin e Ligjit për përmbarim dhe sigurim (2017) është e mundshme që në vend të zbatimit të masës së përkohshme të caktohet garancia ose masa e caktuar të zëvendësohet me garanci .

Me procedurë të veçantë të konfiskimit të zgjeruar të pronës, me masën e përkohshme të konfiskimit, nuk sigurohen kërkesat e ardhshme, lidhur me rezultatin e procedurës penale, përcaktimi i fajësisë dhe lartësia e dobisë pasurore, tash më sigurohet me konfiskimin e pronës për të cilën ekziston dyshimi i bazuar se është fituar me vepër penale, përkatësisht aktivitetet kriminale, të mos vështirësohet apo pamundësohet.

Prandaj, me ligj të veçantë bazohet në dispozitat e Ligjit për përmbarim dhe sigurim 2017, por në pjesën që ka të bëjë me administrimin e pronës së konfiskuar. Ekzistojnë dispozitat që në bazë të këtij Ligji, mbrojnë të drejtat e caktuara, kështu që në nenin 26 paragrafi 2 dhe 3, (Ligji për konfiskimin e pronës së përfituar me vepër penale, 2016), theksohet se Gjykata në aktvendim për konfiskim të pronës, mund të caktojë sekuestrim, nuk ka të bëjë me pronën që duhet veçuar me zbatimin e rregullave për mbrojtjen e përfituesit të ndërgjegjshëm, ndërsa pronarit mund t'i lihet në shfrytëzim pjesa e pronës së sekuestruar, në qoftë se me sekuestrimin e saj do të vihet në pyetje ekzistenca e pronarit ose personit, i cili sipas Ligjit është i detyruar që të kujdeset, si dhe Gjykata nuk mund të konfiskojë pronën, që është e përjashtuar nga përmbarimi, në pajtim me ligjin që rregullon përmbarimin dhe sigurimin.

Në procedurë të rregullt penale, masat që duhet të caktohen ndaj të dyshuarit dhe të pandehurit, si dhe ndaj personit të tretë, mbi të cilin është bartur dobia pronësore, pa kompensim ose me kompensim, që nuk i përgjigjet vlerës reale.

Me procedurë të veçantë, për konfiskimin e zgjeruar të pronës, e njëjta nuk mund të konfiskohet nga rrethi i gjere i personave, të cilët janë pronarë të pronës, dhe këta mund të jenë: i pandehuri, përkatësisht i dyshuari, bashkëpunëtori i pandehur, i cili konsiderohet dëshmitari bashkëpunues dhe bashkëpunëtori i dënuar, trashëgimlënësi, trashëgimtari juridik dhe personi i tretë.

Trashëgimlënës konsiderohet personi kundër të cilit për shkak të vdekjes, procedura nuk është iniciuar ose është pezulluar, ndërsa në procedurë penale, që zhvillohet kundër personave të tjerë, është konstatuar se së bashku me këta persona ka kryer veprën penale, për të cilën në bazë të nenit

2 të Ligjit është lejuar zbatimi i konfiskimit të zgjeruar të pronës (Ligji për konfiskimin e pronës së fituar me vepër penale, 2016).

Duhet theksuar se në bazë të Ligjit të veçantë, kërkesa e prokurorit për konfiskimin e përkohshëm të pronës, pa vonesë i dorëzohet pronarit të pronës me këshillë që në afat prej 15 ditësh, mund të dorëzojë përgjigje ndaj kërkesës, me dëshmitë lidhur me mënyrën e fitimit të pronës. Gjykata, vendimin lidhur me kërkesën e prokurorit, merr pas pranimi të kësaj përgjigje, më së voni në afat prej 8 ditësh nga skadimi i afatit për pranimin e përgjigjes së pronarit (Ligji për konfiskimin e pronës së fituar me vepër penale, 2016).

3.6.2.4. Procedura ankimese

Me procedurë të rregullt penale, ankesa ndaj aktvendimit për masën e përkohshme të sigurimit, mund të ushtrohet në afat prej 3 ditësh. Mund ta ushtrojnë paditësi dhe i pandehuri, përkatësisht i dyshuari. Ankesa nuk ndalon ekzekutimin aktvendimit, lidhur me ankesën ndaj vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, kolegji shqyrtues i gjykatës së njëjte, ndërsa ato që i merr gjyqtari i vetëm apo Kolegjit, gjykata e shkallës së dytë

Në bazë të dispozitave të ligjit të veçantë, prokurori publik dhe pronari i pronës, munden në afat prej 8 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktvendimit mbi sekuestrimin e pronës, të ushtrojnë ankesë në Gjykatën e shkallës së dytë. Ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit. Krahas ankesës kundër aktvendimit, pronari mundet të dorëzojë edhe dëshmitë për prejardhjen e ligjshme të pronës së sekuestruar. (Ligji për konfiskimin e pronës së përfituar me vepër penale, 2016).

Për vendimmarrje lidhur me ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, caktohet shqyrtimi, në të cilin ftohet pronari, mbrojtësi i tij ose avokati dhe prokurori publik.

Ftesa dhe ankesa e palës së kundërt, dërgohen në adresë të njohur, përkatësisht selinë e personit, me vërejtje se shqyrtimi do të mbahet edhe në rast të mosardhjes së tij.

Shqyrtimi do të mbahet më së voni në afat prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të ankesës. Mosardhja e palëve të informuar me kohë, nuk e pengon mbajtjen e shqyrtimit.

Shqyrtimi i filluar, në bazë të rregullave, mbahet pa ndërprerje dhe shtyrje.

3.6.3. Veprimet për konfiskimin e dobisë pasurore, të fituara me vepër penale

3.6.3.1. Llojet e veprimeve dhe karakteristikat e tyre themelore

Në bazë të Ligjit Penal të RS (2016, neni 91), askush nuk mundet ta mbajë dobinë pasurore, të përfituar me vepër penale. Dobia pasurore, në bazë të dispozitave të KP (2016) dhe KPP (2014) konfiskohet sipas detyrës zyrtare, me vendim gjyqësor, me të cilin është konstatuar kryerja e veprës penale. Dispozitat e KP (2016) dhe dispozitat KPP (2014) zbatohen vetëm për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar në mënyrë direkte nga kryerja e veprës penale, që është lëndë e procedurës.

Nga kryesi do të konfiskohen paratë, sendet me vlerë dhe çdo dobi tjetër pronësore, të cilat janë përfituar me vepër penale, ndërsa në qoftë se konfiskimi nuk është i mundshëm, kryesi do të obligohet që të dorëzojë në shkëmbim dobinë tjetër pasurore, që i përgjigjet vlerës së pronës, të përfituar me kryerjen e veprës penale ose që rrjedh nga vepra penale ose do të paguaj shumën monetare, që i përgjigjet dobisë pasurore të përfituar. Me këtë, pas ndryshimit të legjislationit të vitit 2009, në procedurë të rregullt juridike, mundësohet mënyra e zëvendësimit të pronës së konfiskuar.

Dobia e përfituar me vepër penale, do të konfiskohet edhe nga personi juridik dhe fizik, mbi të cilin është bartur prona, pa kompensim ose me kompensim, që është e qartë se nuk i përgjigjet vlerës reale.

Në qoftë se me vepër penale është përfituar dobia pasurore për një person tjetër, kjo dobi do të konfiskohet.

Në rast të vdekjes, në procedurën e rregull penale nuk është i mundur zbatimi i konfiskimit të dobisë pasurore, derisa në rast të arratisjes kjo është e mundshme, në rast të gjyqimit në mungesë.

Në bazë të ligjit të veçantë për konfiskimin e zgjeruar të pronës (Ligji për konfiskimin e pronës së fituar me vepër penale, 2016), është përcaktuar procedurë e veçantë, si dhe organet kompetente për zbulimin, konfiskimin dhe administrimin e pronës së konfiskuar.

Siç u tha edhe me sipër, pronë e përfituar me vepër penale, në bazë të këtij ligji, konsiderohet prona e pronarit, për të cilën është e qartë se është në disbalans me të ardhurat e tij të rregullta, përkatësisht kjo mund të jetë cila do pronë, të cilën pronari e posedon dhe të cilën e ka krijuar para kryerjes së veprës penale, për të cilën gjykohet (Ligji për konfiskimin e pronës së përfituar me vepër penale, 2016). Meqenëse konfiskimi i pronës, në bazë të këtij ligji të veçantë, është i mundshëm vetëm në rast të ekzistimit të aktgjyqimit të plotfuqishëm dënues, për ndonjë nga veprat penale, për të cilat zbatohet ky ligj, në rast të aktgjyqimit lirues nuk ka konfiskim, por prona e sekuestruar i kthehet pronarit.

Në bazë të dispozitave të përgjithshme të KP (2016), dobia pasurore konfiskohet të procedurë që zbatohet në shqyrtimin kryesor, me procedurën që e përcaktohen edhe dëshmitë për vepër penale, përkatësisht përcaktohet në procedurë penale, sipas detyrës zyrtare. Organi i procedurës, varësisht nga faza e procedurës, është i detyruar që t'i grumbulloj dëshmitë dhe verifikoj rrethanat lidhur me konstatimin e dobisë pasurore.

Në qoftë se vjen në konsideratë konfiskimi i dobisë pasurore, të përfituar me kryerjen e veprës penale të kryer nga personat e tjerë, personi mbi të cilin është bartur dobia pasurore, pa kompensim ose me kompensim, që është e qartë se nuk i përgjigjet vlerës reale, përkatësisht përfaqësuesi i personit juridik, do të ftohet me qëllim të marrjes në pyetje në procedurën paraprake edhe në shqyrtimin kryesorë. Në shqyrtimin kryesor, këta persona merren në pyetje, pas të akuzuarit dhe munden lidhur me konstatimin e dobisë pasurore, të propozojnë dëshmi dhe në bazë të autorizimit të kryetarit të kolegjit, të parashtroj pyetje për të akuzuarin, dëshmitarin, ekspertin dhe këshilltarin profesional.

Në qoftë se Gjykata, qysh gjatë shqyrtimit kryesor konstaton se vjen në konsideratë konfiskimi i dobisë pasurore nga personat e tretë të theksuar, do ta ndërprejë shqyrtimin dhe do ta ftoj atë person, përkatësisht përfaqësuesin juridik.

Përjashtimi i publikut në shqyrtimin kryesor nuk vlen për personat e tretë.

Në bazë të ligjit të veçantë, tek konfiskimi i zgjeruar i pronës, procedura për konfiskim të pronës inician sipas kërkesës së prokurorit, në afat prej 6 muajsh, nga dita e dorëzimit të aktgjyqimit të plotfuqishëm, me të cilin është konstatuar se është kryer vepra penale, e përcaktuar në nenit 2 të këtij ligji. (Ligji për konfiskimin e pronës së përfituar me vepër penale, 2016).

Kjo procedurë zbatohet në shqyrtimin kryesor, para gjykatës kompetente dhe konsiderohet procedurë urgjente. Është parashikuar mbajtja e shqyrtimit përgatitor, me qëllim të propozimit të dëshmive dhe paraqitjen e fakteve lidhur me kërkesën e prokurorit. Nuk ka dispozita me të cilat përjashtohet publiku.

Dobia pasurore mund të konfiskohet nga pronari i pronës, ndërsa sipas ligjit të veçantë (Ligji për konfiskimin e pronës së përfutur me vepër penale, 2016, neni 3), pronar konsiderohet i pandehuri, përkatësisht i dyshuari, bashkëpunëtori i pandehur, i cili konsiderohet edhe dëshmitari bashkëpunëtor dhe bashkëpunëtori i dënuar, trashëgimlënësi, trashëgimtari juridik dhe personi i tretë.

Trashëgimlënës konsiderohet personi kundër të cilit, për shkak të vdekjes, procesi penal nuk është iniciuar ose është pezulluar, kurse në procedurë penale, që zhvillohet kundër personave të tjerë është konstatuar se së bashku me këta persona ka kryer veprën penale, për të cilën në bazë të nenit 2 të ligjit, lejohet zbatimi i konfiskimit të zgjeruar të pronës (Ligji për konfiskimin e pronës së fituar me vepër penale, 2016). Kjo praktikisht do të thotë se konfiskimi i pronës është i mundshëm nga trashëgimtari i trashëgimlënësit, përkatësisht të pandehurit, ndaj të cilit për shkak të vdekjes nuk ka filluar gjykimi ose procedura është pezulluar.

3.6.3.2. Të drejtat procedurale të personave ndaj të cilëve caktohet konfiskimi i dobisë pasurore

Këta persona disponojnë me të gjitha të drejta procedurale të parashikuar me KPP (2014), si prania në shqyrtim kryesor në procedurën e rregullt, të drejtat në mbrojtje, propozimi i provave, pjesëmarrje në procedura kontradiktore. Në rastet kur dobia pasurore konfiskohet nga personi i tretë, fizik ose juridik, është obligim që ata të ftohet në shqyrtim kryesor, por me paralajmërim që në rast të ftesës së rregullt, i njëjti mund të mbahet edhe në mungesë të tyre.

Me procedurë të veçantë, të konfiskimi i zgjeruar i pronës, para shqyrtimit kryesorë, mbahet shqyrtimi përgatitor, ku ftohet prokurori publik, pronari dhe avokati i tij. Ftesa i dorëzohet pronarit, për gjykatë në adresë të njohur, përkatësisht në selinë personit të fituar me paralajmërim se shqyrtimi do të mbahet edhe në mungesë të tij. Në qoftë se ftesa është dorëzuar drejtpërdrejtë pronarit ose avokatit, konsiderohet se dorëzimi është kryer në mënyrë të rregullt. Në rast se ftesa nuk mund të dorëzohet në këtë mënyrë, gjykata pronarit do t'ia caktoj avokatin, sipas detyrës zyrtare, për procedurën e konfiskimit të pronës.

Pronarit do ti dorëzohet ftesa, në mënyrë që në mes të ditës së dorëzimit të ftesës dhe ditës së mbajtjes të shqyrtimit përgatitor, të kaloj së paku 8 ditë.

Në ftesë, gjykata do t'i ftoj të gjithë personat e ftuar, që në shqyrtimin përgatitor, ti paraqesin faktet dhe të propozojnë provat, në të cilat bazohet ose mohohet kërkesa e prokurorit publik.

Shqyrtimi kryesor caktohet në afat prej 3 muajve, nga mbajtja e shqyrtimit përgatitor, në të cilën periudhë mund të grumbullohen dëshmitë, ndërsa për shkak të grumbullimit të vështirësuar të provave, shqyrtimi kryesor mund të shtyhet edhe për 3 muaj. Ky afat i shërben të pandehurit dhe prokurorit, me qëllim të grumbullimit të provave shtesë.

Shqyrtimi kryesor fillon me paraqitjen e përmbajtjes së kërkesës së prokurorit publik. Shqyrtimi i filluar do të përfundoj, në bazë të rregullave pa ndërprerje dhe shtyrje.

Në qoftë se kërkesa është e orientuar në pronën e të pandehurit, përkatësisht bashkëpunëtorin e pandehur, prokurori publik paraqet prova lidhur me pronën që i pandehuri, përkatësisht bashkëpunëtori i pandehur posedon, për të ardhurat e tyre të ligjshme dhe rrethanat që indikojnë për ekzistimin e disbalansit të qartë në mes të pronës dhe të ardhurave të ligjshme. I pandehuri, bashkëpunëtori i pandehur përkatësisht avokatët e tyre deklarohen lidhur me theksimet e prokurorit publik.

Në qoftë se kërkesa është e orientuar në pronën e trashëgimtarit juridik ose personit të tretë, prokurori publik paraqet prova se trashëgimtari juridik ka trashëguar pronën e përfitur me veprë penale, përkatësisht që prona është e bartur në personin e tretë pa kompensim ose me kompensim, që është e qartë se nuk i përgjigjet vlerës reale, me qëllim të pengimit të konfiskimit. Trashëgimtari juridik, personi i tretë, përkatësisht avokatët e tyre deklarohen lidhur me theksimet e prokurorit publik.

Në shqyrtimin kryesorë, sipas nevojës, merren në pyetje dëshmitaret e ftuar dhe paraqiten provat të tjera të propozuara, që janë të pranuar nga gjykata.

3.6.3.3. Nxjerrja e vendimit që urdhëron konfiskimin e dobisë pasurore

Gjykata, sipas detyrës zyrtare, konfiskon dobinë pasurore me procedurë të rregullt. Në mënyrë të njëjte veprohet lidhur me veprat penale të caktuara, për të cilat me ligj parashikohet konfiskimi i obligueshëm i dobisë pasurore. Për shembull, tek vepra penale e shpëlarjes së parave, pranimit dhe dhënia e ryshfetit, ndikimi në tregti dhe veprave të tjera penale të korrupsionit.

Gjykata nuk mundet, sipas detyrës zyrtare, që ta konfiskojë pronën me procedurë të konfiskimit të zgjeruar.

KPP (2014) përcakton, përveç tjerash, që në në shqiptimin e aktgjykimit thekson vendimin për konfiskimin e dobisë pasurore, kurse në arsyetim theksohen faktet, që i ka vlerësuar gjykata.

Në shqiptimin e aktgjykimit, i cili më vonë është titull ekzekutiv, duhet saktësisht të theksohet lloji dhe sasia e dobisë pasurore-.

Me procedurë të veçantë për konfiskimin e pronës, gjykata në aktvendim thekson të dhënat mbi pronarin, titullin ligjor të veprës penale nga aktvendimi, të dhënat për pronën që konfiskohet, përkatësisht vlerën që konfiskohet nga pronari, në qoftë se ka pasur në dispozicion pronën, që rrjedh nga vepra penale, me qëllim të pengimit të konfiskimit të saj dhe vendimin për shpenzimet për administrimin e pronës së konfiskuar, kërkesën pronësore-juridike lidhur me kërkesën e të dëmtuarit dhe shpenzimet e përfaqësimit.

3.6.3.4. Procedura ankimuese

I pandehuri dhe personi i tretë, mundën personalisht ose përmes avokatit të ankohen ndaj aktgjykimit edhe në pjesën që ka të bëjë në konfiskimi e dobisë pasurore, në afat që vlen për aktgjykim, pesëmbëdhjetë ditë, ndërsa në rastet e veçanta ky afat mund të vazhdohet deri në 30 ditë. Ankesa e ushtruar me kohë dhe e lejuar, ndaj aktgjykimit, nuk shtyn ekzekutimin e të njëjtës, si dhe në pesën që ka të bëjë me konfiskimin e dobisë pasurore. Lidhur me ankesën ndaj aktgjykimit vendosë gjykata e shkallës së dytë: gjykata për vepra penale, ku është caktuar dënimi deri në 5 vite burg dhe Gjykata e Apelit për të gjitha veprat e rënda penale.

Në procedurë të veçantë për konfiskimin e pronës, ankesa kundër vendimit për konfiskim, mund të ushtrohet në afat prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të vendimit. Lidhur me ankesën vendosë gjykata e shkallës së dytë, që në shumicën e rasteve është Gjykata e Apelit. Personat e autorizuar për ushtrimin e ankesës janë prokurori publik, pronari i pronës së konfiskuar dhe mbrojtësi ose avokati i tij.

Ankesa kundër vendimit nuk pengon Drejtorinë për administrimin e pronës, që të administrojë me pronën e konfiskuar deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës.

Gjykata e shkallës së dytë mundet vetëm një herë të revokojë vendimin, ndërsa për shqyrtimin e serishëm duhet të caktojë seancën dhe të vendosë lidhur me ankesën.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, si këshillë juridike e jashtëzakonshme, për të cilën vendos Gjykata e Kasacionit, lejohet edhe kundër vendimeve për konfiskimin e dobisë pasurore dhe konfiskimin e pronës me procedurë të veçantë. Kjo këshillë juridike lejohet edhe në rastet e sekuestrimit të pronës, përkatësisht caktimin e masës së sigurimit të pronës.

3.6.3.5. Informimi i Agjencisë për Administrim ose i subjekteve të tjera

Me aktgjykim të plotfuqishëm, me të cilin konfiskohet dobia pasurore, gjykata e informon Drejtorinë për administrimin e pronës së konfiskuar. Drejtoria është organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë, kompetente për administrimin e pronës të përfutur me vepër penale, por edhe dobisë pasurore, të konfiskuar në procedurë të rregullt. Kompetencat e Drejtorisë janë përcaktuar me ligj të veçantë për konfiskimin e pronës.

Vendimin lidhur me konfiskimin e pronës, me procedurë të veçantë, gjykata ia dorëzon pronarit, avokatit të tij, prokurorit publik, Drejtorisë për administrimin e pronës së konfiskuar dhe Njesisë për hetim financiar.

Në rast të vendimit të plotfuqishëm për konfiskimin e pronës, prona dhe mjetet monetare, të përfutur me shitjen e pronës, bëhen pronë e Republikës së Serbisë.

Devizat e konfiskuara dhe monedhat e huaja efektive paguhen dhe evidentohen në llogari të veçantë në Bankën Popullore të Serbisë, ndërsa dinarët e konfiskuar deponohen në llogaritë e caktuara për pagesën e të ardhurave publike.

Në bazë të vendimit të ministrisë kompetente për shkencë, përkatësisht kulturë, sendet e konfiskuara me vlerë historike, artistike dhe shkencore, Drejtoria ia dorëzon pa kompensim institucioneve kompetente për ruajtjen e të mirave të tilla.

Për konfiskimin e pronës zbatohen dispozitat e ligjit, me të cilin rregullohet prona publike. Qeveria mund ta caktojë destinimin e pronës së konfiskuar, me qëllim të realizimit të veprimtarisë së dobishme shoqërore. Kjo pronë administrohet nga Drejtoria deri në vendimin e Qeverisë për administrimin e kësaj prone.

3.6.4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për konfiskimin dhe sekuestrimin e dobisë pasurore

3.6.4.1. Veprimet për ekzekutimin e vendimeve për konfiskimin dhe ekzekutimin e dobisë pasurore

Vendimi i gjykatës mund të ekzekutohet kur bëhet i plotfuqishëm dhe kur skadon afati për përm-bushjen vullnetare të obligimit.

Në procedurë të rregullt gjyqësor, gjykata vendimet për sekuestrim ia dorëzon institucioneve kompetente, për shembull bankave, kadastrës, agjencive shtetërore etj.

Vendimi për caktimin e masës së përkohshme ka efektin e vendimit për ekzekutim, ndërsa në rastin kur bëhet fjalë për procedurën që kërkon veprime ekzekutive të veçanta, vendimi i dorëzohet departamentit për ekzekutimin pranë gjykatës kompetente.

Te sekuestrimi i pronës, me ligj të veçantë, pronën e administron Drejtoria për administrimin e pronës së konfiskuar, gjykata do t'i dërgojë pronarit, mbrojtësit të tij, përkatësisht avokatit, prokurorit publik, Njësisë, Drejtorisë dhe bankës ose një organizate të tjetër, e ngarkuar për transaksione të pagesave. Vendimin drejtpërdrejtë e zbaton Drejtoria, përmes të punësuarve të saj, me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sigurimin.

Mbikëqyrja e zbatimit të masës së ndalimit të shfrytëzimit të pronës së konfiskuar bëhet nga Njësia për Hetim Financiar.

Ekzekutimi zbatohet përmes Drejtorisë, në bazë të zbatimit të Ligjit për Sigurime dhe Ekzekutim.

Ekzekutimi vullnetarë zbatohet me dorëzimin e sendeve në drejtori.

Ekzekutimi i dhunshëm zbatohet në bazë të Ligjit për Sigurimin dhe Ekzekutimin (2017). Drejtoria i drejtohet gjykatës, e cila e ka marrë vendimin, kështu që gjykata përmes avokatit fillon procedurën e ekzekutimit të dhunshëm, të cilën e zbaton pranë gjykatës kompetente.

3.6.4.2 Pjesëmarrësit në procedurat për ekzekutimin e vendimeve për konfiskim të dobisë pasurore

Procedura e ekzekutimit është rregulluar me Ligjin për Ekzekutimin dhe Sigurimin (2017). Në procedurat kur shteti është kreditor, ekzekutimi i dhunshëm zbatohet përmes gjykatës, shtetin, që përfaqëson avokati.

Bankave, me regjistra të ndryshëm të pronës, kadastrave u dorëzon vendimet e gjykatave për ekzekutim.

Drejtorja për administrimin e pronës së konfiskuar ka kompetenca të ndryshme, kështu që paluajtëshmëritë mund ti jap me qira, të kryen shitjen e pronës së tundshme, ndërsa gjërat e ndryshme ruhen në institucione të ndryshme, kështu që:

Sekuestrimi i sendeve me vlerë historike, artistike dhe shkencore, Drejtoria i dorëzon në ruajtje institucioneve kompetente për ruajtjen e këtyre sendeve, deri në nxjerrjen e vendimit lidhur me kërkesën për konfiskimin e pronës.

Devizat e sekuestruara dhe monedhat e huaja efektive barten, përkatësisht deponohen në llogari të destinuar të Drejtorisë, që evidentohet në Bankën Popullore të Serbisë, me ç'rast arrihet marrëveshja, ndërsa dinarët e sekuestruar deponohen në llogari të Drejtorisë, e cila mirëmbahet nga ministria, që është kompetente për Punët e Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria për Thesar.

Sendet nga metalet e çmuara, gurëve të çmueshëm dhe gjysmë të çmueshëm dhe perlave, drejtoria i dorëzon në ruajtje Bankës Popullore të Serbisë, deri në nxjerrjen e vendimit për konfiskim.

Armët e konfiskuara dorëzohen në ruajtje në Ministrinë kompetente për Punë të Brendshme, përveç ekzemplarëve koleksionues dhe trofeve, të cilët ia besohen për ruajtje muzeut.

Lidhur me ruajtjen e sendeve, Drejtoria arrin marrëveshje me institucione kompetente, përkatësisht Bankën Popullore të Serbisë.

Në qoftë se konfiskimi është kryer për personin juridik, Drejtoria mundet të drejtën e administrimit ta bartë në person fizik ose juridik, në bazë të marrëveshjes.

Personi mbi të cilin është bartur e drejta e administrimit në punët e administrimit ka kompetenca, obligime dhe përgjegjësi, si përfaqësues i kapitalit shoqëror, në pajtim me Ligjin që rregullon privatizimin.

3.6.4.3 Mbrojtja e personave të tretë

Më herët u fol për mënyrën e mbrojtjes së të drejtave të personave të tretë, në procedurë për konfiskimin e dobisë pasurore, në rastet kur konfiskimi bëhet nga personat e tretë. Theksohen të drejtat e tyre pranë gjykatës në procedurë ankimore, etj. Të drejtat në procedurën e ekzekutimit, personat e tretë kanë të drejta, si çdo pronar tjetër i pronës, në bazë të ligjit të veçantë.

Personat e tretë mund të drejtat e tyre të mbrojnë në procedurë civile.

IV. KONFISKIMI I ZGJERUAR NË ASPEKTIN KRAHASUES

4.1. SHQIPËRIA

4.1.1 Korniza ligjore e konfiskimit të zgjeruar

Sa i përket përmbajtjes substanciale të tij, si masë e bazuar në lidhjen fleksibile ndërmjet veprave penale dhe të ardhurave nga krimi, konfiskimi i zgjeruar drejtohet me ligjin AM (2017), duke qenë një *lex specialis*. Ndërsa sa ju përket procedurave që duhet të respektohen gjatë hetimit financiar, seancës dëgjimore dhe ekzekutimit të vendimeve dhe urdhrave të gjykatës, konfiskimi i zgjeruar drejtohet me ligjin AM (2017), të plotësuar me dispozitat e KPP (2017).

4.1.2. Fushëveprimi i ligjit

4.1.2.1. Kriteret e zbatimit të ligjit për konfiskimin e zgjeruar

Fushëveprimi i ligjit që zbatohet për konfiskimin e zgjeruar parashikohet shprehimisht në nenin 2 të ligjit AM (2017), parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe i trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët e kanë një nivel të paarsyetuar ekonomik si rezultat i aktivitetit të dyshuar kriminal. Kështu që dy kriteret kryesore të shfrytëzuara nga ligji AM (2017) për ta zbatuar konfiskimin e zgjeruar janë:

- a) niveli i pa arsyetuar ekonomik, dhe
- b) pjesëmarrja në aktivitet kriminal.

4.1.2.2. Konfiskimi i zgjeruar i pasurisë

Sipas ligjit AM (2017), konfiskim i zgjeruar mendohet të jetë:

- Konfiskimi i pasurisë konkrete në posedim, vlera e së cilës është në shpërpjestim të konsiderueshëm me shumën e të ardhurave nga burimet e ligjshme;
- Konfiskimi i ndonjë pasurie tjetër (monetare, të tundshme, të patundshme) tjetër prej asaj që i nënshtrohet konfiskimit, në rastet kur kjo e fundit tjetërsohet, shpërbëhet, transferohet, fshihet apo zhvendoset.

4.1.3. Standardet dëshmuuese (prezumimet ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës, dhe të tjerat)

4.1.3.1. Përcaktimi i produkteve që rrjedhin nga krimi

Qëllimi i konfiskimit të zgjeruar është ta bëjë konfiskimin e pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pa arsyetuar ekonomik ndërsa dyshohen për aktivitet kriminal. Bazuar në këtë qëllim, sipas nenit 24 të ligjit AM (2017), gjykata mund ta shqiptojë konfiskimin kur konsideron që prokurori i ka plotësuar të gjitha kushtet në vijim:

- a) Ekzistojnë dyshime të arsyeshme, bazuar në prova, që një person (personi i dyshuar) ka marrë pjesë në njërin prej aktiviteteve kriminale të paraparë në nenin 3 të Ligjit AM (2017);

- b) Ekzistojnë dyshime të bazuara duke u bazuar në prova, për të besuar që pasuria është drejt-përejt apo tërthorazi në posedim të plotë apo të pjesëshëm të personit të dyshuar, të të afërmeve të tij, të personave fizikë ose juridikë nën kontrollin e tij;
- c) Personi i dyshuar, të afërmit e tij, personat fizikë apo juridikë nën kontrollin e tij, nuk arrijnë të sjellin prova (barrë të dëshmisë) përtej dyshimit të arsyeshëm që pasuria e tyre ka prejardhje të ligjshme;
- d) Ekzistojnë dyshime të arsyeshme bazuar në prova, për të ardhur në përfundim që vlera e pasurisë në pronësi të ligjshme të njerëzve të sipërpërmendur vlerësohet të jetë në shpërpjestim substancial me të ardhurat e tyre nga burimet e ligjshme.

Ekzistojnë dy supozime të ligjshme në nenin 3 të ligjit AM (2017). Së pari, ligji supozon që pasuria në pronësi të ligjshme të të afërmeve të personit të dyshuar, i përket vetë personit të dyshuar, në rastet kur nuk ka prova të mjaftueshme lidhur me prejardhjen e tyre të ligjshme.

Së dyti, ligji supozon që pasuria në posedim të personave fizikë ose personave juridikë i takon personit të dyshuar, në rastet kur ekzistojnë prova të mjaftueshme lidhur me marrëdhëniet që ekzistojnë ndërmjet tyre ose lidhur me prejardhjen e tyre të paligjshme.

Duke e analizuar nenin 21 të ligjit AM (2017) lidhur me barrën e dëshmisë, del që kthimi i barrës së dëshmisë tek personat në vijim fillon pasi që prokurori të paraqesë prova për ekzistimin e pasurisë që i plotëson kushtet e përmendura më lart. Pasi që prokurori i plotëson me sukses ato kushte, atëherë:

- Personi i dyshuar ka barrën ta vërtetojë që pasurinë, në posedim të plotë apo të pjesëshëm, e ka fituar nga burimet e ligjshme të të ardhurave;
- Të afërmit kanë barrë ta vërtetojnë që pasuria që e kanë në pronësi të ligjshme:
 - a) ka qenë vetëm në posedim të tyre;
 - b) është në posedim të ligjshëm dhe është fituar nga të ardhurat me prejardhje të ligjshme;
 - c) pasuria në pronësi të tyre të ligjshme nuk është në pronësi të tërthortë ligjore të personit të dyshuar.
- Personat fizikë dhe juridikë kanë barrën të dëshmojnë që provat e paraqitura nga prokurori nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar që pasuria është në pronësi të ligjshme të tyre:
 - a) është plotësisht apo pjesërisht, drejtpërdrejt apo tërthorazi në posedim të personit të dyshuar;
 - b) shfrytëzohet, ka lehtësuar ose ndihmuar në mënyra të caktuara aktivitetin kriminal të personit të dyshuar.

4.1.3.2. Garancitë procedurale dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Në ligjin AM nuk ekziston ndonjë dispozitë që merret në mënyrë të qartë me garancitë e tilla për të drejtat e njeriut. Por supozohet që zbatimi i tyre është në fuqi madje edhe gjatë procedurës parandaluese, ashtu siç thuhet në nenin 5 të ligjit AM (2017) që procedurat për verifikimin, hetimin dhe aktgjykimin sipas ligjit AM për shqiptimin dhe ekzekutimin e masave parandaluese (sequestrimi dhe konfiskimi) bazohen në ligjin AM dhe plotësohen me dispozitat e KPP. Duke ju referuar KPP (2017), në nenin 4 parashikohet parimi i prezumimit të pafajësisë, në nenin 6, e drejta për t'u mbrojtur, në nenin 7, parimi i *non bis in idem* (mbrojtja në rastet kur dikush akuzohet dy herë për veprën e njëjtë).

4.2. BOSNJA DHE HERCEGOVINA

4.2.1. Korniza ligjore për konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasure

Konfiskimi i zgjeruar i dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale, tash më është i pranishëm në legjislacionin penal të Bosnjë dhe Hercegovinës. Në Ligjin Penal të Bosnjë dhe Hercegovinës, Federatës së Bosnjë e Hercegovinës dhe të Distriktit Brčko i Bosnjë dhe Hercegovinës, është përfshirë me reformat e vitit 2010, ndërsa në Republikën Serbe, gjithashtu në vitin 2010, por për këtë qëllim është nxjerr një ligj i veçantë (Ligji për konfiskimin e pronës së përfituar me kryerjen e veprës penale; „Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë”, nr. 12/10). Me ndryshimet e theksuara, kryesisht është krijuar baza materiale-juridike për konfiskimin e zgjeruar, por vet procedura bazohet në dispozita të pakta, të cilat përndryshe e rregullojnë procedurën e konfiskimit. Përrjashtim është Republika Serbe, ligji i veçantë i së cilës në tërësi i kushtohet procedurës për konfiskimin e zgjeruar të pronës, të përfituar nga delikuenca. Këto rregulla më vonë janë zëvendësuar me rregulla të reja – Ligjin për konfiskimin e pronës, të përfituar me kryerjen e veprës penale (“Gazeta Zyrtare RS”, numri 66/18). Ligjet e veçanta janë nxjerr edhe në juridiksionet e Federatës së Bosnjë Hercegovinës (2014) dhe Distriktit të Brçkos të Bosnjë dhe Hercegovinës (2016), por materia e konfiskimit të zgjeruar, me më pak intervenime, kryesisht ka mbetur e pa adresuar.

Ligjvënësit e Bosnjë Hercegovinës, nuk janë aq të qartë, nga ku duhet të burojë prona që i nënshtrohet konfiskimit në regjimin e konfiskimit të zgjeruar: nga vepra penale, për të cilin është duke u zhvilluar procesi penal ose për vepra të tjera penale të papërcaktuara. Intenca themelore e këtij instituti në drejtësinë komperative, është përfshirja në pronën, që është përfituar nga veprat e mëhershme penale, të cilat nuk duhet të caktohen në detaje. (Boucht, 2017).¹⁴⁷ Aty kryesisht flitet se pronën, gjatë procedurës për vepra të rënda penale, konstatohet që ekziston, por për të cilën prokuroria nuk mund të sigurojë prova të mjaftueshme që pa dyshim pohohet që rrjedh nga kjo vepër, duhet të ndërmerren me këtë regjim të konfiskimit.

Siç u tha deri më tash, konfiskimi i zgjeruar i dobisë pasurore, pjesërisht është rregulluar me ligje sistemore (kryesisht nocioni i konfiskimit të zgjeruar, në legjislacionin material penal), ndërsa çështjet procedurale janë të rregulluar për ato vepra për të cilat mund të zbatohen rregullat *lex specialis*. Sikur edhe në rastet e tjera, për çështjet që nuk janë rregulluar me parimin *lex specialis*, aplikohen dispozitat e ligjeve sistemore.

4.2.2. Fushëveprimi

4.2.2.1. Kriteret për zbatimin e ligjit lidhur me konfiskimin e zgjeruar

Materia e konfiskimit të zgjeruar, siç u tha më herët, zbatohet atje ku ekzistojnë parimet *lex specialis*, (më herët është theksuar edhe në cilën pjesë nuk respektohen këto të rregulla). Federata e Bosnjë Hercegovinës dhe Distriktit Brčko të Bosnjë e Hercegovinës, zbatohen sanksionet minimale të kërcënuara (në rastin e FBH, për veprat që mund të shqiptohet dënimi me burg deri në tri vite ose dënim më i rëndë, në rastin e DB-BH, veprat për të cilat si minimum është caktuar dënimi me burg nga 3 vite), kurse Republika Serbe ka kriter të dyfishtë. Kriteri i parë është listimi taksativ i veprës (veprat e caktuara kundër jetës dhe trupit, kundër lirive dhe të drejtave të qytetarëve, kundër integritetit gjinor, kundër keqtrajtimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijës, kundër shëndetit të njerëzve, kundër

147 Përcaktimi nga neni 110a. LP BH (2018), neni 114a. LP FBH (2017), përkatësisht neni 10. parag. 4 Ligji për konfiskimin e pronës së përfunduar me vepër penale FBH (2014), neni 4 Ligji për konfiskimin e pronës së përfunduar me vepër penale RS (2018), neni 114a. LP DBBH (2018), përkatësisht neni 10 parag. 5. Ligji për konfiskimin e pronës së përfunduar me vepër penale DBBH (2016), me të cilin definohet nocioni i konfiskimit të zgjeruar, si duhet nuk i shërbejnë këtij qëllimi.

ekonomisë, transakcioneve, terrorizmit, kundër detyrës zyrtare, kundër komunikacionit publik, kundër rendit dhe qetësisë publike, kundër sigurisë të të dhënave kompjuteristike, kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare), ndërsa i dyti është lartësia e dobisë së përfitur, kështu që konfiskimit i nënshtrohet e gjithë pasuria, e përfitur me çfarëdo veprë, në qoftë se dobia pasurore është përfitur me vepër penale, përkatësisht vlera e objektit të veprës penale është më e lartë se 50.000 KM.

Në rast se nuk ka bazë për zbatimin e legjislacionit të veçantë për konfiskim në Federatën BH dhe Distriktit Brčko BH, i njëjta zgjidhje është edhe në nivel shtetëror, zbatohen dispozitat relevante të legjislacionit material (LP BH, 2018, neni 110a.; KP FBH, 2017, neni 114a. dhe KP DBBH, 2018, neni 114a). Aty bëhet fjalë për listimin taksativ të kapitujve, në bazë të të cilave është i mundshëm caktimi i konfiskimit të zgjeruar.

Mund të konkludohet se në bazë të dispozitave ligjore pozitive bëhet fjalë për rrethanat e ndërlukuara për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar (kryesisht duke u referuar në kapitujt e Ligjit Penal dhe veprat relevante përbrenda kapitujve), për të cilat është i mundshëm caktimi i konfiskimit të caktuar, ndërsa pjesa e dytë, kriteri i sanksionit minimal i caktuar. Në Republikën Serbe, gjithashtu, ekziston mundësia e caktimit të konfiskimit të zgjeruar edhe në bazë të lartësisë së dobisë të realizuar. Në çdo rast, bëhet fjalë për veprat, me të cilat konsiderueshëm rrezikohet dhe shkelet rendi shoqëror dhe vlerat e tij.

4.2.2.2. Konfiskimi i zgjeruar i pronës

Legjislacionet në Bosnjë Hercegovinë parashikojnë përfshirje të gjerë të pronës, që supozohet se është përfitur nga vepra penale, por për të cilën nuk mund me siguri të konstatohet lidhja shkak-pasojë me këto vepra. Me qenë se pronë konsiderohet dobia direkte (që rrjedh nga vepra konkrete), dobia indirekte (ajo që është krijuar si rezultat i manipulimeve me pronën e përfitur në mënyrë direkte) dhe dobia surrogate (në qoftë se prona që mund të ndërlidhet me delikuencën, është bashkuar me pronën e përfitur në mënyrë të ligjshme, është transformuar etj.), në kundërvlerë të asaj dobie (nëse dobia e cilës do forme të theksuar është fshehur, shpenzuar, shkatërruar ose në ndonjë mënyrë tjetër nuk është e qasshme), ky konfiskim i zgjeruar ka të bëjë me pronën, e cila në çfarëdo mënyre ka lidhje me veprimet kriminale të kryesit. Ligji Penal në BH (2018, neni 110a.) dhe Ligji për konfiskimin e pronës së përfitur me kryerjen e veprës penale RS (2018, neni 4 Parag. 1 t. 1), janë goxha të qartë lidhur me këtë, ndërsa dispozitat e tjera ligjore rekomandojnë interpretim të caktuar për nocionin e dobisë pasurore. Mund të thuhet se gjasa më e madhe e përfshirjes në pronën e përfitur me vepra penale, në bazë të regjimit të konfiskimit të zgjeruar, do të jetë për pronën konkrete, që gjendet në posedim të kryesit, ndërsa për të cilën rrethanat flasin se është përfitur nga veprimet delikuede, e cila nuk mund të konstatohet në detaje, por si alternativë ligjet rekomandojnë përfshirje edhe në pronën tjetër, për të cilën supozohet se tash ekziston ose ka ekzistuar (ekziston në bazë të përfundimit logjik lidhur me atë çka ka poseduar kryesi në një moment ose ka mundur të posedojë.

4.2.3. Kriteret e dëshmisë (baza ligjore, shpërpjestimi, tejtërsimi i barrës së provës, etj.)

4.2.3.1. Caktimi i prejardhjes së pronës nga krimi

Një nga parakushtet e zakonshme për konfiskimin e dobisë pasurore, krahas dënimit për vepër të rëndë penale (krimin të organizuar dhe ngjashëm) dhe mosuksesit të të pandehurit, përkatësisht të poseduesit të gjërave ose të drejtës për sqarimin e prejardhjes së ligjshme të pronës, janë rrethanat që indikojnë për mundësinë e ekzistimit edhe të pronës tjetër, të përfitur me vepra penale (të papërcaktuar). (Datzer, 2017).

Rrethanat që qojnë për ekzistimin e pronës, e krijuar, me delikuençë në legjislacionin penal të BH, kryesisht nuk janë specifikuar. Në legjislacionin penal të Bosnjë e Hercegovinës, Federatës së Bosnjë e Hercegovinës dhe Distriktit Brčko të Bosnjë Hercegovinës, në pikëpamje të lidhjes së pronës me aktivitetet kriminale, që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar, kërkohen „dëshmi të mjaftueshme për të supozuar me bindje se kjo dobi pasurore është përfituar me kryerjen e veprës penale, kurse kryesi nuk ka ofruar dëshmi se prona është e përfituar ligjërisht“ (KP BH, 2018, neni. 110a; KP FBH, 2017, neni 114a; përkatësisht Ligji për konfiskimin e pronës së përfituar në mënyrë të paligjshme FBH, 2014, neni 10 parag. 4; KP DBBH, 2018, neni 114a; përkatësisht Ligji për konfiskimin e pronës së përfituar në mënyrë të paligjshme DBBH, 2016, neni 10 parag. 5.). besimi i justifikuar mund të interpretohet si mundësi, mundësia që është klasifikuar, më e besueshme nga supozimi i zakonshëm, duke të orientuar se paragjykimi për prejardhjen delikuyente duhet të jetë mjaftë i bazuar. Krahas kësaj besueshmërie të organit që zhvillon procedurën lidhur me ekzistimin e fakteve të caktuara (që duhet qartë të jetë e lartë), nuk është përpunuar lidhur me atë se në çka duhet konkretisht të binden. Disa rrethana specifike, konkretisht shembuj, që i thekson Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Bashkimit Evropian për ngrirjen dhe konfiskimin e sendeve dhe dobisë pasurore, të përfituar nga veprat penale në Bashkimin Evropian (2014) ose legjislacionet vendore, që në mënyrë eksplicite theksojnë që një rrethanë e tillë mund të jetë vlera e pronësisë së kryesit, që është në disporporcion me të ardhurat e tij të ligjshme, legjislacionet e përmendura nuk i theksojnë. Vetëm në Ligjin për konfiskimin e pronës, të përfituar me kryerjen e veprës penale RS (2018) në nenin 4 parag. 1 t. 2, theksohet se duhet të bëhet fjalë për pronën, që „është në disporporcion të të duksëm me të ardhurat e tij të ligjshme“.

Në bazë të asaj që është theksuar, mund të konkludohet se ligjvënësit në Bosnjë Hercegovinës, nuk janë mjaftë të qartë cilat rrethanat specifike duhet dëshmuar, kur konstatohet lidhja e pronës që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar të dhe të veprave penale, nga të cilat pretendohet se është përfituar, por zgjidhjet në Republikën Serbe dhe interpretimi indirekt i dispozitave të legjislacionit penal në Bosnjë e Hercegovinë, Federatën e Bosnje e Hercegovinës dhe Distriktit të Brçkos të Bosnje Hercegovinës, sugjerojnë që paraprakisht duhet të bëhet fjalë për pronën, vlera e të cilës, duke i krahasuar me të ardhurat e ligjshme, që kryesi i posedon ose i ka poseduar, nuk mund të sqarohen në mënyrë të arsyeshme.

4.2.3.2. Garancitë procedurale dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Në legjislacionet në fuqi në Bosnje e Hercegovinë është në fuqi barra e provës së balancuar e prejardhjes së pronës kontestuese. Fillimisht, prokuroria është e detyruar që në bazë të besueshmërisë së arsyeshme të dëshmojë se prona është e përfituar nga aktivitetet kriminale të kryesit, e cila më pas implikon mundësinë për kryesin për t'i mohuar pretendimet e aktakuzës dhe ta dëshmojë prejardhjen e pronës së tij. Nga i pandehuri pritët që të argumentojë ligjshmërinë e pronës në nivel të njëjte sikur prokuroria. Vetëm në Republikën Serbe nocioni i pronës së përfituar me kryerjen e veprës penale (ajo që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar) është vendosur, në mënyrë që nuk specifikohet cili standard i dëshmisë kërkohet për të konstatuar lidhjen me aktivitetet kriminale të kryesit, kështu që atje mund të flitet për standardin e dëshmisë, që është i nevojshëm për nxjerrjen e aktgjykimit (jashtë dyshimit të arsyeshëm ose sigurisë së plotë).

Barra e dëshmisë së balancuar, si dhe standardet relativisht të larta të dëshmisë, të cilat të qojnë në mundësinë e prejardhjes së pronës nga delikuenca, sugjerojnë se i pandehuri në procedurë të konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore, të përfituar me vepra penale, nuk gjendet në situatë më ndryshe në krahasim kur në procedurë prezantohet çfarëdo rrethane, e cila është *contra favorem* me pozitën së tij juridike, kur i vihet në barrë ndonjë veprim apo pasojë. Kjo ka të drejtë që të theksohet në pretendimet e aktakuzës, por njëjtë (si në rastin e dëshmisë së çfarëdo fakti tjetër) nuk duhet të konsumohet. Mungesa e dëshmisë, sugjerimi i provave etj. ndërkaq implikon

pasoja negative për pronën që gjendet në pronësi të tij, kontrollit ose posedimin, e cila është objekt i konfiskimit të zgjeruar: me qenë se më kompetent për të shpjeguar prejardhjen e pronës së përmendur, kryesit nuk i bëhet shërbim, duke e lëshuar mundësinë për të reaguar në situatat kur ofrohet qartë opsioni për ta arsyetuar prejardhjen e pronës së inkriminuar. Prandaj, mund të thuhet se kryesit i garantohet drejtësia dhe mbrojtja në procedurë, duke përfshirë edhe të drejtën për prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për heshtje (përkatësisht, privilegjin kundër vetakuzës).

Me qenë se bëhet fjalë për lëndën sekondare të procedurës penale, por që zbatohet në bazë të rregullave të tyre, të gjitha të drejtat që janë në lidhje me funksionin e mbrojtjes në procedurë të rregullt, vazhdojnë edhe për procedurat për konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore, si p.sh. e drejta për të marr pjesë në procedurë, e drejta për konfiskimin e të gjitha veprimeve procedurale, të ashtuquajturat të drejtat minimale për mbrojtje (e drejta për lajmërim lidhur me llojin dhe shkaqet e akuzës, e drejta për vendim gjyqësor të arsyetuar, e drejta për kompensim në rast të dënimit të pabazë të gjykatës, si dhe kohën e pamjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen), e drejta për ankesë, mbrojtja nga përdorimi i dëshmimeve të paligjshme etj.

4.3. MALI I ZI

4.3.1. Korniza ligjore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore

Procedura është e rregulluar me ligj të veçantë - Ligjin për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfutur me veprimtari kriminale (2015). Bëhet fjalë për pronën e përfutur në periudhën para dhe/ose pas kryerjes së veprës penale, të theksuar në nenin 2 të Ligjit (2015). Është e nevojshme të ekzistojë „lidhshmëria kohore në mes të kohës kur është përfutur dobia pasurore dhe rrethanat e tjera lidhur me rastin konkret“ (Ligjin për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfutur me veprimtari kriminale 2015, neni 8), me ç’rast kjo në dispozitat e Ligjit nuk është mjaft e sqaruar.

4.3.2. Fushëveprimi

4.3.2.1. Kriteret e zbatimit të ligjit në raport me konfiskimin e zgjeruar

Kriteri i veprave penale, të theksuar në mënyrë taksative është parashikuar në nenin 2 të Ligjit për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfutur me veprimtari kriminale(2015) dhe dispozita thotë: «Nga kryesi i veprës penale mund të konfiskohet dobia pasurore për të cilën dyshohet se është krijuar me veprimtari kriminale, ndërsa kryesi nuk e bën të besueshme se prejardhja e saj është e ligjshme (konfiskimi i zgjeruar) edhe poqë se është i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepër penale, të përcaktuar me Kodin Penal të Republikës së Malit të Zi (2018)», dhe atë:

- 1) kidnapimi, neni 164;
- 2) veprat penale kundër lirisë gjinore, nenet 206, 208, 209, 210, 211, 211a dhe 211b;
- 3) veprat penale kundër pronës, neni 240, 241, 242, 243, 244, 244a, 249, 250, 251 dhe 252;
- 4) veprat penale kundër qarkullimit të transaksioneve të pagesave dhe afarizmit ekonomik, neni 258, 259, 260, 261, 262, 263, 264, 265, 268, 270, 272, 273, 274, 276, 276a, 276b, 281 i 281a;
- 5) prodhimi i paautorizuar, mbajtja dhe vendosja në qarkullim të drogave, neni 300;
- 6) veprat penale kundër mjedisit dhe rregullimit hapësinor nenet 303, 305 i 307;
- 7) veprat penale kundër sigurisë të informacioneve kompjuteristike, nenet 350, 352, 353 i 354;
- 8) veprat penale kundër rendit dhe qetësisë publike, nenet 401, 401a, 402,404 i 405;
- 9) veprat penale kundër komunikacionit, neni 412, 413 i 414;
- 10) veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 416, 419, 420, 422, 422a, 423 i 424;

- 11) veprat penale kundër njerëzimit dhe të mirave të tjera, të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare nenet 444, 445, 446, 447, 447a, 447b, 447c, 447d, 449, 449a i 449b.

4.3.2.2. Konfiskimi i zgjeruar në raport me pronën

Neni 3 i Ligjit për konfiskimin e pronës, të përfutur me veprimtari kriminale, definohet se dobia pasurore e përfutur me veprimtari kriminale, gjithsesi është rritja ose pengimi i zvogëlimit të pronës së përfutur nga veprimtaria kriminale, si dhe të ardhurat dhe dobia tjetër, e realizuar në mënyrë të drekte apo indirekte nga veprimtaria kriminale, si dhe të mirat materiale, në të cilën është transformuar ose me të cilën është bashkuar.

Konfiskimit të zgjeruar i nënshtrohet çdo pronë, që në një mënyrë është e lidhur me vepra penale, të theksuar në dispozitën e theksuar 1 neni 2 (burimore, indirekte, e shndërruar në ndonjë formë tjetër), në qoftë se kjo nuk është e mundshme, zbatohet paragrafi 4, neni 2 (kundërvlera pronësore), e gjithë kjo me kusht se është në disbalans me të ardhurat e ligjshme të kryesit (Ligji për konfiskimin e pronës së përfutur me veprime kriminale, 2015).

Prona nënkupton të drejtat pronësore çfarëdo lloji, pa marrë parasysh a janë të natyrës materiale apo jo materiale, gjërat e tundshme dhe të patundshme, letrat me vlerë dhe dokumentet e tjera, me të cilat dëshmohen të drejtat pronësore.

4.3.3. Kriteret e dëshmisë (baza ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës, etj.)

4.3.3.1. Caktimi i prejardhjes së pronës nga krimi

Prokurori publik prezanton dëshmitë lidhur me pronën e të pandehurit, lidhur me të ardhurat e tij të ligjshme dhe rrethanat që tregojnë për ekzistimin e qartë të joproportionalitetit në mes të vlerës së pronës, pas zvogëlimit për tatimet e paguara dhe të detyrimeve të tjera dhe të ardhurave të ligjshme.

Në qoftë se është lëndë e kërkesës, prona e trashëgimtarit juridik, anëtarit të familjes së pandehurit, ose personit të tretë, prokurori publik prezanton dëshmitë se trashëgimtari juridik ka trashëguar dobinë pasurore, të përfutur me veprimtari kriminale, përkatësisht se është bartur mbi një anëtar të familjes së të pandehurit ose personit të tretë, pa kompensim ose me kompensim, që është e qartë se nuk i përgjigjet vlerës reale, me qëllim të pamundësisë të kompensimit.

4.3.3.2. Garancitë procedurale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Ligji për konfiskimin e pronës, në nenin 2 dhe 8 thekson se nga kryesi i veprës penale mund të konfiskohet dobia pasurore, për të cilën ekziston dyshimi se është përfutur me veprimtari kriminale, kurse kryesi nuk e bënë të besueshme se prejardhja e saj është e ligjshme (konfiskimi i zgjeruar) dhe nëse është i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për veprën penale, të përcaktuar me Kodin Penal (2018), me ç'rast theksohet lista e veprave penale.

Në procedurën e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore, barra e dëshmisë qëndron edhe në të pandehurin, ndërsa mospasja e të pandehurit për të dëshmuar ligjshmërinë e pronës të poseduesit të gjërave ose të drejtës për sqarimin e prejardhjes së ligjshme të pronës, sjell konfiskimin e të njëjtës. E drejta që gjatë dëshmisë, i pandehuri nuk është i detyruar që t'i prezantojë faktet, që e "vetë-akuzojnë", duhet konsideruar në mënyrë që barra e kundërt e dëshmisë dhe mohimi i dëshmisë nuk janë të dobishme për të pandehurin, nga se barra e dëshmisë është edhe në anën e tij. Konkludim është se ky lloj i zgjidhjes ligjore është kontradiktor me aspektet fundamentale të parimit të drejtësisë:

supozimi i pafajësisë dhe privilegjin kundër vetakuzës, por në aspekt të qëllimit, që dëshirohet të arrihet (konfiskimi i dobisë pasurore, të përfituar në mënyrë të paligjshme), nuk është në kundërshtim me standardin e të drejtës për gjykim të drejtë.

E drejta për gjykim të drejtë respektohet edhe në pjesën e transparencës së procedurës dhe të drejtën për mbrojtje.

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, gjykata në bazë të nenit 41 parag. 1 i Ligjit për konfiskimin e dobisë pasurore, nxjerr aktvendim, me të cilin miratohet ose hedhet poshtë kërkesa për konfiskim të dobisë pasurore.

Kundër aktvendimit bartësi, avokati i tij ose autorizuari tij, i dëmtuari ose prokurori publik, mund të parashtojnë ankesë në afat prej 15 ditëve, nda dita e dorëzimit të aktvendimit.

Duke vendosur lidhur me ankesën, gjykata e shkallës së dytë ankesën mund ta refuzojë si jashtë afatit dhe të palejueshme, ta refuzojë si të pabazuar ose ta miratojë ankesën dhe aktvendimin ta ndryshojë ose ta shfuqizojë dhe lëndën ta kthejë në vendosje të serishme.

Në qoftë se për të njëjtën lëndë, aktvendimi ka qenë më parë i shfuqizuar, gjykata e shkallës së dytë do ta caktojë seancën dhe do të merr vendim lidhur me ankesën, me ç'rast aktvendimi nuk mund të shfuqizohet dhe lënda të kthehet sërish për vendimmarrje në gjykatën e shkallës së parë.

4.4. KOSOVA*

4.4.1. Korniza ligjore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore

Konfiskimi i zgjeruar i pronës në Kosovë* është rregulluar me rregullat *lex specialis* për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pronës, të përfituar me kryerjen e veprave penale (06/L-87, 2018). Arsye e përgjithshme për normimin ligjor të veçantë të kompetencave të zgjeruara për konfiskimin është se procedurat e KPP-së, që rregullojnë materien e konfiskimit të dobisë pasurore, të përfituar me veprë penale, nuk janë të mjaftueshme (Neni 1 par. 1).

Kushti i dytë formal për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar, në bazë të dispozitave të këtij Ligji, është se mund të caktohet pas aktgjykimit të plotfuqishëm dënues për veprat e theksuara nga ky Ligj (Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pronës, Neni 2. par. 1).

Ky ligj rregullon procedurën e konfiskimit të pronës, pas përfundimit të procedurës penale, vepron në bazë të propozimit të prokurorit të shtetit, i cili gjatë punës së tij siguron informata, që si rezultat i veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, ekziston edhe ndonjë pronë shtesë, e cila nuk ka qenë lëndë e aktakuzës.

4.4.2. Fushëveprimi

4.4.2.1. Kriteret e zbatimit të ligjit në raport me konfiskimin e zgjeruar

Në ligjin për kompetencat e zgjeruara, në mënyrë të saktë janë listuar veprat penale për të cilat mund të caktohet konfiskimi i zgjeruar (Neni 2, par. 2). Në grupin e parë të këtyre veprave penale

* Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

bëjnë pjesë veprat e rënda penale të krimit të organizuar, korrupsionit, tregtisë me njerëz, kundër shëndetit të popullatës, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, keqpërdorimin e drogave dehëse, keqpërdorimi i armëve të zjarrit, cyber kriminali, kundër pronës, mjedisit etj. Kriteri i dytë, të cilin ligjvënësi e zbaton si cenzus, përkatësisht është lartësia e dobisë pasurore të realizuar, pa marrë parasysh nga cila vepër penale është realizuar kjo dobi, ky ligj cakton cenzusin mbi 10.000 €.

Konfiskimi i zgjeruar mund të shqiptohet, jo vetëm ndaj të pandehurit, përkatësisht personit të dënuar (sepse procedura në bazë të këtij Ligji mund të zhvillohet pas hyrjes në fuqi të aktgjykimit dënues), por edhe ndaj personave të tretë, në qoftë se ata nuk kanë fituar *bona fide* pronën kontestuese.

Në bazë të këtij Ligji, pronë e të pandehurit është çdo lloj prone, që e ka përfituar i pandehuri në periudhë prej dhjetë (10) vitesh, para ditës kur ka filluar hetimi për vepër penale (Neni 3 para. 1- 1.5).

4.4.2.2. Konfiskimi i zgjeruar në raport me pronën

Një nga çështjet kyçe për rregullimin efikas normativ dhe zbatimin e institutit të konfiskimit të zgjeruar ka të bëjë me caktimin kyç të nocioneve, veçanërisht të nocionit të pronës. Ligji i veçantë në Kosovë * gjithashtu në dispozitat fillestare parashikon pronën që konfiskohet, sikur edhe çdo pronë tjetër, në mënyrë direkte ose indirekte e krijuar dhe përfituar me vepër penale, prona e tundshme dhe patundshme, materiale ose jomateriale, dokumentet juridike ose instrumentet, me të cilat dëshmohet pronësia ose interesi për pronën.¹⁴⁹

Lënda e konfiskimit mund të jetë prona zëvendësuese, që i përgjigjet vlerës së pronës, të përfituar nga vepra penale, në qoftë se ndonjë pronë nuk mund të konfiskohet për shkak të rrethanave e ndryshme, p.sh i pandehuri të njëjtën e ka shkatërruar, fshehur ose ngjashëm, ose nëse personi i tretë e ka përfituar pronën *bona fide*, gjykata e obligon të pandehurin që ta paguajë kundërvlerën e pronës për shtetin.

Është e rëndësishme të theksohet se Ligji parashikon që gjetjet e përkohshme dhe përfundimtare të kufizimit të pronës dhe urdhërat për konfiskim të lëshohen në pajtim me këtë Ligj (Neni 21, par. 1), duke përfshirë pronën që gjendet brenda dhe jashtë territorit të Kosovës^{150*}.

4.4.3. Kriteret e dëshmisë (baza ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës etj.)

4.4.3.1. Caktimi i prejardhjes së pronës nga krimi

Në drejtim të rregullave dëshmuese të zbatimi i konfiskimit të zgjeruar, me Ligj të veçantë është zgjedhur qasja e balancuar për barrën e dëshmisë në mes të prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe personave të tretë (në qoftë se konfiskohet prona e tyre). Prokurori i shtetit është i detyruar që të dëshmojë se prona e theksuar për verifikim (hetimi i prejardhjes së paligjshme, në pronësi të pande-

149 Për pronën për të cilën mund të caktohet konfiskimi i zgjeruar Ligji përcakton edhe përbushjen obligative të tri kriterëve lidhur me të pandehurin dhe pronën: (1) se i pandehuri e ka përfituar pronën në afat prej dhjetë (10) vitesh para ditës kur ka filluar hetimi për veprën penale, për të cilën zbatohet ligji i veçantë, ose (2) që është në pronësi ose në posedim të palës së tretë në llogari apo në dobi të të pandehurit ose (3) të cilën e pandehuri e ka bartur në personin e tretë, që nuk ka qenë blerës *bona fide* ose më vonë e ka bartur në kontinuitet në personat e tretë, që nuk kanë qenë blerës *bona fide*, në afat prej 10 vitesh nga dita kur ka filluar faza hetimore për vepër penale.

150 * Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

hurit, ndërsa i pandehuri duhet të dëshmojë se pronën e ka përfituar nga burimet ligjore, për të cilat duhet të ofrojë dëshmi, në të kundërtën Gjykata do të caktojë konfiskimin e asaj prone.

Kështu, verifikimi i pronës është hapi i parë për zhvillimin e procedurës së konfiskimit të zgjeruar, kur në fazat e para të procedurës, për Gjykatën prezanton prova në afat prej 5 vitesh nga aktgjykimi i plotfuqishëm dënues në procedurë penale, në bazë të të cilave duhet të identifikohet prona kontestuese dhe të orientohen në rrethanat e theksuara më herët, të definohet nocionit të pronës (ekzistimi i një nga tre kriteret alternative të caktuara). Ligji si standard dëshmuës thekson gjasat për ekzistimin e pronës (siç definohet në ligj), të cilën prokurori duhet ta dëshmojë, në mënyrë që barra e dëshmisë të transferohet në të pandehurin. Madje, në dispozitat fillestare të Ligjit në drejtim të vlerësimit të pretendimeve, theksohet se bëhet fjalë për standardin dëshmuës “kur diçka është e mundshme ose ka më shumë shanse të jetë e mundshme” (Neni 3, par. 1, pika 1.8). Prokurori i shtetit është i detyruar që në procedurën e verifikimit të pronës, të udhëhiqet me këtë standard dhe t’i vlerësojë pretendimet gjatë shqyrtimit të verifikimit të pronës (Neni. 5).

4.4.3.2. Garancitë procedurale dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Ndonëse me ligj, barra e provës në parim është renditur (balancuar) në mes të palëve në procedurë, fillimisht kjo barrë është në prokurorin e shtetit, i cili duhet të dëshmojë se prona është në pronësi të të pandehurit, në pajtim me kriteret nga (Neni 3, par. 1, pika 1.5 e ligjit), nuk ka kufizime për llojin e dëshmisë dhe mjeteve dëshmuëse, të cilat prokurori shtetëror mund t’i shfrytëzojë në këtë procedurë. Madje, Gjykata në fazën e verifikimit mund ta caktojë angazhimin e ekspertit dhe dëgjimin e dëshmitarëve, me qëllim të verifikimit të pronës kontestuese. I pandehuri dhe palët e treta, kanë të gjitha të drejtat për të marrë pjesë në procedurë, të propozojnë prova dhe të mohojnë provat e prokurorit të shtetit dhe në esencë ta dëshmojnë prejardhjen e ligjshme, përkatësisht mënyrën *bona fide* të përfitimit të pronës kontestuese dhe në qoftë se lidhur me këtë do të kenë sukses, Gjykata është e obliguar të nxjerrë vendim me arsyetim për refuzimin e kërkesës për verifikimin e tërësishëm apo të një pjese të kësaj prone kontestuese (Neni 6, par. 3). Të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat janë të parashikuara me marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, të garantuara edhe me Kushtetutë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatohen në territorin e Kosovës^{151*} mbizotërojnë, në rast të konfliktit, mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe aktet e tjera të institucioneve publike (Neni. 22. I Kushtetutës së Kosovës*).

Ndaj Vendimit të gjykatës, me të cilën është shqiptuar konfiskimi i pronës në shqyrtimin kryesor ose jashtë shqyrtimit kryesor, i pandehuri, personat e tjerë për të cilët ka të bëjë ky vendim, kanë të drejtë anekse në Gjykatën e Apelit. Afati i ankesës kundër aktgjykimit është 15 ditë, ndërsa kundër aktvendimit 3 ditë dhe ankesa ka veprim suspensiv.

Në bazë të dispozitave nga Neni 16, paragrafi 2 i Ligjit të veçantë, prokurori i shtetit, i pandehuri dhe çdo person i tretë, i parashikuar në urdhrin përfundimtar për përkufizim, mund të parashitrojnë ankesë ndaj vendimit për refuzim apo ndryshim të urdhrin përfundimtar për kufizim, por ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrin. Dispozitat e kapitullit për mjetet juridike të Ligjit për procedurë penale të Kosovës* zbatohen , *mutatis mutandis*.

151 * Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

4.5. MAQEDONIA E VERIUT

4.5.1. Korniza ligjore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, materia e konfiskimit të zgjeruar, për dallim nga legjislacionet në Rajon, është rregulluar kryesisht në kuadër dispozitave ligjore sistemore, përkatësisht baza materiale-juridike gjendet në Kodin Penal, ndërsa procedura e konfiskimit është rregulluar me KPP (2016).

4.5.2. Fushëveprimi

4.5.2.1. Kriteri i zbatimit të ligjit në lidhje me konfiskimin e zgjeruar

Kodi Penal në dispozitën e nenit 98-a, rregullon materien e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore. Kur bëhet fjalë për vëllimin e zbatimit të këtij instituti, dispozita e theskuar e Kodit Penal fillon nga kriteri i shumëfishtë. Pikërisht, kriteri i parë ka të bëjë me veprën penale të bashkimit kriminal, nga e cila dobia pasurore e përfituar për të cilën është caktuar së paku 4 vite dënim me burg. Në rastin tjetër konfiskimi i zgjeruar mund të zbatohet për veprat penale të terrorizmit, nga neni 313, 394-a, 394-b, 394-c dhe 419, për të cilat me Kodin Penal është caktuar së paku 5 vite dënim me burg. Në rastin e tretë konfiskimi i zgjeruar ka të bëjë me dobinë pasurore nga veprat penale lidhur me shpëlarjen e parave, për të cilat është caktuar dënimi prej së paku 4 vite dënim me burg (neni 98-a parag. 1).

Në pikëpamje të fushëveprimit, gjithashtu duhet theksuar se me dispozitën e nenit 98-a parag. 2, të Kodit Penal, është përcaktuar se prona, me zbatimin e konfiskimit të zgjeruar, mund të konfiskohet edhe nga personat e tretë, në dobi të të cilëve kjo dobi është përfituar e kryerjen e veprave penale të theksuara më lartë.

Në fund, dispozita e nenit 98-a para. 3, në mënyrë eksplicite zgjeron mundësinë e konfiskimit të zgjeruar edhe në raport me anëtarët e familjes së të pandehurit, mbi të cilët është bartur prona, në qoftë se është e qartë se nuk kanë ofruar kompensimin real në raport me vlerën e dobisë, si dhe personat e tretë, në qoftë se ata nuk dëshmojnë se kanë paguar kompensim për përfitimin e pronës, që korrespondon me vlerën e saj.

Në lidhje me fushën e zbatimit të konfiskimit të zgjeruar, gjithashtu duhet theksuar dispozitën nga neni 359-a. të Kodit Penal, që inkriminon përfitimin e paligjshëm dhe fshehjen e pronës së zyrtarëve publik, saktësisht dispozitën e paragrafit 2 të këtij Ligji. Me të njëjtën përcaktohet se nga rrethi i specifikuar i saktë të zyrtarëve publik me aktgjykim (dënues) do të urdhërohet konfiskimi i pronës nga këta persona ose nga anëtarët e familjes së tyre, për çka me procedurën e rregulluar me ligj, se konsiderueshëm i tejkalojnë të ardhurat e tyre të ligjshme. Pra, ky është një lloj *sui generis* i konfiskimit të zgjeruar të dobisë, kryesisht në raport me veprën penale të pasurimit të paligjshëm, që është rregulluar si formë specifike e ashtuquajtur, vepër penale zyrtare. Dispozitat e paragrafit 5 të këtij ligji përcaktojnë edhe mundësinë e konfiskimit të pronës ekuivalente të pandehurit, në qoftë se konstatohet se posedon dobinë që nuk është në proporcion me të ardhurat e tij të ligjshme, ndërsa është dëshmuar se ka ofruar të dhënat e pasakta dhe të mangëta, ose nuk ka ofruar kurrfarë të dhënash, që dëshmojnë prejardhjen e ligjshme të dobisë, kurse konfiskimi i direkt i kësaj dobie nuk është i mundshëm.

Gjithashtu, duhet theksuar dispozitën e nenit 273 të Kodit Penal, që rregullon veprën penale të shpëlarjes së parave. Në kuadër të kësaj dispozite, paragrafi 10 parashikohet mundësia e rëndësishme e konfiskimit të dobisë, në rastet kur nuk mund të konstatohet paraprakisht vepra penale,

nga e cila është përfituar dobia, që është lëndë e shpërlaje së parave. Kusht që Ligji parashikon në kuadër të kësaj dispozite është regjistrimi i pengesave faktike juridike për zhvillimin e një procedure të tillë të veprës penale paraprake. Në këtë rast, ekzistimi i kësaj veprë penale do të caktohet në bazë të rrethanave faktike të rastit dhe ekzistimin e dyshimit të bazuar se prona kontestuese është përfituar nga kjo vepër.

4.5.2.2. Konfiskimi i zgjeruar lidhur me pronën

Dispozita e nenit 98-a. parag. 1 e Kodit Penal, përcakton se subjekti i konfiskimit në regjimin e konfiskimit të zgjeruar është prona, të cilën kryesi i veprave penale të theksuara (bashkimi kriminal, terrorizmi dhe shpërlarja e parave), me kriteret e përfshira të sanksionit minimal të caktuar në formë të dënimit me burg, e ka përfituar në periudhën para kryerjes së këtyre veprave penale, të cilën periudhë gjykata e vlerëson në bazë të rrethanave të çdo rasti konkret, por i cili nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vite. Përveç këtij kriteri kohor, Kodi Penal, në kuadër të të njëjtës dispozite përcakton se gjykata në bazë të të gjitha rrethanave, konstaton nëse kjo dobi, në bazë të vlerës, i tejkalonte ardhurat e ligjshme e të pandehurit.

Këtu gjithsesi janë edhe rastet e veçanta të konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore, te veprat e theksuara më herët të pasurimit të paligjshëm të zyrtarëve publik dhe shpërlarjes së parave.

Gjykata, me vendim shqipton masën e konfiskimit të zgjeruar, në bazë të kushteve të përcaktuara në Kodin e Prcedurës Penale (2016).

Procedura e shqiptimit të masës së konfiskimit të zgjeruar zbatohet me propozimin e prokurorit publik.

4.5.3. Kriteri i dëshmimit (baza ligjore, shpërpjetimi, tjetërsimi i barrës së provës, etj.)

4.5.3.1. Përcaktimi i prejardhjes së përfitimit nga krimi

Dispozita bazë e nenit 98-a. të Ligjit Penal në drejtimin e konstatimit të rrethanave që flasin për prejardhjen e dobisë nga delikuenca, theksohet se gjykata ka të drejtë të konstatojë, me bindje të plotë, duke respektuar të gjitha rrethanat e rastit, se prona tejkalon të ardhurat e ligjshme e të pandehurit dhe që është përfituar me vepra penale, për të cilat mund të zbatohet instituti për konfiskim të zgjeruar. Është specifikë në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut nga se ligjvënësi e caktuar afatin, përkatësisht periudhën, që ka paraprirë kryerjes së veprës penale, nga e cila është përfituar dobia pasurore, të cilën gjykata e konstaton për çdo rast konkret, por nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vite. Vetëm dobia që është përfituar në këtë periudhë mund të jetë subjekt i konfiskimit të zgjeruar.

Në rastet e konfiskimit të zgjeruar te rastet e veprave penale nga neni 359a. të Kodit Penal, do të thotë tek pasurimi i paligjshëm i zyrtarëve publik, është përcaktuar që si kriter i konstatimit të prejardhjes së dobisë nga delikuenca, merret parasysh standardi “dobia që në masë të konsiderueshme tejkalon të ardhurat e ligjshme e të pandehurit ose të anëtareve të familjes së tij.”.

Konfiskimin e zgjeruar të pronës apo dobisë pasurore mund ta shqiptojë gjykata në aktgjykimin e saj, në të cilin i pandehuri shpallet fajtor, në vendimin e gjykatës ose caktimin e masës së sigurisë. Në shqiptimin e aktgjykimit ose aktvendimit, gjykata do të theksojë cila pronë apo objekt, përkatësisht shuma e kundërvlerës, konfiskohet.

Nuk ka rregulla të veçanta në drejtim të konstatimit të prejardhjes së paligjshme të pronës, por zbatohen rregullat e përcaktuara me KPP, që kanë të bëjnë me konstatimin e gjendjes faktike në procedurë penale.

Përjashtim mund të jenë rregullat e konfiskimit nga personat e tretë, të cilët kanë obligim të dorëzimit të dëshmimeve se pronën kontestuese e kanë përfituar *bona fide*, përkatësisht kanë paguar shumën reale, të plotë dhe të saktë, me rastin e përfitimit të pronës.

Personi, të cilit i është caktuar konfiskimi i zgjeruar i pronës ose dobisë pasurore, mund të parash-troj kërkesë për përsëritjen e procedurës penale, në pajtim me nenin 449 të KPP (2016), lidhur me konfiskimin e pronës dhe dobisë.

Konfiskimi i dobisë pasurore ekzekutohet në afat prej 30 ditësh nga aktgjykimi i plotëfuqishëm. Aktvendimin për ekzekutim nxjerr gjykata, e cila ka nxjerr aktgjykimin e shkallës së parë.

Ekzekutimi kryhet mbi pronën dhe dobinë pasurore me vendim gjyqësor, ndërsa nëse kjo pjesër-isht apo tërësisht nuk është e mundëshme, ekzekutimi bëhet nga prona e mbetur e personit, të cilit i është caktuar një masë e tillë.

4.6. SERBIA

4.6.1. Korniza ligjore për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pronësore

Ligji për konfiskimin e pronës, të përfituar me vepër penale (2016) është *lex specialis*, dhe vetëm me këtë ligj rregullohet konfiskimi i zgjeruar i pronës, që nënkupton pronën e përgjithshme, për të cilën mund të supozohet, në bazë të këtij Ligji, se rrjedh nga aktivitetet kriminale.

Prandaj, zbatohet KPP ZKP (2014).

Në KPP (2014), në dispozitat që rregullojnë Marrëveshjen për pranimin e veprës penale, neni 314 parag. 3, është theksuar se pjesë përbërëse e marrëveshjes mund të jetë edhe marrëveshja në pikëpamje të pronës, të përfituar me vepër penale, e cila mund të konfiskohet nga i pandehuri.

4.6.2. Fushëveprimi

4.6.2.1. Kriteri zbatimit të ligjit lidhur me konfiskimin e zgjeruar

Kriteret që i përcakton Ligji i veçantë janë: (a) veprat penale të theksuara në mënyrë saktë, për një numër të konsiderueshëm për të cilat vendoset edhe kriteri shtesë (b) kriteri lidhur me lartësinë e do-bisë pasurore të përfituar, por është i zbatueshëm vetëm një grup (më të madh), gjithashtu të veprave penale të theksuara në mënyrë saktë, kryesisht atyre të korrupsionit dhe atyre të kryera nga lakmia. Shuma monetare nga kriteri i fundit duhet të jetë më e lartë se një milionë e pesëqind mijë dinarë.

4.6.2.2. Konfiskimi i zgjeruar i pronës

Prona që konfiskohet mund të jetë në formë konkrete, e tundshme, e patundshme, e mirë mate-riale, e mirë jomateriale, pjesëmarrja në personin fizik dhe dokumentet në çfarëdo forme, me të cilat dëshmohet e drejta apo interesi në raport me një të mirë e tillë. Prona e përfituar nga aktivitetet e përgjithshme kriminale e kryesit, që do të thotë se në këtë mënyrë mund të përfshihet çfarëdo prone, për të cilën supozohet se është përfituar me vepër penale, jo vetëm nga vepra konkrete penale, për

të cilën është duke u zhvilluar procedurë penale. Pronë konsiderohen edhe të ardhurat dhe dobia tjetër e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte, nga vepra penale, si dhe e mira në të cilën ajo është transformuar ose me të cilën është përzier.

Mund të konfiskohet prona në shkëmbim, e cila i përgjigjet vlerës së pronës të përfituar me vepër penale.

4.6.3. Kriteret e dëshmisë (baza ligjore, shpërpjestimi, tjetërsimi i barrës së provës, etj.)

4.6.3.1. Përcaktimi i prejardhjes së pronës nga krimi

Pronë e përfituar me vepër penale konsiderohet prona e pronarit, për të cilën është e qartë se nuk është në proporcion me të ardhurat e tij ligjore. Është i nevojshëm përcaktimi i rrethanave, që tregojnë për ekzistimin e pronës, që nuk është në proporcion me pronën dhe të ardhurat e ligjshme, në bazë të të cilës konstatohet besueshmëria e arsyeshme se prona është përfituar nga aktivitetet kriminale. Ligji nuk përcakton rrethanat e sakta, të cilat mund të tregojnë në disproporcion, por ato konstatohen në çdo lëndë veçanërisht. Elementi i rëndësishëm është disbalansi i qartë, që mundëson shfrytëzimin e supozimit ligjorë për prejardhjen kriminale të pronës, të cilin supozim gjykatat e përdorin në arsyetimet e tyre drejtpërdrejtë, duke i aplikuar konventat e ratifikuara.

4.6.3.2. Garancitë procedurale dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Supozimi i pafajësisë ekziston vetëm në raport me procedurën e konstatimit të fajësisë për vepër penale. Barra e dëshmisë për prejardhje kriminale të pronës është e ndarë në mes të prokurorit dhe të pandehurit, përkatësisht pronarit të pronës. Prokurori ofron dëshmi lidhur me të ardhurat e ligjshme të të pandehurit dhe pronës, që posedon ose ka poseduar, si rrethanë që tregon për ekzistimin e disproporcionit të qartë në mes të pronës që posedon dhe të ardhurave e ligjshme.

I pandehuri mohon akuzat e prokurorit dhe dëshmon prejardhjen e ligjshme të pronës.

Barra e dëshmisë, megjithatë është më e madhe në anën e të pandehurit.

E drejta për gjykim të drejtë respektohet në pjesën, që ka të bëjë me procedurën kontradiktore, e drejta e propozimit dhe paraqitja e provave, si dhe e drejta për mbrojtje.

V. PËRFUNDIME

5.1. PASQYRË E OBJEKTIVAVE DHE STANDARDEVE TË KOMBEVE TË BASHKUARA, KËSHILLIT TË EVROPËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN

Pjesa e dytë e Doracakut për Masat e Kthimit të Pasurisë shtjellon standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane të cilat kanë të bëjnë me masat e sekuestrimit dhe të konfiskimit. Kjo pjesë përfshin Konventat e Kombeve të Bashkuara, instrumentet e Bashkimit Evropian, si edhe Rekomandimet më të fundit lidhur me Task Forcën për Veprim Financiar lidhur me Pastimin e Parave. Në mënyrë më specifike për rajonin, në këtë pjesë të Doracakut po ashtu bëhet një shqyrtim i thukhtë i punës së Këshillit të Evropës. Në këtë pjesë trajtohen instrumentet ligjore të Këshillit, paraqitet puna e organeve të tij monitoruese, GRECO dhe MONEYVAL, dhe shqyretohen me hollësi kërkesat e Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 6, 7, 8 dhe neni 1 i Protokollit 1, dhe praktikrat kryesore shoqëruese gjyqësore para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Është relativisht e qartë që instrumentet ndërkombëtare të marra parasysh në Pjesën II përqendrohen në bashkëpunimin më të madh ndërmjet shteteve dhe në harmonizimin e masave kombëtare kundër korrupsionit dhe në ato të konfiskimit. Harmonizimi po ashtu është sfida kryesore në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për arsye se ndonëse autoritetet e secilit shtet veprojnë brenda lirisë së vlerësimit, gjykata ka punuar për të siguruar që veprimet e secilit shtet janë në proporcion me qëllimin e tyre të ligjshëm. Nevoja për ta arritur ekuilibrin ndërmjet veprimeve dhe të drejtave mbetet një fushë zhvillimore e ligjit dhe standardet e zbatuara në këtë aspekt kërkojnë interpretim dhe zbatim të kujdesshëm.

5.2. ANALIZA KRAHASUESE E LEGJISLACIONIT

5.2.1. Hetimi financiar

Në kuadër të analizës krahasuese të legjislacionit në rajon, procedura e parë është konfiskimi e dobisë pronësore, të përfituar me vepër penale, që është përfshirë në këto analiza dhe bëhet fjalë për hetimin financiar. Bëhet fjalë për veprime hetimore të trupit për ndjekje penale, me të cilat udhëheq prokurori, i cili ka për qëllim të zbulojë, vëzhgojë dhe identifikojë pronën, që është lëndë e procedurës, me qëllim të zbatimit të fazave të ardhshme të procedurës, përkatësisht të caktimit të masave gjyqësore për sekuestrimin e pronës.

Shqyrtimet përfundimtare lidhur me mënyrën e rregullimit normativ të hetimit financiar në 6 jurisdiksione të analizuar, mund të shikohet përmes 4 çështjeve kryesore: (a) Mënyra si janë normuar hetimet financiare, në bazë të ligjeve sistemore (KPP) dhe ligjeve të veçanta, në qoftë se ato ekzistojnë në shtetet e caktuara, (b) si janë specifikuar qëllimet e hetimit financiar, (c) në çfarë mënyre ligjet i rregullojnë organizimet për zbatimin e hetimit financiar, dhe (d) në cilat regjistra të pronës dhe baza të të dhënave, prokurorët kanë qasje, me qëllim të zbatimit efikas të hetimit financiar.

Në esencë, nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme në mes të legjislacioneve të analizuar, kur bëhet fjalë për dispozitat e ligjeve procedurale për procedurë penale, të cilët në asnjë rrethanë nuk përcaktojnë hetimin financiar, si veprim i veçantë hetues, me qëllim të zbulimit të dobisë pasur-

ore. Në vend të kësaj, këto dispozita mundësojnë, që në kuadër të hetimit penal (që zbatohet me urdhër, aktvendim apo ndonjë akt tjetër të prokurorit), të zbatohen veprimet specifike dhe aktivitetet hetimore, të cilat kanë qëllimin e karakterit financiar të veprimit hetues. Gjithashtu, duhet theksuar se ato nuk janë formë obliguese e hetimit, që do të thotë prokurori që zhvillon hetimin penal përcaktohet nëse në kuadër të hetimit penal do t'i zbatojë disa veprime, të cilat kanë rëndësinë e hetimit financiar. Gjithashtu, në disa legjislacione (Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, etj), në kuadër të KPP, janë të normuara veprimet (p.sh urdhri për bankën dhe personin tjetër juridik), të cilat në bazë të përmbajtjes dhe *verbal legës*, në të vërtetë janë veprime tipike për hetimin financiar, por të përfshira në veprime të rregullta të dëshmisë (konkretisht në kuadër të kapitullit për sekuestrim të gjërave dhe pronës). Prandaj, në shumicën e legjislacioneve (përveç Maqedonisë së Veriut, e cila nuk ka Ligj të veçantë), hetimi financiar përfshihet në hetimin penal dhe zbatohet në kuadër të të njëjtit, në bazë të vlerësimit dhe urdhrimit të prokurorit. Gjithashtu, duhet shtuar edhe kompetencat që kanë trupat nacionale për parandalimin e shpëlarjes së parave (njësitë financiare të inteligjencës, që veprojnë në bazë të dispozitave për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste, të cilat gjatë punës së tyre arrijnë informacion të rëndësishme lidhur me këto vepra penale, të cilat shpeshherë shërbejnë si bazë për zbatimin e hetimit financiar, në bazë të vendimit të prokurorit.

Një çështje tjetër e rëndësishme për të cilën gjatë analizave është bërë përpjekje për të arritur përgjigje, është nëse zgjidhja ligjore në rajon, mundëson që përmes hetimit financiar mundet në mënyrë efektive të zbulohet, ndjeket dhe identifikohet dobia pasurore? Kur bëhet fjalë për qëllimet e hetimeve financiare, analizat tregojnë se në pikëpamje të dispozitave të ligjeve penale-procedurale, në juridiksionet e analizuara, nuk ekzistojnë dallime të mëdha. Siç u tha, hetimet financiare, në rastet kur zbatohen dispozitat sistimore të karakterit procedural penal, janë përfshirë në hetimin penal dhe qëllimet i përgjigjen atyre që vlejnë për hetimin penal. Në bazë të rregullave, ky grumbullim i provave lidhur me veprën penale dhe përgjegjësia e kryesit, duke shtuar se përmes veprimeve që kanë karakter të hetimit financiar, duhet të grumbullohen provat se me kryerjen e veprës penale është përfituar dobia pasurore. Në anën tjetër, në juridiksionet, ku janë në fuqi ligjet e veçanta, të cilët kryesisht e rregullojnë konfiskimin e zgjeruar (Serbia dhe Mali i Zi), njëkohësisht konfiskimi i zgjeruar dhe i rregullt (FBH dhe DB në Bosnje dhe Hercegovinë), qëllimet të hetimit financiar, kryesisht lidhen me grumbullimin e të dhënave dhe provave, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, obligimet dhe pronën e të pandehurve dhe personave të tjerë ose së paku llojin specifik të “verifikimit” të pronës në kuadër të procedurave të veçanta për konfiskim preventiv (Shqipëria) ose në kuadër të kompetencave të zgjeruara për konfiskim, ku gjithashtu përdoret ky term (Kosova*). Kështu, mund të konkludohet se çështja e legjislacioneve është parashikuar në mënyrë adekuate dhe qëllimet e hetimit financiar, që zbatohen në bazë të rregullave sistimore ashtu edhe *lex specialis*.

Në të gjitha juridiksionet, prokurori, në bazë të ligjeve në fuqi, si atyre sistimore (KPP), ashtu edhe në bazë të ligjeve të veçanta për konfiskimin e dobisë pasurore (në qoftë se ekzistojnë në disa juridiksione), është kompetent për fillimin dhe zbatimin e hetimit financiar. Kjo gjendje është me siguri rezultat i reformave të legjislacionit penal në rajon, e cila është larguar nga koncepti i hetimit gjyqësor përmes gjyqtarit hetues dhe ka miratuar zgjidhjet, kryesit të konceptit adversijal të procedurës penale, në të cilën prokurori është i autorizuar për këto veprime.

Lidhur me organizimin e hetimit financiar, ekzistojnë zgjidhje të shumta dhe kryesisht kanë lidhje me shkallën e specializimit të prokurorisë, të cilat janë kompetente për luftimin e formave të ndryshme të krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimit financiar. Në disa juridiksione (p.sh. Serbi), janë nxjerr ligjet e veçanta për organizimin e organeve shtetërore, të cilat merren me këto punë dhe janë rregulluar kompetencat, të drejtat dhe obligimet të një numër të madh të subjekteve, në pikëpamje

* Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

të veprimit lidhur me hetimin financiar. Në disa raste, vetëm disa organe (p.sh. Policia financiare në Maqedoni të Veriut), në mënyrë eksplicite janë theksuar dhe autorizuar për të ndërmarr veprime të caktuara në kuadër të hetimit të kategorive të veçanta të veprave penale (p.sh. shpëlarja e parave). Në disa raste (Bosnjë e Hercegovinë, entiteti Republika Serbe), kanë formuar njësi të veçanta të specializuara të policisë (zgjdhje të ngjashme ka Serbia), të cilat janë të ngarkuara që të veprojnë në kuadër të hetimit financiar. Në raste të tjera (Bosnja e Hercegovina, përkatësisht Federata BH), vetëm disa institucione janë veçanërisht të theksuara si partnerë kyç të prokurorive për zbatimin e hetimeve financiare. (Drejtoria Tatimore FBH, Regjistri i letrave me vlerë FBH). Në esencë, këto qasje varen nga organizimi i sistemit të qeverisjes shtetërore, dhe veçanërisht të sistemit gjyqësor dhe niveli i arritur i specializimit të organeve policore dhe prokuroriale në raport me veprat penale të theksuara më lartë. Është e evidente se është trend i përgjithshëm specializimi i punëve, që janë në lidhje me zbatimin e hetimeve financiare dhe sipas të gjitha gjasave, i njëjti do të vazhdojë edhe në periudhë të ardhshme.

Në fund, çështja e kërkesave ligjore për qasje direkte dhe/ose qasje të lehtësuara në regjistrat e pronës, regjistrave dhe evidencave në përgjithësi (më së shpeshti baza të të dhënave), që janë një mjet i rëndësishëm për prokurorë gjatë zhvillimit të hetimit financiar dhe mbetet edhe më tutje problem prezent në Rajon. Me qëllim që prokurorët të kenë informacion se është kryer vepra penale, me të cilën është përfituar dobia pasurore ose ndonjë person posedon pronën, për të cilën supozohet se është përfituar me aktivitete kriminale, të zhvillohet hetimi financiar dhe të konstatohet bazueshmëria e dyshimit fillestar, me qëllim të vazhdimin të hetimit financiar, duhet të kenë qasje direkte ose së paku të lehtësuara në regjistrat relevante të pronës, përkatësisht në bazat e të dhënave. Në këtë moment, vetëm disa nga juridiksionet e analizuara kanë parakushtet për diçka të tillë (Serbia, Shqipëria dhe një pjesë BH, përkatësisht entitetin e Republikës Serbe). Në raste të tjera, kjo mundësi nuk ekziston, janë shënuar edhe rastet ku madje nuk ekzistojnë regjistrat unik të llogarive bankare të personave fizik (Bosnje e Hercegovina), por të dhënat sigurohen në mënyrë të tejkaluar me dorëzimin e pyetësorëve në bankat tregtare, që sjellë edhe rreziqe të caktuara për integritetin e hetimit. Kështu, bëhet fjalë për një çështje teknike, por njëkohësisht edhe të rëndësishme, që duhet sa më parë të avancohet ngase nga kjo varet edhe suksesi i hetimit financiar të përgjithshëm, dhe me këtë edhe procedurës për konfiskimin e dobisë pasurore. Nga kjo çështje duhet të dallohen kompetencat e prokurorit, se gjatë hetimit financiar duhet ti dorëzohen të gjitha të dhënat dhe informacionet, që posedojnë organet publike dhe personi fizik, duke përfshirë edhe informacionet bankare, por të cilat edhe më tej dërgohen kryesisht në bazë të lëshimit paraprak të urdhrin të gjykatës. Pritet se në periudhën e ardhshme me reformat e rregullave në fushën e bankave (që është rregulluar në Kroaci), do të liberalizohet nocioni i fshehtësisë bankare, dhe në këtë mënyrë prokurorive do tu mundësohet me ligj, qasje direkte në llogaritë bankare, në bazë të urdhrin dhe në kuadër të hetimit financiar.

Në përfundim mund të konstatohet se në analizat krahasuese të legjislacioneve në juridiksione të rajonit, janë vërejtur përparime të caktuara, kur bëhet fjalë për normimin e hetimit financiar, për të cilin kontribut më të madh ka ofruar fakti se në shumicën e legjislacioneve, në fuqi janë ligjet e veçanta për konfiskim (kryesisht të zgjeruar) të dobisë pasurore. Megjithatë, kjo vetvetiu nuk është e mjaftueshme, ngase është e nevojshme që në nivelin normativ, teknik dhe organizativ, gjithashtu të bëhen hapat konkrete, me qëllim që në mënyrë gjithëpërfshirëse të krijohet infrastruktura e nevojshme për zbatimin efikas të hetimit financiar, me qëllim të zbulimit, vëzhgimit dhe identifikimit të pronës, që do të jetë objekt i konfiskimit. Atëherë ekziston mundësia për përparimet e konsiderueshme në implementimin e ligjeve në fuqi për konfiskimin e dobisë pasurore në rajon.

PASQYRA E ELEMENTEVE PËR HETIMIN FINANCIAR , NË BAZË TË LEGJISLACIONEVE TË ANALIZUARA

Elementet e hetimit financiar	Rregullimi ligjor i hetimit financiar		Forma dhe qëllimi i hetimit financiar		Organizacimi i hetimit financiar		Qasja në regjistrat e pronës	
	KPP	Ligji i veçantë	Urdhri ose një akt i ngjashëm prokurorial	Identifikimi, vëzhgimi dhe zbulimi i dobisë pasurore	Prokurori si dominus litis	Policia, organet tatimore e të tjera	Qasja direkte	Qasja e lehtësuar
Jurisdikcioni								
SHQIPËRIA	JO (pjesë e hetimit penal)	PO	JO (vetëm regj. i procedurës)	PO (verifikimi i mjeteve dhe pronës)	PO	PO (policia gjyqësore)	PO (SMR)	Po
BOSNJA E HERCEGOVINA	JO (pjesë e hetimit penal)	PO (FBH, RS dhe BD) JO (BiH)	PO urdhri për hetim financiar) JO	PO (vetëm në bazë të ligjeve të veçanta)	PO	PO (ligjet e veçanta) Policia (RS-Njësia) Organet tatimore Policia financiare	JO (Njësia MPB RS)	JO (Njësia MPB RS)
MALI I ZI	JO (pjesë e hetimit penal)	PO	PO (urdhri për hetim financ.)	PO	PO	PO	JO	JO
KOSOVA*	JO (pjesë e hetimit penal)	PO	PO (hetimi për konfiskim.)	PO (verifikimi i pronës)	PO	PO	JO	JO
MAQEDONIA E VERIUT	JO (pjesë e hetimit penal)	JO	JO	DA (veprat specifike penale)	PO	PO Policia gjyqësore, veçanërisht policia financiare)	JO	JO
SERBIA	JO (pjesë e hetimit penal)	PO	PO (urdhri për hetim financ.)	PO	PO	PO Njësia-MPB Forenzika financiare	PO (Njësia MPB)	JO

5.2.2. Masat e përkohshme të sigurimit

Në procedurat për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me vepra penale, momenti i parë kur gjykatat kyçen lidhur çështjen e përfshirjes në pronë të personave kundër të cilëve zhvillohet procedura (dhe personave në lidhje me ta), është kur merren vendimet për kufizimin e përkohshëm për të disponuar dhe shfrytëzuar pronën, e cila është lëndë e procedurës. Këto masa më së shpeshti quhen masa (të përkohshme) të sigurimit të dobisë pasurore dhe në kuadër të analizës krahasuese të legjislacioneve në Rajon, hollësisht është analizuar korniza juridike, që rregullon këtë fushë.

Esenca e analizave të zbatuara mund të përmbledhet në disa çështje kyçe, për të cilat është bërë përpjekje që të arrihet përgjigjeje. Çështja e parë ka të bëjë me masat e përkohshme të sigurimit, të rregulluar kryesisht me rregullat penale procedurale dhe/ose me ligje të veçanta (në qoftë se ekzistojnë në disa juridiksione), dhe që është raporti i tyre reciprok.

Me analizat e zbatuara, fillimisht është vërejtur se në të gjitha legjislacionet, ligjet për procedurën penale, rregullon masat e përkohshme, në mënyrë shumë të ngjashme, mund të thuhet në baza konvencionale, dhe ato shpeshherë kanë rëndësi të dyfishtë, madje edhe shumëfishtë. Fillimisht, kjo është dëshmuar, konfiskimi i përkohshëm i gjërave dhe pronës, në kuadër të dispozitave të Ligjit për procedurë penale, i cili rregullon veprimet për grumbullimin të provave për procedurë penale. Kjo është plotësisht e kuptueshme, në qoftë se merret parasysh se dobia pasurore ndonjëherë mund të jetë provë në procedurën penale, kështu që ligjvënësit në këtë mënyrë i identifikojnë dhe juridikisht rregullojnë konfiskimin, me qëllim të zhvillimit të procedurës penale. Në rastin tjetër, ligjet e procedurës penale, në kuadër të kapitujve të veçantë, në të cilat rregullohet procedura e konfiskimit të përkohshëm të dobisë pasurore, përcaktohen dispozitat e të ashtuquajturit konfiskim i dobisë pasurore. Në disa raste, duke u referuar në dispozitat e ligjeve të tjera (procedurë ekzekutive), dhe në disa raste është evident mosharmonizimi në mes të dispozitave të drejtës penale dhe ekzekutive (p.sh. Bosnja e Hercegovina).

Në legjislacionet që ekzistojnë ligjet e veçanta, hollësisht përpunohen masat e përkohshme të sigurimit të dobisë pasurore, me vërejtje se në shumicën e juridiksioneve, dispozitat e ligjeve të veçanta për konfiskimin e përkohshëm, kanë përparësi në zbatim në raport me ligjet për procedurë penale ose raporti i tyre është i kushtëzuar me qëllimet, përkatësisht qëllimet e procedurave të ndryshme (p.sh. Shqipëria në rast të konfiskimit preventiv). Në disa juridiksione, masat e përkohshme mund të caktohen edhe pas përfundimit të procedurës penale, në qoftë se fillohet procedura për konfiskimin e zgjeruar, në bazë të ligjit të veçantë (Serbia, BH, - Entiteti Republika Serbe, si dhe Kosova*).

Çështja tjetër kanë të bëjë me kushtet dhe mënyrën e caktimit të masave të përkohshme. Prap duhet dalluar regjimet juridike, në kuadër të të cilëve caktohen këto masa, përkatësisht llojin e procedurës (që caktojnë qëllimin), në kuadër të cilave ndonjë pronë përkohësisht sigurohet. Në qoftë se ato caktohen në bazë të KPP, varësisht nëse bëhet fjalë për konfiskimin dëshmues ose garantues, baza juridike më së shpeshti është mundësia se bëhet fjalë për pronën, që është përfituar me vepra penale ose ka shërbyer për kryerjen e saj, kështu që në bazë të kësaj, ekziston nevoja që e njëjta përkohësisht të konfiskohet, përkatësisht të pamundësohet tjetërisimi i asaj prone, në qoftë se bëhet fjalë për konfiskim të garantuar. Është interesante se në këtë regjim juridik (KPP), ekziston mundësia ex officio i veprimit të gjykatës në drejtim të konfiskimit të garantuar të dobisë pasurore, derisa në rastet urgjente siguri dëshmues ekziston në disa juridiksione dhe personave të autorizuar zyrtar të policisë, madje edhe prokurorëve (p.sh. Kosova*). Në disa legjislacione, vetëm veprimet dëshmuar të veçanta në procedurë penale, sikur bllokimi i llogarisë dhe pezullimi i transaksioneve financiare

* Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

dhe tregtare, mund të caktohen në bazë të urdhrit të prokurorit, me aprovimin e gjykatës (Bosnja dhe Hercegovina). Në anën tjetër, një mundësi e tillë në regjimin, që rregullon ligji i veçantë (si konfiskimi izgjeruar dhe konfiskimi preventiv), nuk ekziston ndonjë veprim i caktuar i gjykatave, kryesisht sipas kërkesës së prokurorit. Megjithatë, në disa raste të veçanta edhe ligjet e veçanta mundësojnë veprimin urgjent të prokurorit, me qëllim të caktimit të këtyre masave, me aprovimin e gjykatës (p.sh Mali i Zi, Kosova*). Kur bëhet fjalë për regjimin juridik, në kuadër të procedurës penale (KPP), në disa legjislacione janë përcaktuar hollësisht procedurat, si shqyrtimi, afatet dhe elementet e tjera të procedurës për caktimin e masave të përkohshme, ndërsa në legjislacionet e tjera, siç u tha, ekzistojnë vetëm dispozita udhëzuese që parashikojnë zbatimin e rregullave të procedurës ekzekutive.

Duhet theksuar se në pikëpamje të bazës juridike për caktimin e masave të përkohshme në ligjet e veçanta, është përfaqësuar qasja, që shfrytëzon mundësinë e zbatimit të kushteve juridike, të paraqitura në rrezikun nga tjetërsimi i pronës, në qoftë se nuk caktohet masa e përkohshme, derisa disa legjislacione pamundësojnë vendosjen e gjykatës ex parte, (p.sh Ligji i veçantë në BH – entiteti Federata BH dhe Distrikti i Brrçkos, si dhe një pjesë në entitetin Republika Serbe). Çështje vijuese kyçe është nëse dispozitat e legjislacioneve në fuqi në rajon në mënyrë adekuate rregullojnë bllokimin / ngrirjen, si dhe sekuestrimin / konfiskimi i përkohshëm i pronës. Analizat flasin se kësaj çështje iu kushtua kujdes adekuat, veçanërisht nëse flitet për ligjet e veçanta që rregullojnë këtë fushë, në ato juridiksione, që kanë në fuqi ligjet e veçanta, dhe të cilat janë gjithëpërfshirës, të qartë dhe preciz, kur bëhet fjalë për pronën, e cila mund të përfshihet në masat e bllokimit dhe / ose sekuestrimit (specifikimi i pronës, në bazë të simboleve faktike).

Në fund, shumica e legjislacioneve, në drejtim të afatit të mundshëm të zgjatjes së masave të përkohshme të sigurisë të dobisë pasurore, ka parashikuar në esencë afate të kufizuara, përkatësisht periudhën për të cilën mund të caktohet, i cili më së shpeshti ka të bëjë me statusin (hyrjen në fuqi ose vendimi i shkallës së parë) e vendimit për konfiskim, me kontrollin gjyqësor, që zhvillohet periodikisht në bazë të vlerësimit të gjykatës ose në afatet e përcaktuara me Ligj. Me qenë se bëhet fjalë për një nga standardet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është me rëndësi që ligjvënësit në rajon e kanë konstatuar këtë standard dhe e kanë përfshirë në dispozita të Ligjeve të veçanta për konfiskimin (e zgjeruar) të dobisë pasurore. Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe proporcionalitetit, ku domosdo duhet të theksohet se me ligje të veçanta në rajon, janë parashikuar edhe mundësitë e shqiptimit të masave më të buta dhe zëvendësuese (garancia, prona zëvendësuese etj), si dhe ndalimi i përfshirjes së pronës të poseduesit të ndershëm (Serbia), pronës që është e nevojshme për kujdesin e domosdoshëm të familjes, të personit ndaj të cilit shqiptohen këto masa.

PASQYRA E ELEMENTEVE TË KONFISKIMIT TË ZGJRUAR TË DOBISË PASURORE, NË BAZË TË LEGJISLACIONEVE TË ANALIZUARA

Elementet e masave të përkohshme	Rregullimi ligjor i masave të përkohshme		Kushtet dhe mënyra për caktimin e masave të përkohshme		Lloji i masës		Statusi i procedurës	
	KPP	Ligji i veçantë	Kërkesat ligjore (rreziku etj.)	Vendimi gjyqësor	Blokada/ rritja	Sekuestrimi/ Konfiskim i përkohshëm	Kohëzgjatja	Mundësia për caktimin e masave zëvendësuese/ më të buta
Jurisdiksioni								
SHQIPËRIA	PO Dëshmuar + Sigurimi i dobisë pasurore	PO (konfiskimi preventiv)	PO (ligji i veçantë)	PO (sipas KPP mundësia ex officio) + Policia gjyqësore (dëshmuese)	PO	PO	6 muaj, me kontrolle gjyqësore	DA
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	PO Dëshmuese + Sigurimi i dobisë pasurore	PO (FBH; RS dhe BD) JO (BH)	PO (ligjet e veçanta FBH; RS DHE BD)	PO (veçanërisht OSL, në rast të konfiskimit dëshmuës, në bazë të KPP)	PO	PO	Ligjet e veçanta (FBH; RS; BD) 60 ditë nga hyrja në fuqi	DA
MALI I ZI	PO	PO	PO (ligji i veçantë)	PO (veçanërisht prokurori, në bazë të ligjit të veçantë)	PO	PO	Ligji i veçantë (deri në hyrje në fuqi të vendimit për konfiskim)	DA
KOSOVA*	PO Dëshmuese + Sigurimi i dobisë pasurore	PO (kompetencat e zgjeruara për konfiskim)	PO (ligji i veçantë)	PO (parashtimi i propozimit për konfiskim)	PO	PO	Afati i arsyeshëm	PO
MAGEDONIA E VERIUT	PO Dëshmuese + Sigurimi i dobisë pasurore	JO	PO	PO	PO	PO	Deri në përfundimin e procedurës së shkallës së parë	JO
SERBIA	PO Dëshmuese + Sigurimi i dobisë pasurore	PO	PO (ligji i veçantë)	PO	PO	PO	Deri në vendosje lidhur me konfiskimin e pronës	PO

5.2.3. Konfiskimi i zgjeruar

Konfiskimi i zgjeruar të dobisë, të përfituar me vepra penale, paraqet regjim të veçantë i masës penalo-juridike për konfiskimin e dobisë pasurore.

Konstatimi i lidhshmërisë së pronës me veprën penale konkrete në konfiskimin e rregullt, mund të jetë i vështirësuar, veçanërisht në rast të mashtrimeve, në të cilat manipulohet me shuma të mëdha të parave dhe që vazhdojnë një kohë të gjatë, veprat e krimit të organizuar në fushën e tregtisë me narkotik ose kontrabandë, si dhe të gjitha veprat, në të cilat janë të përfshirë një numër i madh i njerëzve, që janë komplekse ose kanë tipare të delikteve transnacionale. Prandaj, konfiskimi i zgjeruar konsiderohet mënyrë e mirë për tejkalimin e problemeve të theksuara, ndërsa veçanërisht kur rrethanat flasin për ekzistimin e pronës së dyshimtë, prejardhja e të cilës nuk mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme.

Janë tri elemente, përmes të cilëve, zgjidhja e legjislacioneve që kanë të bëjnë me konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore, mund të përmbledhin: a) për cilat vepra është i mundshëm konfiskimi i zgjeruar; b) për cilën pronë bëhet fjalë, që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar dhe cila është lidhja me aktivitetet kriminale të kryesit; c) cilat janë të drejtat e kryesit ose të personit të tretë në procedurë.

Me qenë se bëhet fjalë për një materie senzitive - përfshirjen në pronë, që vetëm indirekt mund të lidhet me veprimet delikuede të kryesit – mund të pritet që ligjvënësit të jenë vigjilent për cilat vepra mund të ndërmerret një procedurë e tillë. Mund të vërehen tri qasje: Qasja e parë dhe më e shpeshta, listimi taksativ i veprave penale, çoftë individualisht ose një kapitull i ligjeve penale, lidhur me të cilat mund të fillohet procedura për konfiskim të zgjeruar të dobisë, të përfituar me vepër penale. Një situatë e tillë është në Shqipëri, në shumicën e juridiksioneve në BH, Malin e Zi, Kosovë^{154*}, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Gjithashtu, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, kushtëzojnë zbatimin e këtij instituti me kriteret shtesë (lartësia e dënimit të kërcënuar me burg, përkatësisht lartësia e dobisë së realizuar). Disa nga legjislacioneve të analizuar përcaktojnë mundësitë e shumëfishta për zbatimin e këtij regjimi të konfiskimit, kështu në Republikën Serbe (BH) dhe Kosovë*, krahas listimit taksativ të delikteve, që i nënshtrohen zbatimit të këtij regjimi, mund të caktohet konfiskimi i zgjeruar edhe për vepra të tjera, në qoftë se lartësia e dobisë së përfituar është e konsiderueshme.

Në fund, qasja e tretë ka të bëjë me lartësinë e sanksionit të kërcënuar me burg. I njëjti është prezent edhe në Federatën e Bosnje e Hercegovinës dhe në Distriktin Brčko të Bosnje dhe Hercegovinës (BH), por vetëm nëse veprohet në bazë të dispozitave *lex specialis* për konfiskim. Për të gjitha qasjet është e përbashkët se kryesisht bëhet fjalë për veprat e rënda penale, si veprat e krimit të organizuar, ekonomik, korrupsionit, por edhe terrorizmit, shpëlarjes së parave, deliktet kundër pronës, jetës dhe trupit, shëndetit të njerëzve dhe vepra të tjera.

Prona që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore, zakonisht është ajo që gjendet në pronësi të kryesit ose personave në lidhje me te (familjarët e kryesit, pjesëmarrësit në vepër, trashëgimtarët juridik dhe personat e tretë, mbi të cilët është bartur prona). Kërkesë e zakonshme është që prona e tillë të jetë në disproporcion me të ardhurat e ligjshme të kryesit, siç është përcaktuar në Shqipëri, Republikës Serbe (BH), Malin e Zi, Kosovë^{155*}, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

154 * Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

155 * Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Në pjesën më të madhe të legjislacioneve të lartpërmendura është i mundshëm, jo vetëm konfiskimi i pronës në pronësi të kryerësit dhe personave të tjerë por, në rast të pamundësisë së qasjes në pronën, për të cilën është konstatuar se i nënshtrohet konfiskimit, duke e zgjeruar konfiskimin, pronën zëvendësuese ose kundërvlerën e pronës së vlerësuar.

Në shumicën e juridiksioneve në Bosnjë dhe Hercegovinë (përveç Republika Serbe), dhe deri diku në Mal të Zi, prona mund të konfiskohet, përmes konfiskimit të zgjeruar, duke përdorur disa kritere të tjera, ku ligjvënësit nuk janë të saktë: zakonisht përdorin formulimin “ ekziston besueshmëria e arsyeshme se dobia pasurore është përfituar nga kryerja e veprës penale “, duke mos specifikuar se cila rrethanë pikërisht duhet të vërtetohet dhe për të cilën pronë bëhet fjalë.

Nuk përjashtohet, duke interpretuar gjerësisht dispozitat e tilla ligjore, konkludimi se bëhet fjalë për pronën e trajtuar në mënyrë të dyshimtë (p.sh. paratë e fshehura në bunkerë të fshehtë) ose ndonjë rrethanë tjetër, që tregon prejardhjen e saj kriminale (p.sh., lidhje të forta të kryesve me kriminalitetin, të cilën, për shembull, e njih jurisprudenca gjermane). Për këtë duhet ende të krijohet praktika. Kryesit dhe personat e lidhur (familjarët e kryesit, trashëgimtarët ligjorë ose palët e treta të cilëve u është transferuar prona), në të gjitha juridiksionet e analizuara, kanë në dispozicion mundësinë e mbrojtjes, siç u garantohen zakonisht të pandehurve në procedurat e rregullta të konfiskimit. Kjo nënkupton të drejtën për të marrë pjesë në procedurë, të drejtën për të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale, si dhe të pandehurit (të ashtuquajturat barazinë e mjeteve), të ashtuquajturat të drejtat minimale të mbrojtjes (e drejta për vendim gjyqësor të arsyetuar, e drejta për kompensim, në rastin e dënimit të pabazë, si dhe koha e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes), e drejta për ankesë, mbrojtja nga përdorimi i provave të paligjshme, etj. Karakteristikë e procedurës së konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore është fakti se i pandehuri dhe personat e lidhur me te, pritet të deklarohen lidhur me akuzat e prokurorisë, në të kundërtën kjo mund të ketë ndikim negativ në pozitën pronësor-juridike të të pandehurit. Me fjalë të tjera, nga i pandehuri nuk pritet të jetë plotësisht pasiv dhe të kontribuojë në mënyrë aktive në ndriçimin e prejardhjes së pronës së inkriminuar. Në qoftë se vepron më ndryshe, kjo do të jetë në dëm të tij.

Por kjo nuk do të thotë se barra e vërtetimit të ligjshmërisë së pronës është tërësisht e zhvendosur . Në disa është i ndarë në mënyrë eksplicite (p.sh. Bosnja dhe Hercegovina), por edhe në ato juridiksione ku i kundërt dhe kërkon një përfshirje më aktive të të pandehurit, në fuqi është gjithmonë parimi i akuzës, që kërkon zhvillimin e procedurës, vetëm në bazë të kërkesës së prokurorit dhe në veçanti supozimin e pafajësisë, që përveç tjerash, kërkon nga prokurorët që të grumbullojë prova dhe të kërkojë deklaram nga pala tjetër.

Në Shqipëri, Mal të Zi, Kosovë^{156*} dhe Maqedoninë e Veriut, nga prokuroria pritet të dëshmojë disbalansin në mes të pronës në posedim të kryesit ose të një personi të tretë dhe të ardhurat e ligjshme (duke mos hyrë në detajet e prejardhjes të asaj prone), fakt që të pandehurin dhe personat e lidhur, i vendos në pozitë për tu deklaruar lidhur me ligjshmërinë e përfitimit të pronës.

Një situatë e ngjashme ekziston në Serbi dhe në Republika Serbe (BH) dhe një përfshirje disi më e madhe e prokurorëve në vërtetimin e prejardhjes kriminale të pronës, pritet në Federatën e BH, në Distriktin Brcko - BH dhe në nivelin shtetëror të BH.

Sidoqoftë, pavarësisht nga zgjidhja, prona që i nënshtrohet konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore nuk konsiderohet sanksion ose akuzë e re, por një rrethanë shtesë që kërkon deklarimin e poseduesve të gjërave ose të drejtave lidhur me prejardhjen e zë njëjtës, për të cilin *në qoftë se prona*

156 * Ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

është fituar ligjërisht, është në interes të tij ta bëjë një gjë të tillë dhe për të cilin kjo nuk duhet të jetë një problem i veçantë. Një mundësi e tillë e veprimit të organeve shtetërore parashikohet, gjithashtu me Direktivën e Bashkimit Evropian 2014/42 / BE për ngrirjen dhe konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me vepra penale në Unionin Evropian.

Në parim, mund të konkludohet se: (a) legjislacioni i analizuar ka kufizuar zbatimin e regjimit të konfiskimit të zgjeruar, të dobisë pasurore, vetëm në pjesën e inkriminuar (kryesisht më të rënda); (b) se të ardhurat e pronës kanë të bëjnë kryesisht me pronën e kryerësit ose personave të lidhur (familjarët e kryesit, pjesëmarrësit, trashëgimtarët ligjorë ose personat e tretë, të cilëve u është transferuar prona) dhe rrethanë tipike konsiderohet se prona që është përfituar me vepra kriminale nuk është në proporcion me të ardhurat e fituara ligjërisht; (c) se mosbalancimi i theksuar nënkupton mundësinë që i pandehuri dhe personat e lidhur të zbulojnë origjinën e pronës, kështu që mosveprimi ose mosuksesi do të ndikojnë negativisht, që nënkupton konfiskimin e saj.

PASQYRA E ELEMENTEVE TË KONFISKIMIT TË ZGJËRUAR TË DOBISË PASURORE, NË BAZË TË ANALIZËS SË LEGJISLACIONEVE

Elementet e konfiskimit të zgjeruar	Caktimi i veprave penale, për të cilat është i mundur konfiskimi i zgjeruar			Prona që i nënshtrohet konfiskimit dhe rrethanat që flasin për preardhjen kriminale				Garancionet procedurale dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut	
	Veprat e caktuara në mënyrë taksative	Lartësia e dorisë	Lartësia e sanksionit të kërcnuar	Në posedim të kryesit ose të personit të lidhur me të	Prona shëmblyese, përkatësisht kundërvlerë monetare	Disporporcioni i pronës së inkriminuar në raport me të ardhurat e ligjshme të kryesit	Rrethanat e tjera që flasin për preardhjen kriminale të pronës	Barra e provës	Të drejtat minimale për mbrojtje
Jurisdikcioni									
SHQIPËRIA	Po	-	-	Po	-	Po	-	E kundërt (në të pandehurin)	Po
BOSNIA DHE HERCEGOVINA	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	E ndarë	Da
MALI I ZI	Po	-	-	Po	Po	Po	Po	E kundërt (në të pandehurin)	Da
KOSOVA*	Po	Po	-	Po	Po	Po	-	E kundërt (në të pandehurin)	Po
MAqedonia E VERIUT	Po (me kriter shtesë i lartësisë së sanksionit të kërcnuar)	-	-	Po	-	Po	-	E kundërt (në të pandehurin)	Po
SERBIA	Po (tek disa vepra, kriteri shtesë është lartësia e dorisë së realizuar)	-	-	Po	Po	Po	-	I ndarë	Po

5.3. ANALIZA KRAHASUESE E PËRVOJAVE PRAKTIKE NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONEVE

5.3.1. Hetimi financiar

Në kuadër të fazës së parë të procedurës për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me veprë penale, problemet praktike kanë të bëjnë për disa çështje të rëndësishme, që në mënyrë direkt apo indirekte ndikojnë në efikasitetin e hetimit financiar, përkatësisht suksesin e zbulimit, vëzhgimit dhe identifikimit të pronës konkrete, që është lëndë e procedurës.

Shpeshherë, për shkak të pengesave të caktuara normative, të prezantuara në mosharmonizimin në mes të dispozitave procedurale të ligjeve për procedurë penale dhe dispozitave të ligjeve të veçanta për konfiskimin e pronës së përfituar në mënyrë të pa ligjshme, që kryesisht rregullojnë konfiskimin e zgjeruar të pronës, nuk është e mundur të zbatohen veprimet e veçanta hetimore në këto procedura (p.sh në Serbi, shumica e veprimeve të veçanta dëshmuese, në bazë të KPP, neni 162, mund të caktohet vetëm fajësia për veprat e krimit të organizuar dhe disa vepra të tjera penale, të listuara në mënyrë taksative, kështu që paraqitet problemi i dëshmisë në procedura të veçanta për konfiskimin e pronës). Ky problem veçanërisht theksohet në drejtim të dëshmisë të standardit të jetesës në drejtim të përcaktimit të disbalansit si kategori ligjore. Problem i veçantë për praktikues paraqesin situatat, në të cilat hetimi financiar zhvillohet me qëllim të konfiskimit të zgjeruar kundër personave (i pandehuri dhe/ose personat e lidhur me të), të cilët një kohë të gjatë realizojnë të ardhura të ligjshme. Ndonëse ekziston disbalansi i qartë në mes të pronës, që e posedojnë dhe të ardhurave të tyre të ligjshme, këta persona përmes prezantimit të ardhurave të ligjshme të tyre dhe familjarëve, dëshmitë për ndihmën dhe përkujdesjen ndaj familjes dhe anëtarëve të gjerë të familjes, ngarkesat kreditore dhe të ngjashme, bëjnë përpjekje për ta mohuar supozimin për prejardhjen e paligjshme të pronës së tyre. Në anën tjetër, në rastet kur personat e pandehur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme, por disponojnë me pronën, e cila është në disbalans të qartë, me ç'rast merren me krimin konvencional, këto probleme nuk janë aq të përhapura.

Nga analiza komperative e legjislacionit vërehet se ekzistojnë bazat juridike për zbatimin e hetimit financiar, qoftë në kuadër të hetimit penal, që zhvillohet në bazë të KPP ose në bazë të ligjeve të veçanta për konfiskim. Pa marrë parasysh cili nga këto dy regjime juridike është shfrytëzuar, përvojat e shteteve të veçanta, si Mali i Zi, tregojnë se rekomandohet që hetimi penal dhe financiar të zbatohen njëkohësisht, përkatësisht paralelisht dhe të plotësohen reciprokisht. Nga rezultati i hetimit financiar në mënyrë direkte varet rezultati i procedurës së tërësishme për konfiskimin e dobisë pasurore, kështu që ato janë të një lloji “pika kritike”, ndërsa zbatimin e tyre e vështirësojnë rastet në të cilat hetohen afarizmat e personave juridik, që janë të regjistruar në “oazat tatimore”, që do të thotë rajonet off-shore. Gjithsesi, në periudhën e ardhshme mund të pritet një numër i madh i rasteve, në të cilat instrumentet e reja të ndryshme dhe mënyra e transaksioneve, përmes sistemeve kompjuterike dhe internetit, shfrytëzohen për fshehjen e pronës të përfituar në mënyrë të paligjshme dhe shpëlarjes së parave. Në kontekst të teknologjive të reja të zbatimit të hetimit financiar, gjithsesi nuk duhet të harrohet as problemi i grumbullimit të ligjshëm i provave, veçanërisht të atyre që gjenden në sistemet kompjuterike dhe mediat digjitale.

Lidhur me problemin, i cili ka të bëjë me transferimin e pronës jashtë vendit, në shtete të tjera dhe territore, hetimi financiar duhet të jetë i konceptuar në mënyrë strategjike, kështu që në fazat e hershme, informacionet fillestare për këtë duhet të merren nga të gjitha burimet në dispozicion (dëshmitarët, i pandehuri, dokumentet, informacionet e personave zyrtarë), me zbatimin e veprimeve operative dhe dëshmuese (dëgjimi dhe hetimi, shqyrtimi, veprime të veçanta hetimore etj). Në një rast në Bosnje e Hercegovinë, informacion fillestare për posedimin e paluajtshmërisë jashtë vendit, është

marrë në mënyrë që gjatë bastisjes së banesës së pandehurit, është gjetur dëshmia për pagesën e një shërbimi komunal për banesën që gjendet në një shtet tjetër, ndërsa e cila më vonë ka qenë objekt i procedurës për konfiskim. Pas verifikimit të informatës fillestare, ato në vazhdim të procedurës duhet të shfrytëzohen përmes ndihmës ndërkombëtare juridike dhe procedurës gjyqësore në veprën e procedurës për sekuestrimin e pronës.

Praktikuesit, në shumicën e juridiksioneve në rajon, veçanërisht prokurorët dhe trupat për zbatimin e ligjit, që veprojnë në bazë të urdhrin të prokurorit në kuadër të hetimit financiar edhe më tutje ballafaqohen me problemet e qasjes me kohë në regjistrat publik, regjistrat dhe evidencat e tjera të pronës, të ardhurave, obligimeve dhe shpenzimeve, që konsiderueshëm ngadalëson dhe vështirëson përcaktimin e të ardhurave të ligjshme të personave të përfshirë në hetimin financiar, lidhur me pronën që disponon, e cila prima facie është në disbalanc me këto të ardhura. Disa juridiksione, si p.sh. Bosnja e Hercegovina, ende nuk i kanë formuar regjistrat unik të llogarive bankare për personat fizik, me ç'rast veprimi në kuadër të hetimit financiar paraprakisht është jashtëzakonisht i vështirësuar. Gjithashtu, praktikantët flasin se në kuadër të hetimit financiar, vështirë zbulohen disa kategori të pronës (veçanërisht paluajtshmërisë), e cila nuk është regjistruar në regjistrat publik, por paraqet pronë që nuk është regjistruar, që dëshmon se duhet të punohet për formimin e regjistrave gjithëpërfshirës, të azhuruar të pronës dhe të qasshëm për organet e ndjekjes penale.

Shtetet në rajon që tash janë anëtare të Bashkimit Evropian, si Kroacia, këto probleme kanë bërë përpjekje që t'i zvogëlojnë me mundësimin e qasjes direkte dhe/ose të thjeshtëzuar në bazat e të dhënave, të cilat janë relevante për prokurorë për zbatimin e shpejt të hetimit financiar. Në anën tjetër, në këto juridiksione është mundësuar hapja më e thjeshtë e llogarive bankare në vendet e BE-së, por edhe bartjen më të thjeshtë të parave të gatshme në këto shtete, që në mënyrë të konsiderueshme vështirëson zbulimin e pronës, që është përfituar me vepra penale. Problem i veçantë janë transferet bankare përmes internetit, për të cilët prokurorët marrin informata, pasi që janë bartur mjetet. Në këto raste, preventiva është mundësia e vetme që mund të sjellë rezultate, kurse në këtë drejtim rol kyç kanë zyrat kombëtare për parandalimin e shpëlarjes së parave (FIU), si dhe sektori privat, i cili me ligj është i detyruar për vëzhgimin e transaksioneve të dyshimta dhe kontestuese (Departamentet për parandalimin e shpëlarjes së parave në bankat tregtare), të cilat duhet të edukohen që t'i dallojnë transaksionet e dyshimta, që të reagojnë në mënyrë adekuate dhe me kohë lidhur me informimin e institucioneve shtetërore. Kështu lidhja ndërinstitucionale, puna e përbashkët e përfaqësuesve të përfshirë në institucione, janë të rëndësishëm për tejkalimin e këtyre problemeve, veçanërisht me rastin e veprimit në lëndët e ndërlikuara. Veçanërisht është i rëndësishëm bashkëpunimi i prokurorëve me organet tatimore dhe shërbimet e tyre të specializuara, që merren me zbulimin e fshehjeve tatiimore dhe mashtrimeve, që gjithsesi shembull i praktikës së mirë në disa juridiksione në rajon.

Shpeshherë, në kuadër të hetimeve financiare, është e nevojshme të kryhet një ose më shumë ekspertiza, në veçanti me qëllim të përcaktimit të disbalansit në mes të të ardhurave të ligjshme dhe pronës me të cilën disa persona disponojnë.

Legjislacioni rregullon në mënyrë të ngjashme këtë fushë, por analiza e praktikës tregon se kostoja e ekspertizës ndikon dukshëm në efektivitetin e punës së prokurorëve, që punojnë në hetimet financiare. Kjo kryesisht ka të bëjë me një pozicion të drejtë të praktikës gjyqësore, sipas të cilës disproporcioni i pronës mund të provohet vetëm me ekspertizë.

Ndonjëherë, në praktikë, ekspertiza financiare kërkon disa të tjera, për shembull, ekspertizë në art, pasuri të patundshme, automjete etj. Të gjitha këto krijojnë një kosto të konsiderueshëm, dhe për këtë arsye deri në një faktor kufizues në kryerjen e hetimeve financiare.

Në kontekstin e dispozitave të mësipërme të praktikës gjyqësore, janë vërejtur raste që disa fakte të përfshira në dokumentet publike (p.sh. një kontratë shitjeje autentike, dmth e vërtetuar nga noteri, në bazë të të cilave autoritetet tatimore kanë shkurtuar dhe mbledhur taksa etj.) nuk pranojnë, por si rregull, kërkohet një ekspert, ndonëse është e qartë se, për shembull, çmimi i pasurisë së theksuar në këtë marrëveshje është reale në treg. Përsa i përket problemit të ekspertizës, duhet të theksohet edhe problemi i angazhimi (formal) i zyrtarëve tatimor dhe organeve të tjera, që kanë marrë pjesë në hetimet financiare në cilësi të ekspertit, i cili do t'i paraqiste gjetjet gjykatës gjatë hetimit financiar.

Kjo (përsëri) krijon problemin e punës së dyfishtë (punë të përsëritur), për të njëjtat punë dhe kostot që krijohen me angazhimin i një eksperti, i cili në përgjithësi merr përsipër atë që është gjetur gjatë një hetimi financiar.

Edhe në këtë pjesë, standardizimi më i mirë do të ndihmonte dhe do të çonte në konfiskimin më efikas dhe konfiskimin më ekonomik. Në shembullin e Kosovës * mund të shihet tendenca e një ligjvënësi, i cili përmes dispozitës së nenit 148 të Kodit të Procedurës Penale do të mundësonte angazhimin e personave zyrtarë, me qëllim për të kryer analiza financiare, raporti i të cilëve ka karakterin e gjetjeve dhe mendimeve të ekspertëve.

Së fundi, nuk duhet të harrojmë rëndësinë e edukimit profesional të prokurorëve, që kryejnë hetime financiare, si dhe bartësit e tjerë të funksioneve gjyqësore dhe personave gjyqësorë.

Zbatimi i legjislacionit në fuqi, në të gjitha juridiksionet në rajon ende duket të jetë në fillim dhe rezultatet e zbatimit modest duket të jenë vazhdimisht të pranishme. Është padyshim një sfidë për të motivuar prokurorët për të kryer hetime financiare dhe për të propozuar masa të përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore dhe të propozojnë konfiskimin e dobisë pasurore.

5.3.2. Masat e përkohshme të sigurimit

Një nga problemet e identifikuar në praktikë kur është fjala për masat e përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore, ka të bëjë me përfshirjen e palëve të treta. Praktikuesit shpesh bëjnë pyetje para gjykatës, nëse prokurori duhet (në mënyrë të vendosur) të provojë në këtë fazë të procedurës, që prona në fjalë është transferuar palëve të treta, në mënyrë që të pengojnë dhe vështirësojnë konfiskimin e ardhshëm, gjë që përndryshe është standard, që kërkohet për konfiskim të përhershëm. Një problem i tillë ndodh në praktikë, për shembull, në Serbi në kuptim të dispozitave të nenit 25 dhe 26 të ligjit të veçantë, si standarde për konfiskim të përhershëm të pronës së përmendur, nga neni 38, 3. dhe neni. 43 parag. 3. Një nga zgjidhjet e mundshme mund të jetë përmirësimi i rregulloreve në mënyrë të tillë që të parashikojnë detyrimin e këtyre provave, por ndoshta me një nivel më të ulët dyshimi, që duhet të përcaktohet saktësisht në procedurën e sekuestrimit. Për të zbatuar në mënyrë më efektive dispozitat për konfiskimin e përkohshëm (si dhe të përhershëm), do të duhej në Ligj të veçantë (konfiksimi i zgjeruar) të rregullohet më saktë nocioni i pronarit të përgjegjshëm të pronës.

Në përgjithësi është një problem i madh që procedurat penale zgjasin për një kohë të gjatë dhe periudha e sekuestrimit është shumë e gjatë dhe në rastin e aktgjykimit lirues kthehet prona, që shpeshherë shkakton kosto të konsiderueshme, për shkak të ndryshimit të statusit ose shitjes së mundshme (urgjente) të pronës. Përndryshe, çështja e afatit të zgjatjes së masave të përkohshme për sigurimin e dobisë pasurore, korrespondon drejtpërdrejt me standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtën për shfytëzimin e pronës.

Në këtë drejtim, disa shtete, me ndryshimin e legjislacionit, janë përpjekur të zvogëlojnë afatet absolute për kohëzgjatjen e masave për sekuestrimin e dobisë pasurore. Kështu, ligjvënësi në Kroaci përcaktoi që masat e përkohshme të sigurimit, në pajtim me nenin 557 të KPP i RK, deri në

konfirmimin e aktakuzës mund të zgjasë maksimumi dy vjet. Masat e sigurimit të përkohshëm përcaktohen si rregull në kohën e fillimit të hetimit, i cili në rastet komplekse të ZPKKO zgjatë deri në 18 muaj dhe shumë pak aktakuza konfirmohen në kohën e mbetur deri në 2 vjet nga caktimi i masave, gjë që çon në pezullimin e tyre.

Caktimi i sërishëm i masave të përkohshme, për të njëjtin rast, për të njëjtën pronë, në shumicën e rasteve nuk është pranuar nga gjykatat, sipas të cilave zbatimi i të ashtuquajturës “raport financiar” dhe sigurimi i konfiskimit e humbasin qëllimin. Afati i caktuar nuk është aq problematik në raste të rregullta, por në raste komplekse është tepër i shkurtër, që edhe praktika e ka dëshmuar.

5.3.3. Konfiskimi i zgjeruar

Sa i përket përvojës praktike dhe zbatimit të legjislacionit në rajon, shumica e dilemave kanë të bëjnë me konfiskimin e gjerë të dobisë pasurore, të përfituar nëpërmjet veprave penale, gjë që më së shumti kontribuon faktin se bëhet fjalë për një institut ligjor relativisht i ri dhe kompleks, i cili në periudhë të shkurtër është miratuar. Në këtë drejtim, praktika tregon se mund të jetë koha për të rishikuar dispozitat e ligjeve të veçanta, që kryesisht rregullojnë konfiskimin e dobisë pasurore, veçanërisht atyre që përcaktojnë fushën e zbatimit të këtyre ligjeve në lidhje me përfitimin e dobisë me kategori të caktuara të veprave penale.

Është e mundur që në shumicën e legjislacioneve kjo fushë e përcaktuar është shumë e gjerë, megjithëse ekzistojnë arsye të qarta kriminalistike-politike për një veprim të tillë legjislativ, por nga ana tjetër ekziston një shqetësim objektiv, që në këtë mënyrë të pandehurit i vendoset barrë e tepruar (por edhe atyre të lidhur me të), në lidhje me të drejtën konvencionale dhe të të drejtën e mbrojtur kushtetues, për shfrytëzimin e pronës. Para për një rishikimi të tillë të legjislacionit në rajon, gjithsesi duhet të kryhen analiza gjithëpërfshirëse dhe të besueshme, si dhe hulumtime praktike, në mënyrë që të shqyrtohet gjendja reale dhe për këtë të merren vendime, të bazuar në tregues objektiv. Çështja tjetër, për të cilën nuk ka konsensus të plotë në praktikë, lidhet me masën në të cilën zgjidhjet ligjore parashikojnë një afat kohor, në të cilin është e mundur (në mënyrë retroaktive) të shqyrtohet ligjshmëria e përfitimit të pronës, në kuadër të procedurave për konfiskimin e zgjeruar të pronës, respektivisht kufizuese për funksionimit efektiv të prokurorive. Në juridiksione ku ky afat është i përcaktuar në mënyrë të saktë ligjore (Maqedonia Veriore, Kosova*, etj.), ekzistojnë rezerva të caktuara të praktikantëve në lidhje me zgjidhjet e tilla, sepse në këtë mënyrë do të mund të flitet për relativizmin e parimit që askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore, të përfituar nëpërmjet një veprave penale, pa marrë parasysh kur është fituar. Në anën tjetër, në juridiksione ku nuk ka një afat të tillë në ligjet që rregullojnë konfiskimin e zgjeruar (Serbia, BiH, Kroacia etj.), Praktikuesit janë të mendimit se megjithatë duhet të kufizohet periudha kohore për të cilën shqyrtohet prona e të akuzuarit, kundër të cilave zhvillohen procedurat e zgjeruara të konfiskimit. Një pjesë e kësaj çështje përcaktohet saktësisht përmes qëndrimeve të praktikës gjyqësore, që nganjëherë nënkupton se përcaktimi i të ardhurave ligjore të të pandehurit bëhet për tërë jetën e tij të punës (p.sh. Kroaci). Në disa raste, kjo nënkupton verifikimin e rrethanave financiare dhe standardet e jetesës së një familjeje për 30 vjet ose më shumë, që zgjatë në mënyrë të konsiderueshme kohën e hetimit dhe çon në kosto të konsiderueshme të ekspertizës.

Disa juridiksione në ligjet e tyre të veçanta mbi konfiskimin (e zgjeruar) të dobisë pasurore, gjithashtu përcaktojnë afatin për fillimin e procedurës, pas aktgjykimit të plotëfuqshëm denues, të njerrë në procedurën penale. Praktika ka qëndrime të ndryshme për këtë çështje, pasi sigurisht që është mirë që në rastin pas përfundimit të procedurës penale, pasi të ketë mësuar se dyshohet se pandehuri ka pronë, të përfituar me vepër penale, ai mund të fillojë një procedurë të posaçme për konfiskimin e kësaj pasurie. Në anën tjetër, afati ligjor është përcaktuar qartë (p.sh. Kosova * ku është pesë vjet pas aktgjykimit përfundimtar), mund t'i mundësojë të pandehurit që me sukses të fshehë pronën

kontestuese për atë periudhë, dhe pas skadimit të periudhës, ai do të mund të dispononte atë pasuri pa ndonjë pengesë. Gjithashtu, nuk është e qartë se si dhe cili prokuror do të fillojë procedurën dhe do të identifikojë një pronë të tillë, sepse pas një periudhe të gjatë pas një aktgjykimi të plotëfuqishëm penal, është jounksional në gjithë procedurën për konfiskimin e zgjeruar dhe zbulimin e “pasurisë shtesë” të të pandehurit.

Standardet e provave në konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasuror, në praktikën e gjykatave në rajon janë të ndryshme. Në disa raste (p.sh. Mali i Zi), kohëzgjatja e procesit të provave duket si një problem kyç, jo vetëm në shkallë të parë, por edhe gjatë procedurave ankimore, gjë që vë në pikëpyetje tërë kuptimin e këtij instituti. Përveç problemit të kohëzgjatjes së procedurave, juridiksionet e tjera gjithashtu kanë probleme të pranimit provave lidhur me prejardhjen e ligjshme të pronës së kontestuar, në formën e marrëveshjes së huas nga familjarët e të pandehurit, të cilët paraqiten për herë të parë në seancës gjyqësore kryesore dhe të ngjashme. Si rregull, gjykatat shpesh japin mirëbesim dhe pranojnë si dëshmi dokumentet ose dëshmitë e dëshmitarëve të cilët vetëm e bëjnë të besueshëm që prona është prfittuar ligjërisht. Në anën tjetër, ka shumë pak praktikë gjyqësore që do të jepte udhëzime që gjykata e pranon dhe çka nuk pranon si dëshmi, përkatësisht cili standard i provës është i mjaftueshëm që gjykata të konsiderojë një pronë të ligjshme. Në praktikimin e juridiksioneve të caktuara (p.sh. Serbi) lindin probleme që pronarët të dëshmojnë origjinën e pronës, madje edhe me kontrata të pavërtetuara për hua, ose pa marrëveshje, kështu që propozohen dëshmitarë të shumtë, ose pohohet se shumta të mëdha parash janë fituar nga dasma (shembuj të ngjashëm ekzistojnë në Mal të Zi), që përsëri kërkon dëshmi, ndërsa nuk janë përcaktuar me praktikë gjyqësore standardet e qarta për të vërtetuar pretendime e tilla. Ky problem është edhe më i theksuar në rastet kur personat e lidhur me te dëshmojnë prejardhjen ligjore të pronës nga të ardhurat e veta nga paga, burime shtesë, ndihma familjare dhe të ngjashme. Duke pasur parasysh se këta persona nuk janë të pandehur, praktika tregon se pohimet e tyre në lidhje me prejardhjen e ligjshme të pronës në fjalë pranohen në mirëbesim.

Të gjitha këto çështje duhet të rregullohen më qartë dhe më thjeshtë, në kuadër të ligjeve relevante dhe praktikës gjyqësore.

Lidhur me standardet e provës, duhet të merret parasysh praktika relevante gjyqësore (vendore dhe GJEDNJ), veçanërisht të prokurorive. Me siguri do të ishte e dobishme që në kuadër të institucioneve gjyqësore do të caktoheshin personat që do ta vëzhgonin vendimet për një segment të caktuar dhe në seanca do të paraqesin praktikën e mirë, e cila sigurisht do të ishte e dobishme.

VI. LITERATURA

- Baçiq, F. (1998). *E drejta penale: pjesa e përgjithshme*. Zagreb: Informator.
- Bavcon, L. Š. (1996). *E drejta penale: (splošni del)*. Ljubljana: Enti i gazetarisë Gazeta Zyrtae, Republika e Sllovenisë.
- Boucht, J. (2017). *The Limits of Asset Confiscation: On the Legitimacy of Extended Appropriation of Criminal Proceeds*. Oxford; Portland: Hart Publishing.
- Datzer, D. (2016). Hyrje në materjën e konfiskimit të pronës, të përfituar me vepër penale. U E. Mujanović, & D. Datzer, *konfiskimi i pronës, të përfituar me vepër penale: Doracak për përdoruesit* (fq. 19-39). Sarajevë: Qendra për hulumtimin e politikave për kundërshtimin e kriminalitetit.
- Datzer, D. (2017). Aspektet teorike për normimin e formave të veçanta të konfiskimit të dobisë pasurore. U E. Mujanović, & D. Datzer, *Konfiskimii zgjeruar i dobisë pasurore, të përfituar me vepra penale* (faqe 15-36). Sarajevë: Qendra për hulumtimin e politikave për kundërshtimin e kriminalitetit.
- Deronçinović, D. (1999). Natyra juridike e Institutit për konfiskimin e dobisë pasurore dhe domethënia e tij në preventivë kundër krimit të organizuar. *Policia dhe siguria*, 8 (3-4), fq. 161-170.
- European Police Office (Europol). (2016). *Does crime still pay? Criminal Asset Recovery in the EU*. The Hague: Autor.
- Kilchling, M. (2014). Finance-Oriented Strategies of Organized Crime Control. U L. Paoli, *The Oxford Handbook of Organized Crime* (str. 655-674). Oxford: Oxford University Press.
- Martinson, R. (1974). What works? – questions and answers about prison reform. *The Public Interest*, 35, str. 22-54.
- Mujanović, E. (2017). Algoritme për prezantimin e veprimeve për konfiskimin e dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale. U E. Mujanović, *Objektivat për veprimin e institucioneve kompetente në procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale*. (fq. 112-130). Sarajevë, Qendra për hulumtimin e politikave për kundërshtimin e kriminalitetit.
- Mujanović, E., & Sarajlija, S. (2014). Konfiskimi i dobisë pasurore, të përfituar me vepër penale, Bosnjë e Hercegovinë – Në mes të idealit dhe realitetit. Në *Konferencë ndërkombëtare shkencore-profesionale "Ndërtimi i sistemiz modern juridk "*. Përmbledhje e punimeve (fq. 871-896). Sarajevë: International Burch University.
- Mujanović, E., Datzer, D., & Kadribašić, N. (2018). Administrimi me pronën e përfituar me vepër penale në të drejtën ndërkombëtare krahasuese. *Kriminalističke teme*, XVIII (1-2), 71-95.
- Pavishiq, B., Grozdanić, V., & Veić, P. (2007). *Koment i Ligjit Penal*. Zagreb: Narodne novine d.d.
- Vettori, B. (2006). *Tough on Criminal Wealth*. Dordrecht: Springer.
- Këshilli i Evropës. (2007). *Hetimi financiar dhe konfiskimi i pronës, të përfituar në mënyrë të kundërligjshme*. Strasbourg: Autor.



Ky botim është mbështetur nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

RAI

Nisma Rajonale Antikorrupsion (RAI) është një organizatë ndërqeveritare dhe ka nëntë vende anëtare: Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë, Malin e Zi, Rumaninë dhe Serbinë. Polonia, Gjeorgjia dhe Sllovenia janë vende me statusin e vëzhguesit. Misioni i RAI-it është udhëheqja e bashkëpunimit rajonal në mbështetjen e përpjekjeve antikorrupsion duke ofruar një platformë të përbashkët për diskutime përmes këmbimit të njohurive dhe të praktikave më të mira.

Sekretaria e organizatës e ka selinë në Sarajevë, me projekte në mbarë Evropën Juglindore, të cilat në radhë të parë përqendrohen te forcimi i bashkëpunimit rajonal në zbulimin e konfliktit të interesit dhe të pasurisë, legjislacionin për provimin e korrupsionit, vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni, sinjalizimin, zhvillimin e integritetit të agjencive të zbatimit të ligjit dhe forcimin e kapaciteteve kombëtare lidhur me kthimin e pasurisë.

Qendra AIRE

Qendra AIRE është organizatë joqeveritare e cila e promovon ndërgjegjësimin lidhur me të drejtën evropiane dhe ofron ndihmë për viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut. Një ekip juristësh ndërkombëtarë ofron informacion, mbështetje dhe këshilla lidhur me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Ekipi ka përvojë të posaçme në çështjet gjyqësore para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg dhe ka marrë pjesë në më shumë se 150 jështje. Gjatë 20 viteve të fundit, Qendra AIRE ka organizuar dhe ka organizuar shumë seminare në Evropën Qendrore dhe Lindore, nga të cilat kanë përfituar të avokatët, gjyqtarët, zyrtarët e qeverisë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Qendra AIRE është përqendruar në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku për më shumë se një dekadë e gjysmë ka kryer disa programe afatgjata për sundimin e ligjit, në partneritet me institucionet dhe gjykatat kombëtare. Gjatë gjithë këtyre programeve, qëllimi ynë ka qenë përkrahja e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nivel kombëtar, të ndihmuarit e procesit të integritetit evropian duke forcuar sundimin e ligjit dhe njohjen e plotë të të drejtave të njeriut, dhe inkurajimi i bashkëpunimit rajonal midis gjyqtarëve dhe profesionistëve të së drejtës.